



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Spitalin Rajonal
“Memorial” Fier

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
MBI PËRPUTHSHMËRINË

NË

SPITALIN RAJONAL “MEMORIAL” FIER

TIRANË DHJETOR 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-8
1.	Përshkrim i shkurtër i rezultateve të auditimit	3-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-6
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	7-8
II.	HYRJA	8-12
1.	Objektivat dhe qëllimi	8
2.	Identifikimi i çështjes	8
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
4.	Përgjegjësitë e audituesve	9
5.	Kriteret e vlerësimit	9-10
6.	Standardet e auditimit	10
7.	Metodat e auditimit	10-12
8.	Dokumentimi i auditimit	12
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12-113
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	12-13
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejttimeve të auditimit	13-113
2.1	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.	13-18
2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe shpenzimet administrative.	18-41
2.3	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave.	41-51
2.4	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit.	51-61
2.5	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave të mallrave shërbimeve dhe punimeve civile.	61-90
2.6	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave.	91-94
2.7	Mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, funksionimi i strukturës së Auditit të Brendshëm.	95-113
IV.	REKOMANDIME	113-129

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Spitali Rajonal “Memorial” Fier është institucion publik, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit nr.9106, datë 17.07.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë; i ndryshuar me ligjin nr. 55/2022, “Për shërbimin spitalor”.

Spitali Rajonal “Memorial” Fier, ushtron veprimtarinë e tij në bazë të legjislacionit në fushën e shërbimit spitalor dhe bazuar në Marrëveshjen e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, të ratifikuar me ligjin nr.23/2021, datë 22.02.2021, VKM nr.175, datë 17.03.2021 “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e spitalit Rajonal “Memorial” Fier”, i ndryshuar, dhe VKM nr.687, date 26.10.2022 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, si aplikues i autonomisë spitalore menaxheriale” pjesë e skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

Spitali Rajonal “Memorial” Fier, është institucion i shërbimit shëndetësor publik, jofitimprurës, qendër e nivelit tercial që ofron shërbime të specializuara në nivel rajonal në diagnostikim, mjekim dhe kërkim shkencor, sipas përcaktimeve në sistemin e referimit, bazuar në urdhrin e Ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Spitali është dhuratë e qeverisë së Republikës së Turqisë dhe ka një bashkëpunim funksional me palën turke për një periudhë minimum 3 vjet.

Bashkëpunimi për funksionimin e spitalit është përcaktuar në Marrëveshjet dhe protokollin e lidhur me palën turke sipas protokollit të bashkëpunimit të lidhur ndërmjet dy ministrave përkatës për shëndetësinë, miratuar me VKM nr.660, datë 03.11.2021 “Për miratimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, gjatë fazës kalimtare”.

Struktura është miratuar nga Ministri i Shëndetësisë, e cila ka të përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të planifikuar sipas organigramës përkatëse.

Spitali Rajonal “Memorial” Fier, i shërben pacientëve të rajonit të Jugut, qarkut Fier, Vlorë e Gjirokastrë. Ekipi i këtij Spitali përbëhet nga mjekë të specializuar nga Turqia dhe Shqipëria. Spitali kryen aktivitetin në bazë të legjislacionit të mësipërm, Rregullores së Brendshme dhe Statutit.

-Objekti i veprimtarisë së spitalit, është të ofrojë shërbime të specializuara për qytetarët dhe të reduktojë ndjeshëm nevojën e pacientëve për të udhëtuar jashtë vendit për trajtime dhe ndërhyrje specifike si edhe një pol i shërbimit të integruar shëndetësor dhe një qendër e transferimit të dijeve kërkimore dhe ndërhyrjeve me teknologji të avancuar. Spitali është i pajisur me 6 salla operacioni ku do të kryhen ndërhyrje komplekse kirurgjikale me metoda mini-invazive, neurokirurgjikale, kirurgji torakale, kirurgji vaskulare, endoskopi intervencionuese, ndërhyrje me bronkoskop, ndërhyrje ortopedike nëpërmjet C-ARM dhe trajtimin e politraumave.

-Misioni i Spitalit Rajonal Memorial Fier, është të siguroj një shërbim spitalor cilësor dhe të përgjegjshëm për pacientët me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë komunitetin e jugut. Spitali Rajonal “Memorial” Fier është një institucion i nivelit terciar mjekësor i përkushtuar për të ofruar kujdes cilësor për pacientët, vëmendje të pareshtur për përsosmëri klinike, siguri shëndetësore ndaj pacientit dhe një pasion dhe angazhim për të siguruar kujdes më të mirë shëndetësor.

-Vizioni i Spitalit Rajonal Memorial Fier është të vendosë standardet në shekullin e ri për shëndetin, trajtimin dhe rehabilitimin. Të drejtojë rajonin e Jugut si një ekip Turko - Shqiptar duke tejkalluar pritjet e pacientëve përmes avancimit të shërbimeve cilësore. Të dallojë veten si një lider në ripërcaktimin e ofrimit të kujdesit shëndetësor dhe të njihet për modelin e autonomisë spitalore me pasionin për njerëzit dhe partnerët e tij në ofrimin e cilësisë, garancisë dhe kujdesit inovativ për pacientët.

Auditimi në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Është audituar aktiviteti ekonomik-financiar për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar organizimi i spitalit, shpenzime për investime, shpenzimet operative, strukturat dhe pagat, buxheti dhe realizimi i tij, etj. Është audituar vendimmarrja e organeve drejtuese, si edhe probleme të tjera.

Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me mangësi në dokumentacionin bankar, zbatimin e kontratave, etj.

Nga auditimi janë konstatuar mangësi kryesisht në zbatimin të kontratave, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të veçanta/kualifikim në procedurat e prokurimit. Janë konstatuar mangësi në implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe ngritjen e funksionimit të auditit të brendshëm. Janë konstatuar mangësi në evidentimin dhe menaxhimin e asetëve kryesisht të pajisjeve kompjuterike dhe pajisje mjekësore. Në hartimin e Projekt Buxheteve nuk janë identifikuar nevojat dhe nuk janë paraqitur kërkesat nga departamentet sipas strukturës organizative, nuk ka shkresa të përgjegjësve të sektorëve apo shërbimeve dërguar grupit punës për hartimin e projekt buxhetit, etj.

Janë rekomanduar masa për përmirësimin e procesit të prokurimit, si për sa i përket përlllogaritjes së fondit limit, ashtu edhe në hartimin e dokumenteve të tenderit, apo vlerësimin e ofertave.

2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

- Regjistrime jo korrekte në ditarin e magazinës duke pasqyruar gjendjen jo reale të inventarëve

dhe dhënien jo korrekte të evidencave dhe regjistrave. Në Pasqyrat Financiare të vitit 2021 llogaria 218 “Inventar ekonomik” me vlerën 55,377,721 lekë nuk paraqitet me shumat reale. Nga dokumentacionin vërtetues konstatohet se nuk janë regjistruar në regjistrin e aktiveve disa aktive

- Nga regjistri i mbetjeve spitalore sasia e administruar që prej përfundimit të marrëveshjes kuadër të 2023 për periudhën 01.04.2024-15.07.2024 është 6594 kg, nga verifikimi në terren i grumbullimit dhe administrimit të tyre, nuk është kryer ndarja sipas llojit dhe kategorisë përkatëse. Spitali Rajonal Memorial Fier në cilësinë e prodhuesit të mbetjeve spitalore, ka grumbulluar dhe ka magazinuar mbetjet infektive spitalore duke tejkaluar afatin ligjor prej 45 ditë.

- Spitali Rajonal Memorial Fier për 3 shërbimet kryesore të mbarëvajtjes spitalore dhe në funksion të pacientëve të hospitalizuar për një periudhë 4 muaj, nuk ka ofruar Shërbimin e lavanderisë, Shërbimin e trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore dhe Shërbimin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, për të cilat nuk janë realizuar procedurat e prokurimit.

- Në hartimin e Pasqyrave të PBA (2024-2026) dhe relacionin sqarues për planifikimin e shpenzimeve dhe të ardhurave, nuk janë paraqitur kërkesat reale buxhetore sipas Drejtorive/departamentet/pavioneve. Në zbatimin e buxhetit janë konstatuar tejkalime shpenzimesh, janë kryer shpenzime për investime me fonde buxhetore dhe nga të ardhurat e krijuara pa miratim nga Bordi Drejtues. Grupi i auditimit konstatoi se me financimin e FSDKSH janë blerë pajisje kompjuterike dhe mjekësore.videncat e shpenzimeve dhe të ardhurave nuk rakordojnë me shpenzimet e konstatuara në ditarin e bankës dhe arkës.Janë lidhur kontrata pa pasur fonde në dispozicion.

- Në Pasqyrat Financiare janë konstatuar mangësi në regjistrimin e të dhënave kontabile për llogaritë e të ardhurave, të shpenzimeve për paga dhe shpërbime, të sigurimeve shoqërore e shëndetsore, në kontabilitet nuk perputhen me të dhënat sipas dokumenteve vërtetues, ku të ardhurat e krijuara nuk janë regjistruar mbi bazën e metodës së detyrimeve dhe të drejtave të konstatuara.

- Në procedurën e prokurimit “*Shërbimi i Lavanderisë*”, grupi punës për llogaritjen e fondit limit është bazur në kontratat e ngjashme të realizuara nga Autoritete Kontraktore të tjera. Konkretisht AK i është referuar kontratës së shërbimit nr.3983/3 prot., datë 19.08.2015 e QSU “Nënë Tereza” Tiranë dhe jo kontratës aktuale të shërbimit, me një diferencë me vlerën e përlllogaritur prej **315,299 lekë** mbi fondin limit.

- Spitali Rajonal “Memorial” Fier ka kryer pagesë për personelin turk në vlerën 1,000 lekë/dita për shërbim ushqimi në total **9,310,000 lekë** për periudhën 01.05.2022-31.12.2022.

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore”, rezultoi se, vlera e fondit limit nga 10,689,340 lekë pa TVSH e llogaritur në procedurën e anuluar është prokuruar pas një periudhë rreth 3 muaj në vlerën 13,705,188 lekë pa TVSH, e cila nuk është argumentuar nga grupi i punës për llogaritjen e vlerës së kontratës. Pra vlera **3,015,848 lekë** pa TVSH ka sjellë efekt financiar negativ për buxhetin e SRMF.

- Nga auditimi i kryer për shpenzimet e karburantit për vitet 2021-2023, u konstatuan mangësi në evidentimin e lëvizjeve të tyre, si në dokumentet autorizues edhe në dokumentet justifikues, nuk janë nënshkruar nga personat përgjegjës dhe drejtuesit e mjeteve fletë udhëtimet, urdhrat e punës, etj. Evidentohen sipas normativave të konsumit dhe distancave/km të përshkruar tejkalime të pajustikuara në sasinë e karburantit për 10599 litra si edhe 1700 litra diferencë e konsumit të karburantit për makinat e marra me qira të cilat janë deklaruar si të reja por në fakt janë të përdorura dhe normativa faktike është më e lartë, si rrjedhojë është shkaktuar dëm ekonomik për SRMF në shumën **2,123,085 lekë**.

➤ **Paraqitja e rekomandimeve kryesore:** Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Drejtoria e Financës dhe e Shërbimeve të Përgjithshme të ngrejë grupin për inventarizimin dhe për vlerësimin e pajisjeve të cilat nuk kanë çmime, të analizojë efektin negativ, të sistemojë kontabilizojë vlerat përkatëse dhe ti pasqyrojë këto ndryshime në regjistrin e aktiveve në ditarët e magazinës, në kartelat e punonjësve për aktivet që janë në përdorim si dhe në Pasqyrat Financiare.

- SMRF të marrë masa për ngritjen e grupit të administrimit të mbetjeve spitalore (GAMS) brenda afateve, me qëllim zbatimin me efikasitet dhe efektivitet të Planit të Administrimit të Mbetjeve, si edhe hartimin dhe zbatimin e një programi për uljen e vëllimit, të sasisë dhe toksicitetit të mbetjeve të rrezikshme, me qëllim uljen e ndikimit në mjedis dhe shëndetin publik.

- Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve të marrë masa për kryerjen brenda afateve kohore të procedurave të prokurimit me qëllim ofrimin pa ndërprerje të shërbimeve kryesore ndaj pacientëve.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik i SRMF të marrë masa që strukturat që do të merren me programimin e Planifikimit buxhetor afatmesëm, të kryejnë analiza të hollësishme të treguesve të buxhetit, me qëllim eliminimin e ndryshimeve të konsiderueshme të buxhetit gjatë vitit ushtrimor.

- Drejtoria e Financës dhe e Shërbimeve të Përgjithshme të marrë në konsideratë kërkesat reale buxhetore sipas Drejtorive/departamentet/pavioneve për hartimin e treguesve buxhetor afatmesëm PBA. Për të gjitha ndryshimet e konstatuara të njoftohet Bordi Drejtues dhe të merret miratimi i tij. Të bëhet kontabilizimi i transaksioneve të kryera me bankë.

- Drejtoria e Financës dhe e Shërbimeve të Përgjithshme të analizojë vlerat me diferenca, të kryej sistemimet në llogaritë kontabile, të nxjerrë përgjegjësitë lidhur me pasaktësitë e krijuara dhe të pasqyrohen ndryshimet në Pasqyrat Financiare të vitit 2024.

- Autoriteti kontraktor, në këtë rast SRMF në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës duhet ti referohet një ose me shumë alternativave, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut, të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes të sa më shumë operatorëve ekonomikë dhe të sigurojë realizimin e prokurimit me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet.

- Bordi Drejtues, Drejtori i përgjithshëm të marrë në analizë efektin negativ të shkaktuar në vlerën **9,310,000 lekë**, përfituar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi si dhe të marrë masa për ndërprejen e këtij shpenzimi.
- Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës të analizojë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për dëmin ekonomik të shkaktuar në shumën **2,123,085 lekë**, dhe të ndjekë rrugët ligjore për arkëtimin e kësaj shume nga personat përgjegjës.

3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionin i auditimit

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, për periudhën nga data 13.05.2021-31.12.2023 sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së ligjeve, vendimeve, rregulloreve, udhëzimeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) vlerësimit të përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret, duke përfshirë auditimin e sistemeve financiare dhe transaksioneve, b) auditimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik; c) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, d) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike

Opinion i modifikuar, kualifikuar¹

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së SRMF me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “*Bazës për Opinionin*”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionin të kualifikuar/modifikuar**.

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Konkluzionet dhe opinionin ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga SRMF, e cila konsiderohet nga ana jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme.

Parregullsitë janë të shoqëruara me efekte financiare për buxhetin e shtetit, ku janë kërkuar **3,338,561 lekë dëmshpërblim dhe 28,857,448 lekë shpenzime pa efektivitet dhe pa eficencë**.

Kanë rezultuar parregullsi në fushën e prokurimeve, në regjistrimin dhe inventarizimin e pasurisë, në kontabilizimin e llogarive bankare, në procedurat e ndjekura për zbatimin e buxhetit dhe cilësinë e auditit të brendshëm, etj.

Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionin me siguri të arsyeshme.

Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, ISSAI 1500 (ISA 500) dhe ISSAI 1530 (ISA 530); Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit në përputhje me

¹ *Opinionin i modifikuar/ i kualifikuar: Audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: Anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në lidhje me kriteret e aplikuara*

kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit, kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në këtë auditim përputhshmërie.

Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim kryerjen e një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinionit të gabuar rreth objektivit të auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 610/1, datë 09.05.2024, i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 13.05.2024 deri në datë 02.08.2024, në subjektin Spitali Rajonal “Memorial” Fier, për periudhën nga data e krijimit të institucionit deri në datë 31.12.2023, u krye auditimi “Mbi Përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike-financiare” nga Grupi i Auditimit, me përbërje:

1. M. B, Përgjegjës Grupi
2. I.B
3. A.S
4. R.F
5. A.H

1. Objektivat dhe qëllimi Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse Spitali Rajonal “Memorial” Fier, në të gjithë aspektet materiale, aktivitet ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse, me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, kornizën ligjore të prokurimit publik, si edhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së tij. Auditimi ka për qëllim promovimin e transparencës, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar, siç kërkohet në aktet ligjore. Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuarra i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, është dhënia e opinionit apo hartimi i Raportit Përfundimtar të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar. Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin shëndetësor, duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*). Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.

2. Identifikimi i çështjes Institucioni shëndetësor duhet të ketë organizimin e duhur për të funksionuar duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, efijencë dhe efektivitet. Projekt Raporti mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Spitalit “Memorial” Fier, për periudhën e audituar, ka identifikuar sipas kriterëve specifikë të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- Ligjshmërinë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese dhe vendimeve të marra;
- Hartimin, shqyrtimin, miratimin si edhe realizimin e buxhetit;
- Zbatimin e strukturës organizative dhe administrimin e marrëdhënieve të punës;
- Rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve;
- Mbajtjen e evidencës kontabile dhe analiza e debitorëve e kreditorëve;
- Zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave;
- Funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm, etj.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Një ndër përgjegjësitë kryesore të strukturave drejtuese është ngritja e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime korruptive të punonjësve. Hartimi i rregullave të brendshme referuar funksionit të veprimtarisë së spitalit, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi në zbatim të akteve ligjore në fuqi, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit. Përgjegjësi e strukturave drejtuese të institucionit është përdorimi me efektivitet dhe ligjor të fondeve, duke eliminuar shpenzimet jo efektive dhe jo në funksion të veprimtarisë tij, sigurisht edhe marrja e masave për njohjen e akteve ligjore që veprojnë dhe janë në fuqi për të gjithë punonjësit e strukturës funksionale duke programuar trajnimin e vazhdueshëm dhe mbikëqyrur integritetin e tyre.

Në zbatim të dispozitave ligjore, institucioni, merr masa për:

- të siguruar një shërbim cilësor dhe të përgjegjshëm për pacientët me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës për komunitetin e jugut.
- të siguruar përsosmëri të kujdesit shëndetësor përmes kujdesit shëndetësor me në qendër pacientin.
- Përmirësimin financiar dhe operacional spitalor përmes autonomisë në burime njerëzore, financiare, prokurimeve dhe menaxhimit.
- zgjerimin e shërbimeve përmes avancimit të teknologjisë dhe kërkimit mjekësor.
- të siguruar qasje në cilësi të lartë të kujdesit shëndetësor spitalor të integruar dhe zgjerimin e aksesit për komunitetin e jugut
- të siguruar përsosmëri të shërbimeve dhe vazhdueshmërinë e përmirësimit të performancës spitalore, si një ofrues i vetëm i shërbimeve universitare për rajonin e jugut
- Zbatimin e dispozitave të vendosura në Kontratën e Punës, etj.

4. Përgjegjësitë e audituesve Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion të saktë objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen ose jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë ekonomiko financiare, në bazë të auditimit tonë. Ne mbajmë përgjegjësi që në praktikën e auditimit si dhe në hartimin e P/Raportit Përfundimtar të auditimit janë zbatuar procedurat në përputhje me rregulloret e miratuara dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Referuar këtyre Standardeve audituesi gjithashtu duhet të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar. Siguria e kërkuar i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

5. Kriteret e vlerësimit Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë dhe detyrësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit: ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për Sponsorizimet”, i ndryshuar, ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 8510, datë 15.07.1999

“Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar, ligji nr.9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në RSH”, i ndryshuar, ligji nr.105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, ligj nr.23/2021 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë”, VKM nr.175, datë 17.03.2021 “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e spitalit rajonal “Memorial” Fier, ndryshuar me VKM nr.258, datë 05.05.2021 dhe VKM nr.867, datë 29.12.2021, VKM nr.58, datë 26.01.2022 “Për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, gjatë fazës kalimtare, VKM nr.687, datë 26.10.2022 “Për mënyrën e organizimit dhe organizimit të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, si aplikues i autonomisë spitalore menaxheriale”, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, VKM nr.234, datë 20.04.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme dhe disa institucioneve të administratës publike”, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr.559, datë 26.10.2009 “Për aplikimin e tarifave të shërbimeve mjekësore”, Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr.182/3, datë 07.05.2021 “Për miratimin e statutit”, etj.

6. Standardet e auditimit Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ISSAI 100 – (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik).
- ISSAI 400 – (Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë).
- Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme.
- ISSAI 4000- Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; si dhe në praktikat më të mira të fushës.

7. Metodat e auditimit Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e Shoqërisë, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt-Raporti.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të

realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, dhe Publikimi i Auditimit.

- Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara nuk kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumenter, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

- Kontrolli i vlerësimeve

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- Konfirmimi nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, mangësi në nënshkrime, etj.

- Intervista

U kryen intervista me specialistët e institucionit me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

- Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim

- Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon $KLSH\text{-}ja^2$.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e

² Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirëinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

8. Dokumentimi i auditimit është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore.

Projekt-Raporti i auditimit është i strukturuar në 5 kapituj. Në kapitullin e parë të përmbledhjes ekzekutive janë trajtuar çështjet e rezultateve të auditimit, gjetjet rekomandimet kryesore dhe konkluzioni e opinionit i auditimit, në kapitullin e dytë janë trajtuar objektivat dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve, metodat, etj. Në vijim në kapitullin e tretë është përshkrimi i auditimit, në të cilin trajtohet një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 7 drejtimeve të auditimit. Në kapitullin e katërt jepen rekomandimet, bazuar në rezultatet e auditimit gjetjet dhe rekomandimet të strukturuar sipas llojit të tyre, është vendosur në kapitullin e pestë lista e dokumenteve.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Spitali Rajonal “Memorial” Fier, është krijuar bazuar në Marrëveshjen e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së republikës së Turqisë, të ratifikuar me ligjin nr.23/2021 dhe ushtron veprimtarinë e tij në bazë të legjislacionit në fushën e shërbimit spitalor dhe pjesë e skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

Spitali Rajonal “Memorial” Fier, është institucion i shërbimit shëndetësor publik, jofitimprurës, qendër e nivelit tercial që ofron shërbime të specializuara në nivel rajonal në diagnostikim, mjekim

dhe kërkim shkencor, sipas përcaktimeve në sistemin e referimit bazuar në urdhrin e Ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Spitali është dhuratë e qeverisë së Republikës së Turqisë dhe ka një bashkëpunim funksional me palën turke për një periudhë minimum 3 vjet.

Bashkëpunimi për funksionimin e spitalit është përcaktuar në Marrëveshjet dhe protokollin e lidhur me palën turke sipas protokollit të bashkëpunimit të lidhur ndërmjet dy ministrave përkatës për shëndetësinë, miratuar me VKM nr.58, datë 26.01.2022 “Për miratimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, gjatë fazës kalimtare”.

-Objekti i veprimtarisë së Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, është të ofrojë shërbime të specializuara për qytetarët dhe të reduktojë ndjeshëm nevojën e pacientëve për të udhëtuar jashtë vendit për trajtime dhe ndërhyrje specifike si edhe një pol i shërbimit të integruar shëndetësor dhe një qendër e transferimit të dijeve kërkimore dhe ndërhyrjeve me teknologji të avancuar;

Auditimi në këtë institucion, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar organizimi i spitalit, shpenzime për investime, shpenzimet operative, strukturat dhe pagat, buxheti dhe realizimi i tij, vendimmarrja e organeve drejtuese, si edhe probleme të tjera.

Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E në fushën e prokurimeve, zbatimin e kontratave, në strukturën organizative dhe pagat, mangësi në dokumentacionin bankar dhe financiar, etj.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

1. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Në lidhje me funksionimin e strukturave drejtuese, u shqyrtua dokumentecioni si më poshtë:

- Dokumentacioni i mbajtur për organizimin e mbledhjeve të Bordit drejtues.
- Statuti i Spitalit “Memorial” Fier.
- Rregullorja e brendshme e Spitalit
- Relacionet e drejtorisë për miratim në Bordin Drejtues
- Vendimet e Bordit për periudhën 2021-2023
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e SRM, Fier, etj.

Spitali rajonal “Memorial” Fier, ushtron veprimtarinë e tij në bazë të legjislacionit në fushën e shërbimit spitalor në bazë të legjislacionit në fushën e shërbimit spitalor dhe bazuar në Marrëveshjen e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së republikës së Turqisë, të ratifikuar me ligjin nr.23/2021, pjesë e skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

Spitali Rajonal “Memorial” Fier, është institucion i shërbimit shëndetësor publik, jofitimprurës, qendër e nivelit tercial që ofron shërbime të specializuara në nivel rajonal në diagnostikim, mjekim

dhe kërkim shkencor, sipas përcaktimeve në sistemin e referimit bazuar në urdhrin e Ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Spitali është dhuratë e qeverisë së Republikës së Turqisë dhe ka një bashkëpunim funksional me palën turke për një periudhë minimum 3 vjet.

Bashkëpunimi për funksionimin e spitalit është përcaktuar në Marrëveshjet dhe protokollin e lidhur me palën turke sipas protokollit të bashkëpunimit të lidhur ndërmjet dy ministrave përkatës për shëndetësinë, miratuar me VKM nr.58, date 26.01.2022 “Për miratimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, gjatë fazës kalimtare”.

Organet drejtuese të spitalit janë:

-Bordi drejtues i spitalit rajonal “Memorial” Fier, si organi më i lartë ekzekutiv, i cili është i pavarur

në veprimtarinë e tij dhe funksionon si organ kolegjal.

-Drejtori i përgjithshëm i spitalit.

-Komisioni Mjekësor.

-Bordi drejtues, kryesohet nga përfaqësuesi i Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe ka në përbërje:

1 përfaqësues nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor

1 përfaqësues të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

1 përfaqësues të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

1 përfaqësues të Urdhrit të Mjekut

Periudha e përfaqësimit në Bordin drejtues është 3 vjet. Anëtarët e Bordit kanë të drejtë rizgjedhje jo më shumë se 2 herë radhë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

- ***Viti 2021***

Bordi drejtues përbëhet nga M. Xh, A. A, M. C, F.B dhe B.Q. Bordi është ngritur dhe ushtron detyrën bazuar në urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr.182, datë 25.03.2021 “Për ngritjen e Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier”. Me urdhrin nr.451, datë 25.10.2021 “Për një ndryshim në urdhrin nr.182, datë 25.03.2021” është caktuar znj.E. T Kryetar i Bordit.

Bordi drejtues i Spitalit Memorial, Fier për vitet 2021-2022 ka marrë nga 10 vendime për secilin vit dhe për vitin 2023 ka marrë 7 vendime, si më poshtë:

Vendimet	Objekti
Nr.1, dt.25.03.2021	Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Spitalit Rajonal “Memorial” Fier
Nr.2, dt.07.05.2021	Miratimin e Statutit të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier
Nr.3 dt.07.05.2021	Miratimin e Buxhetit për Spitalin Rajonal “Memorial” Fier 2021
Nr.4 dt.07.05.2021	Caktimin e sekretarit të Bordit Drejtues për Spitalin Rajonal “Memorial” Fier
Nr.5 dt.21.09.2021	Miratimin e Kontratës Tip për personelin Shqiptar dhe Turk.
Nr.6 dt.21.09.2021	Ndryshime në Strukturë dhe organikën e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier.
Nr.7 dt.21.09.2021	Miratimin e të ardhurave dytësore të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier.
Nr.8 dt.21.09.2021	Miratimin e shpenzimeve të Drejtorit të Spitalit që ndodhet larg vendbanimit të tij.
Nr.9 dt.21.10.2021	Ndryshimet e shpenzimeve të Drejtorit të Spitalit që ndodhet larg vendbanimit të tij.
Nr.10, dt.26.11.2021	Propozimin e rishikimit të Shpërblimit të personelit Turk pranë Spitalit Rajonal “Memorial” Fier.

Janë zhvilluar 3 mbledhje dhe janë marrë 10 vendime.

-Në mbledhjen e datës 25.03.2021, është marrë 1 vendim

-Në mbledhjen e datës 07.05.2021, janë marrë 3 vendime

-Në mbledhjen e datës 21.09.2021, janë marrë 5 vendime dhe 1 vendim qarkullues.

-Në mbledhjen e datës 25.03.2021, është marrë vendimi Nr.1, dt.25.03.2021 për miratimin e strukturës dhe organikës së Spitalit memorial, Fier, konstatohet se mbledhja dhe propozimi për miratimin e strukturës janë në të njëjtën datë. Mungon njoftimi për mbledhje, në kundërshtim me nenin 7 të statutit të Spitalit “Memorial” Fier ku citohet se “Njoftimet sipas nenit 7 bëhen 3-7 ditë përpara duke bërë të ditur rendin e ditës”.

-Në mbledhjen e datës 07.05.2021, janë marrë 3 vendime

Me vendimin Nr.2, dt.07.05.2021 me objekt “Miratimin e Statutit të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier”, nga Bordi i Administrimit është miratuar Statuti si edhe pagesa/mbledhje që përfitojnë anëtarët e Bordit të Administrimit.

Në nenin 8, përcaktohet se “Bordi drejtues mbledhet minimalisht 4 herë në vit, dhe kur kërkohet nga drejtori i spitalit”.

Në nenin 11, përcaktohet se “Anëtarët e Bordit drejtues për pjesëmarrje në çdo mbledhje, marrin shpërblim në masën 15% të pagës së drejtorit të përgjithshëm të spitalit. Kryetari merr shpërblim në masën 20% të pagës së drejtorit të përgjithshëm të spitalit”. Sekretari i Bordit ka një pagesë 5000 lekë/mbledhje”.

Nga auditimi i pagesave të kryera për Kryetarin dhe anëtarët e Bordit Drejtues rezulton se pagesat e përcaktuara/mbledhje janë caktuar dhe miratuar nga vetë anëtarët e tij dhe nëse zhvillohen minimalisht 4 mbledhje shuma e pagesës për çdo anëtar Bordi është thujse e barabartë me pagën mujore të Drejtorit të Përgjithshëm, po kështu në llogaritjen e vlerës prej 20%/mbledhje për kryetarin e Bordit dhe 15%/mbledhje për anëtarët në raport me pagën e Drejtorit të Përgjithshëm, në caktimin e këtyre raporteve nuk janë respektuar elementët e pagës sepse llogaritjet janë kryer mbi pagën bruto duke zbritur vetëm shumën për vjetërsinë në punë dhe nuk është zbritur shuma e shtesës mbi pagë për kushte pune.

Me vendimin Nr.3, dt.07.05.2021, miratuar Buxheti për Spitalin Rajonal “Memorial” Fier 2021

Me vendimin Nr.4, dt 07.05.2021 është miratuar caktimi i sekretarit të Bordit Drejtues.

Po kështu konstatohet se mbledhja është zhvilluar në datën 07.05.2021, në të njëjtën datë është dërguar edhe propozimi i tematikave të mbledhjes nga drejtoria. Mungon njoftimi për mbledhjen e Bordit, në kundërshtim me nenin 7, të statutit të Spitalit “Memorial” Fier, ku citohet se “Njoftimet sipas nenit 7 bëhen 3-7 ditë përpara duke bërë të ditur rendin e ditës”.

-Në mbledhjen e datës 21.09.2021, janë marrë 4 vendime

Me vendimin Nr.5, dt 21.09.2021 është miratuar Kontrata Tip për personelin Shqiptar dhe Turk

Me vendimin Nr.6, dt 21.09.2021, miratuar Ndryshime në Strukturë dhe organikën e Spitalit
Me vendimin Nr.7, dt 21.09.2021, miratuar të ardhurat dytësore të Spitalit Rajonal “Memorial”
Fier.

Me vendimin Nr.8, dt 21.09.2021, miratimi shpenzimeve të Drejtorit të Spitalit që ndodhet larg
vendbanimit të tij.

-Në vendimin nr.9, datë 21.10.2021, (vendim qarkullues) Bordi ka vendosur ndryshimin e nenit
8, 11 dhe 12 të statutit

Neni 8, përcaktohet se “Bordi drejtues mbliidhet kur kërkohet nga drejtori i përgjithshëm i
spitalit ose edhe nga 1 prej anëtarëve të bordit”.

Neni 11, përcaktohet se “Kryetari dhe Anëtarët e Bordit drejtues të spitalit për pjesëmarrje në
çdo mbledhje, marrin shpërblim në masën 7000 lekë. Sekretari i Bordit ka një pagesë 3000
lekë/mbledhje”. Veprime në kundërshtim me VKM nr.656, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin
e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave bordeve, komisioneve të përhershme të njësive
të qeverisjes qendrore”, i ndryshuar.

Me urdhër nr.453, datë 25.10.2021, të ministrit të shëndetësisë “Për disa ndryshime në urdhrin
nr.182/3, datë 07.05.2021“Për miratimin e statutit të spitalit “Memorial”, Fier”

Në mbështetje të nenit 102/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë urdhëroj ndryshimet
në statut ku janë ndryshuar nenet 8, 11 dhe 12

Në nenin 102/4 të Kushtetutës përcaktohet se: Ministri, brenda drejtimeve kryesore të
politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në
kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime

Megjithëse Ministri nxjerr urdhra dhe udhëzime, në këtë rast urdhri bie në kundërshtim me
VKM nr.656, datë 31.10.2018, i ndryshuar, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të
anëtarëve të këshillave bordeve, komisioneve të përhershme të njësive të njësive të qeverisjes
qendrore”

-Referuar VKM nr.687, datë 26.10.2022 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të
spitalit rajonal “Memorial”, Fier si aplikues i autonomisë spitalore menaxheriale” neni 13 ku
përcaktohet se: “Anëtarët e bordit marrin shpërblim për pjesëmarrje në mbledhje, sipas
përcaktimeve në Vendimet e Këshillit të Ministrave për përcaktimin e masës së shpërblimit të
anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes
qendrore”

-Në vendimin nr.10, datë 26.11.2021, (vendim qarkullues) për rishikimin e pagave të personelit
turk.

Relacioni mbi masën e shpërblimit të personelit të caktuar nga pala turke datë 25.11.2021,
paraqitur nga drejtorja e spitalit ku kërkohet ndryshimi i pagës dhe shpërblimit të personelit
turk, ku konstatohen diferenca midis pagës neto dhe pagës bruto të diskutuar dhe
mirëpërcaktuar në protokollin midis 2 shteteve turke dhe shqiptare sipas pozicioneve të punës.
Këto ndryshime kanë lindur si rrjedhojë e aplikimit të % së ndalesave për sigurimet shoqërore
dhe shëndetësore dhe % që mbahet për tatim fitim. Nëpërmjet relacionit është kërkuar rishikimi
i pagës dhe shpërblimit sipas VKM nr.555, datë 11.08.2011 me qëllim që paga në total pas
ndalesave të përcaktuara në legjislacion të jetë e barazuar me masën e shpërblimit të propozuar
në protokollin e palës turke.

Bordi drejtues ka marrë vendimin nr.10, datë 26.11.2021, vetëm 1 ditë pas paraqitjes së
relacionit pa pasur në dispozicion kohën e nevojshme për vendimmarrje e cila shoqërohet me
një efekt financiar në shumën 45,111,200 lekë.

➤ **Viti 2022**

Bordi drejtues për vitin 2022 përbëhet nga M. R, A. A, M. C, F. B dhe B.Q. Zj.M. R ka
zvendësuar zj.M. Xh, sipas urdhrit nr.102, datë 11.02.2022, të Ministrit të Shëndetësisë dhe
Mbrojtjes Sociale.

Vendimet	Objekti
Nr.1 dt.15.03.2022	Miratimin e Buxhetit për Spitalin Rajonal “Memorial” Fier per vitin 2022.
Nr.2 dt.15.03.2022	Miratimin e mënyrës së përdorimit të të ardhurave dytësore të Spitalit
Nr.3 dt.15.03.2022	Për ngritjen e Bordit të Burimeve Njerëzore pranë Spitalit Rajonal “Memorial” Fier .
Nr.4 dt.15.03.2022	Miratimin e Kontrates Tip për personelin Turk.
Nr.5 dt.15.07.2022	Rishpërndarje të zërave të Buxhetit Vjetor 2022 të Spitalit Rajonal Memorial Fier
Nr.6 dt.11.10.2022	Rishpërndarje të zërave të Buxhetit Vjetor 2022 të Spitalit Rajonal Memorial Fier
Nr.7 dt.11.10.2022	Miratimin e Rregullores se Brendshme per Organizimin dhe Funksionimin e Spitalit
Nr.8 dt.11.10.2022	Përdorimi i të ardhurave dytësore të Spitalit. Blerje për Neurokirurgjinë dhe Kirurgjinë
Nr.9 dt.29.12.2022	Miratimin e mënyrës së përdorimit të të ardhurave dytësore të Spitalit
Nr.10 dt.29.12.2022	Rishpërndarje të zërave të Buxhetit Vjetor 2022 të Spitalit Rajonal Memorial Fier

Janë zhvilluar 4 mbledhje dhe janë marrë 10 vendime.

- Në mbledhjen e datës 15.03.2022 janë marrë 4 vendime
- Në mbledhjen e datës 15.07.2022 është marrë 1 vendim
- Në mbledhjen e datës 11.10.2022 janë marrë 3 vendime
- Në mbledhjen e datës 29.12.2022 janë marrë 2 vendime

Në mbledhjen e datës 15.03.2022, janë marrë 4 vendime në lidhje me miratimin e buxhetit të vitit 2022, mënyrën e përdorimit të të ardhurave dytësore, ngritjen e Bordit të burimeve njerëzore dhe miratimin e kontratës tip për personelin turk.

Takimi datë 15.03.2022, Relacioni datë 11.03.2022 dhe Njoftim për mbledhje datë 11.03.2022.

Në mbledhjen e datës 15.07.2022, është marrë 1 vendim, në lidhje me rishpërndarjen e zërave të buxhetit për vitin 2022. Takimi datë 15.07.2022, Relacioni datë 14.07.2022 dhe Njoftimi për mbledhje datë 14.07.2022. Njoftimi për mbledhje konstatohet se është dërguar 1 ditë para takimit dhe nuk është në dispozicion koha e mjaftueshme për tu njohur me relacionin anëtarët e bordit, në kundërshtim me nenin 7 të statutit të Spitalit “Memorial” Fier ku citohet se “Njoftimet sipas nenit 7 bëhen 3-7 ditë përpara duke bërë të ditur rendin e ditës”.

Në mbledhjen e datës 11.10.2022, janë marrë 3 vendime në lidhje me rishpërndarjen e zërave të buxhetit të vitit 2022, miratimin e rregullores së brendshme të spitalit dhe përdorimin e të ardhurave dytësore për blerje në plotësim të nevojave të reparteve kirurgji dhe neurokirurgji. Takimi datë 11.10.2022, Relacioni datë 07.10.2022 dhe Njoftim për mbledhje 07.10.2022.

Në mbledhjen e datës 29.12.2022, janë marrë 2 vendime në lidhje me mënyrën e përdorimit të të ardhurave dytësore dhe rishpërndarjen e zërave të buxhetit të vitit 2022.

Takimi datë 29.12.2022, Relacioni datë 19.12.2022 dhe Njoftimi për mbledhje datë 22.12.2022.

➤ Viti 2023

Bordi drejtues për vitin 2023 përbëhet nga M. R, A.A, M. C, F.B dhe B.Q.

Vendimet	Objekti
Nr.1 dt.24.02.2023	Miratimin e Buxhetit për Spitalin Rajonal “Memorial” Fier per vitin 2023.
Nr.2 dt.21.07.2023	Miratimin e tarifës së Shërbimeve të parkimit të automjeteve në Spitalit Rajonal “Memorial” Fier
Nr.3 dt.21.07.2023	Disa ndryshime në Strukturën dhe Organikën e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier .
Nr.4 dt.15.11.2023	Miratim për Rishpërndarje të zërave të Buxhetit Vjetor 2023 të Spitalit Rajonal Memorial Fier
Nr.5 dt.15.11.2023	Mbi miratimin e tarifave të ekzaminimeve ambulatorore dhe kostove të shërbimeve
Nr.6 dt.15.11.2023	Për ngritjen e grupit të posaçëm të monitorimit, për monitorimin e praktikës së dyfishtë
Nr.7 dt. 15.11.2023	Për një korigjim në vendimin nr.3, datë 21.07.2023

Janë zhvilluar 3 mbledhje dhe janë marrë 7 vendime.

- Në mbledhjen e datës 24.02.2023 është marrë 1 vendim
- Në mbledhjen e datës 21.07.2023 janë marrë 2 vendime
- Në mbledhjen e datës 15.11.2023 janë marrë 4 vendime

Në mbledhjen e datës 24.02.2023, në lidhje me miratimin e Buxhetit për Spitalin Rajonal “Memorial” Fier për vitin 2023. Takimi datë 24.02.2023, Relacioni datë 22.02.2023 dhe

Njoftim për mbledhje 22.02.2023, Njoftimet sipas nenit 7 bëhen 3-7 ditë përpara duke bërë të ditur rendin e ditës.

Miratimi i buxhetit për vitin 2022 dhe 2023, nga Bordi nuk është i detajuar por vetëm në zëra shpenzimesh 600 “Paga dhe shpërblime”, 601 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” dhe 602 “Mallra e shërbime”, në kundërshtim me nenin 3 të Rregullores së Spitalit “Për menaxhimin financiar” shkurt 2023.

Në mbledhjen e datës 21.07.2023, në lidhje me miratimin e tarifës së shërbimit të parkimit të automjeteve, konstatohet se Takimi është bërë në datë 21.07.2023, Relacioni datë 21.07.2023 dhe Njoftimi për mbledhje në datën 14.07.2023.

Në mbledhjen e datës 15.11.2023, në lidhje me rishpërndarjen e buxhetit të vitit 2023, miratimin e tarifave të ekzaminimeve ambulatorë dhe monitorimin e praktikës së dyfishtë. Takimi datë 15.11.2023, Relacioni datë 15.11.2023 dhe Njoftim për mbledhje datë 14.11.2023, në kundërshtim me nenin 7 të statutit të Spitalit “Memorial” Fier ku citohet se “Njoftimet sipas nenit 7 bëhen 3-7 ditë përpara duke bërë të ditur rendin e ditës”.

Konkluzion: Referuar relacioneve dhe numrit të tematikave për marrjen e vendimeve konstatohet se nuk është respektuar koha e nevojshme për njohjen nga anëtarët e Bordit me temat që do të trajtohen në mbledhje, si edhe vonesa kohore në marrjen e disa vendimeve nga Bordi drejtues, pasi periudha nga krijimi i spitalit deri në marrjen e disa vendimeve është rreth 2 vjet, si:

-Miratimin e tarifës së Shërbimeve të parkimit të automjeteve në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier me vendimin nr.2, datë 21.07.2023

-Miratimin e tarifave të ekzaminimeve ambulatorë dhe kostove të shërbimeve me vendimin nr.5, datë 15.11.2023

-Miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Spitalit me vendimin nr.7, datë 11.10.2022.

Bordi drejtues nuk ka respektuar nenin 12/b/e dhe d, të Statutit, ku përcaktohen detyrat e Bordit, nga ku konstatohet se nuk ka gjurmë të mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së spitalit, nuk ka vendime për miratimin e bilanceve vjetore si edhe miratim të planit të trajnimeve dhe programit të ekselencës.

-Drejtori Përgjithshëm

Nga drejtori përgjithshëm për vitin 2021 janë marrë 8 urdhra, si për krijimin e komisionit Teknik për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të pritjes dhe informimit të pacientëve në recepsionin e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, krijimin e komisionit Teknik për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të shërbimit të urgjencës mjekësore, krijimin e komisionit Teknik për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të farmacisë spitalore, krijimin e komisionit Teknik për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të daljes së pacientit, krijimin e komisionit Teknik për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të kujdesit infermieror, krijimin e komisionit teknik për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të menaxhimit të burimeve njerëzore, krijimin e komisionit teknik për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të shërbimit imazherik në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier dhe rregullore për procedurën standarde në shërbimin e imazherisë në SRMF.

-Për vitin 2022, janë nxjerrë 13 urdhra në lidhje me krijimin e komisioneve teknik për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të shërbimit të magazinës spitalore në SRMF, për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të kujdesit infermieror në shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme, për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të kujdesit infermieror në shërbimin e mjekësisë interne, për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të kujdesit infermieror në shërbimin e neurologjisë, për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të kujdesit infermieror në shërbimin e kardiologjisë, për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore,

për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të shërbimit të pastrimit, për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë, për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të kujdesit infermieror në shërbimin infektiv, për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të kujdesit infermieror në shërbimin e reanimacionit, për hartimin e proceseve standarde operacionale (SOP) të kujdesit infermieror në shërbimin e pneumologjisë, etj.

161 urdhra në lidhje me zbatimin e kontratave të nënshkruara për prokurime, marrje në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, asgjësimin e barnave, llogaritjen e fondeve limit, monitorimin e kontratave, planifikimin e nevojave sipas pavioneve dhe specialiteteve.

82 urdhra prokurimi.

14 urdhra në lidhje me mbarëvajtjen e punës në shërbimin shëndetësor, për dorëzimin e detyrës, disiplinën në punë, caktimin e personit për të drejtën e informimit, etj.

-Për vitin 2023, Janë nxjerrë 224 urdhra në lidhje me krijimin e komisioneve për monitorimin e kontratave, krijimin e komisioneve të prokurimit, komisioneve të llogaritjes së vlerës së kontratës, krijimin grupit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, lëvizje personeli, etj.

-Komisioni mjekësor është organ këshillimi teknik i drejtorisë dhe përbëhet nga drejtorët e spitaleve, që funksionojnë brenda autoritetit spitalor të qarkut dhe shefat e shërbimeve ose përfaqësues të zgjedhur nga vetë shërbimet e këtyre spitaleve. Komisioni mjekësor kryesohet nga kryetari i zgjedhur me votim të fshehtë, në bazë të kriterëve të vendosura nga Ministri i Shëndetësisë dhe ushtron veprimtarinë e tij për tre vjet.

Procedura për krijimin e komisionit mjekësor ka filluar me urdhrin e Drejtorit përgjithshëm nr.50, datë 08.10.2021 “Për ngritjen e komisionit mjekësor në spitalin rajonal “Memorial” Fier”, procesverbali për ngritjen e komisionit është mbajtur në datat 27 dhe 28.10.2021. Me procesverbalin e datës 29.10.2021, mbajtur nga anëtarët e komisionit mjekësor është zgjedhur kryetari i komisionit mjekësor.

Komisioni mjekësor është zgjedhur me vendimin nr.1056, datë 29.10.2021, komisioni mjekësor kryen funksionet e tij duke i propozuar drejtorisë së autoritetit spitalor:

a) blerjen e pajisjeve mjekësore, diagnostike dhe terapeutike;

b) vendimet, që përfshijnë aspektet mjekësore të punës;

c) rregullat e organizimit të shërbimeve mjekësore të institucionit;

ç) vlerësimin, krijimin, mbylljen ose modifikimin e reparteve, spitaleve ose të gjitha njësive funksionale në varësi;

d) vlerësimin e treguesit cilësor të shërbimeve;

dh) zbatimin e protokolleve të mjekimit;

e) trajnimin e personelit mjekësor dhe atij ndihmës;

ë) shërbimet dhe pajisjet e reja.

2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe shpenzimet administrative.

Për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të SRMF, u shqyrtua dokumentecioni si më poshtë:

-Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit.

-Dokumentecioni i PBA-ve të miratuara gjatë periudhës objekt auditimi.

-Buxheti i miratuar dhe ndryshimet e kryera gjatë periudhës objekt auditimi

-Realizimi i shpenzimeve me planifikimet.

-Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit, të udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe të FSDKSH mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit;

Nga shqyrtimi i dokumentecionit të sipërcituar konstatohet se kërkesat buxhetore sipas PBA 2022-2024, 2023-2025, 2024-2026 janë bazuar në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së PBA” i ndryshuar, dhe për investimet me VKM 185, datë 29.03.2018” Për procedurat e menaxhimit të

investimeve publike”, i ndryshuar, me VKM 887 datë 19.12.2022,” Për procedurat standarte të investimeve” i ndryshuar:

A. Për dokumentet e hartimit të PBA 2022-2024:

Për vitin 2021 nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik për hartimin e strategjive në arritjen e objektivave dhe qëllimeve për të cilin ushtron aktivitetin SRM Fier as ndonjë Grup Pune tjetër specifik për përllogaritjen e vlerave të treguesve buxhetor afatmesëm të nevojshëm për veprimtarinë e shërbimeve spitalore për arritjen e objektivave dhe qëllimeve në SRM Fier Përllogaritja e vlerave të paraqitura në relacion dhe pasqyrat e PBA 2022-2024 nga ana e Sektorit të Financës është bërë pa argumentim dhe vlerat e parashikuara nuk janë llogaritur saktë për zërat buxhetor (600,601,602) që financohen nga FSDKSH në kuadër të kontratës së lidhur përkatësisht:

për zërin 600 “Paga e shpërblime” nuk ka asnjë referencë mbi bazën e të cilës është llogaritur buxheti total i pagave, sa do të jetë numri faktik i punonjësve në strukturë dhe me kontratë., sa është llogaritur fondi i vecantë nga fondi i pagave në masën 5%

për zërin 601 “Sigurimet shoqërore e shëndetsore” vlera është llogaritur gabim për kontributet e punëdhënësit e cila duhet të jetë 16.7% dhe jo 14.2% mbi pagën bruto

për zërin 602 “Shpenzime për mallra e shërbime” nuk ka argumentim për përllogaritjen e kërkesave të nevojshme për shpenzimet korente dhe të paketave për shërbimet e miratuara në VKM 175, datë 17.03.2021 “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e SRMF, si projekt pilot” dhe bazuar në sistemin shëndetsor terciar, në numrin faktik të personelit shqiptar-turk për muajin Qershor 2021.

Për zërat e investimeve (230+231) të cilat miratohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka vlerë të parashikuar, pasi spitali i ka pajisjet e reja.

Nuk ka asnjë parashikim sa do të jetë fondi i të ardhurave të krijuara dhe parashikimi për të ardhurat që do të shpenzohet dhe si do të shpenzohen.

Relacioni shpjegues për shumatat që do të shpenzohen në buxhetin afatmesëm së bashku me pasqyrën nr.1 “Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve”, bazuar në nenin 12 pika 3 e Statutit të spitalit, nuk i është paraqitur për miratim Bordit para se të dërgohej në FSDKSH (DRF Fier) apo në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këto dokumente i janë dërguar pa miratim DRF Fier me shkresën nr 449/1, datë 19.07.2021” Relacioni” formulari nr 1 “Të ardhurat dhe shpenzimet”, referuar shkresës nr.621, datë 14.07.2021” Për hartimin e treguesve të programit buxhetor 2022-2024” të dërguar nga DRF Fier.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me kërkesat e neneve 25 e 26 të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008” Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar, të nenit 8, pika 8b) me Ligjin Nr.10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, i ndryshuar, në nenin 10 dhe 12 të kontratës me FSDKSH me nr 152, datë 24.05.2021“Për financimin e shërbimeve shëndetsore për Spitalin Rajonal Memorial në Fier si projekt pilot, për vitin 2021”, në nenin 12, pika e) e Statutit të Spitalit, të miratuar në Urdhrin nr.182/3, datë 07.05.2021 “Për miratimin e Statutit të Spitalit Rajonal Memorial Fier” të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i ndryshuar.

2- Për dokumentet e hartimit të PBA 2023-2025:

Me shkresën nr.1122, datë 14.07.2022 “Relacion” dhe pasqyrat e PBA 2023-2025 janë dërguar në Drejtorisë Rajonale të FSDKSH Fier (DRF Fier) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Hartimi është bërë referuar shkresës nr.2589, datë 05.07.2023 “Procedurat e hartimit të Projektbuxhetit për vitin 2024-2026” të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Për vitin 2022 nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik për hartimin e strategjive në arritjen e objektivave dhe qëllimeve për të cilin ushtron aktivitetin SRM Fier apo ndonjë Grup Pune specifik për përllogaritjen e vlerave të treguesve buxhetor të nevojshëm për veprimtarinë e shërbimeve spitalore dhe arritjen e objektivave dhe qëllimeve të SRM Fier.

Përllogaritja e vlerave të paraqitura në relacion dhe pasqyrat e PBA 2023-2025 nga ana e Sektorit të Financës është bërë pa argumentim dhe vlerat e parashikuara nuk janë llogaritur saktë për zërat buxhetor (600,601,602) që do të financohen nga FSDKSH në kuadër të kontratës së lidhur. Për sa vijon kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetsore (punëdhënës) janë llogaritur 11.2% ndërkohë që duhet 16.7%, dhe nuk është llogaritur fondi i vecantë nga fondi i pagave në masën 5%. Ky nuk është bërë parashikim për fondin rezervë nga fondi i të ardhurave të krijuara në masën rreth 10%, për shpenzimet emergjente. Në shtojcën 1/A “Pasqyrat shtesë për buxhetin vjetor”, përkatësisht Pasqyra nr 5, realizimi faktik viti 2021 për zërin 602 janë paraqitur pa realizim, ndërkohë që janë kryer pagesa nga arka me fondin e të ardhurave. Në relacion është deklaruar se vlerat e llogaritura janë bazuar në shpenzimet e sistemit shëndetsor terciar, në numrin faktik të personelit shqiptar dhe atë turk, në shpenzimet faktike realizuar në vitin 2021, në 6 mujorin e parë, të vitit 2022 dhe në vlerat e pritshme të shpenzimeve në vitin 2022-2024.

Nuk është bërë parashikim sa do të jetë fondi i të ardhurave të krijuara nga Spitali dhe parashikimi për të ardhurat që do të shpenzohet sipas artikujve buxhetor.

Pasqyra e PBA dhe relacioni sqarues nuk i është paraqitur për miratim Bordit të Administrimit para dërgimit zyrtarisht në FSDKSH (DRF Fier).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e neneve 25 e 26 të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar, të nenit 8, pika 8b) të ligjit 10292 date 08.07.2010 “Për menxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, i ndryshuar, në nenet 10 e 12, të kontratës me FSDKSH me nr 21, datë 10.01.2022 “Për financimin e shërbimeve shëndetsore për Spitalin Rajonal Memorial në Fier si projekt pilot, për vitin 2022”, në nenin 12, pika e) të Statutit të Spitalit, miratuar me Urdhrin nr.182/3, datë 07.05.2021 “Për miratimin e Statutit të Spitalit Rajonal Memorial Fier” të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i ndryshuar.

3- Për dokumentet e hartimit të PBA 2024-2026

Referuar shkresës nr 2589, datë 05.07.2023 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale nga ana e SRM Fier janë kryer veprimet si vijon:

Me Urdhër nr.01, datë 07.07.2023 “Për krijimin e grupit të punës për hartimin dhe programimin e PBA 2024-2026 për Spitalin Rajonal Memorial Fier” është realizuar ngritja e grupit të punës për hartimin e treguesve në kuadër të PBA 2024-2026 si dhe është bërë ndarja e detyrave dhe përgjegjësi për përcaktimin e strategjive, objektivave dhe qëllimeve për perspektivën 3 vjecare 2024-2026 e cila është dokumentuar në proces verbalin nr 298/3, datë 15.07.2023

Me Vendim me nr.1, nr 979/3, datë 28.07.2023 “Për miratimin e projekt buxhetit afatmesëm 2024-2026 të Spitalit Rajonal Memorial Fier” është dokumentuar marrja e vendimit nga GMS referuar kërkesës me nr. 979/1, datë 28.07.2023 “Për miratim mbi relacionin e PBA 2024-2026” nga Sektori Financës.

Me kërkesën nr. 979/2, datë 28.07.2023 “Kërkesë për miratim mbi relacionin e PBA 2024-2026” i është kërkuar miratim Bordit Drejtues për të cilën Bordi nuk është shprehur.

Me shkresën nr.979/4, datë 28.07.2022 “Shkresë përcjellëse” i është dërguar informacioni Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale edhe Drejtorisë Rajonale të FSDKSH Fier (DRF Fier) lidhur me parashikimin e shpenzimeve në kuadër të PBA 2024-2026.

Relacioni shpjegues bashkë me pasqyrat përkatëse bashkëlidhur, paraqesin parashikimin për vlerat e shpenzimeve që kërkohen për zërat “Paga e shpërblime” artikulli (600), “Sigurimet shoqërore e shëndetsore” artikulli (601), për shpenzimet “Mallra e shërbime” (602), “Investime” artikulli (230, 231). ky informacion nuk jep argumentimin se si janë llogaritur fondet e pagave dhe kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetsore, nuk është llogaritur asnjë vlerë për fondin e veçantë. Fondi për sigurime shëndetsore e shoqërore zëri 601 kontributet e punëdhënësit janë llogaritur 11.2% dhe jo 16.7% dhe Rritja e shpenzimeve për cdo vit është parashkuar 1.2 % pa dhënë asnjë argument referues se kujt institucioni apo indeksi të rritjes së shpenzimeve i janë referuar Në shtojcën 1/A “Pasqyrat shtesë për buxhetin vjetor”

Pasqyra nr 5, shpenzimet faktike për zërin 602, në shpenzimet viti 2022 janë paraqitur në vlerën 0, ndërkohë që janë kryer shumë pagesa nga arka me fondin e të ardhurave të krijuara.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e neneve 25 e 26 të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008” Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar, të nenit 8, pika 8b) të ligjit 10292 date 08.07.2010 “Për menxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, i ndryshuar, në nenet 10 e 12, të kontratës me FSDKSH me nr 21, datë 10.01.2022 “Për financimin e shërbimeve shëndetsore për spitalin rajonal memorial në Fier si projekt pilot, për vitin 2022, në nenin 12, pika e) të Statutit të Spitalit, miratuar me Urdhrin nr.182/3, datë 07.05.2021 “Për miratimin e Statutit të Spitalit Rajonal Memorial Fier” të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i ndryshuar.

Planifikimi i kërkesave buxhetore sipas PBA 2022-2024, PBA 2023-2025; PBA 2024-2026 në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

		Kërkesa 2022	Kërkesa 2023	
600	Paga e shperblime	691,578	484,000	394,442
601	Sigurime shoqërore	98,122	80,800	44,178
602	Shërbime dhe mallra	483,358	843,500	1,101,490
230+231	Shp. Operative (A)	1,273,058	1,408,300	1,540,110
	Investime			
	Shpenzime kapitale (B)	0	0	0
	II.Totalshpenzime	1,273,058	1,408,300	1,540,110
	Numri punonjësve plan	398	398	398

Burimi: SRMF

Parashikimi i shpenzimeve për paga siç shihet në tabelën e mësipërme ka ndryshim në rënie të kërkesave përkatësisht të fondit të pagave nga viti 2022 në vitin 2023 dhe në vitin 2024. E njëjta situatë paraqitet edhe për kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetsore (punëdhënës), ndërsa për shpenzimet e tjera të administrimit zëri 602 ka një rritje prej 360,142 mijë lekë ose 1.75 % pasi është parashikur rritje e numrit të pacientëve dhe me një rritje totale prej 135,242 mijë lekë. Rritja nga viti 2022 kundrejt 2024 llogaritet 618,132 mijë lekë ose 1.78% dhe një rritje totale prej 267,052 mijë lekë.

Referuar dokumentacionit të pasqyrave të PBA, për vitin 2021 shumica e zërave të shpenzimeve nuk janë parashikuar kjo gjë ka ardhur për mungesë të trajnimit të stafit, të kapaciteteve njerëzore si dhe të mungesës së rregulloreve operationale.

Gjatë shqyrtimit të pasqyrave të PBA rezulton se parashikimet për zërat e shpenzimeve administrative “Për mallra dhe shërbime”, janë parashikuar përkatësisht si vijon në:

-zërin “Materiale dhe shërbime zyre dhe te pergjithshme” ku në PBA janë parashikuar shpenzime për kancelari, blerje tonera materiale, materiale pastrimi blerje detergjentë, blerje dokumentecioni, materiale per funksionimin e pajisjeve të zyrës, etj.

-zërin “Materiale dhe shërbime speciale” Shërbime speciale janë bërë parashikime të ndryshme për Ilaçe dhe materiale mjekësore, blerje uniforma mjekësore, medikamente dhe materiale mjekësore, Furnizime dhe shërbime me ushqim per mencent, Materiale dhe pajisje laboratorik e të shërbimit publik, Të tjera materiale dhe shërbime speciale

-zërin “Shërbime nga të tretët” për shërbimet që realizohen nga të tretët si energji elektrike, shpenzim për ngrohje, posta, telefon, shërbimi të tjera etj. Janë bërë parashikime për shërbimt e sigurimit dhe ruajtjes” janë parashikuar për ruajtjen me roje private të godinës së SRM FIER-së, përkatësisht me 8 vendroje 8,12,24 orëshe, kjo për të minimizuar riskun e sigurisë së godinës ku punohet 24 orë në 7 ditë të javës.

-zërin “shpenzime transporti” janë parashikuar shpenzime për blerje karburanti dhe gazi për gjeneratorin dhe për mjetet e transportit, siguracione të mjeteve të transportit janë parashikuar vitin e tretë pasi automjetet kanë qenë me qera pjesë këmbimi të mjeteve të transportit nuk janë parashikuar por ndërkohë ka patur realizim të shpenzimeve të buxhetit, shpenzime të tjera qeraje është parashikuar qeramarrje automjetesh për automjetet.

-zërin “udhëtime dhe dieta” janë parashikuar shpenzimet për dieta brenda vendit dhe jashtë vendit por pa dhënë argument reference.

-zërin “shpenzime për mirëmbajtje” janë parashikuar mirëmbajtjet e objekteve ndërtimore, mirëmbajtje e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës

-zëri “Shpenzime për qiramarrje” janë parashikuar për qeramarrje mjetesh transporti shpenzimet për pagesën e taksave vendore, honorare për bashkëpunëtor të jashtëm, (rastet e trajnerëve ose specialist fushe të jashtëm që marrin pjesë në procedura të ndryshme në SRM FIER)

-zërin “shpenzime për sigurimin e ndërtesës” është parashikimi i siguracionit 1(një) vjeçar të ndërtesës.

-zërin “Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime operative” është vendosur për të parashikuar shpenzime të ndryshme për të cilat nuk ka informacion.

000/lekë

Analiza	E M Ë R T I M I	Kërkesa 2022	Kërkesa 2023	Kërkesa 2024
		PBA 2022-2024	PBA 2023-2025	PBA 2024-2026
600	Paga, shpërblime e shpenz. Tjera personeli	691,578	484,000	394,442
6001	Paga të personelit të përhershëm	691,578	484,000	394,442
6001001	Paga baze	104,000	64,800	61,967
6001003	Shtesë page për vjetërsi në punë	6,900	3,480	4,962
6001004	Shtesë page për veshitësi dhe rreziqe	10,000	27,600	37,514
6001005	Shtesë page për funksionin	310,610	171,330	164,425
6001006	Shtesë page për turnë të dyta e të treta	31,744	16,680	10,122
6001007	Shtesë page për largësi nga qendra e banimit	2,700	3,600	
6001013	Shtesë page për punë jashtë orarit	90,000	82,950	9,865
6001014	Shtesë page për punonjësit që rregullohen me akte të veçanta	135,624	113,560	105,587
601	Kontributë të sigurimeve shoqërore e shendetësore(16.7%)	98,122	80,800	65,872
6010000	Kontributë për sigurime shoqërore (15%)	94,786	72,600	59,166
6011000	Kontributë për sigurimet shendetësore (1.7 %)	3,336	8,200	6,706
602	Mallra dhe shërbime të tjera	335,666	843,500	915,268
6020	Materiale dhe shërbime zyre dhe të përgjithshme	7,600	12,580	8,129
6020100	Kancelari	1,600	5,000	3,263
6020200	Materiale për pastrim, disinfektim, ngrohje dhe ndriçim	-	4,580	3,766
6020300	Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës	6,000	-	-
6020500	Blerje dokumentacioni	-	3,000	1,100
6021	Materiale dhe shërbime speciale	286,600	304,673	613,688
6021001	Uniforma dhe të tjera veshje speciale	-	-	262
6021003	Ilaçe dhe materiale mjekësore	211,600	224,269	417,565
6021004	Furnizime dhe shërbime me ushqim për mizat	-	35,200	9,120
6021009	Materiale dhe pajisje laboratorik e të shërbimit publik	-	-	156,209
6021099	Të tjera materiale dhe shërbime speciale	75,000	45,204	30,532
6022	Shërbime nga të tretë	39,926	337,623	213,414
6022001	Elektricitet	8,200	70,600	40,000
6022002	Ujë	2,000	3,000	14,800
6022003	Shërbime telefonike	186	300	2,640
6022004	Posta dhe shërbimi korrier	-	50	-
6022005	Shërbime për ngrohje	-	-	20,058
6022007	Shërbime bankare	-	6	-
6022008	Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes	-	40,872	40,872
6022099	Shërbime të tjera	29,540	222,795	95,044
6023	Shërbime transporti	-	78,559	14,825
6023100	Karburant dhe vaj	-	71,670	14,075
6023200	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri	-	-	-
6023300	Shpenzimet e siguracionit të mjetëve të transportit	-	-	750
6023900	Shpenzime të tjera transporti	-	-	-
6026500	Shpenzime të tjera qeraje	-	6,889	-
6024	Shpenzime udhëtimi	-	-	5,400
6024100	Udhëtim i brendshëm	-	-	5,000
6024200	Udhëtim jashtë shtetit	-	-	400
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	1,540	-	42,012
6025300	Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore	1,540	-	-
6025500	Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike	-	-	42,012
6026	Shpenzime për qiramarrje	-	-	4,700
6026400	Shpenzime për qiramarrje mjetesh transporti	-	-	4,700
6026900	Shpenzime të tjera qiraje	-	-	-
6029	Shpenzime të tjera operative	-	110,065	13,100
6029004	Shpenzime për sigurimin e ndërtesave dhe të tjera kosto	-	-	2,200
6029099	Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime operative	-	110,065	10,900
	Gjithsej	1,125,366	1,408,300	1,375,582

7111099	Te tjera te ardhura sekondare dhe pagesa sherbimesh	6,150	25,900	41,916
	Totali	6,150	25,900	41,916

Burimi: SRMF

Burimi kryesor i të ardhurave për funksionimin e SRMF është buxheti i shtetit dhe financohet me fondet e FSDKSH me të cilin lidhen kontrata vjetore.

Kostatohet që në disa zëra ku çdo vit ka patur realizim të shpenzimeve ndërkohë parashikimi në PBA jepet me vlerat zero.

B. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2021

Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësisë shpenzuese është bërë mbështetur në ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” në UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në zbatim të VKM nr 175, datë 17.03.2021 “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e spitalit Rajonal Memorial, Fier si projekt pilot, pika 14, i ndryshuar të kontratës së lidhur me FSDKSH me nr 152, datë 24.05.2021 “Për financimin e shërbimeve shëndetsore për Spitalin Rajonal Memorial në Fier si projekt pilot, për vitin 2021”. në Udhëzimin nr.02 "Per zbatimin e buxhetit ë fondit per vitin 2021" nr.1522 dhe 1522/1 prot, datë 10.03.2021 të FSDKSH protokolluar në DRF me nr.248, datë 11.03.2021, është dërguar në DRF Fier shkresa nr 38, datë 12.05.2021 “Detajimi i Buxhetit për Spitalin Rajonal “Memorial” Fier.

000/lekë

Art	Emërtimi	Plani i miratuar	Plani rishikuar Shtesa+	Plani me ndryshime	Kërkesë Buxhetore 2021
	Shpenzime (A)+(B)	300,000	28400	328,400	523,311
600	Paga	215,000	28400	239,800	345,000
601	Sigurime	36,000		36,000	49,061
602	Shpenzime operative	49,000		49,000	167,833
	Shp.Operative (A)	300,000	28,400	328,400	523,311
230	Investime	0			
231	Investime	0			
	Shpenzime kapitale (B)	0	0	0	0
	Nr. punonjesve total	398			

Burimi: SRMF

Shtesa e buxhetit është miratuar nga FSDKSH me shkresën nr. 6913, datë 30.12.2021 “Dërgohet shtesë buxheti për Spitali Rajonal Memorial Fier”.

Referuar kërkesave për buxhetin e pritsëm për vitin 2021 janë kërkuar 523,311 mijë lekë duke u miratuar 194,911 mijë lekë më pak. Fondet e alokuara në fund viti në raport me fondet që nevojiten për veprimtarinë e Spitalit janë:

Për (Art. 600) Fondet e kërkuara janë 345,000 mijë lekë ndërsa fondet e alokuara deri në fund të vitit 239,000 mijë lekë, pra 70%

Për (Art. 601) Fondet e kerkuara ishin 14,277 mijë lekë, fondet e alokuara ishin 14,231 mijë lekë - 100%

Për (Art 602) Fondet e kërkuara ishin 222,600 mijë lekë dhe fondet e alokuara ishin 228,654 mijë lekë, pra 97,4 %.

Referuar situacionit të shpenzimeve faktike për vitin 2021 të dhënat për shpenzimet faktike të realizuara janë si vijon:

Art	Emërtimi	Plan	Fakt	Realizimi
600	Paga, shperblime e shpenzime personeli	243,400	158,424	65%
601	Kontribute te sigurimeve	36,000	17,400	48%
602	Mallra dhe sherbime te tjera	49,000	136,740	279%
	Totali	328,400	312,565	95%

Burimi: SRMF

Fondet e alokuara janë miratuar në fillim nga Bordi Drejtues me Vendim nr 3, datë 07.05.2021 për shumën 300,000 mijë lekë dhe më vonë është kërkuar shtesë buxheti në shumën 28,400 mijë lekë për paga pasi numri i rekrutimeve të punonjësve mjekësor dhe të administratës si për

stafin turk dhe atë shqiptar është ndryshuar duke pësuar rritje. Realizimi i shpenzimeve faktike në total është 95% kundrejt planit të Buxhetit, por rialokimetmidis zërave (600,601,602) nuk janë miratuar me vendim të bordit drejtues. Mosrealizimi i fondit të pagave rezulton për shkak të numrit të ulët të rekrutimeve e rrjedhimisht të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetsore.

Shpenzimet për zërin 6021 “Materiale dhe shërbime speciale” zë 2.4% të shpenzimeve totale. Ky shpenzim përfshin blerjen e medikamenteve, kiteve dhe reagentëve si dhe për shpenzimeve të tjera për administrimin.

Shpenzimet për zërin 6022 “Shërbime nga të tretë” zë peshën më të madhe të shpenzimeve rreth 30% kundrejt shpenzimeve totale të tilla si për energji elektrike, shpenzime për ujin për ruajtjen dhe sigurinë e spitalit, për pastrim gjelbërimin dhe për shpenzime të tjera

Shpenzimet për zërin 6023 “Shpenzime transporti” zë rreth 0.2% të shpenzimeve totale dhe kryesisht janë shpenzuar për siguracionin e autoambulancave dhe për blerje e riparime te tyre. Shpenzimet për zërin 6025” Shpenzime per mirembajtje te zakonshme” zë rreth 1.1 % të shpenzimeve totale dhe kryesisht janë shpenzuar për riparimin e automjeteve dhe për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave, por në fakt janë blere 5 pajisje kompjuterike të cilat janë pasqyruar si shpenzim riparimi dhe ndërkohë janë investime dhe nuk janë pasqyruar në regjistrin e aktiveve.

Shpenzimet për zërin 6026” shpenzime per qiramarrje” zë rreth 2.6 % të shpenzimeve totale dhe kryesisht janë shpenzuar për qeramarrje te automjeteve dhe për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave, por në fakt janë blere rreth 5 pajisje kompjuterike të cilat nuk janë pasqyruar në regjistrin e aktiveve.

Shpenzimet për zërin 6029” shpenzime te tjera operative” zë rreth 42.9 % të shpenzimeve totale dhe kryesisht janë shpenzuar për pritje e përcjellje si dhe për nje tarife për shpenzimet gjyqësore. Janë konstatuar shpenzime të cilat kanë tejkaluar shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve ku plani ishte 49000 mijë lekë dhe fakti 136,740 mijë lekë. Blerja e mallrave dhe e shërbimeve me tejkalime të buxhetit të planifikuar përbën shkelje, referuar kontratës me FSDKSH (neni 20)

Për Vitin 2022

Detajimi i buxhetit të miratuar për vitin 2022 është mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, të Ligjit 115/2021 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2022”, të UMF nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022” të UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në Udhezimin nr. 1 "Për zbatimin e buxhetit te FSDKSH për vitin 2022" me nr.1248 dhe nr.1248/1 datë 24.02.2022 të FSDKSH.

Plan buxheti fillestar i miratuar nga FSDKSH është dërguar nga DRF Fier me shkresë nr 144/4, datë 01.02.2022 e nr hyrës 176 prot, datë 02.02.2022 “Mbi financimin e shërbimit spitalor për vitin 2022” dhe është për vlerën totale 874,800 mijë lekë.

Detajimi i buxhetit në DRF Fier është dërguar me shkresën nr 336, datë 28.02.2023 “Detajimi i buxhetit 2022 për Spitalin Rajonal” Memorial” Fier” nga ana e SRM Fier me vonesë mbi 10 ditë pasi është marrë miratimi nga Bordi Drejtues. Ky detajim është bërë vetem sipas limitit mujor të arkës sipas artikujve (600,601,602) por jo në analiza 7 shifrore, në kundërshtim me nenin 10, pika 3 të kontratës së lidhur me FSDKSH me nr.21, datë 10.01.2022 “Për financimin e shërbimeve shëndetsore për Spitalin Rajonal Memorial në Fier si projekt pilot, për vitin 2022”.

Të dhënat për vlerat e ndryshuara gjatë vitit 2022 në planin e buxhetit jepen në tabelën e mëposhtme:

Plan buxheti me ndryshimet viti 2022

000/lekë

Art.	Emërtimi	Plani fillestar i miratuar	Plani rishikuar	Plani me shtesa	Plani me pakesime rialokim	Plani Final	Kërkesë Buxhetore Sipas PBA	% kundrejt PBA
	Shpenzime (A)+(B)	874,800	79,300	151,296	0	1,105,396	1,408,300	78%
600	Paga	416,000	10,200		(32,100)	394,100	484,000	81%

606	Transferta F .Vecante							
601	Sigurime	68,000	2400		(4,900)	65,500	80,800	81%
602	Shp.Operative (A)	390,800	66,700	151,296	37,000	645,796	843,500	131%
230	Investime	0						
231	Investime	0						
	Nr. punonjesve total	398						

Burimi SRMF

Gjatë vitit 2022 nga SRM Fier janë kërkuar dhe miratuar shtesat e buxhetit si vijon:

Shtesa e plan buxhetit me vleren 79,300 mijë lekë për hemodinamikën. është dërguar me shkresën nr 1252, datë 24.02.2022 “Shtesë buxheti në shërbimin spitalor me nr.344 hyrës, datë 28.02.2022 në SRM Fier. Detajimi i Buxheti i vitit 2022 është miratuar nga Bordi Drejtues me Vendimin nr 1 datë 15.03.2022 me nr 1251/6, datë 15.03.2022 në total për shumën 874,800 mijë lekë ku 950,000 mijë lekë është buxheti fillestar dhe 79,300 mijë shtesa e miratuar. Ky detajim vetëm sipas limitit mujor të arkës i është dërguar DRF Fier me shkresën nr 539, datë 31.03. 2022. Mos detajimi në analiza 7 shifrore, është në kundërshtim me nenin 10, pika 3 të kontratës së lidhur me FSDKSH me nr.21, datë 10.01.2022 “Për financimin e shërbimeve shëndetsore për Spitalin Rajonal Memorial në Fier si projekt pilot, për vitin 2022”

Shtesa e plan buxhetit me vleren 63,000 mijë lekë është miratuar nga FSDKSH me shkresën nr. 5960, datë 03.10.2022 me nr 1442 hyrës, datë 05.10.2022 “Ndryshim i buxhetit 2022 për shërbimin spitalor” për vlerën 63,000 mijë. Kërkesa i është dërguar FSDKSH, me shkresën 1249 datë 24.08.2022 “Shtesë Buxheti për vitin 2022 për hapjen e shërbimeve spitalore “Bordi Drejtues ka bërë miratimin referuar relacionit nga SRM Fier me shkresën nr 1460/2 datë 07.10.2022 “Relacion” Kjo rishpërndarje fondeve është miratuar me Vendimin nr 6, datë 11.10.2022

Shtesa e plan buxhetit me vleren 88,296 mijë lekë është miratuar me shkresën nr 6762/19, datë 16.11.2022 e nr.1602 hyrës, datë 21.11.2022” Shtesë buxheti në shërbimin spitalor” të FSDKSH. detajimi është bërë me Vendimin nr 10, datë 29.12.2022 “Për rishpërndarje të zërave të buxhetit vjetor 2022, të spitalit Rajonal “Memorial” Fier” ku shuma prej 56120 mijë lekë është për fillimin e procedurave për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore imazherike dhe shuma prej 32,176 mijë lekë për instrumenta kirurgjikale për shërbimin ORL dhe për aparatura laboratorike për shërbimin e Anotom-patologjisë.Për sa vijon për kërkesa i është dërguar bordit për miratim me relacioni shpjegues me shkresën 1715/1 daqtë 19.12.2022.

Për Vitin 2022, Fondet e alokuara krahasuar me fondet e kërkuara janë si më poshtë:

Për (Art. 600) Fondet e kërkuara janë 484,000 mijë lekë fondet e alokuara deri ne Fund të vitit ishin 394,100 mijë lekë, pra 81%

Për (Art. 601) Fondet e kërkuara janë 80,800 mijë lekë, fondet e alokuara me ndryshimet janë 65,500 mijë lekë - 81 %

Për (Art 602) Fondet e kërkuara ishin 843,500 mijë lekë dhe fondet e alokuara mendryshimet janë 645,796 mijë lekë, pra 131%.

Tabela “Realizimi i shpenzimeve Viti 2022

000/lekë

Art	Emërtimi	Plan	Fakt	Realizimi
600	Paga, shperblime e shpenz. Tjera personeli	394,100	324,115	82%
601	Kontribute te sigurimeve shoqerore	65,500	36,056	55%
602	Mallra dhe sherbime te tjera	645,796	429,509	67%
	Totali	1,105,396	789,680	71%

Burimi SRMF

Shpenzimet për zërin 602” Mallra dhe sherbime te tjera” janë realizuar në vlerën totale Shpenzimet për zërin 6021 “Materiale dhe shërbime speciale” zë 27 % të shpenzimeve totale. Ky shpenzim përfshin blerjen e medikamenteve, kiteve dhe reagentëve si dhe për shpenzimeve të tjera për administrimin.

Shpenzimet për zërin 6022 “Shërbime nga të tretë” zë peshën më të madhe të shpenzimeve rreth 42% kundrejt shpenzimeve totale të tilla si për energji elektrike, shpenzime për ujin për ruajtjen dhe sigurinë e spitalit, për pastrim gjelbërimin dhe për shpenzime të tjera

Shpenzimet për zërin 6023 “Shpenzime transporti” zë rreth 13% të shpenzimeve totale dhe kryesisht janë shpenzuar për siguracionin e autoambulancave dhe për blerje e riparime të tyre. Shpenzimet për zërin 6024 “Shpenzime udhëtime” zë rreth 0.7% të shpenzimeve totale dhe kryesisht janë shpenzuar për dieta brenda vendit për pjesëmarrje në aktivitete e konferenca mjekësore.

Shpenzimet për zërin 6025” Shpenzime për mirembajtje të zakonshme” nuk ka shpenzimeve. Shpenzimet për zërin 6026” shpenzime për qiramarrje” zë rreth 1.3 % të shpenzimeve totale dhe kryesisht janë shpenzuar për qeramarrje të automjeteve.

Shpenzimet për zërin 6029” shpenzime të tjera operative” zë rreth 42.9 % të shpenzimeve totale dhe kryesisht janë shpenzuar për pritje e përcjellje dhe për honorare.

Për vitin 2023

Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësisë shpenzuese është bërë mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, Ligjit 84/2022 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2023” në UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar me UMF plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” në Udhezimin nr.7 "Për zbatimin e buxhetit të fondit për vitin 2023" me nr.638 prot dhe nr.638/1 prot, datë 13.02.2023 të FSDKSH. Nga ana e SRM Fier është dërguar në DRF Fier detajimi i buxhetit me shkresën nr 336, datë 28.02.2023 “Detajimi i buxhetit 2023 për Spitalin Rajonal “Memorial” Fier detajimi është bërë në analiza 7 shifrore dhe është miratuar nga Bordi Drejtues me shkresën nr 298, datë 23.02.2023.

Plan buxheti me ndryshimet viti 2023

Art	Emërtimi	Plani fillestar i miratuar	Plani rishikuar	Ndryshimi Plani rishikuar/ Plani Fillestar	Kërkesë Buxhetore viti 2023
	Shpenzime (A)+(B)	950,000	199,300		
600	Pagat	377,200	32,000	409,200	484,000
601	Sigurime	63,148		63,148	80,800
602	Shpenzime operative	509,652	167,300	676,952	843,500
	Shp. Operative (A)	950,000	199,300	1,149,300	1,408,300
230	Investime				
231	Investime				
	Nr. punonjësve total	398	Nr. punonjës perhershem Nr.punonjësish kontrate të perkohshme		349 49

Burimi SRMF

Për vitin 2023 janë miratuar dy fonde shtesë me shkresat nr. 646, datë 14.02.2023 “Shtesë buxheti në shërbimin spitalor” të FSDKSH dhe shkresa nr 2768/31, datë 07.09.2023 “Shtesë buxheti në shërbimin spitalor” për shumën 120,000 mijë lekë.

Tabela “Realizimi i shpenzimeve Viti 2023

000/lekë

Art	Emërtimi	Plan	Fakt	Realizimi
600	Paga, shperblime e shpenz. Tjera personeli	409,200	388,839	95%
601	Kontribute të sigurimeve shoqerore e shendetesore	63,148	44,420	70%
602	Mallra dhe sherbime të tjera	1,003,268	648,484	65%
	Totali	1,475,616	1,081,743	73%

Burimi: SRMF

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 9 dhe nenin 12 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, Udhezimin e Ministrisë së Financave nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së PBA” i ndryshuar, dhe për investimet me VKM 185, datë 29.03.2018” Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, i ndryshuar, me VKM 887 datë 19.12.2022,” Për procedurat standarte të investimeve” i ndryshuar në Ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”,

pika 35, 36, 42, 43, 45, 46 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

-Veprimet e kryera nëpërmjet bankës për vitin 2021, nga ku rezultoi se:

Regjistrimi i shpenzimeve dhe i të ardhurave në ditarët e bankës dhe të arkës bëhet referuar urdhër Pagesave në rend kronologjik.

Për periudhën objekt auditimi në lidhje me kontrollin e shpenzimeve që janë regjistruar në ditarin e bankës është kërkuar dokumentecioni justifikues mbi bazën e të cilit janë bërë transfertat bankare. Në të gjithë ditarët apo librat kontabël ku janë bërë rregjistrimet kontabël për veprime e ngjarjet ekonomike të veprimtarisë së Spitalit, nuk janë mbajtur saktë ditaret e shpenzimeve, ditari e të ardhurave, ditari magazinës, ditari veprimeve për donacionet dhe huamarrjet, libri i madh për regjistrimin e veprimeve e ngjarjeve të ndryshme ekonomike kontabile.

Nga auditimi rezulton se veprime e ngjarje ekonomike kontabile të ndryshme nuk janë regjistruar në llogaritë e përcaktuara sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimet e MFE. Këto veprime lidhen me kthime veprimesh për vlera te caktuara nga klientë të ndryshëm, të ardhura nga qeratë, të cilat janë kontabilizuar në nënllogarinë e të ardhurave nga pacientët. Veprime të regjistruara në ditarin e bankës në nënllogarinë "Të ardhura nga pacientet"

Gjatë shqyrtimit të dokumentecionit për pagesat e kryera me bankë, rezulton se për vitet 2021, 2022, 2023 konstatohen mungesa në dokumentecionin vërtetues dhe regjistrimet në ditarin e bankës janë mbajtur me programin “excel” pa pasur një soft financiar dhe janë të regjistruara në mënyrë kronologjike referuar statementit të llogarisë bankare pranë Tirana Bank.

Veprimet e regjistruara në ditarin e bankës dhe të arkës, nuk janë të plota. Përshkrimi i veprimit të kryer nuk jepet i qartë duke dhënë një përshkrim të përgjithshëm, nuk evidentohen numri dhe data faturës që lëshon furnitori, nuk pershkruhet përmbajtja e plotë e veprimit ekonomik të kryer.

Regjistrimi veprimit të pagesës së pagave, rubrika "Përshkrimi i veprimit" thuhet: Kaluar paga, nderkohë që nuk evidentohet se ciles periudhë i përkasin pagat, ose në rast të kalimit të pagës për një punonjës nuk përshkruhet as përfituesi dhe as periudha e pagës së përfituar.

Nga auditimi i dokumentecionit bankar rezulton se në 4 raste nuk janë bashkëlidhur urdhër transfertat të cilat duhet të jenë të nënshkuara nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i SRMF

Dokumentet vërtetues për kryerjen e pagesave nuk janë të plota

-Për pagesat e kryera për blerje emergjente të karburantit (LPG/LNP gaz), blerje detergjente, blerje kancelari, blerje medikamentesh, kite dhe reagent në kushtet e emergjencës rezulton likujdimi vjetor mbi 100,000 lekë duke bërë ndarjen e fondit në kundërshtim me VKM 285 datë 19.01.2021, neni 11, pika 5” ...Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP-ja “ dhe neni 56, pika 9 “...Autoriteti/enti kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për blerjen e mallrave, për të cilat ka një nevojë emergjente apo për kryerjen e shërbimeve të paparashikueshme me kusht që vlera e përlllogaritur e mallrave dhe shërbimeve, për plotësimin e nevojave të lidhura me situatën e paparashikuar, nuk është më e madhe se 100, 000lekë ” dhe në pikën 11 “Në asnjë rast, autoriteti/enti kontraktor në momentin e planifikimit të nevojave të tij, nuk duhet të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat e prokurimit”.

Sa më sipër likujdimi është në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke mos bërë detajimin e fondeve në analiza 7 shifrore, Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligjin nr 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” në kundërshtim me VKM 285, datë 19.05.2020.

-Kontrata për qiramarrje automjeteve, pagesat e likujdimit të qiramarrjes së automjeteve janë bërë në dy operatorë ekonomikë, “ACR” dhe “C.” SHPK, ndërkohë që procedura është kryer vetëm me operatorin “C.” SHPK. Nga Kontrata e lidhur me këtë të fundit, me nr 13/11 prot.,

datë 04.05.2021, me vlerë mujore prej 536,900 leke, rezulton se likuidimi është bërë në 04.06.2021 për muajin maj 2021 me vlerën 274,230 leke dhe për muajin qershor, është likuiduar në datën 15.07.2021 me vlerë të plotë prej 536,900 lekë, ndërkohë që automjetet janë dorëzuar nga Operatori më datën 18.06.2021 me 47 ditë më shumë se vlera mujore, ***pra paguar me shumë 578,473 lekë duke*** shkaktuar dëm ekonomik për SRMF. Përgjegjësi e nëpunësit zbatues i cili ka kryer likuidimin në kundërshtim me kushtet e kontratës pa marrë në dorëzim automjetet. Kontrata është lidhur më datën 04.05.2021, para miratimit të buxhetit nga Bordi Drejtues dhe nënshkrimit të kontratës së Spitalit me FSDKSH për vitin 2021.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.628/30 prot. datë 29.10.2024, protokolluar në KLSH me nr. 610/10 prot., datë 04.11.2024, nga zj. R. D, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Kontrata e qiramarrjes së automjeteve është nënshkruar dhe ka hyrë në fuqi më datë 04.05.2024. Në nenin 5 të saj , pika 5.1 përcakohet se automjetet do të dorëzohen në ambientet e Qiramarrësit nga Qeradhënësi brenda 5 ditësh mbas kryerjes së parapagimit, paragam nuk është përcaktuar nga palët.Në rastin konkret , pavarësisht se procesverbali i marrjes në dorëzim të automjeteve nga grupi i punës i posaçëm është regjistruar në protokollin e institucionit tonë më datë 18.06.2024 , këto automjete realisht dhe praktikisht janë përdorur nga institucioni ynë në bazë të kontratës së qiramarrjes, kjo vërtetohet nga fletë udhëtimet e nënshkruara pasi rezulton të jete konsumuar karburant që prej muajit maj 2021 për automjetet me targa: AA279VG, AA825DJ, AB586BB dhe AA118MN. Fatura e parë e dorëzuar nga qeradhënësi ka një vlerë prej 274 230 lekë për shërbim qiradhënieje automjetesh. Në nenin 4 të kontratës përcaktohet se vlera e qerasë mujore është 536 900 lekë në muaj. Pra rezulton se pagesa në vlerën prej 274 230 lekë nuk është e plotë sipas kontratës, pasi është kryer në përputhje me shërbimin e ofruar nga qiradhënësi dhe automjetet janë përdorur mesatarisht për 15 ditë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet tuaja sqarojmë se argumentat nuk qëndrojnë, pasi për këto veprime nuk janë zbatuar procedurat e prokurimit. Kontrata është lidhur drejtpërdrejt pa patur disponibilitete në llogari pasi fondet tuaja janë akorduar më datën 27.05.2021. Dëmi ekonomik është llogaritur për 47 ditë më tepër, ***pra 578,473 lekë.***

-Blerjet me vlera të vogla

Për procedurat e deklaruara sipas regjistrit të parashikimeve dhe atyre të realizimeve te prokurimeve te dhenat jepen si mëposhtë:

Tabela 1 “Prokurimet me vlerë të vogël për vitet 2021-2022-2023”

Nr	Objekti	Viti	Parashikuar	Realizuar	Fondi Limit	Vlera e kontratës
1	Prokurimet me vlerë të vogël	2021	17	13	11,094,548	9,430,330
2	Prokurimet me vlerë të vogël	2022	25	21	10,109,239	853,184.44
3	Prokurimet me vlerë të vogël	2023	29	26	15,653,815	8,634,524

Referuar VKM 285 datë 19.05.2021” Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, neni 11 “Kufijtë monetarë” pika 3 “Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit. Në çdo rast, pavarësisht nga fakti që nuk do të prokurohen, planifikimi i këtyre objekteve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik....Për sa vijon në të gjitha rastet rezulton se procedurat e emergjencës nuk janë paraqitur as në Regjistrin e parashikimeve dhe për pasojë as në Regjistrin e realizimeve të prokurimit.

-Për shërbimin e ruajtjes e sigurisë fizike të ambienteve të Spitalit Rajonal Memorial Fier është nënshkruar kontrata me “I. G SHA”, në datën 19.04.2021 midis Autoritetit kontraktor: “Spitali Rajonal Memorial Fier” me nr 8. prot. datë 19.04.2021 dhe Kontraktuesit “I..G SHA” me nr.642/3 prot., datë 09.04.2021. Në dokumentet mbështetëse për zbatimin e kontratës u

konstatua se pagesa që është kryer në muajin qershor 2021 ka qenë me efekt prapaveprues - kontrata është nënshkruar 19.04.2021 dhe pagesa është llogaritur nga data 30.03.2021. Referuar nenit 10 të kontratës” Kohëzgjatja dhe përfundimi i kontratës” është përcaktuar data e hyrjes në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët, ndërkohë si datë fillimi është shënuar 30.03.2021, pra 21 ditë më tepër. Përsa i përket nenit 7, të kësaj kontrate “Çmimi dhe mënyra e pagesës” është përcaktuar vlera mujore 2,838,321 leke pa tvsh. Për sa më lart vlera e paguar më tepër ka një efekt financiar negativ prej 1,986,825 lekë pa TVSH.

Për këtë kontratë mungon urdhri për ngritjen e komisionit të monitorimit të kontratës së shërbimit, Dokumentet mbështetëse të lëshuara nga I. G SHA kanë parregullsi në data. Për muajin mars 2021 për të cilin është faturuar shërbim mungon grafiku i shërbimit dhe deklarata tatimore për sigurimet e muajit mars. Për sa vijon në dokumentet mbështetëse për pagesë mungon formulari i urdhër transfertës së nënshkruar nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi zbatues, por pagesa është shoqëruar vetëm me Transfertën e bankës (T.B) dhe përgjegjësia është e nëpunësit zbatues

Sa më sipër kjo është në kundërshtim me ligjin nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe në kundërshtim me Ligjin nr 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në kundërshtim me Udhëzimin nr 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

- Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” pagesë e kryer në datën 15.12.2021, me vlerë 100,000 lekë, “të nevojshëm për procesin e akreditimit duhet skica e projektit të dizenjimit të sistemit të mbrojtjes nga zjarri. Hartimi i skicës së projektit të dizenjimit nga një subjekt licensuar në këtë fushë ka kërkuar realizimin e një shpenzimi ku fituesi është i paracaktuar pasi skicat me projektet e dizenjimit për këtë shërbim, janë depozituar që në datën 03.11.2021 në protokollin e SRM Fier, ndërsa procedura për posedimin e këtij projekti ka filluar më datën 15.11.2023, si më poshtë:

1- Me Shkresën nr. 1154, datë 15.11.2021“Kërkesë për vënien në dispozicion dokumentecioni” drejtuar Bashkisë Fier, kërkohet vënia në dispozicion e dokumentecionit të spitalit (planimetri te godinës, e projektit të gjelbërimit dhe vaditjes).

2- Me Shkresën nr. 1154/1, datë 15.11.2021 “kërkesë për pajisje me certifikatë për sigurinë nga zjarri (C.S.Z) drejtuar Drejtorisë së Shërbimit të MZSH”, në Bashkinë Fier.

3- Me Shkresën nr. 1154/2, datë 15.11.2021 “Njoftim” i Drejtorit të Përgjithshëm të Spitalit drejtuar subjekteve/personave fizikë për paraqitjen e projekteve “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri”.

4- Me E-mail datë 14.06.2021 për fillimin e procedurës së Akreditimit të Spitalit Rajonal Memorial Fier, drejtuar Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetsore (QKCSA-ISH).

5-Ofertat e tregut të paraqitura nga inxhinierët L.Gj. PF nr. 1154/3, datë 16.11.2021, H.A.PF nr .1154/4, datë 16.11.2021, T.N. PF nr .1154/5, datë 16.11.2021.

6-Me Shkresën nr.1154/6, datë 16.11.2021“Informacion” drejtuar titullarit nga Përgjegjësja e Financës është vlerësuar oferta më e ulët për hartimin projektit të godinës “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” oferta e dhënë nga ing. L. Gj.

7- Me Shkresën nr 1154/7 datë 16.11.2021 “Përzgjedhje e ofertës më të ulët” për operatorin me vlerën më të ulët prej 100,000 lekë pa tvsh.

8-Projekti i dorëzuar nga operatori ekonomik L. Gj. PF. Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, shkresa nr. 1089, datë 03.11.2021

Për këtë projekt nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit Për Prokurimin Publik procedura “Blerjet me vlera të vogla” si edhe mungon procesverbali i marrjes në dorëzim.

Projekti duhej të ishte pjesë integrale e dokumenteve të objektit të kolauduar dhe pranuar nga Grupi i Punës ngritur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe pranuar nga Grupi i punës i Spitalit, pra rezulton se ky shpenzim në vlerën 100,000 lekë, për këtë projekt nuk duhej kërkuar duke dhënë një efekt financiar dhe një shpenzim të paefektshëm. Për sa më

sipër mban përgjegjësi komisioni i prokurimit me vlerë të vogël si dhe znj. N. M. e cila ka zhvilluar procedurën me përgjegjësitë e komisionit me vlerë të vogël.

- Për dy pagesat e kryera Operatorit ekonomik A. P. shpk me NIPT K.....H në datën 13.10.2021, për vlerën 1,198,758 lekë, “Për shpenzime të pastrimit gjeneral siperfaqe të brendshme pastrim gjeneral siperfaqe të jashtme” dhe në datën 26.10.2021, për vlerën 1,188,000 lekë për shërbimin e dizifektimit, dezisektimit dhe deratizimit të ambienteve të brendshme dokumentet e konstatuara janë si vijon:

Preventiv punimesh nga A. P. shpk datë 27.03.2021 me vlerën 1,198,758 lekë

Situacion punimesh datë 15.04.2021 me vlerën 1,198,758 lekë

Faturë tatimore elektronike, nr 113/2021, datë 05.10.2021 vlerë 1,198,758 lekë me tvsh

Faturë tatimore elektronike nr 114/2021, datë 05.10.2021 vlerë 1,188,000 lekë me tvsh

Preventiv punimesh datë 27.03.2021 me vlerën 1,188,000 lekë

Situacion punimesh datë 16.04.2021 me vlerën 1,188,000 lekë

Këto pagesa nuk kanë procedurë prokurimi dhe nuk kanë asnjë dokument të urdhëruar nga titullari i Spitalit.

-Për pagesën e kryer në datën 26.10.2021, me vlerë 1,094,580 lekë, “Blerje LPG/GNL (gas)” të nevojshëm për ngrohjen e ambienteve të spitalit kostatohen dokumentet si vijon:

Faturë tatimore elektronike nr 295/2021, datë 02.09.2021 vlerë 1,094,580 lekë me tvsh nga “R” sha me NIPT L.....V

Procesverbal datë 02.09.2021, mbajtur nga komisioni i pritjes, administrimit dhe dokumentimit të mallrave në magazinën e shërbimeve të përgjithshme të institucionit për vitin 2021

Fletë hyrje në magazinën e Spitalit nr 38/4 datë 02.09.2021 vlerë 1,094,580 lekë per gazin

Fletë dalje për sektorin e shërbimit me nr 310/1, datë 02.09.2021 1,094,580 vlerë lekë në depozitën e furnizimit të kaldajës.

Dokumentet vërtetuese në transfertat bankare nuk i janë bashkëlidhur pagesës.

Objekti i prokurimit për këtë procedurë është parashikuar si element në Regjistrin e prokurimeve për vitin 2021.

Kërkesa për nevojën e fillimit të procedurës - Aktualisht janë të administruara 3(tre) shkresa të ndryshme për sasi të ndryshme përkatësisht 10,000 litra, 200,000 litra/muaj dhe 20270 litra.

Për sa u konstatua nga të dhënat në informacionin e paraqitur me shkresat nr. 204/1 datë 3.06.2021 “Memo” dhe shkresën nr 201, date 03.06.2021 kapacitetet e depozitës janë paraqitur të dhëna kontradiktore në një rast thuhet 50,000 litra dhe në shkresën tjetër 52,000 litra gaz e llogaritur rreth \approx 200,000 litra në muaj kurse, ndërkohë që katalogu paraqet kapacitetin maksimal 169 m³ rreth 4 ditë në këtë rast konsumi i nevojshëm shkon 52000 litra *7.5 here/muaj \approx 390,000 litra në muaj.

vlera mujore që duhet shpenzuar nga kaldaja që punon me karburant naftë është 11,239,200 lekë (70 litra/ore x 24 ore x 30) = 50,400litra/muaj x 183 leke/litër) kurse shpenzimet mujore kur kaldaja punon me karburant Gaz i naftës së lëngëzuar (LPG) llogariten rreth 10,800,000 lekë / muaj (200,000 litra x 54 lekë/litër) rrjedhimisht shpenzimi i kaldajës me naftë koston rreth 439,200 lekë/muaj më tepër se ai me Gaz (LPG).

Sa më sipër nuk janë zbatuar procedurat dhe rregullat e prokurimit publik në zbatim të ligjit 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe janë në kundërshtim me nenin 2, pika 2 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, Pagesa është në kundërshtim me nenin 35, 36,37,38,39 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, urdhërat e sipërcituar me nr 24/1 dhe me nr 24/2 janë protokolluar në kundërshtim me nenin 19 të Normativave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, pasi mbajnë të njëjtin numër protokoll duke mos qene në renditje kronologjike.Gjithashtu dokumentet e Fletë hyrje në magazinën e Spitalit nr 38/4 datë 02.09.2021 vlerë 1094580 lekë per gazin dhe Fletë daljes me nr 310/1, datë 02.09.2021 1,094,580 vlerë lekë në depozitën e furnizimit të kaldajës nuk kanë autorizimin e personit përgjegjës që duhet të autorizojë konsumin e kaldajës, po kështu në

proces verbalin e datës 30.12.2021 vlera e konsumit total nuk përputhet me shumatoren e konsumeve mujore. Nuk është mbajtur libri i oreve të punës për konsumin e kaldajës.

-Janë kryer tre pagesa për riparim automjetesh më datën 13.10.2021 me vlerë 100,000 lekë me tvsh seicila ku dokumentet e konstatuara janë si vijon:

faturë tatimore elektronike nr 24/2021, datë 05.10.2021 vlerë 100,000 lekë me tvsh nga subjekti LAND ROVER LINE me NIPT K.....A

Preventiv datë 30.09.2021 e vlerë totale 100,000 lekë me tvsh

Procesverbal nr 187/3, datë 29.06.2021 për pranimin e autoambulancave me targa AA865XX dhe AA866XX nga Spitali Rajonal Memorial Fier

Preventiv nr 19, datë 01.10.2021 vlere totale 100,000 lekë me tvsh

faturë tatimore elektronike nr 26/2021, datë 05.10.2021 vlerë 100,000 lekë me tvsh nga subjekti LAND ROVER LINE me NIPT K.....A

faturë tatimore elektronike nr 25/2021, datë 05.10.2021 vlerë 100,000 lekë me tvsh nga subjekti LAND ROVER LINE me NIPT K.....A

Preventiv nr 4, datë 01.10.2021 vlere totale 100,000 lekë me tvsh

Spitali Rajonal “Memorial” Fier (SRMF) është një institucion i cili ka filluar aktivitetin spitalor në muajin maj të vitit 2021.

Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Soaciale Nr. 257, datë 21.05.2021 “*Mbi marrjen e masave për zbatimin e planit të mobilizimit, për një periudhë tranzitore, deri në vënien në funksion me kapacitet të plotë të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier*”, Institucionet: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitalin Rajonal Vlorë, Spitalin Rajonal Fier, Spitalin Rajonal Gjirokastër dhe Spitalin Bashkiak të Lushnjës detyroheshin të angazhoheshin maksimalisht për t’iu përgjigjur të gjitha nevojat për mallra dhe shërbime të domosdoshme për vënien në funksion të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, gjatë periudhës së mobilizimit.

Viti 2022

Për blerjet me vlera të vogla u konstatuan mangësi proceduriale, si më poshtë:

- “Blerje Kompjutera pajisje IT” pagesa e datës 20.10.2022, me vlerë 578,160 lekë, konstatohen dokumentet si vijon:

-Faturë elektronike tatimore nr 1391/2022, datë 12.09.2022 me vlerë totale 578,160 lekë

-Shkresë për likuidim nr 1266/4., datë 30.09.2022 të komisionit të Blerjeve të vogla

-shkresë nr 926., datë 08.06.2022 “Kërkesë për pajisje IT” të sektorit të IT, shkresë nr 170/1, datë 02.02.2022 “Kërkesat për vitin 2022” të Sektorit të IT,

-nr.926/2 datë 22.06.2022 procesverbal studim tregu nga grupi i punës ngritur me urdhër 65, datë 13.06.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për studimin e tregut për “Blerje pajisje IT”

- Procesverbal nr.1010/1 datë 07.07.2022 “Për hartimin e specifikimeve teknike për prokurimin me objekt: “Për blerje pajisje IT” -Procesverbal nr.1010/2 datë 19.07.2022 ‘Për përlllogaritjen e fondit limit për prokurimin me objekt: “Për blerje pajisje IT”, me vlerën e fondit limit 568,666.67 lekë pa tvsh

-Proces verbal datë 12.09.2022 për komisionin e pritjes, administrimit dhe dokumentimin e mallrave në magazinn e shërbimeve të përgjithshme të institucionit për vitn 2022 ku është referuar fatura tatimore e Operatorit Ekonomik S.Z., PF si dhe Fletë Hyrja nr 84, datë 12.09.2022 e vleren totale 578160 lekë me tvsh.

Kjo pagesë bie në kundërshtim me pikën 3 të kontratës së lidhur me FSDKSH, pasi këto fonde janë investime dhe nuk janë shpenzime për mallra dhe shërbime të financuara nga FSDKSH Investimet duhen miratuar nga Bordi Drejtues si të ardhura të krijuara nga spitali.

Për sa më sipër në vitin 2022 u konstatuan 31 raste të blerjeve me emergjencë të likujduara në vlerën 2,999,520 lekë dhe për vitin 2023 u konstatuan 17 raste të blerjes së medikamenteve me procedurë emergjente likujduar në vlerën 1,398,451 lekë. Gjithashtu u konstatuan 3 raste blerje e disa medikamenteve dhe kiteve nga arka pa asnjë procedurë prokurimi bashkëlidhur pagesës.

Gjithashtu nga konstatimi me zgjedhje i pagesave të kryera për vitin 2022 në ditarin e bankës ka shumë mangësi në dokumentet vërtetuese, si:

-Blerje kancelarie më datën 24.01.2022 në vlerën 120,000 lekë ka vetëm faturën elektronike nr 9538/2022 dt.24.01.2022 nga subjekti N. M.L03202402E pa Dokumente vërtetuese të tilla që vërtojnë procedurën e prokurimit të kryer (emergjence apo blerje me vlerë të vogël) dhe fletë hyrjen e kryer

-Furnizim dhe vendosje e sinjalistikës së orientimit të brendshëm 366,015 lekë datë 15.03.2022 Faturë me nr 25/2021 datë 16.11.2021 të operatorit ekonomik V. L. PF për shërbimet Dizenjator, dekor, reklama, postera, etj, preventiv me vleren 366,035 leke, kërkesë me nr 1081 prot., datë 02.11.2021 të Drejtorit Ekonomik pa Dokumente vërtetuese të tilla që vërtojnë procedurën e prokurimit të kryer (emergjence apo blerje me vlerë të vogël) dhe fletë hyrjen e kryer.

-Blerje medikamente me vlerë totale 936,000 lekë tek operatori F. datë 09.02.2022 detyrim nga viti 2021 pa Dokumente vërtetuese të tilla që vërtojnë procedurën e prokurimit të kryer (emergjence apo blerje me vlerë të vogël) dhe fletë hyrjen e kryer

-Blerje medikamenti-propofol me vlerën 49,600 lekë datë 29.01.2022 R. F. fatura nr.5983/2022 likujduar me datën 22.04.2022 pa Dokumente vërtetuese të tilla që vërtojnë procedurën e prokurimit të kryer (emergjence apo blerje me vlerë të vogël) dhe fletë hyrjen e kryer

-Blerje medikamente me vlerën totale 459123 lekë likujduar më datë 21.04.2022 G.P.fatura nr.1480/2022 dhe fatura nr.1508/2022 pa Dokumente vërtetuese të tilla që vërtojnë procedurën e prokurimit të kryer (emergjence apo blerje me vlerë të vogël) dhe fletë hyrjen e kryer

-Blerje medikamente dhe materiale mjekesore me vlerën totale 459,123 lekë likujduar më datë 21.04.2022 G. P. fatura nr.1480/2022 vlera 124850 lekë dhe fatura nr.1508/2022 me vleren 334,273 leke pa Dokumente vërtetuese të tilla që vërtojnë procedurën e prokurimit të kryer (emergjence apo blerje me vlerë të vogël) dhe fletë hyrjen e kryer

-Blerje medikamente me vlerën totale 49,842lekë likujduar më datë 21.04.2022 P. O. fat.3680/2022 vlera 92,301 lekë dhe fatura nr. fat.7542/2022 me vleren 406,120 leke pa Dokumente vërtetuese të tilla që vërtojnë procedurën e prokurimit të kryer (emergjence apo blerje me vlerë të vogël) dhe fletë hyrjen e kryer

-Blerje alchool dhe kaseta histologjike me vlerën 115,200 lekë tek subjekti K. shpk fat 417/2022 date likujdimi 04.05.2022 pa Dokumente vërtetuese të tilla që vërtojnë procedurën e prokurimit të kryer (emergjence apo blerje me vlerë të vogël) dhe fletë hyrjen e kryer

-Blerje reagent për shërbimin e kirurgjise (ligatures clips) në vlerën 49,500 lekë datë 25.02,2022 O. D. fatura nr. 341/2022 likujduar date 10.06.2022 pa Dokumente vërtetuese të tilla që vërtojnë procedurën e prokurimit të kryer (emergjence apo blerje me vlerë të vogël) dhe fletë hyrjen e kryer

-Likujdim fature T. L.shpenzime per dekore dhe postera me daten 15.03.2022 vlera 366015 leke subjekti i Regjistruar pa Dokumente vërtetuese të tilla që vërtojnë procedurën e prokurimit të kryer (emergjence apo blerje me vlerë të vogël) dhe fletë hyrjen e kryer

-Likujdim për shpenzime pritje përcjellje për 1 vjetorin e Spitalit me vlere 200,000 lekë datë 31.05.2022 blerë tek OE A. C. PF pa Dokumente vërtetuese të tilla që vërtojnë procedurën e prokurimit të kryer (emergjence apo blerje me vlerë të vogël) dhe fletë hyrjen e kryer.

-Nga shpenzimet totale që Spitali ka paguar për shpenzimet e akomodimit dhe të ushqimit për vitet 2021,2022,2023 për stafin mjekësor turk u konstatuan shpenzimet si më poshtë vijon:

Përshkrimi	viti 2021	viti 2022	viti 2023	Totali
Sherbim per akomodim	98,129,042	38,695,766.40	32,980,747.20	169,805,555
Ushqim	44,854,957	5,406,000	14,111,000	64,371,957
Shpenzime për lavanderi	10,892,093			10,892,093
Transport për lëvizjet	1,238,576	2,083,572	1,252,933	4,575,080
Paga dhe bonus	89,671,536	138,068,929	147,254,666	374,995,131
Totali	244,786,203	184,254,267	195,599,346	624,639,816

Për sa më sipër pagesat janë kryer në kundërshtim me VKM 660, datë 03.11.2021 ku në nenin 5 është përcaktuar që pala shqiptare merr përsipër vetëm shpenzimet e akomodimit dhe jo të ushqimit dhe të lavanderisë.

-Veprimet nëpërmjet magazinës

Ditaret e magazinave për vitet 2021, 2022,2023 janë mbajtur në formatin excel

Nga kontrolli i dokumenteve u evidentua se numrat e dokumenteve si për fletë hyrjet edhe për fletë daljet janë mbajtur jo në mënyrë kronologjike. dhe veprimet e Regjistrimit nuk japin informacionin kontabël për llogaritë 312, 327, 45, 218,212, 214, dhe 63. Kartelat e artikujve nuk janë të evidentuara për të gjithë artikujt e blerë apo të marra në kuadër të donacioneve dhe akt marrëveshjeve me spitalet e tjera.

Fletë hyrjet dhe fletë daljet janë në shumë raste me fraksion dhe numrat përsëriten si për mallrat e blera ashtu edhe për donacionet pra jo në kronologji me numrat paraardhës dhe pasardhës.

Në 10 raste të dokumentit të flete daljes kur mallrat kanë qenë donacione nga qytetarë si fletë hyrjet edhe flete daljet janë bërë pa vlera duke mos ngritur komision vlerësimi.

Për Artikujt AQT si PC, Monitor, projektor e laptop u konstatua se gjendja fizike ishte më e madhe se gjendja kontabile pasi nuk janë bërë hyrje dhe dalje në magazinë Ky informacion erdhi nga zyra e IT me e-mail e datës 28.07.2024 duke krahasur të dhënat në regjistrin e aktiveve. Bashkëlidhur janë të dhënat sipas këtij e-mail dhe nga regjistri i aktiveve.

Të gjitha këto veprime bien në kundërshtim me nenin 35, 36,37,38,39 deri tek pika 43 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar por edhe me ligjin nr 25/2018 per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Për vitin 2021

Gjatë vitit 2021 nevojat për karburant dhe lëndë djegëse për vënien në punë të kaldajës dhe të automjeteve janë realizuar me huamarrje nga spitalet e Gjirokastrës, Shkodrës, Fierit, QSUT për sasinë 23,988 litra gjithësej për automjetet dhe 15,978 litra për kaldajën dhe në shumën 7,125,048.5 leke, nga të cilat 4,280,381 lekë për automjetet dhe 2,844,667.5 lekë për kaldajën dhe gjeneratorin me anë të akt marrëveshjeve përkatëse. Gjatë periudhës audituese u konstatua se qiramarrja për 4 automjetet me targa AA825DJ, AB586BB, AA279VG, AA118MN nga operatori ekonomik “C” SHPK, dorëzimi është bërë sipas procesverbalit datë 18.06.2021 ku konfirmohet se automjetet janë të rinj dhe nuk janë plotësuar treguesit e kërkuar për harxhimin e karburantit për km të cilat janë prezent në momentin e dorëzimit. Përdorimi i automjeteve të përdorura ka sjellë konsum më të lart të karburantit në total një diferencë prej 2768 litra. Në dokumentacionin vërtetues dhe autorizues për konsumin e karburantit ka parregullsi: mungojnë autorizimet apo urdhrat për lëvizjet e automjeteve të cilat do të transportojnë stafin mjekësor turk nga aeroporti Rinasit-Hotel -SRMF, Hotel- SRMF-hotel, konsumi i karburantit të pajustificuar për periudhën 27.05.2021 deri më 18.06.2021 kur automjetet janë marrë në dorëzim më datën 18.06.2021 dhe nuk janë nënshkruar fletë udhëtimet nga asnjë prej drejtuesve të automjeteve.

Për vitin 2021 lidhur me normativat e konsumit të karburantit nga ana e Titullarit të Spitalit nuk ka urdhër të ngritur për llogaritjen e normativave të konsumit si për autoambulancat, për autoveturat e marra me qera, kaldajën dhe gjeneratorët. Referuar informacionit të dhënë me shkresën nr 204/1, datë 03.06.2021“MEMO” konstatohen të dhënat si vijon:

<i>Nr</i>	<i>Targa e automjeteve</i>	<i>Tipi</i>	<i>Normativa e Konsumit</i>
1	AA866XX	Ford Transit	15l/100km
2	AA865XX	Ford Transit	15l/100km
3	AA279VG	Hyndai	5.5 l/100km
4	AA825DJ	Hyndai	5.5 l/100km
5	AB586BB	Mitsubibish	6.5 l/100km
6	AA118MN	Fiat	12l/100km
7		Kaldaja	70l/h
8	ASKA	Gjenerator	161l/h

Burimi: SRMF

Vetëm për koordinimin e lëvizjeve të autoambulancave është ngritur urdhër i brendshëm me nr.1, datë 29.06.2021 “Për caktimin e koordinatorit për lëvizjen e autoambulancave”.

Të dhënat për konsumin e lëndës djegëse dhe karburant janë mbajtur dhe regjistruar në formatin excel dhe jo në progresiv muaj pas muaji në mënyrë që të bëhet e mundur monitorimi i km të kryera dhe konsumi i karburantit. Nga dokumentacioni i fletë udhëtimeve që çdo shofer kishte plotësuar, u konstatua se në disa raste km e përshkruara janë të pajustificuara duke e paraqitur distancën më tepër -llogaritur nga google map. Në tabelat e mëposhtme jepen të dhënat për karburantin e konsumuar, distancat në km të realizuara

Furnizimet nga çdo automjet, viti 2021

Nr	Targat e automjeteve	Tipi	Furnizimi	Km faktik	Konsumi sipas norm.	Diferencat
1	AA866XX	Ford Transit	1,855	12,776	1,916	-61
2	AA865XX	Ford Transit	221	2,256	338	-117
3	AA170FV	Fiat Dukato	606	9,319	513	93
4	AA279VG	Hyndai	1,484	21,405	1,177	307
5	AA825DJ	Hyndai	2,266	18,380	1,195	1071
6	AB586BB	Mitsubish	3,628	26,838	3,221	407
		Totali	10,060	90,974	8,360	1,700

Burimi: SRMF

Bazuar në kilometrat e përshkruara për 4 automjetet rezulton se diferenca midis sasisë së tërhequr prej 10,060 litra, dhe sasisë prej 8360 litra të llogaritur sipas katalogut është 1700 litra më tepër. Dëmi ekonomik i llogaritur në vlerën 314,500 lekë. Automjetet nuk janë të rinj por të përdorura dhe ka sjellë konsum më të lart të karburantit, në total një diferencë prej 2768 litra, e llogaritur si dëm ekonomik me vlerën 442,870 lekë.

Konsumi për karburantin

Targat e automjeteve	Km e përshkruara viti 2021	Diferencë konsum-katalog	Diferenca litra
AA279VG	9.319	2,5	233
AA825DJ	21.405	2,5	535
AB586BB	18.380	6,5	1.195
AA118MN	26.838	3,0	805
Totali	75.942	14,5	2.768

Burimi: SRMF

Referuar fletë daljeve të magazinës për periudhën 27.05.2021 deri më datën 18.06.2021 konstatohet konsum i pajustificuar në total 536 litra duke llogaritur një dëm ekonomik prej me vlerën 99,160 lekë. Mbajnë përgjegjësi znj M.Ç. si personi përgjegjës për planifikimin, menaxhimin dhe shpërndarjen e tij, ish magazinieri znj.K. C., kordinatorët për lëvizjet e autoambulancave si dhe drejtuesit e mjeteve që nuk kanë justifikuar distancat sipas fletë udhëtimeve.

Për vitin 2021 nga Sektori i Shërbimeve në asnjë rast nuk është bërë një planifikim i lëvizjeve të përaferta të automjeteve të cilat janë për lëvizjet e stafit mjekësor turk nga aeroporti i Rinanit drejt Hotelit, SRMF dhe anasjelltas si dhe lëvizjet ditore nga Hoteli drejt SRMF në mënyrë që të realizohet një menaxhim dhe planifikim sa më i mirë i konsumit të karburantit me *ekonomicitet eficence dhe efektivitet*. Mungesa e regjistrave për lëvizjet e automjeteve si dhe parregullsitë e kostuara në dokumentet autorizuese nga personi përgjegjës dhe drejtuesit e automjetit dhe nuk janë nënshkruar fletë udhëtimeve për lëvizjen e tyre e fletë udhëtimeve, vërtetojnë se rregjistrimi i të dhënave është jo të besueshëm mungon saktësia e rekordeve të mbajtura. Nga dokumentacioni i mbajtur në ditarin e magazinës për konsumin e karburantit të makinave me qira dhe për autoambulancat, konstatohet se regjistrimet janë kryer në mënyrë jo kronologjike. Për dokumentet e fletë daljeve dhe të fletë hyrjeve u konstatua se në data të ndryshme ishte vendosur i njëjti numër regjistrimi.

Më datën 30.12.2021 është mbajtur proces verbal ku konstatohet se për kaldajat janë bërë furnizimet me naftë 15,678 litra ose 2,844,667.5 lekë dhe 42,530 litra gaz 327,4810 lekë.

Referuar librave të punës rezulton se orët që kaldaja ka punuar gjatë periudhës shtatori-dhjetor 2021 me lëndën djegëse gaz LPG/GLN janë 234.5 orë ose 24384 litra. Gjendja e lëndës djegëse gaz në depozite është 18,146litra ose 1,397,242 lekë.

Orët që kaldaja ka punuar gjatë periudhës shtatori-dhjetor 2021 me naftë 12985 litra Gjendja e naftës në depozite është 2693 litra

Nga kostatimi rezulton se nuk është mbajtur libri i punës por konsumin e gazit dhe naftës në kaldaja për gjatë gjithë kohe janë mbajtur proces/verbale të cilat nuk janë të nënshruara nga të gjithë punonjësit por vetëm nga dy prej tyre.

Për vitin 2022

Nga auditimi i dokumentacionit vërtetues për konsumin e karburantit se mungon regjistrimi kronologjik i lëvizjeve të automjeteve (autovetura dhe autoambulanca) në format elektronik. Në muajin shkurt është ngritur urdhri me nr 28, datë 28.02.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e normës së harxhimit të karburantit për automjetet në pronësi e në përdorim të institucionit.

Normativat e Konsumit Viti 2022

Nr.	Targat/Marka	Tipi	Norma e Konsumit
1	AA866XX	Ford Transit	15l/100km
2	AA865XX	Ford Transit	15l/100km
3	AA170FV	FIAT	18/15l/100
4	AA279VG	Hyndai	8 l/100km
5	AA825DJ	Hyndai	8 l/100km
6	AB586BB	Mitsubibish	13 l/100km
7	AA118MN	Fiat	15l/100km
8	Kaldaja	Kaldaja	70l/h
9	Aska	Gjenerator	161l/h

Burimi: SRMF

Në muajin shtator është ngritur me urdhri nr 96, datë 13.06.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e normës së harxhimit të karburantit për automjetet në pronësi e në përdorim të institucionit, komisioni për normativat e konsumit të karburantit. Siç shihet në tabelën e mëposhtme bazuar në distancat (km) e përshkruara rezulton se ka mosrakordim midis sasisë së tërhequr prej 17,129 litra dhe sasisë së konsumuar prej 19,196 litra diferenca është 2067 litra dhe me vlerë 332,787 lekë, e cila përbën dëm ekonomik.

Diferencat furnizim konsum viti 2022

Nr	Targat e Automjeteve	Furnizime	Km Realiz	Konsumi	Diferenca
1	AA865XX	1,790	12,253	2,206	(416)
2	AA866XX	3,085	22,888	4,120	(1,035)
3	AB170FV	1,400	9,821	1,768	(368)
4	AA279VG	1,625	24,294	1,336	288
5	AA825DJ	490	7,489	412	78
6	AB586BB	2,400	19,526	2,343	57
7	AA118MN	2,925	23,533	2,353	572
8	AA560ON	1,004	15,743	1,574	(570)
9	AB381HO	1,145	9,450	1,418	(273)
10	AB391HO	1,239	10,958	1,644	(405)
11	AB392HO	26	225	23	4
	TOTALI	17,129	156,180	19,196	(2,067)

Burimi: SRMF

Mungesa e regjistrimit elektronik të lëvizjeve të automjeteve si dhe parregullsitë e konstatuara në dokumentet e fletë udhëtimeve, ku mungojnë nënshkrimet e kordinatorit, nënshkrimet e shoferëve, të cilat vërtetojnë se regjistrimi i të dhënave nuk është i saktë.

Për vitin 2023

Nga auditimi i dokumentacionit vërtetues për konsumin e karburantit mungon regjistrimi kronologjik i lëvizjeve të automjeteve (autovetura dhe autoambulanca) në format elektronik. Nuk janë firmosur fletë daljet nga shoferët e automjeteve dhe kordinatori, edhe autoambulancat u bë verifikimi me regjistrat e urgjencës ku kishte rakordim me largësitë e përshkruara.

në tabelën e mëposhtme bazuar në distancat (km) e përshkruara rezulton se ka mosrakordim midis sasisë së tërhequr prej 20,985 litra dhe sasisë së konsumuar prej 26,749 litra diferenca është 5764 litra me vlerë 933,768 lekë, e cila përbën dëm ekonomik.

Diferencat furnizim konsum viti 2023

Nr	Targat	Furnizimi	km faktik	normativa	Diferenca
1	AA560ON	1,627	20,045	3,608	(1981)
2	AA865XX	2,700	18,603	3,349	(649)
3	AA866XX	4,003	29,550	5,319	(1316)
4	AB170FV	3,112	21,870	1,312	1800
5	AB381HO	2,035	17,815	1,069	966

6	AB391HO	2,281	21,027	2,523	(242)
7	AB392HO	-	-	-	-
8	AA686VE	1,350	25,923	2,592	(1242)
9	AB867IV	2,027	29,066	4,360	(2333)
10	AA839TS	1,850	17,447	2,617	(767)
	TOTALI	20,985	201,346	26,749	(5764)

Burimi: SRMF

Për sa më lart, të gjitha shkeljet dhe veprimet e mësipërme llogarisin në total një dëm ekonomik prej **2,123,085 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi zj. M. Ç, zj. K. C, z. E. Sh, Zj M. G, z. D. N. Për sa më sipër të gjitha shkeljet e konstatuara janë në kundërshtim me nenin 2, nenin 20, të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për kontrollin dhe menaxhimin financiar” me pikat 35, 36, 42, 43, 45, 46 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.628/30 prot. datë 29.10.2024, protokolluar në KLSH me nr. 610/10 prot., datë 04.11.2024, nga zj. R. D, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Për sa i përket pretendimeve të SRMF, të paraqitura në shkresën nr.628/30 prot.datë 29.10.2024 “Dërgohet komentet/vërejtjet mbi raportin e Auditimit të KLSH” të S R “M” Fier, jepet shpjegimi dhe argumentimi se gjatë vitit 2021, nevojat për karburant dhe lëndë djegëse për vënien në punë të kaldajës dhe të automjeteve janë realizuar me huamarrje nga spitalet e Gjirokastrës, Shkodrës, Fierit, QSUT për sasinë 23,988 litra gjithsej për automjetet dhe 15,978 litra për kaldajën dhe në shumën 7,125,048.5 me anë të aktmarrëveshjeve përkatëse, sqarojmë se këto spitale nuk na kanë mbuluar me karburante në formë huamarrjeje, por në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Soziale Nr. 257, datë 21.05.2021 “Mbi marrjen e masave për zbatimin e planit të mobilizimit, për një periudhë tranzitore, deri në vënien në funksion me kapacitet të plotë të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier” i ndryshuar, pika 1 e tij, **urdhërohen institucionet** “...1. Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitalin Rajonal Vlorë, Spitalin Rajonal Fier, Spitalin Rajonal Gjirokastër dhe Spitalin Bashkiak të Lushnjës të **angazhohen maksimalisht për t’iu përgjigjur të gjitha nevojave për mallra dhe shërbime të domosdoshme për vënien në funksion të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, deri në përfundimin të procedurave ligjore organizative administrative etj. për vënien në funksion.**

pra Spitali Rajonal Memorial Fier, nuk i ka kthyer mbrapsht spitaleve publik të sipërcituar mall në formë huaje apo të këtë paguar vlerën e këtyre mallrave pasi spitalet e tjerë kanë mbuluar përkohësisht nevojat për karburante të spitalit Memorial sipas buxhetit të tyre, bazuar në Urdhrin e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të sipërcituar. Për vitin 2021, në mungesë edhe të burimeve njerëzore sepse Spitali sapo ishte krijuar si institucion shëndetësor publik, grupi i punës nuk ka mbajtur procesverbal për normativat e karburanteve por ka nënshkruar një akt me shkresë zyrtare ‘Memo’, në të cilën referohen normativat përkatëse të çdo automjeti si dhe normativat për kaldajën, gjenerator. Për sa i përket normativave të viteve 2022 dhe 2023 janë ngritur grupet e punës dhe kanë mbajtur procesverbalet përkatëse. Në tre periudhat përmbledhëse 2021 – 2022 – 2023 për konsumin dhe furnizimet përsa i përket vitit 2021, totali i furnizimeve për automjetet ka qënë 10,060 litra dhe konsumi ka qënë 8360 litra. Diferenca prej 1700 litra rezulton gjëndje në vazhdim për konsum. Kjo diferencë nuk mund të konsiderohet dëm ekonomik sipas ligjit, sepse konsumi rezulton të jetë më pak sesa furnizimi.

Periudha Maj-Dhjetor 2021

Nr	Automjetet	Furnizime	km e kryer	Konsumi
1	AA866XX	1,855	12,776	1,916
2	AA865XX	221	2,256	338
3	AA279VG	606	9,319	513
4	AA825DJ	1,484	21,405	1,177
5	AB586BB	2,266	18,38	1,195
6	AA118MN	3,628	26,838	3,221

	Shuma	10,060	90,974	8,360
--	--------------	---------------	---------------	--------------

Periudha Janar-Dhjetor 2023

Periudha Janar-Dhjetor 2022

Automjetet	Furnizime	km e kryer	konsumi	Nr	Automjetet	Furnizime	km e kryer	konsumi
AA560ON	1,627	20,045	3,608	1	AA865XX	1,790	12,253	2,206
AA865XX	2,7	18,603	3,349	2	AA866XX	3,085	22,888	4,12
AA866XX	4,003	29,55	5,319	3	AB170FV	1,400	9,821	1,768
AB170FV	3,112	21,87	1,312	4	AA279VG	1,625	24,294	1,336
AB381HO	2035	17815	1069	5	AA825DJ	490	7489	412
AB391HO	2,281	21,027	2,523	6	AB586BB	2,400	19,526	2,343
AA686VE	1,35	25,923	2,592	7	AA118MN	2,925	23,533	2,353
AB867IV	2,027	29,066	4,36	8	AA560ON	1,004	15,743	1,574
AA839TS	1,85	17,447	2,617	9	AB381HO	1,145	9,45	1,418
Shuma	20,985	201,346	26,749	10	AB391HO	1,239	10,958	1,644
				11	AB392HO	26	225	23
					Shuma	17,129	156,18	19,196

Përsa i përket periudhës janar- dhjetor 2022 dhe janar-dhjetor 2023 kjo pasqyruar edhe në tabelat e mësipërme na rezulton se furnizimet janë më pak se konsumet. Si rrjedhim edhe kjo diferencë nuk përbën dëm ekonomik sepse Drejtoria e Financës dhe e Shërbimeve të Përgjithshme ka shlyer si detyrim vetëm furnizimet në vlerë monetare dhe jo konsumin. Atëherë nuk kemi të bëjmë me dëme ekonomike por me parregullsi në mbajtjen e dokumentacioneve përkatëse nga personat përgjegjës që ka sjellë efekt negativ financiar, por jo dëm ekonomik në buxhetin e institucionit tonë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Shkeljet e konstatuara në administrimin e karburantit paraqesin keqmenaxhim të fondeve pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficence. Lidhur me pretendimet tuaja sqarojmë se, referuar dokumentacionit të magazinës për konsumin e karburantit, ju keni deklaruar se sasi të tërhequra dhe të konsumuara janë të barabarta ndërkohë që të gjitha diferencat janë të konstatuara nga grupi i auditimit. Referuar informacionit tuaj ju keni deklaruar se për vitin 2021 keni tërhequr dhe konsumuar 10,060 litra, për vitin 2022 keni tërhequr dhe konsumuar 17,129 litra, dhe 20,985 litra për vitin 2023. Për automjetet që nuk janë të rinj por të përdorur konsumi është më i lartë dhe është llogaritur diferenca prej 2768 litra.

Grupi i auditimit ka konstatuar se për vitin 2021 sasia faktike e konsumuar duhet të jetë 8,360 litra diferenca prej 1700 litra është e pajustificuar dhe përbën dëm ekonomik, për vitin 2022 referuar kilometrave të përshkruara dhe normativave, sasia faktike duhej të ishte përkatësisht 19,196 litra dhe për vitin 2023 duhej të ishte 26,749 litra, pra rezulton se sasia e konsumuar është më e madhe se sasia e tërhequr, që do të thotë se distancat e përshkruara janë paraqitur në mënyrë fiktive. Gjithashtu sasia e tërhequr nga magazine prej 536 litra pa marrë në dorëzim automjetet përbën dëm ekonomik. Dokumentacioni bashkëngjitur observacionit tuaj nuk është i mjaftueshëm dhe nuk ka mbështetje ligjore. Ju nuk keni paraqitur fakte të reja apo argumenta justifikuese për parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara. Pretendimi nuk qëndron, ky koment nuk merret në konsideratë.

-Mbi veprimet nëpërmjet arkës

Pagesat me arkën janë kryer me limit ditor në shumën 50,000 lekë, sipas VKM 290, datë 14.06.1993 “Për limitin e arkës në ndërmarrjet shtetërore” i ndryshuar, me limit jo më shumë se 10,000 lekë, duke vepruar në kundërshtim edhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Në të gjithë ditaret apo librat kontabël ku janë bërë regjistrimet kontabël për veprime e ngjarjet ekonomike në veprimtarinë e Spitalit, nuk janë mbajtur saktë ditaret i shpenzimeve, ditari i të ardhurave, ditari magazinës, ditari veprimeve ndryshme, libri i madh- centralizatori , ditare të tjerë të nevojshëm për regjistrimin e veprimeve e ngjarjeve të ndryshme ekonomike kontabile Rezultojnë se veprime e ngjarje ekonomike kontabile të ndryshme nuk janë regjistruar në llogaritë e përcaktuara në ligjin e kontabilitetit dhe udhëzimet e MFE.

Në ditarin e arkës, regjistrimi i ngjarjes ekonomike kontabile të arkëtimit të vlerave përkatëse nga pacientët për shërbimet që janë kryer është bërë me shprehjen "Arketuar nga klientet", pra nuk përkrahë emër, mbiemër i pacientit, lloji i shërbimit që ka paguar. Rregjistrimi i pagesave të bëra nga arka është përkrahë me shprehjen "Pagesë", "Pagesë parkimi", "Pagesë për blloqe arkëtimi", "Pagesë për ilaçe", etj, pra nuk përkrahë emër, mbiemër i punonjësit që ka përfituar pagesën, shërbimin apo punën që ka kryer, numrin dhe datën e faturës së përfituesit, etj.

Nuk ka mbajtur të gjithë ditarët apo librat kontabël ku rregjistrohen b. veprimet e ngjarjet ekonomike kontabile të cilët evidentojnë veprimtarinë e Spitalit, nuk është mbajtur ditari i shpenzimeve, ditari i të ardhurave, ditari magazinës, ditari veprimeve ndryshme, libri i madh-centralizatori, ditarë të tjerë të nevojshëm për regjistrimin e veprimeve e ngjarjeve të ndryshme ekonomike kontabile.

Pagesat e kryera nëpërmjet arkës për vitet 2021-2023

Muaji	Vitet		
	2021	2022	2023
Janar	-	386,070	287,920
Shkurt	-	269,720	98,120
Mars	-	239,690	88,500
Prill	-	152,070	191,100
Maj	-	117,970	202,300
Qershor	-	233,360	199,120
Korrik	286,705	77,200	105,980
Gusht	298,935	26590	0
Shtator	361,830	65,380	65,600
Tetor	450,320	192,035	91,670
Nëntor	543,550	144785	32100
Dhjetor	326,850	239,590	153,080
Shuma	2,268,190	2,144,460	1,515,490

Në ditar në asnjë rast nuk ka të përkrahë veprimin e pagesës, dhe as numrin rendor kronologjik por thjesht me përkrahë pagesë. Ka mungesa në dokumentacionin vërtetues.

-Materialet e pastrimit janë blerë me mandat pagesën nr.139, datë 06.10.2021, paguar shuma 49980 lekë, me mandat pagesën 142 datë 11.10.2021 me vlerë 49930 lekë, me mandat pagesën 164 datë 21.10.2021 me vlerë 49000 lekë për të njëjtat artikuj pastrimi dhe nuk ka as kërkesë dhe miratim nga titullari.

-Me mandat pagesën nr.150, datë 15.10.2021 është blerë mokat me gjithë elementët fiksues, ndërkohë që përkrahë jepet tapet shiu dhe nuk ka fh dhe as fletë dalje, paguar shuma 50,000 lekë. Referuar dokumentacionit vërtetues konstatohet se nuk është pasqyruar tek Regjistri i inventarit të imët

-Me mandat pagesën nr.154, datë 19.10.2021 është blerë bombul oksigjeni me rregullator ndërkohë që tek kërkesa e paraqitur për këtë shpenzim kërkon bombula 5kg dhe 10kg Vlera e paguar është 20,000 lekë Referuar dokumentacionit vërtetues konstatohet se s' ka proces verbal të marrjes në dorëzim dhe nuk është pasqyruar tek Regjistri i inventarit të imët

-Me mandat pagesën nr 158 datë 19.10.2021, me vlerën 1908 lekë, nr 189 datë 10.11.2021, me vlerën 2600 lekë për autoambulancën AA866XX, është blerë AD blue. Konsumi për këtë tip makine është 5 litra për 100km. Procesverbali dhe kërkesa është firmosur vetëm nga Znj.C dhe në të gjitha rastet ku është blerë AD BLUE për autoambulancat nuk është paraqitur kupon tatimor për pagesën por një dokument tjetër fletë dalje e magazinës nga subjekti J. shpk

Në ditar nuk ka nr mandat pagese por vetem datë 01.11.2021 me shumën 49,500 lekë ku janë blerë 660 litra gaz LPG me 75l lekë pa procedurë prokurimi, për testimin e kaldajës. Dokumentet vërtetues nuk janë në përputhje me ligjin e prokurimit dhe të VKM pa asnjë procedurë prokurimi në kundërshtim me nenin 11 nenin 56 pika 9 dhe 11 të VKM 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik".

-Gjatë muajit nëntor janë kryer 5 pagesa "punime për lulishten" përkatësisht me shumën totale 223,500 lekë përkatësisht në datën 12.11.2021 me shumën 35100 lekë, më datën 16.11.2021,

datë 18.11.2021, datë 22.11.2021, datë 24.11.2021 me vleren 47100 lekë secila pa asnjë procedurë prokurimi në kundërshtim me nenin 11 nenin 56 pika 9 dhe 11 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.

-Me mandat pagesën nr 199 datë 15.11.2021 me vlerë 6000 lekë është bërë blerje pompe për kaldajën por nuk ka specifikime, por vetëm një kërkesë nga punonjësi i mirëmbajtjes nuk është bërë hyrje në magazinë dhe s’është kontabilizuar tek Regjistri i AQT.

Janë kryer për gjithë vitin 12 pagesa për furnizim me Ad Blue në total 36,760 lekë për automjetin AA866XX si vijon:

Nr MP	Data	Emertimi	Shuma
8	11.01.2022	pagese per AD BLUE	2,600
40	28.01.2022	pagese per AD BLUE	2,500
44	01.02.2022	pagese per ad blue	2,500
88	01.03.2022	Pagese per Ad Blue	2,000
117	23.03.2022	Pagese Ad Blue	4,000
118	23.03.2022	Pagese Ad Blue	4,000
133	05.04.2022	Pagese per Ad Blue	5,580
187	26.05.2022	Pagese per Ad Blue	2,830
228	01.07.2022	Pagese per Ad Blue	2,500
236	07.07.2022	Pagese per Ad Blue	2,490
274	12.08.2022	Pagese per Ad Blue	2,650
293	31.08.2022	Pagese per Ad Blue	2,600
346	18.10.2022	Pagese për Ad Blue+parkim	4,500
		Totali	40,750

Gjithashtu janë kryer 4 pagesa për punime me lulishten ne vlerën totale 31,500 lekë. Në 11 raste 97,260 lekë janë bërë blerje kancelarie duke bërë copëzimin e fondit.

Nr	Data	Emertimi	Shuma
9	11.01.2022	Pagese per baze materiale	2,000
20	17.01.2022	Pagese per liber protokolli	1,000
36	26.01.2022	Pagese per bateri per holterin	4,600
57	09.02.2022	Pagese per liber arke	500
126	30.03.2022	Pagese kancelari	49,920
141/142	11.04.2022	Pagese per liber arke / kase	3,140
150	19.04.2022	Pagese per bateri	2,000
167	10.05.2022	Pagese per bateri kodak	8,000
168	11.05.2022	Pagese per liber arke	600
333	06.10.2022	Pagese pagese kancelari	25,000
376	11.11.2022	Pagese per komision banke	500
		Totali	97,260

Pagesat e kryera me arkë për blerje dhe shërbime, janë kryer të gjitha pa asnjë procedurë prokurimi në shkelle të Udhëzimit 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 62,63,64,65,68 dhe VKM 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, duke bërë copëzimin e fondeve. Kontabilizimi i këtyre shpenzimeve nuk është kryer korrekt në përputhje me udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022” Për disa ndryshime në udhëzimin nr 8, datë 09.02.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pa siguruar transparencë të të dhënave të plota duke mos paraqitur me vërtetësi të dhënat e nevojshme për vendimmarrje eficiente dhe me efektivitet.

-Me mandat pagesën nr.92, datë 07.04.2023, paguar shuma 45,000 lekë për “Dieta dhe Pritje Përcjellje”. Referuar dokumentacionit konstatohet se është parapaguar dieta për 3 punonjës për dy ditë qëndrimi në Tiranë me argumentimin dorëzim dokumentacioni dhe 15,000 lekë për shpenzim pritje përcjellje pa program të miratuar apo preventiv të shpenzimeve

-Me mandat pagesën nr.110, datë 11.04.2023, paguar shuma 23,000 lekë për “Dieta ushqimore”. Për personelin turk 23 ditë x 1000 lekë=23000 lekë

-Me mandat pagesën nr.170, datë 26.06.2023, paguar shuma 35,000 lekë për “Blerje tavolina për shërbimin angiografi”. Referuar dokumentacionit konstatohet se blerja është realizuar vetëm nëpërmjet 1 kërkesë nga pavioni dhe konfirmimi nga titullari, pa u përcaktuar elementët dhe specifikimet e tavolinave si madhësia, ngjyra, dimensionet e materialeve, etj. Nuk është pasqyruar në Regjistrin e aktiveve.

-Me mandat pagesën nr.154, date 12.06.2023 paguar shuma 19,800 lekë për “Blerje materiale pastrimi, 6 kova larje shtrydhje” për këtë qëllim është zhvilluar procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale pastrimi” me fond limit 5,700,717 lekë, ku referuar nevojave edhe prokurimi i këtyre artikujve duhej parashikuar në procedurën e prokurimit.

-Me mandat pagesën nr.151, datë 08.06.2023, paguar shuma 25,900 lekë për “Blerje kasafortë për arkën”. Ky shpenzim ishte parashikuar në Regjistrin e prokurimeve me fond limit 50,000 lekë Referuar specifikimeve teknike dhe studimit të tregut fondi limit doli 169,738 lekë mbi fondin e parashikuar në Regjistër dhe nga Sektori i prokurimit nuk u miratua zhvillimi i procedurës

Blerja është realizuar pa procedurë prokurimi në mënyrë të drejtpërdrejtë pasi vlera ishte nën 100,000 lekë. Kjo pajisje nuk është kontabilizuar si AQT dhe nuk është pasqyruar në Regjistrin e aktiveve. Dokumenti vërtetues i FH është me nr 39/3 datë 06.06.2023 para datës së pagesës dhe jo me nr kronologjik me fletëhyrjen paraardhëse në kundërshtim me pikën 35/b) të Udhëzimit 30 datë 27.11.2011. Nuk ka procesverbal të marrjes në dorëzim

-Me mandat pagesën nr.150, datë 08.06.2023, paguar shuma 4,920 lekë për “Blerje letër termike” ndërkohë që duhej të përfshihej në procedurën për prokurim me objekt “Blerje kancelarie”, nuk ka miratim nga nd/Ekonomik apo titullari i SRM Fier.

-Me mandat pagesën nr.166, datë 21.06.2023, paguar shuma 3,000 lekë për “Shërbim catering”

-Me mandat pagesën nr.129, datë 19.05.2023, paguar shuma 50,000 lekë për “Blerje dhe vendosje xhami” sipas kërkesës nga R. F, E. Sh dhe I. A me argumentin se u thye nga karoca e nje patienti. Blerja është kryer pa specifikime teknike si edhe pa përcaktuar sipërfaqen e tij. Në faturë është shkruar sasia 1 copë dhe vlera 50,000 lekë.

“Shpenzime pritje përcjellje” dhe për “Dekor” janë paguar në totale 529,350 lekë. Në asnjë rast nuk ka program pune dhe preventiv shpenzimesh për pritje përcjelljet e organizuara.

-Me mandat pagesën nr.135/1, date 25.05.2023, paguar shuma 40,000 lekë për “Shpenzime pritje përcjellje”, mungon dokumentacioni justifikues si Programi dhe preventivi kërkesa nga shërbimet mbështetëse, numri pjesëmarrësve etj, dokumente ligjore të domosdoshme për kryerjen e pagesës. Fatura nr.144/2023 me vlerë 40,000 lekë ka të përcaktuar 10 copë vlera 40,000 lekë, lëshuar nga subjekti L.H PF (Mandat pagesa nënshkruar nga M. G, K. K dhe N. M)

-Me mandat pagesën nr.131, date 22.05.2023, paguar shuma 50,000 lekë për “Pastrim gjelbërim” për frezimin e tokës. Kërkesa nr.474/2, datë 04.04.2023, nga E. Sh përgjegjës i shërbimeve, kopshtari P. H dhe zv/drejtori turk I. A kërkohet pastrimi i 1000- 1500 m2 sipërfaqe si:

Pastrimi kallamave përballë fasadës

Pasurimi tokës për ruajtjen e bimëve

Pastrimi teritorit nga barishtet dhe frezimi tokes.

Kërkesa nuk është miratuar nga titullari dhe nuk ka asnje dokument tjetër, mungon procesverbali per kryerjen e punimeve dhe pranimin e shërbimit të kryer

Kërkesa nr.474, date 04.04.2023 nga E.Sh përgjegjës i shërbimeve, kopshtari P. H dhe zv/drejtori turk I. A kërkohet pastrimi i 1000- 1500 m sipërfaqe si:

Pastrimi kallamave përballë fasadës

Pasurimi tokës për ruajtjen e bimëve

Pastrimi teritorit nga barishtet dhe frezimi tokes.

Kerkesa nuk është miratuar nga titullari dhe nuk ka asnje dokument tjetër. Gjithashtu mungon procesverbali per pranimin e kryerjes së punimeve

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 9 dhe nenin 12 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, në nenin 1 “Përgjegjësia e autoritetit/entit kontraktor” në nenin 11, pika 3 dhe në nenin 56 pika 9 dhe 11 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, në Ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në pika 35,36,42,43,45,46 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

3. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave.

Për zbatimin e strukturës organizative, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Struktura organizative,
- Dosjet e personelit,
- Rregullorja e brendshme,
- Rregullorja për përcaktimin e kriterëve të punësimit sipas pozicionit të vendit të punës,
- Kontrata kolektive dhe ato individuale të punës,
- Procedurat e rekrutimit dhe përfundimit të marrëdhënieve të punës,
- Procedurat e dhënies të masave disiplinore,
- Hartimi i listë pagesave.

Struktura Organizative

Me urdhrin e Ministrit nr.181/1, datë 25.03.2021 është krijuar struktura e Spitalit Rajonal Memorial Fier (SRMF), e cila ka në përbërjen e saj 398 punonjës, staf administrativ, mjekësor dhe mbështetës.

Me vendimin e Bordit Drejtues nr. 6, datë 21.09.2021, me urdhrin e Ministrit nr. 503, datë 22.11.2021 dhe urdhrin e brendshëm nr.503/1, datë 24.11.2023 “Për një ndryshim në strukturën organizative të spitalit Memorial Fier”, janë bërë ndryshime ku Kabineti i Hemodinamikës me 4 punonjës është kthyer në Shërbim Hemodinamike me 1 Shef Shërbimi, 1 mjek, 1 kryeinfermier dhe 7 infermierë.

Numri i teknikëve të Shërbimit të Anestezi – Reaminacionit ka shkuar nga 5 teknikë në 3. Numri i infermierëve në shërbimin e Transfuzioligjisë ka shkuar nga 2 në 1, në shërbimin e Pneumonisë nga 7 në 6 dhe në shërbimin e Kardiologjisë nga 8 në 6.

Tabela nr. 1: Të dhëna përmbledhëse për treguesit e punës për periudhën objekt auditimi

Emërtimi	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Nr mesatar i punonjësve	398	227	398	265	398	281
Paga mesatare (lekë)	-	46,044	-	101,923	-	115,179
Fondi i pagave	243,000,000	158,424,653	394,100,000	324,114,747	409,200,000	388,838,708

Burimi: Të dhëna të gjeneruara nga subjekti

Sipas buxhetit të miratuar në SMRF për vitin **2021**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 398 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve të vitit 2021 është realizuar 227 punonjës. Fondi i pagave është 243,000,000 lekë, pra **84,575,347 lekë** dhe **171 punonjës** më pak se plani.

Për vitin **2022**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 398 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve të vitit 2022 është realizuar 265 punonjës. Fondi i pagave është 394,100,000 lekë, pra **69,985,253 lekë** dhe **133 punonjës** më pak se plani.

Për vitin **2023**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 398 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve të vitit 2023 është realizuar 281 punonjës. Fondi i pagave është 409,200,000 lekë, pra **20,361,292 lekë** dhe **117 punonjës** më pak se plani.

Tabela nr. 2: Të dhëna lidhur me lëvizjet e stafit në SRMF

Largime nga puna	2021	2022	2023	Total

Mbarim kontrate	60	146	144	350
Larguar me dorëheqje	23	22	17	62
Larguar / në total	83	168	161	412
Pension	0	0	0	0
Emërimet e reja	346	156	198	
Emërimet e reja staf turk	113	104	135	352

Burimi: Të dhëna të gjeneruara nga subjekti

-Me vendimin e Bordit Drejtues nr. 3, datë 15.03.2022 “Për ngritjen e Bordit të Burimeve Njerëzore pranë Spitalit Rajonal “Memorial”, Fier” është ngritur bordi i përbërë nga Drejtori i Përgjithshëm, Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Përgjegjësi i Sektorit të Rekrutimeve, Nëndrejtori i Përgjithshëm (turk), Shef i Shërbimit të Urgjencës (turk) dhe Shef i Shërbimit të Kirurgjisë (turk). Detyrat e këtij bordi përfshijnë propozimin e emërimeve të shefave të shërbimeve, analizën dhe propozimet e ndryshimeve në strukturë drejtuar Bordit Drejtues, si dhe miratimin e kriterëve të punësimit.

Referuar të dhënave të mësipërme konstatohet se numri i planifikuar i punonjësve ka qenë 398 dhe nuk është plotësuar për gjithë periudhën objekt auditimi. Shërbimet të cilat nuk janë funksionale në këtë spital janë shërbimi i kirurgjisë kardio-vaskulare dhe shërbimi i kirurgjisë torakale. Shërbimi infektiv në këtë spital ka funksionuar vetëm në periudhat 05.07.2021-31.12.2021 dhe 21.01.2022-15.04.2022.

Nga strukturat drejtuese të SRMF nuk është analizuar nevoja për numër punonjësish, ecuria e punësimeve, shkaqet të cilat kanë sjellë mosrealizim të numrit të planifikuar të punonjësve, si edhe ndikimin që mund të ketë mungesa e stafit në performancën e spitalit.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: Drejtoresha e Përgjithshme znj. R. D., Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme znj. N. M., Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore znj. R. M.

Punonjësit e përkohshëm

Struktura e SRMF përfshin punonjës të përhershëm dhe të përkohshëm, nga ku rezulton se punonjës të përkohshëm janë 43 (pra 10% e numrit total të 398 punonjësve). Ky zë në strukturën organizative përfshin 20 sanitare, 1 recepsioniste dhe 1, të cilat në fakt janë pjesë e përhershme e kësaj strukture, mbasi konstatohet se janë punësuar prej krijimit të spitalit dhe në vazhdim.

-Me shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 102 prot, datë 18.05.2021 “Kërkesë për personel mbështetës (sanitare)”, në mungesë të kapaciteteve të burimeve njerëzore në fazën e parë të hapjes së tij, me qëllim mundësimin për shërbimin e mirëmbajtjes dhe pastrimit, SRMF -ja i është drejtuar Spitalit Rajonal Fier, për të vënë në dispozicion staf mbështetës (sanitare).

-Me shkresën nr. prot.102/1, datë 18.05.2021 “Kthim përgjigje” të Spitalit Rajonal Fier, në kuadër të bashkëpunimit për mundësimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe pastrimit në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier, deri në plotësimin e stafit të SRMF-së, i janë vendosur në dispozicion 15 sanitare.

-Me shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm nr. prot.592, me datë 17.08.2021 “Kërkesë për miratim punësimi”, SRMF i është drejtuar Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) për 20 sanitare.

-Me shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS nr. 3532/1 prot, datë 30.08.2021 “Miratim kërkesë” është dhënë miratimi për punësimi i 20 sanitare, me kontratë të përkohshme, deri në përfundim të procedurave publike për ofrimin e shërbimit të pastrimit në SRMF.

-Për sa më sipër, me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.249, datë 01.09.2021 “Për krijimin e komisionit AD – HOC”, është ngritur komisioni i përbërë nga 3 anëtarë, për të kryer procedurat lidhur me punësimin e 20 sanitareve.

-Me Procesverbalin e datës 03.09.2021 komisioni AD - HOC janë pasqyruar intervistat e aplikanteve për pozicionin Sanitare, dhe është vijuar me lidhjen e kontratave individuale të punës me afat të caktuar 3 - mujor, dhe me përfundimin e këtij afati është proceduar me anekse kontratash me afat 6 - mujor.

Punësimi i sanitarëve me kontrata 3 - mujore dhe në vijimësi me kontrata 6 - mujore nuk justifikohet në asnjë rast me natyrën e punës, duke qenë se detyra e sanitarëve është e përhershme, pasi është një detyrë e nevojshme, e domosdoshme dhe jetike lidhur me funksionimin e spitalit, si edhe është e lidhur ngushtësisht me higjienën spitalore, pra kjo kategori rezulton se duhet të ishte përfshirë dhe miratuar në strukturë si punonjës të përhershëm.

Nga grupi i auditimit konstatohet se punësimi i tyre ka ndodhur në gusht të vitit 2021 dhe me ezaurimin e afateve ligjore nuk janë marrë masa për lidhjen e kontratave me afat të pacaktuar. Po kështu, konstatohet se sanitarët nuk janë pjesë e strukturës të përhershme, nuk janë vlerësuar si strukturë e domosdoshme dhe pjesë e punonjësve të spitalit për kryerjen e shërbimit, duke lënë hapësirë për shkelje të Kodit të punës dhe për lëvizje të paargumentuara nga puna.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimin e nenit 140, pika 2 të Ligjit nr. 136, datë 05.12.2015 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: Drejtoresha e Përgjithshme znj. R.D., Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme znj. N. M, Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore znj. R.M.

Statuti i SRMF

Me urdhrin e Ministrit nr. 182/1, datë 07.05.2021 “Për miratimin e statutit të spitalit Memorial Fier” është miratuar dhe ka hyrë në fuqi menjëherë statuti i këtij spitali. Me urdhrin e Ministrit nr. 453, datë 25.10.2021 “Për miratimin e statutit të spitalit Memorial Fier” janë miratuar disa ndryshime në statut.

Kontrata Kolektive dhe Kontrata Individuale

Marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me kontratën kolektive nr. 1528/1 prot, datë 30.03.2021 midis Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm znj. G.P. dhe Konfederatës të Sindikatave të Shqipërisë, të përfaqësuar nga z. K. N. Kjo kontratë është nënshkruar mes palëve në datën 30.03.2021, për një periudhë tre vjeçare.

Me vendimin e Bordit Drejtues nr. 5, datë 21.09.2021 është miratuar kontrata Tip për personelin shqiptar dhe atë turk.

Grupi i auditimit konstaton se për periudhën maj-shtator 2021, rezulton se midis SRMF dhe stafit turk nuk janë lidhur kontrata punësimi. Kontratat me stafin turk kanë nisur të lidhen në tetor 2021. Nga grupi i auditimit konstatohet se kontratat e lidhura midis SRMF dhe stafit turk kanë pasur ndryshime në krahasim me kontratat e lidhura midis SRMF dhe stafit shqiptar, pavarësisht se në vendimin e Bordit nr. 5, datë 21.09.2021 është vendosur se kontrata Tip për të dy stafet do të ishte e njëjte.

Me vendimin e Bordit Drejtues nr. 4, datë 15.03.2022 “Miratimi i kontratës Tip për personelin turk”, kontrata Tip e personelit turk ndryshon nga kontrata Tip e personelit shqiptar, duke miratuar kontratën faktike e cila është përdorur për stafin turk nga krijimi i SRMF deri në mars 2022.

Referuar pikës 2 të vendimit të Bordit “Kontrata Individuale e Punës, kontratë tip për personelin shqiptar dhe turk e miratuar me vendimin e Bordit Drejtues nr. 5, datë 21.09.2021 të zbatohet vetën për personelin shqiptar” rezulton se ndryshimet konsistojnë në disa nene të cilat nuk janë pjesë e kontratave individuale të personelit turk:

1. Neni 4 “Koha e punës”,
2. Neni 5 “Detyrimet e punëmarrësit”,
3. Neni 6 “Detyrimet e përgjithshme të punëdhënësit”,
4. Neni 10 “Mungesa për shkak të sëmundjes”,
5. Neni 11 “Dëmet”,
6. Neni 12 “Masat disiplinore”.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me: VKM nr. 58, datë 17.03.2021 “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, si projekt pilot”, neni 20, ku citohet se “Marrëdhëniet e punës së punonjësve të spitalit rregullohen në

bazë të dispozitave të Kodit të Punës”, Kodin e Punës (ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015), Neni 3/1, pika 2.e “parimin e trajtimit të barabartë, përfshirë dispozitat e kontratës kolektive”.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: Drejtoresha e Përgjithshme znj. R. D., Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme znj. N. M., Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore znj. R.M.

Urdhri i mjekut dhe i infermierit në Republikën e Shqipërisë

Gjatë periudhës maj 2021 - dhjetor 2023, SRMF ka punësuar në total 83 mjek turq.

Nga grupi i auditimit konstatohet se janë licencuar vetëm 8 mjekë turq (afërsisht 10%) me “Urdhrin e mjekut” duke derdhur detyrimin financiar, prej 300,800 lekë.

Për periudhën Maj 2021-Dhjetor 2023, janë punësuar 250 punonjës turq në profesionin “Infermierë”, të cilët nuk janë licencuar nga urdhri i Infermierit në RSH.

-Bazuar në legjislacionin shqiptar çdo shtetas i huaj i cili ushtron profesionin e mjekut dhe infermierit në Republikën e Shqipërisë duhet të licencohet nga Urdhri i Mjekëve dhe Urdhri i Infermierëve. Mjekët dhe infermierët turq nuk janë të licencuar në shtetin e tyre, pasi në shtetin turk nuk njihet procedura e licencimit të stafit mjekësor. Pjesë e Protokollit të hartuar mes palës shqiptare dhe asaj turke është detyrimi i palës shqiptare të bashkëpunojë me urdhrat përkatës për lëshimin e lejeve të ushtrimit të profesionit për të gjithë profesionistët mjekësor turq.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 58, datë 26.01.2022 “Për miratimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë të Republikës të Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, gjatë fazës kalimtare”, neni 4. B, pika 5 “Bashkëpunon me urdhrat profesionistë përkatës për lëshimin e lejeve të ushtrimit të profesionit për të gjithë profesionistët turq”, Ligjin nr. 123/2014 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 5, pika 3, ku citohet se: “Çdo mjek, shtetas i huaj, që të ushtrojë profesionin si rezident në Shqipëri, apo i atashuar në një institucion shëndetësor ku vjen periodikisht për ushtrimin e profesionit, duhet të ketë edhe këto dokumente” dhe me Ligjin nr. 9718, datë 19.04.2007 “Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë”, neni 5, pika 4, ku citohet se: “Anëtarë të Urdhrit të Infermierit bëhen edhe të gjithë infermierët dhe mamitë, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e shtetas shqiptarë dhe të huaj, të diplomuar jashtë vendit, pas njohjes së diplomës, sipas legjislacionit në fuqi”.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: Drejtoresha e Përgjithshme znj. R.D, Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme znj. N. M, Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore znj. R.M.

Pagesat e punonjësve turq dhe shqiptar

Pagesat e punonjësve turq dhe atyre shqiptar kryhen referuar VKM nr. 555, datë 11.08.2021, i ndryshuar. Referuar lidhjes 10 të VKM, është përcaktuar shpërblimi i punonjësve të caktuar nga pala turke në SRMF si personel mjek si edhe në pozicionet “Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale”, ku rezulton se pagat bruto të stafit shqiptar janë në nivelet nga 77,800 –168,000 lekë, kurse pagat bruto të stafit turk (duke përfshirë bonusin i cili është në varësi të pozicioneve 205,000-300,000 lekë) janë në nivelin 282,800-468,000 lekë.

Konstatohen diferenca në paga krahasuar me stafin shqiptar për të njëjtat pozicione pune.

Ky diferencim dhe sjellje preferenciale, mund të sjellë pakënaqësi të shoqëruar me ulje të performancës në punë dhe shërbimin ndaj pacientëve të palës shqiptare.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kodin e Punës (ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015), Neni 115, “Barazia në shpërblim”, pika 2, ku citohet se “Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, sipas nenit 9, të këtij Kodi, në lidhje me të gjitha aspektet dhe kushtet e shpërblimit për punë të njëjtë ose për punë me vlerë të barabartë”,

si dhe “Ndalimi i diskriminimit” neni 9, pika c, ku citohet se “kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”.

Procedura e Rekrutimit të Punonjësve

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka ngritur Urdhrin nr. 243, datë 06.05.2021 “Për ngritjen e komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e personelit mjekësor dhe administrativ me arsim të lartë në Spitalin Rajonal Memorial Fier.

Procedura e rekrutimit të burimeve njerëzore është kryer me urdhër transferime të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për pozicionet, si vijon:

-Për procedurat e rekrutimit të stafit mjekësor në SRMF janë mbështetur në shkresat “Miratim transferimin” të ardhura nga MSHMS, për transferimin e 3 mjekëve nga Spitali Rajonal Fier,

-Procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier është mbështetur në shkresat “Miratim transferimin” të ardhura nga MSHMS, për transferimin e 20 punonjësve (nga Spitali Rajonal Fier dhe nga Qendrat shëndetësore me urdhër të MSHMS),

-Për pozicionet e administratës janë transferuar 9 punonjës nga Spitali Rajonal Fier.

-Për pozicionet “mjekë”, procedura e rekrutimit është kryer bazuar në Udhëzimin nr. 499, datë 02.07.2019 “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”.

Spitali Rajonal “Memorial” Fier i dërgon njoftimet për vendet e lira të punës në (DQOSHKSH) Vlorë, njoftimi për vende të lira të punës publikohen në portalet përkatës “Mjek për Shqipërinë” “Infermier për Shqipërinë”. Spitali Rajonal Memorial Fier ka ngritur urdhër për ngritjen e komisionit të vlerësimit për pozicionin mjek.

-Për procedurën e rekrutimit për “profesionistët e shkencave mjekësore teknike” procedura e rekrutimit bazohet në udhëzimin nr.481, datë 27.06.2019 “Për procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar”. Në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier raportimi i vendeve të lira të punës bëhet pranë DROSHKSH Vlorë, për publikim në portalin “Infermier për Shqipërinë”.

-Për procedurat e rekrutimit të stafit administrativ në SRMF është mbështetur në Kodin e Punës, pozicionet e lira të punës shpallen në Buletin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimeve Publike si dhe në faqen-ëeb të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier. Njoftimi për vendet e lira të punës qëndron i publikuar 7 (shtatë) ditë kalendarike nga data e botimit të këtij njoftimi në Buletin e APP.

Procedura e rekrutimit të të punësuarit i bashkëlidhet dokumentacionit të dorëzuar nga punëmarrësi dhe inventarizohet nga DMBNJ së bashku “Formularin prezantues të dosjes”.

Punonjësi regjistrohet në Regjistrin Themeltar të punonjësve si dhe bëhet hapje e librezës së punës.

Tabela nr. 3: Të dhënat e lëvizjeve të punonjësve

Largime nga puna	2021	2022	2023	Total
Mbarim kontrate	60	146	144	350
Larguar me dorëheqje	23	22	17	62
Larguar / në total	83	168	161	412
Pension	0	0	0	0
Emërimet e reja	346	156	198	
Emërimet e reja staf turk	113	104	135	352

Burimi: Të dhëna të gjeneruara nga subjekti

Evidentohet mungesa e deklarimeve për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Fier, si edhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: Drejtoresha e Përgjithshme znj. R.D, Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme znj. N. M, Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore znj. R. M.

Rekrutimi i Përgjegjës të Auditit të Brendshëm

-Me shkresën nr. 1639 prot, datë 01.12.2022 “Kërkesë për asistencë juridike” SMRF i është drejtuar MFE lidhur me procedurën e rekrutimit të Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm, nisur nga fakti që kjo procedurë është mbyllur pa aplikante, dhe janë punësuar 2 specialiste. Paqartësia lidhet me mundësinë e këtyre 2 specialisteve për të hartuar Kartën e Brendshme të Auditit, Kodin e Etikës të Auditit, Rregulloren e Brendshme për funksionimin e Auditit të Brendshëm, planin vjetor e strategjik, angazhimin në auditim, etj, deri sa të plotësohet pozicioni i Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm.

-Me shkresën e MFE nr. 22292/1 prot, datë 27.12.2022 “Kthim përgjigje” është sjellë në vëmendjen e spitalit rolin e auditimit të brendshëm në mbështetje të titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të kontroleve të brendshme të vendosura duke adresuar rekomandime për përmirësimin e mangësive të konstatuara dhe që realizohet nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike.

Po ashtu, vihet në vëmendje funksionimi i shërbimit të auditit të brendshëm si një strukturë e tërë dhe në përmbushje të përgjegjësi individuale nga i gjithë stafi i punësuar pranë NJAB, nga Përgjegjësi i Sektorit sipas përcaktimeve në nenin 14 të ligjit 114/2015, si dhe nga audituesit e brendshëm sipas përcaktimeve në nenin 16 të këtij ligji.

-Me urdhrin nr. 130 prot, datë 20.01.2023 “Caktimin e ekspertit të jashtëm të përkohshëm për Sektorin e Auditit” është emëruar znj. V.D, me qëllim arritjen e objektivave të spitalit duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të kontroleve të brendshme për Sektorin e Auditit (eksperte e jashtme) në pozicionin Përgjegjëse e Sektorit të Auditit të Brendshëm pranë SRMF.

-Kontrata e shërbimit e përkohshme nr. 130/1 prot, datë 23.01.2023 është lidhur mes palëve me datë fillimi 23.01.2023 dhe datë përfundimi 23.04.2023.

-Me aneksin e kontratës të shërbimit të përkohshëm nr. 130/2 prot, datë 24.04.2023 është shtyrë afati i kësaj kontrate deri në datën 24.10.2023.

-Me shkresën nr. 130/3 prot, datë 11.10.2023 “Për përfundimin e kontratës me nr. 130/1 prot, datë 23.01.2023” është caktuar përfundimi i punësimit të ekspertit të jashtëm në këtë pozicion data 24.10.2023.

Tabela nr. 4: Pagesat e përgjegjëses të auditit të brendshëm

Nr.	Viti 2023	Masa e shpërblimit	Tatimi 15%	Pagesa neto	Data e pagesës
1	Janar	19,411	2,912	16,499	23.02.2023
2	Shkurt	61,000	9,150	51,850	06.03.2023
3	Mars	61,000	9,150	51,850	11.04.2023
4	Prill	61,000	9,150	51,850	09.05.2023
5	Maj	59,100	8,865	50,235	09.06.2023
6	Qershor	59,100	8,865	50,235	06.07.2023
7	Korrik	59,100	8,865	50,235	02.08.2023
8	Gusht	59,100	8,865	50,235	06.09.2023
9	Shtator	59,100	8,865	50,235	10.10.2023
10	Tetor	59,092	8,864	50,228	02.11.2023
	Totali	557,003	83,551	473,452	

Burimi: Të dhëna të gjeneruara nga SRMF

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM Nr.353, datë 11.05.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, pika 5 “Në njësitë publike, të cilat kanë varësi nga dy ose më shumë institucione dhe nuk kanë të krijuar njësinë e auditimit të brendshëm, shërbimi i auditimit të brendshëm kryhet nga institucioni në fushën e përgjegjësisë shtetërore të të cilit bën pjesë njësia publike” dhe pika 6.b “kontraktimit të personave fizikë ose juridikë, të certifikuar si “auditues të brendshëm”, i cili kryhet vetëm në rastet kur është i pamundur krijimi i shërbimit të auditimit sipas formave të tjera të parashikuara në nenin 10, të ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Njësia publike, për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm me kontraktim, duhet të planifikojë

një fond që nuk duhet të jetë më shumë se 30% e pagës mesatare vjetore të një punonjësi, të njëjtë me nivelin e pagës së audituesit në sektorin publik”.

Nga grupi i auditimit konstatohet se nuk janë përmbushur kërkesat për të cilat ekspertja është punësuar, si hartimi i Kartës së Brendshme të Auditit, Kodin e Etikës të Auditit, Rregulloren e Brendshme për funksionimin e Auditit të Brendshëm, planin vjetor e strategjik, dhe angazhimi në vetëm tre auditime. Po ashtu konstatohet se Përgjegjësja e Auditit të Brendshëm, në periudhën në të cilën është kontraktuar në këtë detyrë ka qenë njëkohësisht e punësuar me kohë të plotë në Degën e Thesarit Fier, fakt të cilin nuk e ka deklaruar në lidhjen e marrëdhënies të punësimit.

Veprime këto në kundërshtim me Kontratën e Shërbimit nr. 130/1 prot, datë 23.01.2023, neni 4, pika 1 “*Orët e fillimit dhe të mbarimit të punës shkruhen në rregulloren e brendshme ose me urdhër të titullarit, brenda kufijve të parashikuar nga ligji dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave*”, pika 2 “*Vendi i punës të punëmarrësit do të jetë Spitali Rajonal Memorial Fier*”, dhe Rregullores të Brendshme, Kreu 3, neni 28, pika 1 “*Orari i punës në institucion është nga ora 8:00 deri në orën 16:30, ditën e premte nga ora 8:00 deri në orën 14:00, e shtuna e diela janë pushim.*”

Lidhja e kontratës të shërbimit mes palëve bie në kundërshtim me Ligjin nr.114, datë 22.10.2015, i ndryshuar “*Për auditin e brendshëm në Sektorin Publik*”, kreu IV, neni 10, pika 2/1 “*Modeli i marrëveshjes ndërmjet titullarëve të njësive publike, si dhe i kontratës, kur kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm realizohet me kontraktim, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat.*”

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk justifikojnë në asnjë rast pagesën e Përgjegjësës së Auditit të Brendshëm, e për pasojë vlera e pagesës 557,003 lekë konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e SMRF. *Sa më sipër mban përgjegjësi Drejtoresha e Përgjithshme znj. R.D.*

Rekrutimi i punonjësve turq

Çdo muaj raportohet pranë Ministrisë së Shëndetësisë Turke për vendet e lira të punës pranë Spitalit Rajonal Memorial Fier.

Ministria e Shëndetësisë Turke, nis në adresën zyrtare të Spitalit Rajonal Memorial Fier shkresën e skanuar të personelit mjekësor dhe jo mjekësor që janë përcaktuar të punojnë përkohësisht nga Ministria e Shëndetësisë Turke si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Bashkimin Evropian pranë Spitalit Rajonal Memorial Fier.

Dosjet e personelit

Nga auditimi i ushtruar në 102 dosje personeli të SRMF (nga të cilat 30 staf turk dhe 72 staf shqiptar) për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin ligjor, konstatohet se: dosjet e personelit janë të plotësuara me dokumentet ligjore si certifikata e gjendjes familjare, vërtetime nga prokuroria, gjykata, librezën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; raport mjekësor për aftësinë në punë; të dhënat për marrëdhëniet e punës, diploma e shkollës së lartë, lista e notave; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja,, procedura e rekrutimit, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Po kështu u konstatua se dosjet e personelit kanë rregullshmëri në pasqyrimin dhe renditjen e dokumentacionit, kanë të bashkëngjitur inventarin e dosjes.

Masat Disiplinore

-Me urdhrin nr. 1122 prot, datë 09.11.2021 “*Krijimin e Komisionit të Disiplinës për personelin mjekësor në Spitalin Rajonal Memorial Fier*” është ngritur komisioni i përbërë nga:

1. R. M, Përgjegjëse e Sektorit të Rekrutimeve (Kryetar),
2. Dr. E. Xh, Mjeke Specialiste Reumatologe (Anëtar),
3. Dr. M. Gj, Mjeke Specialiste ORL (Anëtar),
4. A. R, Përgjegjëse e Sektorit Juridik (Anëtar),
5. I. D, Kryeinfermier i Përgjithshëm (Anëtar),
6. E. Xh, Kryeinfermiere Kirurgjia e Përgjithshme (Anëtar),
7. M. J, Kryeinfermier i Urgjencës (Anëtar).

-Me urdhrin nr. 1118 prot, datë 09.11.2021 “Krijimin e Komisionit të Disiplinës për personelin e administratës në Spitalin Rajonal Memorial Fier” është ngritur komisioni i përbërë nga:

1. R. M., Përgjegjëse e Sektorit të Rekrutimeve (Kryetar),
2. J. D, Përgjegjëse e Sektorit të Performancës (Anëtar),
3. A. R, Përgjegjëse e Sektorit Juridik (Anëtar).

-Me urdhrin nr. 1123 prot, datë 09.11.2021 “Krijimin e Komisionit të Disiplinës për personelin mbështetës në Spitalin Rajonal Memorial Fier” është ngritur komisioni i përbërë nga:

1. A. R, Përgjegjëse e Sektorit Juridik (Kryetar),
2. I.G, Përgjegjëse e Sektorit të Koordinimit me Pacientin (Anëtar),
3. R.M, Përgjegjëse e Sektorit të Rekrutimeve (Anëtar).

-Me urdhrin nr. 703 prot, datë 19.05.2023 “Ndryshimin e Aktit Administrativ /Urdhër nr. 61 ‘Krijimin e Komisionit të Disiplinës për personelin e administratës në Spitalin Rajonal Memorial Fier’” është ndryshuar komisioni i përbërë nga:

1. R. M, Përgjegjëse e Sektorit të Rekrutimeve (Kryetar),
2. D. K, Përgjegjëse e Sektorit Juridik (Anëtar),
3. J. D, Përgjegjëse e Sektorit të Rekrutimeve (Anëtar).

Tabela nr.5: Evidencat e masave disiplinore

Nr	SMRF	Vërejtje	Vërejtje paralajmërim pushim nga puna	me për	Kalim në një detyrë të një niveli apo klasë më të ulët	Pushim nga puna
1	Viti 2021	1	-	-	-	-
2	Viti 2022	16	1	-	-	-
3	Viti 2023	28	1	-	1	-
Totali		45	2		1	-

Burimi: Të dhëna të gjeneruara nga subjekti

Nga grupi i auditimit konstatohet se është dhënë 1 vërejtje gjatë vitit 2021, 17 vërejtje për vitin 2022 dhe 30 vërejtje gjatë vitit 2023.

Mbi procedurën e ndjekur për dhënien e masave disiplinore ndaj punonjësve të SRMF për shkeljet administrative rezultojn se:

-Personeli i SRMF kur ka dijeni apo dyshon për shkelje disiplinore të kryera nga personeli mjekësor/administrativ/mbështetës, duhet ta raportojë atë me shkrim drejtuar Komisionit Disiplinor përkatës, për personin që pretendohet se ka kryer shkeljen. Kjo ankesë duhet të plotësojë kushte si: të jetë me shkrim, të identifikojë personelin përkatës që pretendohet se ka kryer shkeljen disiplinore dhe të përcaktojë veprimin konkret që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij. Nuk pranohen kërkesa anonime për shqyrtim.

-Në rast se informacioni rezulton të ketë elemente të klasifikuara si shkelje disiplinore, Komisioni i Disiplinës i klasifikon shkeljet sipas Ligjit nr. 152/2013, si dhe bazuar Kontratës Individuale të Punës.

-Komisioni i Disiplinës fillon ecurinë disiplinore dhe njofton me shkrim nëpunësin përkatës për shkelje e pretenduar për të, të drejtën për të paraqitur me shkrim sqarimet rreth shkeljes të pretenduar, inspektimin e dosjes të procedimit, për tu dëgjuar ai vet ose përfaqësuesi ligjor, për të paraqitur prova dhe dëshmitarë, ose për të kërkuar marrjen e tyre. Data kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar nuk mund të caktohet më shpejt se 4 ditë dhe jo më vonë se 16 ditë nga marrja e njoftimit.

-Komisioni i Disiplinës heton të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e ngjarjes dhe mund të përdorë çdo mjet për të mbledhur prova në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

-Komisioni Disiplinor merr vendim për ndërprerjen e ecurisë disiplinore ose masën disiplinore në varësitë rrethanave të caktuara.

Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se në përgjithësi nuk ka procedura transparente, dhe nuk ka komision apelimi për të ankumuar vendimin përfundimtar.

Këto veprime bien në kundërshtim me: - Pika 3, kreu 6, i Udhëzimit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr.481, datë 27.06.2019 “Për procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në Institucionet Shëndetësore Publike në Republikën e Shqipërisë”.

-Pika 3, kreu VII, Udhëzim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 499, datë 02.07.2019 “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në Institucionet Shëndetësore Publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet Platformës Elektronike”.

-Pika 3, kreu V, Udhëzim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr.673, datë 02.10.2019 “Për procedurat e punësimit të punonjësve të administratës në OSHKSH, spitalet rajonale/bashkiake dhe NJVKSH”. *Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: Drejtoresha e Përgjithshme znj. R.D., Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme znj. N.M.*

-Plotësimi i listë pagesave nga punonjësi i caktuar për pagat, si dhe mbështetja në të dhënat e dokumentacionit bazë (listë prezencë e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Kontrolli dhe nënshkrimi nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.

Nga auditimi i listë pagesave për periudhën e përcaktuar në program, rezultoi se përmbledhëset e listë pagesës në çdo rast janë të nënshkruara nga eprori direkt dhe drejtori i departamenti etj. Listë pagesat janë të shoqëruara me listë prezencat përkatëse për çdo drejtori. Listë pagesat paraqesin nga paga bruto, shtesat, ndalesat deri në pagën neto.

Në procedurën e pagesës hartohet listë prezencë dhe nënshkruhet nga drejtorët e drejtorive më pas hartohet listë pagesa mbi bazën e klasifikimit të pagave, shtesa për pozicione të veçanta pune të cilat janë të miratuara nga Bordi Drejtues, duke kryer llogaritjet për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe kontributet e sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësorë plotësohet listë-pagesa përkatëse dhe dërgohet në bankë për pagesë.

Janë kryer ndalesat për tatimin e të ardhurave personale nga punësimi sipas përcaktimeve në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe janë paguar brenda datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa, me përjashtim të muajit maj 2021 dhe në muajin shkurt 2023, vonesa për të cilat janë gjobitur nga Drejtoria e Tatimeve në vlerën 30,000 lekë.

Është përlllogaritur, ndalur dhe derdhur në organet tatimorë kontributi i sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësorë mbi bazën e pagës minimale dhe maksimale si dhe përqindjeve përkatëse punëdhënës e punëmarrës.

Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësorë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës. Pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësorë në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimorë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 6: Të dhëna përmbledhëse për detyrimet nga marrëdhëniet e punës për periudhën objekt auditimi

Nr	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
1	Fondi i pagave gjithsej	243,000,000	394,100,000	409,200,000
2	Detyrimi për tatimin mbi të ardhurat personale	8,078,580	15,767,493	21,305,476
3	Gjoha të paguara për pagesë të vonuar	25,000	-	5,000
4	Interesa të paguar për pagesë të vonuar	-	-	-
5	Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	31,073,189	60,539,764	75,552,718
6	Gjoha të paguara për pagesë të vonuar	-	-	-
7	Interesa të paguar për pagesë të vonuar	-	-	-

Burimi: Të dhëna të gjeneruara nga subjekti

Grupi i auditimit konstaton se janë kryer pagesa mbi orët e punës jashtë orarit ku çdo orë shtesë (jo më shumë se 200 orë në muaj), paguhet me 25% mbi pagën e orës ditore me vlerën totale për periudhën objekt auditimi 651,218 lekë, si më poshtë:

Tabela nr.7: Të dhëna mbi orët e punës jashtë orarit

SMRF	Orë jashtë orari		Vlera ALL		
	Periudha	Ditë Normale	Ditë Feste	Ditë Normale	Ditë Feste
2021	-	-	-	-	-
Viti 2022	22 dite/464orë	3 dite/24 orë	216,416	3,272	
Viti 2023	110 dite/932 orë	8 dite/32 orë	421,505	10,025	
Totali	132 ditë/1396 orë	11 ditë/56 orë	637,921	13,297	

Burimi: Të dhëna të gjeneruara nga subjekti

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: Drejtoresha e Përgjithshme znj. R. D., dhe Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme znj. N. M.

Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturorë, etj.

Me vendimin e Bordit Drejtues nr. 9, datë 29.12.2022 “Për miratimin e mënyrës të përdorimit të të ardhurave dytësore të Spitalit Rajonal ‘Memorial’ Fier” është miratuar shpërblimi i punonjësve shqiptarë të këtij spitali në vlerën 13,306,000 lekë dhe është dërguar për miratim në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Tabela nr.8: Të dhëna përmbledhëse për përdorimin e fondit të veçantë për periudhën objekt auditimi

Nr	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
1	Fondi i veçantë	-	-	-
2	Shpërblime për rezultate në punë	-	-	-
3	Shpërblime për fund viti (nga të ardhurat dytësore)	-	12,838,133	-
4	Shpërblime sëmundje	-	42,500	-
5	Për largime nga puna	-	-	-
6	Për raste fatkeqësie/lindje	-	25,500	60,000
7	Për dalje në pension	-	-	-

Burimi: Të dhëna të gjeneruara nga subjekti

Nga grupi i auditimit konstatohet se vendimi i Bordit Drejtues nuk është miratuar nga MSHMS dhe punonjësit e SRMF janë shpërblyer në vlerën 12,838,133 lekë, vlerë kjo e cila konsiderohet si shpenzim pa ekonomikitet në buxhetin e SRMF. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 1 të VKM nr. 809, datë 12.12.2022, ku përcaktohet. Sa më sipër mbajnë përgjegjësi Drejtoresha e Përgjithshme znj. R. D., Drejtoresha e Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme znj. N. M.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.628/30 prot. datë 29.10.2024, protokolluar në KLSH me nr. 610/10 prot., datë 04.11.2024, nga zj. R. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit të audituar: 1. Drejtorja e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka publikuar në vazhdimësi vendin e lirë të punës në pozicionin “Përgjegjës Sektori” në Sektorin e Auditit pranë Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, në web-faqen e SRMF-së si dhe në Agjencinë e Prokurimeve Publike Tiranë botuar në Buletinin e njoftimeve publike për vende të lira pune Të gjitha këto shpallje janë mbyllur pa konkurrentë. Kontrata e shërbimit për punësim të përkohshëm si eksperte e jashtme me kohë te pjesshme me znj. V.D.u nënshkrua për shkak të nevojës të trajtuar si më sipër dhe ka përfunduar, pra Spitali e ka ndërprerë këtë marrëdhënie pune të përkohshme.

2. Ky shpërblim nuk ka burim financimi buxhetin e shtetit dhe fondin e veçantë, por rrjedh nga të ardhurat dytësore të Spitalit Memorial Fier të cilat ligjërisht përdoren nga vetë spitali, sipas kriterëve që përcaktohen në statut dhe miratohen nga Bordi Drejtues i spitalit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: 1. Argumentet tuaja lidhur me punësimin e Përgjegjës së Auditit të Brendshëm nuk sjellin asnjë dokument justifikues dhe fakt shtesë e të patrajtuar nga

grupi i auditimit në mënyrë plotë dhe shteruese në të gjitha fazat e auditimit, dhe për këto arsye nuk merret në konsideratë.

2. Observacioni juaj nuk sjell të dhëna shtesë e argumente shtesë dhe nuk merret në konsideratë.

4. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit.

Për mbajtjen e evidencës kontabël, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Pasqyrat financiare të viteve 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me formatet 1-9.

-Dokumente kontabël si: ditari i bankës, ditari i arkës, ditari i magazinës, ditari i pagave i veprimeve të ndryshme, debitorët, kreditorët, furnitorët, etj.

-Dokumentecioni i kryerjes së inventareve të aktiveve per periudhën audituese vitet 2021, 2022,2023,

-Regjistri i aktiveve.

-Urdhër shpenzimet dhe dokumentecioni vërtetues bashkëlidhur për vitet 2021, 2022, 2023.

-Evidencat për shpenzimet dhe të ardhurat e krijuara dhe të përdorura dërguar në FSDKSH (DRFFier) dhe në Degën e Thesarit, Fier në mbyllje të vitit buxhetor 2021, 2022, 2023.

-Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për investimet, përditaret,shpenzimet e të ardhurave, etj).

Spitali Rajonal Memorial Fier për periudhën audituese 2021,2022,2023 ka hartuar Pasqyrat Financiare brenda afateve kohore të përcaktuara.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga Drejtori i Përgjithshëm i SRM Fier znj. R.D dhe janë dërguar si vijon:

- Për vitin ushtrimor 2021 shkresa nr.538 prot., datë 31.03.2022” Shkresë përcjellëse”, i është përcjellë vetëm Degës së Thesarit Fier dhe DRF Fier me e-mail në të njëjtën datë.
- Për vitin ushtrimor 2022, shkresa nr.396 prot., datë 13.03.2023 “Relacion shpjegues për pasqyratfinanciare të vitit 2022” i është përcjellë Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Degën e Thesarit Fier dhe në Drejtorinë Rajonale të FSDKSH Fier brenda afateve ligjore.
- Për vitin ushtrimor 2023 shkresa nr.446 prot., datë 13.03.2024 “Relacion shpjegues për pasqyratfinanciare të vitit 2023” i është përcjellë Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Degën e Thesarit Fier dhe në Drejtorinë Rajonale të FSDKSH Fier brenda afateve ligjore.

Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është emëruar znj.R. D., Drejtor i Spitalit Rajonal Memorial Fier. Nëpunësi Zbatues i nivelit të dytë ka qenë z.S.K., Drejtor i Buxhetit pranë Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për periudhën 08.04.2021 deri në 15.12.2021 , miratuar me shkresën nr 84, datë 08.04.2021 “Kërkesë për depozitim firme të titullarit të Institucionit”. Për periudhën nga 16.12.2021 e në vazhdim në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është e caktuar znj.N. M., Drejtor i Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme me shkresën nr 1242/1, datë 16.12.2021”Mbi caktimin e Nëpunësit Zbatues”.

- *Rakordimi i vlerave të pasqyrave financiare me vlerat e nxjerra nga llogaria bankare e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.*

Nga verifikimi i ditarit të bankës dhe arkës i mbajtur sipas natyrës dhe sipas destinacionit rezulton se vlerat totale janë të rakorduara me lëvizjet sipas llogarisë bankare (debi e kredi) nxjerr për çdo muaj (statement banke, T. Bank), por referuar vlerave të paraqitura në situacionin 12 mujore dhe ato mujore, Pasqyra 11 “Situacioni i Shpenzimeve”, Pasqyra 12 “Pasqyra e Realizimit dhe Përdorimit të të Ardhurave Dytësore” i kontratës me FSDKSH dhe lëvizjeve debitore e kreditore nxjerr për çdo muaj si dhe për periudhën 12 mujore nga llogaria bankare T.Bank, rezultojnë diferenca për të cilat ka paqartësi dhe nuk ka relacion me argumentet shpjegues.

- *Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentecionit justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore,*

financiare dhe rezultatit.

Në lidhje me vërtetësinë e informacionit kontabël dhe për t'u siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryhen testime në regjistrimet e ditareve kontabël në lidhje me:

- Tërësinë e regjistrimeve nëse janë në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor dhe në të gjithë ciklin e tij.
- Kontrollin rrjedhës dhe kontrollin e mëvonshëm nëpërmjet mbështetjes së dokumenteve justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Shqyrtimin e vlefshmërisë së regjistrimit fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollin e vlefshmërisë së një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimin e pajtueshmërisë së vlerave përmbledhëse të nxjerra nga regjistrimet kronologjike meregjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2021 rezulton se:

-Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore dhe u konstatua se në këtë institucion, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në programin Microsoft Office “**Excel**”. së bashku me Pasqyrat financiare - Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar; Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare ose pasqyra e të ardhurave dheshpenzimeve; - Formati 3 - Pasqyra e flukseve monetare; - Formati 4 - Pasqyra e ndryshimeve nëaktivet neto/fondet neto; - Formati 5 - Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore) janë plotësuar edhe Pasqyrat statistikore - Formati 6 - Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre; - Formati 7 - Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveveafatgjata me koston historike dhe me vlerën neto AQT dhe AQJT; - Formati 8 - Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave të ndarë sipas drejtimit, kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetsore.

Në zbatim të Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin nr 5, datë 22.02.2021, Kreu III, “Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njërive të qeverisjes së përgjithshme” në të cilën përcaktohet: Mbyllja e llogarive vjetore nga ana e njërive të qeverisjes së përgjithshme si një proces i domosdoshëm, ku duhet ndjekur radha kronologjike përparapërgatitjes së pasqyrave financiare vjetore *u kontrolluan* zbatimi i pikës 43 “*Fillimisht, njësite e qeverisjes së përgjithshme (në varësi të mënyrës së mbajtjes së kontabilitetit) përgatisin dokumentin përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, gjatë periudhës ushtrimore vjetore*”, dhe të realizojnë transaksionin e transferimit të tepricës së llogarisë 85 “*Rezultat i veprimtarisë ushtrimore*” në llogarinë 12 “*Rezultat i mbartur*”, zbatimi i pikës 43”*Pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, hartuesi i pasqyrave financiare duhet të realizojë veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, për periudhën ushtrimore që raportohet.*

Konstatohet se nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme nuk janë kryer procedurat ligjore të mësipërme.

-Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme. SRMF ka përgatitur gjatë periudhës ushtrimore vjetore dokumentet përmbledhës të transaksionevedhe veprimeve nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik.

SRMF ka filluar aktivitetin në vitin 2021, prandaj në vijim trajtohet vetëm evidentimi i të dhënave pasi nuk mund të bëhen krahasime me periudhën e mëparshme.

- Pasqyra e performancës financiare ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Nr. Llog.	P e r s h k r i m i i o p e r a c i o n e v e	Viti Ushtrimor 2021
A	Te Ardhurat	309,543,640
70	<i>I.Te Ardhurat Nga Taksat E Tatimet</i>	0
75	<i>Ii.Kontribute Sigurime Shoqerore E Shendetesore</i>	0
71	<i>Iii.Te Ardhura Jo Tatimore</i>	10,569,093
710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	0
7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare	
7101	Nga Ndermarrjet publike financiare	
7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	10,569,093
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	
7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	10,569,093
72	V.GRANTE KORENTE	298,974,547
720	1.Grant korent I Brendshem	298,974,547
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	179,939,741
7206	Financim i pritshem nga buxheti	119,034,806
	VI.TE ARDHURA TE TJERA	0
3	<i>VII.Ndryshimi i gjendjes se inventarit te produkteve</i>	
B	Shpenzimet	317,413,711
600	I.Pagat dhe perfitimet e punonjseve	183,355,661
6001	Paga, personel I perhershem	111,015,654
6002	Paga personel I Perkohshem	0
6003	Shperblime	72,340,007
6009	Shpenzime te tjera per personelin	0
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	30,973,367
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	27,198,835
6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	3,774,532
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	137,747,577
602	Mallra dhe sherbime te tjera	36,938,867
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	0
6021	Materiale dhe sherbime speciale	0
6022	Sherbime nga te trete	42,457,771
6023	Shpenzime transporti	0
6024	Shpenzime udhetimi	0
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	0
6026	Shpenzime per qeramarrje	0
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	0
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	0
6029	Shpenzime te tjera operative	58,350,939
686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare	
63	<i>VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</i>	-34,662,894
	IX.SHPENZIME TE TJERA	0
85	Teprica ose deficieti i periudhes (Rezultati i veprimtarise)	-7,870,071

Burimi SRMF

Për sa vijon u auditua gjendja e llogarive kontabile datë 31.12.2021 për mjetet monetare, të inventarëve, të dokumenteve të tjerë vërtetues (mandat arketimet, situacioni për të ardhurat e realizuara dhe të përdorura, urdhër transferta banke, ekstrakt të lëvizjeve monetare bankare) ditaret e bankës, ditaret e arkës, dokumentet për donacionet dhe aktmarrëveshjet për huadhënie midis Spitaleve për artikuj të ndryshëm dhe për sherbime të domosdoshëm për fillimin e veprimtarisë së SRMF. Nga kontrolli i të dhënave në Pasqyrën e performancës financiare ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve disa të dhëna të regjistruara në kontabilitet nuk përputhen me të dhënat sipas dokumenteve vërtetues, ku të ardhurat e

krijua nuk janë regjistruar mbi bazën e metodës detyrimevedhe të drejta të konstatuara. Gjendjet e llogarive kontabile të cilat në pasqyrat financiare janë konstatuar me diferenca dhe nuk pasqyrojnë në mënyrë të plotë e të saktë veprimtarinë financiare të Spitalit. Për veprimet që janë regjistruar dhe për ato që nuk janë regjistruar grupi i auditimit konstatoi si vijon:

I. Në pasqyrën Pasqyrën e Performancës Financiare, viti 2021 të dhënat nuk japin besueshmëri duke dhënë një pasqyrim të gabuar të gjendjes financiare.

1. Vlera e llogarisë 7111 "Të ardhurave sekondare pagesa shërbimesh" duhet të jetë në total 12,642,603 lekë, ndërsa në pasqyrën e performancës kjo llogari paraqitet në shumën 10,569,096 lekë me një diferencë prej 2,170,510 lekë.

Referuar situacionit së të ardhurave viti 2021, ditarit të arkës, ditarit të bankës vlerat e të ardhurave që duhen pasqyruar janë në total 12,642,603 lekë nga të cilat a) të ardhurat nga qiratë 271,500 lekë, të ardhurat e arkëtuara nga tarifat e pacientëve janë 12,276,700 lekë. Të ardhurat e konstatuara në vitin 2021 dhe të arkëtuara në janar 2022 janë gjithësej 94,403 lekë (referuar ditarit të bankës me reference nr 51, dt 21.01.2022 "Te Ardhura nga Qira nga A. shpk" shuma 68,000 lekë, nga referenca nr.53 e nr.54, dt 24.01.2022 "Te ardhurat nga qirate me subjektin "T. M" shumat 22,635 lekë dhe 3,768 lekë). Gjithashtu këto vlera nuk janë në llogarinë 468 "Llogari të arkëtueshme". Pra në pasqyrimin të ardhurave nuk është mbajtur parasysh metoda e regjistrimit mbi bazën e të ardhurave të konstatuara ky fakt ka deformuar rezultatin financiar në llogarinë nr. 85 "Rezultati i vitit ushtrimor".

2. Vlera e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes" duhet të jetë e ndryshme nga shuma prej - 34,662,894 leke pasi gjatë vitit 2021 janë marrë donacione të cilat nuk janë pasqyruar në Ditarin e magazinës përkatësisht duke iu referuar dokumentit të fletëhyrjes nr.5, datë 04.06.2021 donacion nga një individ, si dhe dokumenteve të tjera nga fletë dalja me nr 4, dt 04.06.2021 deri tek fletë daljes me nr 10, datë 10.06.2021 ku rezultoi se këto artikuj janë magazinuar vetëm me sasi dhe pa cmim e vlerë. Nga SRMF nuk është ngritur komisioni i inventarizimit dhe i vlerësimit për vendosjen e çmimit/njësi në kundërshtim me udhëzimin 30, datë 21.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik pikat 57-60. Regjistrimet kontabile duhet të pasqyrohen në ditarin e magazinës.

3. Llogaria 45 "Marrëdhënie midis institucioneve apo njërive ekonomike" është pa vlerë, ndërkohë që SRMF ka marrë donacione dhe ka lidhur Akt Marrëveshje me Spitalet e tjera ku janë marrë disa artikuj me të drejtë kthimi në periudhat e mëvonshme si artikujt lëndë djegëse/karburant, medikamente, çadër për promovim, artikuj pastrimi dhe kancelarie që duhet të kontabilizohen duke debituar dhe kredituar vlerat në llogaritë respektive të llog 63 "Ndryshimi i gjendjeve", në llog. 45 "Marrëdhënie midis institucioneve apo njërive ekonomike" apo në llog.74, "Të ardhura në natyrë" gjë e cila nuk ka ndodhur. Vlera totale për karburantin është 4,280,381 lekë, është marrë oksigjen i lëngshëm nga Spitali Rajonal Fier me vlerën 3,489,079 lekë, ushqim katering nga Spitali Rajonal Vlorë me vlerë totale 3,048,426 lekë, Mbetje spitalore nga Spitali Rajonal Fier me vlerën totale 2,194,320 lekë, kite dhe reagent për analiza laboratorike nga Spitali Rajonal Fier me vlerën totale 24,540,950 lekë, Shërbim Lavanteri nga Spitali Rajonal Fier me vlerën totale 2,492,220 leke, sete kirurgjikale nga Spitali Rajonal Fier me vlerën totale 9,582,002 lekë, pra shuma totale është 49,637,378 lekë.

4. Llogaria 600 "Paga dhe shpërblime" rezulton me një diferencë prej 593,297 lekë që duhet pasqyruar në Pasqyrat Financiare pasi vlera totale në ditarin e pagave viti 2021 është 183,948,958 lekë, kurse në Pasqyrën e performancës, Formular 2, kjo vlerë është paraqitur në vlerën 183,355,661 lekë. Kjo diferencë është me një efekt financiar negativ të shpenzimeve për pagat duke cuar në një pasqyrim të gabuar edhe të rezultatit të llogarisë 85 "Rezultati i Veprimtarisë së vitit ushtrimor".

Po në llogarinë 600“Paga e shpërblime” për vitin ushtrimor 2022 është konstatuar përsëri një diferencë në vlerë 39,000 lekë. ku në bilanc është paraqitur në shumën 317,230,442 lekë, ndërkohë që vlera sipas ditarit të pagave viti 2022 është 317,191,442 lekë.

Edhe në vitin ushtrimor 2023 llogaria 600 “Paga e shpërblime” paraqitet me një diferencë prej 2,675,875 lekë, ku në bilanc paraqitet në shumën 386,600,517 lekë, ndërkohë që vlera sipas ditarit të pagave është 383,974,642 Lekë.

5.Llogaria 601” Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetsore” paraqitet me një diferencë me vlerën 12,446,523 lekë ndërkohë që kontributet nga punëdhënësi në llogarinë 601 duhet të jenë 16.7% konstatohet se ato janë paraqitur në vlerën 29.7%.

6. Po ashtu, edhe për vitin ushtrimor 2022 konstatohet diferencë në llogarinë 601 me vlerë 10,256 lekë ku referuar bilancit vlera totale është paraqitur në shumën 32,476,049 lekë dhe në ditarin e pagave është paraqitur në vlerën 32,466,831 lekë.

7. “Rezultatet e mbartura”. Në vitin ushtrimor 2023 situata paraqitet përsëri me një devijim prej 1,984,184 lekë ku në bilanc paraqitet me vlerën 45,339,083 lekë dhe në ditarin e pagave **43,354,899 lekë**

Pasqyra e Pozicionit Financiar, viti 2021

Ref. Llog.	E M E R T I M I	Ushtrimi mbyllur
A	A K T I V E T	3,078,328,619
	I.Aktivët Afat shkurtra	180,490,523
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	26,792,823
531	Mjete monetare ne Arke	
512,56	Mjete monetare ne Banke	26,792,823
520	Disponibilitete ne Thesar	
50	Letra me vlere	
532	Vlera te tjera	
54	Akreditiva dhe paradhenie	
59	Provigione zhvlersimi letra me vlere (-)	
	2.Gjendje Inventari qarkullues	34,662,894
31	Materiale	34,662,894
32	Inventar I imet	
33	Prodhim nre proces	
34	Produkte	
35	Mallra	
36	Kafshe ne rritje e majmeri	
37	Gjendje te pa mberitura, ose prane te treteve	
38	Diferenca nga cmimet e magazinimit	
39	Provigione per zhvlersimin e inventarit (-)	
	3.Llogari te Arketushme	119,034,806
411	Kliente e llogari te ngjashme	
423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	
431	Tatim e Taksa	
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal	
433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti	
435	Sigurime Shoqerore	
436	Sigurime Shendetsore	
437,438,	Organizma te tjere shteterore	
44	Institucione te tjera publike	
465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere	
468	Debitore te ndryshem	
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	119,034,806
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike	
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)	
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	0
409	Parapagime	
473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin	
477	Diferenca konvertimi aktive	
481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime	
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	
	II.Aktivët Afat gjata	2,897,838,096
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	0
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave	
202	Studime dhe kerkime	
203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme	
21	2.Aktive Afatgjata materiale	2,897,838,096

210	Toka, T.roje, Terene	
211	Pyje, Plantacione	
212	Ndertesa e Konstruksione	2,621,160,000
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	
214	Instalime teknike, makineri e paisje	210,210,891
215	Mjete Transporti	11,089,484
218	Inventar ekonomik	55,377,721
24	Aktive afatgjata te demtuara	
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	
25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0
	4.Investime	0
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale	
231	Per Aktive Afatgjata materiale	
B	PASIVET(DETYRIMET)	119,034,806
	I.Pasivet Afat shkurtra	119,034,806
	1. Llogari te Pagushme	119,034,806
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	63,951,985
42	Detyrime ndaj personelit	23,077,406
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	17,352,647
435	Sigurime Shoqerore	4,289,206
436	Sigurime Shendetesore	604,322
44	Institucione te tjera publike	
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike	
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	
467	Kreditore te ndryshem	9,759,240
4341	Operacione me shtetin(detyrime	
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	0
419	Kreditore, Parapagime	
	II.Pasivet Afat Gjata	0
Klase 4	Llogari te pagushme	
16.17,18	Huate Afat gjata	
	Provigjonet afatgjata	
Klasa 4	Te tjera	
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	2,959,293,813
D	FONDI KONSOLIDUAR :	2,959,293,813
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	2,967,163,884
12	Rezultatet e mbartura	
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	-7,870,071
	Te Tjera	
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	3,078,328,619

Burimi: SRNF

Nga kontrolli i aktivitet dhe pasivit rezulton se:

I.Aktivet Afat shkurtra

Llogaria 531”Mjetet monetare: nuk ka vlerë. Kjo vlerë përputhet me gjendjen më dt 31.12.2021 të paraqitur në ditarin e arkës. Llogaria 512”Mjete monetare ne Banke” vlera 26,792,823 lekë përputhet me gjendjen në dt31.12.2021 të ditarit të bankës dhe gjendjen në llogarinë e Tirana bank

II.Gjendja e inventarit qarkullues

Llogaria 312 “Materiale” paraqitet me vlerën 34,662,894 lekë Kjo vlerë nuk është reale pasi nuk paraqet besueshmëri referuar ditarit të magazinës (fletë hyrje dhe fletë dalje), ditar magazine, dokumente tëakt marreveshjeve donatorë individë dhe operator ekonomik, ku u konstatuan se disa artikujt sidomos donacionet, nuk janë të regjistruar në ditarin e magazinës dhe si pasojë edhe vlerat e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes”, të llogarisë 45“ Marrëdhënie midis institucioneve apo njesive ekonomike” dhetë llogarisë 74 “Të ardhura në natyrë” duhen përditësuar dhe ndryshuar .

Gjithashtu referuar listës së inventarit të datës 31.12.2021 ku janë paraqitur me gjendje shumë artikujmjete pastrimi, artikujt kancelarie, medikamente, regjistra tipe të ndryshme, letër A4, toner etj rezulton se ka disa artikuj që duhet të regjistrohen në llogarinë 327 “Inventar i imët” dhe jo në llogarinë 312 të tilla si instrumenta mjekësore, artikuj të natyres kirurgjikale psh Pleurovac me regullator , tub zgjatës me varëse për krevat , Maskë për terapi CPAP, etj që duhej paraqiten në llog 327, ku gjendja në magazinë sipas ditarit të magazinës është

1,027,722 lekë . Nga kontrolli rastesor i dokumenteve në fletë hyrjen nr 41, datë 06.09.2021 sasia është 300 rizma x480 lekë =144000 lekë por rezulton se artikulli leter A4 i blerë nga operatori Gj. kompjuterfatura nr 143/2021 rezulton se janë bërë dalje 191 rizma dhe gjendja duhet të jetë 109 rizma , ndërkohëqë në inventar gjendja e dt 31.12.2021 është 9 rizma , ky veprim duhet të korrigohet.

2. Aktive Afatgjata materiale

Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” është 2,624,100,000 lekë

Vlera e llogarisë 218 “ Inventar ekonomik” është 55,377,721 leke kjo sipas procesverbalit të datës 20.04.2021 kur pajisjet janë marrë në dorëzim dhe rezulton se SRMF nuk ka kryer inventarizimin e aktiveve afatgjata materiale në fund te vitit 2021.

Vlera e Llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” paraqitet në vlerën 210,210,891 lekë ” e cila kuadron me vlerën neto në pasqyrën 7/b “ Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata(kosto historike)”.

Llogaria 215 “Mjete transporti “Paraqitet në vlerën 11,089,484 Lekë për 2 autoambulancat e marra kalim kapital nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (Te drejta)” me vlerën 119,034,806 lekë vlerë e cila kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” ku janë të përfshira të gjitha detyrimet që duhet të likujdohen për vitin pasardhës.

Llogaria 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” rezulton me vlerën 63,951,985 lekë këtu përfshihen detyrimet për kontrata të palikujduara nga viti 2021.

Llogaria 421 “Detyrime ndaj personelit” paraqitet me vlerën 23,077,406 lekë dhe janë pagat e muajitdhjetor 2021. Për sa vijon nga ditari i pagave, situacioni i shpenzimeve dhe ditari i bankës ka moskuadrim për llog. 421” Detyrime ndaj personelit” në ditari paraqitet me vlerën 26,112,146 lekë me devijim për shumën 3,024,740 lekë për vitin 2021.

Në llogarinë 431”Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa” konstatohet devijim për shumën 14,044,127 lekë për vitin 2021 dhe vlera në Pasqyrën e Pozicionit Financiar paraqitet me vlerë 17,352,647 lekë, vlerë e cila është më e madhe se sa detyrimi i muajit dhjetor 2021, dhe nuk ka argumentim apo relacion shpjegues.

Në llogarinë 435 “Sigurimet shoqërore” konstatohet diferencë 24,356 lekë për vitin 2021, Llogaria 435 “Sigurimet shoqërore” paraqitet në vlerën 4,289,206 lekë, ndërkohë në ditarin e pagave paraqitet me vlerën 4,264,850 lekë në llogarinë 436 “Sigurimet shëndetësore” konstatohet diferencë në shumën 8,799 lekë për vitin 2021. Devijimet e vlerave në pasqyrat financiare gjenerojnë informacion të pasaktë në kundërshtim me pikat 2 dhe 5.f, të UMF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e qeverisjes së Përgjithshme".

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet në vlerën 9,759,240 lekë për shpenzimet e ujë, elektricitet, telefon etj është e ndryshme nga vlerat që janë në ditarin e bankës viti 2022. Për vitin 2021 nuk ka asnjë relacion apo analizë sqaruese për pasqyrat.

III. Pasqyra e ndryshimeve në Aktivet Neto/ Fondet Neto-Pasqyra nr. 4

Aktivitet neto paraqiten me shumën 2,959,293,813 lekë dhe janë paraqitur në pasqyrën 7/b . Kjo vlerë nuk është e saktë dhe nuk paraqet besueshmëri, pasi në regjistrin e aktiveve nuk janë regjistruar disa pajisje kompjuterike, mjekësore, tavolina, etj, të blera me fonde buxhetore dhe me fondet nga të ardhurat.

Referuar regjistrin të aktiveve dhe gjendjes faktike të tyre, konstatohet se sasia e pajisjeve kompjuterike dhe pajisje mjekësore, që janë në funksion është me e madhe se gjendja kontabile. Këto pajisje janë të dhuruara nga stafi turk por nuk kanë çmime dhe nuk janë regjistruar në regjistrin e aktiveve. Për evidentimin e tyre nuk është ngritur grup pune për vlerësimin e pajisjeve si edhe nuk janë kryer veprimet e magazinimit, kontabilizimit si edhe regjistrimi në regjistrin e aktiveve. Në kundërshtim me udhëzimin 30, datë 21.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik“.

Për llogaritë e aktiveve në vitin 2022 u konstatuan artikuj dhe pajisje që nuk ishin regjistruar në magazinë dhe as në ditarin e saj e për rrjedhje as në regjistrin e aktiveve. Referuar pasqyrës 7/b vlera 61,455,717 lekë për aktivet neto nuk ka asnjë argumentim se si është llogaritur.

Ref.	E M E R T I M I	Ushtrimi	Ushtrimi
		I Mbyllur	Paraardhes
A	A K T I V E T	3,098,688,766	3,078,328,619
	I.Aktivët Afat shkurtër	460,356,871	180,490,523
	1.Mjete monetare dhe ekujvalent të tyre	336,690,842	26,792,823
531	Mjete monetare në Arke		
512,56	Mjete monetare në Banke	336,690,842	26,792,823
520	Disponibilitete në Thesar		
50	Letra me vlerë		
532	Vlera të tjera		
54	Akreditiva dhe paradhanie		
59	Provizione zhvlersimi letra me vlerë (-)		
	2.Gjendje Inventari qarkullues	58,552,400	34,662,894
31	Materiale	58,552,400	34,662,894
32	Inventar i imet		
39	Provizione perzhvlersimin e inventarit (-)		
	3.Llogari të Arketushme	65,113,628	119,034,806
411	Kliente e llogari të ngjashme		
423,429	Personeli, paradhanie, deficite, gjoba		
431	Tatim e Taksa		
435	Sigurime Shoqerore		
436	Sigurime Shendetore		
44	Institucione të tjera publike		
468	Debitore të ndryshëm		
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	65,113,628	119,034,806
49	Shuma të parashikuara për Zhvleresim(-)		
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	0
409	Parapagime		
	II.Aktivët Afat gjatë	2,638,331,895	2,897,838,096
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	0	0
201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave		
202	Studime dhe kerkime		
203	Koncesione,Patenta,Licenca e të ngjashme		
21	2.Aktive Afatgjata materiale	2,638,331,895	2,897,838,096
210	Toka, T.roje, Terene		
211	Pyje, Plantacione		
212	Ndertesa e Konstruksione	2,420,240,900	2,621,160,000
213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	148,549,030	210,210,891
215	Mjete Transporti	18,467,555	11,089,484
216	Rezerva Shtetore		
217	Kafshe pune e prodhimi		
218	Inventar ekonomik	51,074,410	55,377,721
24	Aktive afatgjata të demtuara		
28	Kaktime të Aktiveve Afatgjata		
25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
	4.Investime	0	0
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
231	Per Aktive Afatgjata materiale		0
B	PASIVET(DETYRIMET)	65,113,628	119,034,806
	I.Pasivet Afat shkurtër	65,113,628	119,034,806
	1. Llogari të Pagushme	65,113,628	119,034,806
401-408	Furnitore e llogari të lidhura me to	35,916,019	63,951,985
42	Detyrime ndaj personelit	16,491,333	23,077,406
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	4,331,783	17,352,647
435	Sigurime Shoqerore	4,475,527	4,289,206
436	Sigurime Shendetore	626,729	604,322
44	Institucione të tjera publike		
45	Mardhenie midis institucioneve		
466	Kreditore për mjete në ruajtje		
467	Kreditore të ndryshëm	3,272,237	9,759,240
4341	Operacione me shtetin(detyrime		
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
419	Kreditore, Parapagime		

475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
478	Diferenca konvertimi pasive		
480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
	II.Pasivet Afat Gjata	0	0
Klase 4	Llogari te pagushme		
Klasa 4	Te tjera		
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	3,033,575,137	2,959,293,813
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	3,009,685,631	2,959,293,813
101	Teprica (Fondi akumuluar)/Deficiti	2,699,787,612	2,967,163,884
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	309,898,019	-7,870,071
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme		
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
107	Vlera e mjeçteve te caktuara ne perdorim		
109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
	Te Tjera		
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	3,074,799,259	3,078,328,619

Burimet SRMF

IV. Inventarizimi i aktiveve për vitet 2022 - 2023

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese konstatohet se nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2023 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimin për vitin 2023”, Urdhër nr. 797, datë 12.12.2023. Urdhër nr. 798, datë 12.12.2023. Urdhër nr. 799, datë 12.12.2023 Urdhër nr. 800, datë 12.12.2023. Urdhër nr. 801, datë 12.12.2023. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit, rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara e të trupëzuara si dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe nga personi me përgjegjësi materiale brenda muajit dhjetor 2022 dhe në fillim të vitit 2023. Referuar regjistrin të aktiveve dhe gjendjes faktike të tyre, konstatohet se sasia e pajisjeve kompjuterike dhe pajisje mjekësore, që janë në funksion është me e madhe se gjendja kontabile. Pajisjet artikujt pajisje kompjuterike, pajisje mjekësore - aparat analizues i gazrave plus elektroliteve ne gjak, Pajisje per Banken e Gjakut, tavoline në shërbimin e angiografisë, kasafortë për arkën etj, nuk janë regjistruar në regjistrin e aktiveve. Për evidentimin e tyre nuk janë kryer veprimet e magazinimit, kontabilizimit si edhe regjistrimit në regjistrin e aktiveve. Në kundërshtim me udhëzimin 30, datë 21.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” sasia e konstatuar me sasinë e regjistruar të jetë më e madhe. Gjatë vitit 2022 janë blerë me fondet e arkës, printer termik nga Image Communication Development me vlerën 27,183 lekë e cila nuk është regjistruar në regjistrin e aktiveve, me referencën nr 80 datë 20.10.2022 nga ditari i bankës është bërë likuidimi i pajisjeve kompjuteriketë blera tek subjekti S.Z. sipas fat. 1391/2022 dhe vlerën 578,560 lekë pajisje të cilat janë blerë në fonde buxhetore dhe nuk janë regjistruar në regjistrin e aktiveve Mos regjistrimi i tyre në regjistrin e aktiveve e bën të vështirë monitorimin dhe menaxhimin efektiv të pasurive publike në SRMF duke i hapur rrugë abuzimit dhe keqmenaxhimit si dhe duke ulur besueshmërinë dhe transparencën e pasqyrave financiare. Theksojmë se aktivet e paregjistruara janë më të prekshme ndaj abuzimit (vjedhjeve, dëmtimit, humbjeve) gjë që mund të shkaktojë efekt negativ financiar për buxhetin e institucionit. Mangësitë që janë konstatuar në llog. 312, llog. 327 në llog. 45 në llog. nr 63 “Ndryshimi i gjendjeve” dhe në llog.74, “Të ardhura në natyrë” e konfirmojnë këtë efekt. Në asnjë rast nuk është ngritur komisioni i vlerësimit për pajisjet kompjuterike të dhuruara në shkelje të pikës 57 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Për periudhën objekt auditimi, nuk është ngritur komision për vlerësimin e aktiveve përkatësisht në shkelje me pikat 95 - 99, të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Për vitin 2023

Referuar ditarit të arkës me dokumentin vërtetues pagesa nr.151, datë 08.06.2023, është paguar shuma 25,900 lekë për “Blerje kasafortë për arkën” që nuk është paraqitur në regjistrin e aktiveve.

- Me mandat pagesën nr 154, date 12.06.2023 është paguar shuma 19,800 lekë, për “Blerje materiale pastrimi, 6 kova larje shtrydhje që nuk janë sistemuar tek llogaria 327 “Inventar i imët”, e cila duhet kontabilizuar.
- Me mandat pagesën nr.170, datë 26.06.2023, paguar shuma 35,000 lekë për “Blerje tavolina për shërbimin angiografi” të cilat nuk janë rregjistruar në regjistrin e aktiveve,
- Referuar ditarit të bankës me Reference nr 94, datë 20.06.2023 nga subjekti R.2000 me nr fature 104/2023 janë blerë dhe likujduar pajisje IT në vlerën 685,000 lekë të cilat nuk janë rregjistruara në regjistrin e aktiveve.
- Referuar ditarit të bankes me Reference nr 163, date 27.12.2023 nga subjekti S. M. me nr fature 15/2023 është blerë dhe likujdur pajisje IT në vlerën 194,532 lekë e cila nuk është e regjistruar ne regjistrin e aktiveve.
- Referuar ditarit të bankës me reference nr 112, datë 12.12.2023 nga subjekti M. me nr fature 17/2023 janë blerë dhe likujduar pjesë për aparatura mjekësore në vlerën 984,000 lekë të cilat nuk janë të regjistruara ne regjistrin e aktiveve.
- Referuar ditarit të bankës me referencë nr 97, datë 14.07.2023 nga subjekti I.me nr fature 30/2023 janë blerë dhe likujduar në vlerën 612,000 lekë pajisje IT të cilat nuk janë të regjistruara ne regjistrin e aktiveve.
- Referuar ditarit të bankes me referencë 10, datë 28.07.2023 nga subjekti P.- S.me nr fature 4898/2023 janë blerë dhe likujduar në vlerën 334,8000 lekë pajisje të sistemit ë traut të cilat nuk janë të regjistruara në regjistrin e aktiveve.
- Referuar ditarit të bankës me referencë 112, datë 20.11.2023 nga subjekti T. me nr fature 117083-114469/2023 janë blerë dhe likujduar në vlerën 13,584,000 lekë për pajisjemjekësore të bankës së gjakut të cilat nuk janë të regjistruara ne regjistrin e aktiveve.

Për asnjë vit ushtrimor nuk është ngritur komisioni i vlerësimit dhe komisioni për nxjerrjen jashtëpërdorimit si dhe të jetë hartuar lista e veçimit për artikujt, paisjet që duhen të nxirren jashtë përdorimit referuar Udhëzimit 30, datë 21.11.2011, nga pika 96 deri ne pikën 110.

Për vitin 2022 dhe vitin 2023 është bërë relacion shpjegues për llogaritë ne fund të vitit edhe pse të dhënat nuk janë të besueshme. Për vitin 2021 amortizimi ka qenë zero pasi dokumentecioni iu është vënë në dispozicion në muajin mars 2022. Amortizimi i ndërtesës duhet të llogaritet 5%, përlllogaritja e amortizimit për aktivet hyrje , fillon në ditën e parë të muajit pasardhes (p.sh hyrje 04.04.2018, fillon me date 01.05.2018) dhe përlllogaritja e amortizimit për aktivet dalje bëhet deri në fund të muajit ose përfundon në ditën e parë të muajit pasardhës (p.sh dalje 04.04.2018, përlllogaritja bëhet deri ne dt 30.04.2018) për instalimet Paisjet audio vizuale (projektori, televizori nese keni) Mjete dhe Paisje te tjera teknike në masën 20%.

Referuar Statutit të SRM Fier të gjitha pasqyrat financiare nuk janë të miratuara në Bordin Drejtues në përputhje me nenin 12, pika 3. Për sa më lart të gjitha shkeljet e konstatuara të veprimevetë mësipërme janë në kundërshtim me nenin 9 dhe nenin 12 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar në Ligjin nr.25/2018 “ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në pikat 35,36,42,43,45,46 të udhëzimit 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin financiar të aktiveve në njësitë e sektorit publik”i ndryshuar.

Nga grupi i auditimit u konstatuan mangësi dhe pasqyrim jo të plotë të të dhënave kontabile në Pasqyrat Financiare të vitit 2021, 2022, 2023:

Kontabilizimi i të ardhurave është bërë me metodën e të drejtave dhe detyrimeve të arkëtuara dhe jo me metodën e të ardhurave të konstatuara. U konstatuan se të ardhura e munguara nga kontabilizimi jo i drejtë në llog 7111“Të ardhura sekondare pagesa shërbimesh” në shumën 2,710,510 lekë. Informacioni për arkëtimet e munguara në llog. 468 “Llogari të arkëtueshme” në vlerën 2,710,510 lekë është marr nga dokumentet kontabël (ditari i arkës ,bankës , kontratat

e lidhura për qeradhënie) Mosnjohja dhe zbatimi i standarteve për kontabilitetin, e udhëzimit 30 datë 27.12.2021 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” e legjislacionit në fuqi për menaxhimin dhe kontrollin financiar dhe mungesa e burimeve njerëzore në fillimet e krijimit të SRMF kanë sjellë keqmenaxhim të përdorimit të fondeve publike duke i pasqyruar dhe llogaritur vlerat e tyre herë me efekte financiare negative dhe në disa herë me mbivlerësim të vlerave të shpenzimeve.

-Në llog. 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” kontabilizuar me vlerën 117,846 lekë për “programin alpha” dhe e pasqyruar edhe në regjistrin e aktiveve konstatohet se shpenzimi i kryer nuk është investim por është shërbim nga të tretët, për regjistrimet kontabile financiare. Programi Alfa shërben me bazë website dhe është me afat licence përdorimi 1 vit kalendarik duke mos plotësuar kriteret që përcaktohet për një aktiv afatgjat jo material (në SNKK 1) ku cilësohet se program financiar duhet të ketë një periudhë përdorimi dhe përfitimi më të gjatë se një vit.

5. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave të mallrave shërbimeve dhe punimeve civile.

Për Vitin 2021, referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve SRMF dhe sipas analizës së riskut janë audituar procedurat e mëposhtme:

Nr.	Objekti prokurimit	Procedura	Fondi limit
1	“Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore”	E hapur	13,705,189
2	“Blerje materiale mjekimi për shërbimin e ortopedisë, për nevojat e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier”	E hapur	10,333,720
3	Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, dermatologjike, hormonale sistemike, hormonet seksuale, Anestezë Reanimacion, Gjaku dhe organet formuese të gjakut dhe Sistemi Respirator, Nervor, Kardiovaskular, muskolo-skeletik, Lëndë kontrasti për CT	E hapur mbi kufirin e lartë monetar	Lot 5: 33,920,640
4	Blerje Dioksid Karboni (CO2)	E hapur e Thjeshtuar	4,336,000
5	Blerje materiale mjekimi për nevojat e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier	E hapur	Lot 2: 14,429,489
6	Blerje materiale mjekimi për shërbimin e hemodinamikes për nevojat e spitalit Rajonal “Memorial” Fier	E hapur	18,683,250
7	Blerje Protoksid Azoti (N2O)	E hapur e Thjeshtuar	4,568,400
	Shuma		99,976,688

1. “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore”

-Për realizimin e këtij prokurimi është zhvilluar procedura e mëposhtme e cila është anuluar.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore”		
Urdhër Prokurimi Nr.18, Dt 19.10.2021	Specifikimet teknike, Urdhër Nr.29, datë 04.10.2021 Llogaritja e Fondit Limit Procesverbal Nr. Prot., 689/13 datë 13.10.2021 M. Ç. Kryetare I. D. Anëtar A. H. Anëtare Njësia Prokurimit Urdhër Nr. 18, datë 19.10.2021 P. D.– Anëtar, Përgjegjës F. V. – Anëtar N. M.– Anëtar A. A. – Anëtar A.S. - Anëtar	Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 18/1 datë 19.10.2021 J. D.- Kryetare M. Ç.-Anëtare B.H – Anëtare, Mjeke A. R. - Anëtare
Lloji i Procedurës së Prokurimit “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore”, Procedurë e hapur		
Fondi Limit (pa tvsh) 13,705,189 lekë	Oferta fituese 12,625,000 Lekë	Diferenca me fondin limit 1,080,189 Lekë
Data e hapjes së tenderit 08.10.2021	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike Fitues BOE “M” sh.p.k dhe “B” sh.p.k

Ankimime Pranë AK - nuk ka	Përgjigje Ankesës nga AK nuk ka	Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik nuk ka
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		
Lidhja e kontratës Drafti i Marrëveshje kuadër nr.114 prot., datë 26.01.2022 Kontrata 1, nr.114/5, datë 28.02.2022 Kontrata 2, nr.114/12, datë 25.07.2022 Kontrata 3, nr.114/19 prot, datë 19.01.2023	Vlera e kontratës 12,625,000 lekë pa tvsh Kontrata 1, vlera 3,381,580 lekë pa tvsh, Kontrata 2, vlera 2,006,790 lekë pa tvsh Kontrata 3, vlera 7,093,400 lekë pa tvsh	Likujduar 12, 481,770 lekë pa tvsh

Burimi: Të dhënat SRMF dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

-Urdhër prokurimi, Nr.12, prot.689, datë 31.08.2021 i titullarit të Ak, urdhërohet hapja e procedurës së prokurimit “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevojat e Spitalit Rajonal Memorial Fier, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 12 muaj”. Lloji i procedurës së prokurimit është: e hapur.

-Urdhër Nr.12, prot.689, datë 31.08.2021 i titullarit të AK, është ngritur Njësia e prokurimit e përbërë nga: P. D. Përgjegjës Prokurimi, F. V. Anëtar, N. M. Anëtar, A. A. Anëtar, A.S Anëtar.

-Procesverbal Nr.133 prot., datë 20.05.2021 nga grupi i punës i spitalit Fier është bërë përcaktimi i fondit limit prej 10,689,340 lekë pa TVSH, për procedurën e prokurimit “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore”. Nuk janë argumentuar nevojat reale të SRMF për përcaktimin e këtij fondi, por janë marë si referencë nevojat e spitaleve të tjera rajonale më afër Fierit.

-Urdhër Nr.12/1, prot.689/1, datë 31.08.2021 i drejtorit, për ngritjen e KVO përbërë nga: znj. J. D. Kryetare, z. E. P. Anëtar, Mjek, znj. M. Ç. Anëtare, znj. B. H. Anëtare, Mjeke, znj. A. R.– Anëtare

-Vendim Pezullimi, Nr.727 prot., datë 07.09.2021 i titullarit të AK znj. R. D., për shkak të rekomandimit të APP-së dërguar me datë 07.09.2021 (Rekomandime mbi kriteret e DST-së), për pezullimin e procedurës së prokurimit “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore, Marrëveshje Kuadër me një OE, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 12 muaj” me fond limit 10,689,340 lekë pa TVSH. Publikuar me datë 02.09.2021, me datë dorëzimi/hapje oferte 20.09.2021 ora 10.30.

-Vendim Për Heqjen e Pezullimit, Nr.727/1 prot., datë 07.09.2021 e titullarit të AK znj. R.D., heqje e pezullimit të procedurës së prokurimit “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore, Marrëveshje Kuadër me një OE, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 12 muaj” me fond limit 10,689,340 lekë pa TVSH.

-Procesverbal, Nr.689/4 prot., datë 23.09.2021, mbi hapjen, zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave të Operatorëve ekonomikë, mbajtur në SRMF në prezencë të anëtarëve të KVO-së në datën 20.09.2021 ora 10:30. Për këtë procedurë janë paraqitur 3 (tre) OE ku dy prej tyre kanë paraqitur ofertë ekonomike, e konkretisht:

-OE “B.Albania”, me vlerë 12,908,150 lekë pa TVSH,

-OE “M. shpk”, me vlerë 12,626,520 lekë pa TVSH,

-Formulari i Njoftimit të Anulimit, Nr.689/5 prot., datë 27.09.2021. AK njofton anulimin e procedurës së prokurimit “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore, Marrëveshje Kuadër me një OE, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 12 muaj” me fond limit 10,689,340 lekë pa TVSH. KVO refuzoi të dyja ofertat e paraqitura nga OE pasi rezultuan më të larta se Fondi Limit.

-Memo, Nr.689/6 prot., datë 01.10.2021, e nënshkruar nga KVO “Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme”, drejtuar titullarit të AK ku i ka propozuar ngritjen e një grupi pune për të studiuar edhe njëherë tregun për të argumentuar dhe rillogaritur fondin limit.

-Me anë të Formularit të Anulimit Nr.689/5 prot., datë 27.09.2021, AK njofton anulimin e procedurës së prokurimit “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore,

Marrëveshje Kuadër me një OE, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 12 muaj” me fond limit 10,689,340 lekë pa TVSH. KVO refuzoi të dyja ofertat e paraqitura nga OE pasi rezultuan më të larta se Fondi Limit.

-Procedura e dytë zhvilluar në datën 13.10.2021.

-Urdhër prokurimi, Nr.18, prot.1012, date 19.10.2021 i titullarit të AK për prokurimin e procedurës “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore”

-Urdhër Nr.18/1, prot.1012/1, date 19.10.2021 i titullarit të AK “Për emërimin e Komisionin e Vlerësimit të Ofertave”, për procedurën “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore”, i përbërë nga: znj. J. D. Kryetare, z. E. P. Anëtar, Mjek, znj. M. Ç. Anëtare, znj. B. H. Anëtare, Mjeke, znj. A. R. Anëtare.

-Argumentimi dhe Hartimi i Fondit Limit,

-Me procesverbalin nr. 689/13, datë 13.10.2021 është ngritur grupi i punës për përcaktimin e fondit limit i përbërë nga: znj. M. Ç. Kryetare, z. I.D. Anëtar, znj. A. H. Anëtare, të cilët kanë llogaritur vlerën e kontratës në shumën 13,705,188 lekë pa TVSH.

Vlera e kontratës e llogaritur nga grupi i punës nuk është e argumentuar pasi janë marrë ofertat dhe është bërë studimi i tregut duke marrë oferta nga 2(dy) OE dhe konkretisht:

1. OE “B.Albania”, me vlerë 12,908,150 lekë pa TVSH,
2. OE “M.shpk”, me vlerë 12,626,520 lekë pa TVSH.

Nga auditimi rezultoi se, oferta fituese e BOE “M.shpk” dhe “B. Albania shpk” është 12,625,000 lekë pa TVSH dhe është e njëjtë me ofertën e dhënë për përcaktimin e fondit limit si edhe me ofertën e ofruar 3 muaj më parë në procedurën me të njëjtin objekt, e cila është anuluar sepse ofertat janë paraqitur mbi fondin limit. Po kështu grupi i punës nuk ka argumentuar nevojat për materiale mjeksore, por ka hartuar tabela referuar sasive të përcaktuara nga spitali i Fierit dhe jo nevojave të pavioneve të shërbimit mjeksor.

Vlera e fondit limit nga 10,689,340 lekë pa TVSH e llogaritur në procedurën e anuluar është prokuruar pas një periudhë rreth 3 muaj në vlerën 13,705,188 lekë pa TVSH, e cila nuk është argumentuar nga grupi i punës për llogaritjen e vlerës së kontratës. Kemi një rritje në vlerën 3,015,848 lekë pa TVSH duke sjellë efekt financiar negativ për buxhetin e SRMF. Veprime në kundërshtim me nenin 34, “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i punës i përbërë: znj. M. Ç., znj. A. H., z. I.D..

-Mbi vlerësimin e ofertave, Procesverbali Nr.1012/8 prot., datë 22.11.2021, “Mbi hapjen, zhvillimin dhe vlerësimin e procedurave të tenderit me mjete elektronike”, me objekt “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore”. Nga sa më sipër rezultoi se, në procedurë ka marë pjesë 1(një) BOE konkretisht “M shpk” dhe “B.Albania shpk” me ofertë 12,625,000 lekë pa tvsh.

-Raport përmbledhës, Nr.1012/10 prot., datë 30.11.2021 i miratuar nga titullari i AK znj. R.D. njoftohet BOE “M shpk” dhe “B Albania shpk” me ofertë 12,625,000 lekë pa tvsh për nënshkrimin e marrëveshjes kuadër me afat 12 muaj.

Nga ana e BOE nuk ka patur ankesa.

-Mbi Zbatimin e Kontratës,

-Sipas kontratës Nr.114/5 prot., datë 28.02.2022, “Kontratë Furnizimi Nr.1” të nënshkruar ndërmjet SRMF dhe BOE “M” shpk dhe “B” shpk, rezultoi se, janë mbajtur procesverbalet e hyrjes dhe fletëhyrjet sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Nga auditimi rezultoi se barnat janë dorëzuar në ambjentet e magazinës SRMF nga BOE dhe janë marë në dorëzim nga komisioni i pranimit sipas listave referuar kontratës.

-Sipas kontratës Nr.114/12 prot., datë 25.07.2022, “Kontratë Furnizimi Nr.2” të nënshkruar ndërmjet SRMF dhe BOE “M” shpk dhe “B” shpk, rezultoi se, janë mbajtur procesverbalet e hyrjes dhe fletëhyrjet sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Nga auditimi rezultoi se barnat

janë dorëzuar në ambjentet e magazinës SRMF nga BOE dhe janë marë në dorëzim nga komisioni i pranimit.

-Sipas kontratës Nr.114/19 prot., datë 19.01.2023, “Kontratë Furnizimi Nr.3” të nënshkruar ndërmjet SRMF dhe BOE “M” shpk dhe “B” shpk, rezultoi se, janë mbajtur procesverbalet e hyrjes dhe fletëhyrjet sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Nga kontrolli rezultoi se, barnat janë dorëzuar në ambjentet e magazinës SRMF nga BOE dhe është bërë pranimi i tyre nga komisioni.

2.“Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, dermatologjike, hormonale sistemike, hormonet seksuale, Anestezi Reanimacion, Gjaku dhe organet formuese të gjakut dhe Sistemi Respirator, Nervor, Kardiovaskular, muskolo-skeletik, Lëndë kontrasti për CT, gastrointestinale, MRI, Metabolizmi dhe trakti tretës, Organet e shqisave për Spitalin “Memorial” Fier”, ndarë në 5 lote. Nga kjo procedurë është zhvilluar vetëm: Loti 5- Blerje Gazra mjekësorë (Oksigjen)

Blerje Gazra mjekësore Loti 5		
Urdhër Prokurimi Nr.15, Dt 09.09.2021	Njësia Prokurimit Urdhër Nr.758/1 prot., Dt 09.09.2021	Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.758/2 prot., Dt 09.09.2021
Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur mbi kufirin e larte monetar	P. M.K N.M. R. M J. D. I. P. J. D Specifikimet teknike/Fondi Limit Procesverbal nr.758 Prot datë 09.09.2021 N.M. Kryetare I.D. Anëtar I. P Anëtar	A. A K. Gj A. R. O .D M. Gj. M. Ç. R. M.
Fondi Limit 33,920,640 lekë pa tvsh	Oferta fituese 33,901,840 lekë pa tvsh	Diferenca me fondin limit 18,800 lekë pa tvsh
Data e hapjes së tenderit 22.10.2021	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike G- Shqiptare sh.p.k
Ankimime Pranë AK - Ankesë nga T -Nr.758/13, datë 08.10.2021	Përgjigje Ankesës nga AK Nr.758/15 datë 12.10.2021	Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik Nr 1904/5 datë 22.10.2021 Vendim i KPP Nr.1904/5 datë 22.10.2021
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		
Lidhja e kontratës Drafti i Marrëveshjes kuadër nr.758/27 prot., datë 30.12.2021 Nr. 758/33, datë 24.01.2022 2Nr. 758/42, datë 24.10.2022 3Nr. 1752/1, datë 30.12.2022	Vlera e kontratës 10,836,147 lekë pa Tvsh 47,693 lekë pa Tvsh 23,018,000 lekë pa Tvsh	Likujduar 33,901,840 lekë pa tvsh Afati i kontratës Nga nënshkrimi me afat 12 muaj.

Burimi: Të dhënat SRMF dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

-Urdhër prokurimi, Nr.15, prot.758/1, datë 09.09.2021 i titullarit të AK për prokurimin e procedurës “Blerje Gazra Mjekësore”, Loti 5 me fond limit 33,920,640 lekë pa tvsh.

-Urdhër, Nr. 758/2, datë 09.09.2021 i titullarit të AK “Për emërimin e Komisionin e Vlerësimit të Ofertave”, për procedurën “Blerje Gazra Mjekësore”, Loti 5, për nevojat e Spitalit Rajonal Memorial Fier, i përbërë nga: znj. A. A, z. K. Gj, znj. A. R, znj. O. D, znj.M.Gj , znj. M. Ç, znj. R.M.

-Mbi kriteret e hartuara APP i ka rekomanduar AK të saktësojë/riformulojë kriteret e tenderit me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen në plotësimin e kriterit nga OE ofertues. Rekomandimet e APP i referohen kryesisht, kriterit të “xhiros vjetore” kur kontratat për mallra shërbime ndahen në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë *kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot*. Kërkesat duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit”, sipas nenit 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për prokurimin publik”, sipas pikës 9 të këtij neni parashikohet: “Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure”. *Fillimi dhe përfundimi i njërës lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës, si dhe të pikës 2, të nenit 43, të këtij vendimi, ku përcaktohet: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. APP i ka rekomanduar AK që të korrigjojë dhe pikën 2,3,6 të kapacitetit teknik ku; OE duhet të provojë se nëse shpallet fitues, është në gjendje të sigurojë tanker oksigjeni për ta zëvendësuar brenda 10 ditëve nga lidhja e kontratës, pranë Autoritetit Kontraktor. Kërkohet minimumi 1(një) tank me kapacitet jo më të vogël se 20,000 litra. Kjo problematikë ka sjellë vonesë në shpalljen e OE fitues dhe lidhjen e kontratës me 2 muaj duke krijuar pasoja në furnizimin e SRMF me barna. Veprime në kundërshtim me Nenin 36 “Specifikimet teknike”, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Për veprimet e mësipërme mban përgjegjësi grupi i punës përbërë nga: znj. N.M., znj. M.Ç, znj. I. P.*

Ankesë nr.758/13 prot., datë 08.10.2021 bërë nga “T” shpk lidhur për procedurën “Blerje Gazra Mjekësore”, Loti 5, për nevojat e SRMF.

Vendim i KPP nr.1904/5 prot., datë 22.10.2021 vendosi: Të mos pranojë ankesën e OE “T” shpk për procedurën e hapur mbi kufirin e lartë monetar, me objekt “procedurën “Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, dermatologjike, hormonale sistemike, hormonet seksuale, Anestezia Reanimacion, Gjaku dhe organet formuese të gjakut dhe Sistemi Respirator, Nervor, Kardiovaskular, muskolo-skeletik, Lëndë kontrasti për CT, gastrointestinale, MRI, Metabolizmi dhe trakti tretës, Organet e shqisave për Spitalin “Memorial” Fier”, ndarë në 5 lote. AK lejohet të vazhdojë me hapat e tjerë të procedurës së prokurimit.

-Mbi zbatimin e kontratës

Bazuar në marrëveshjen kuadër janë nënshkruar 3 kontrata, si më poshtë:

-Kontrata nr.1 758/33 prot., datë 24.01.2022, me vlerë 10,836,147.2 lekë pa TVSH, për furnizimin e sasisë 80, 000 litra oksigjen i lëngshëm dhe 120 litra oksigjen i kompresuar(gaz)

-Kontrata nr.2 758/42 prot., datë 24.10.2022, me vlerë 47,692.8 lekë, për furnizimin e sasisë 1,380 litra oksigjen i kompresuar(gaz)

-Kontrata nr.3 1752/1 prot., datë 30.12.2022, me vlerë 23,018,000 lekë pa TVSH, për furnizimin e sasisë 170,000 litra oksigjen i lëngshëm.

-Kontrata është realizuar plotësisht sa i përket sasive dhe vlerës. U verifikua dokumentacioni sa i përket furnizimeve ditore, konsumit ditor për tanket, për të gjithë periudhën e furnizimit të kontratës. Furnizimi është bërë nëpërmjet automjeteve autobotë në tankerin e SRMF që është vënë në dispozicion nga OE sipas DST dhe ka kapacitet 22,000 litra sipas kriterëve të kërkuara. Matja e sasisë bëhet nëpërmjet manometrave. Oksigjeni i lëngshëm i furnizuar, kalon për përdorim nëpërmjet tubacioneve të brendshme të spitalit. Oksigjeni i kompresuar përdoret nëpërmjet bombolave. Tankeri kontrollon dhe kolaudon çdo vit nga ISHTI.

3. “Blerje materiale mjekimi për shërbimin e hemodinamikës për nevojat e spitalit Rajonal Memorial Fier”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Blerje materiale mjekimi për shërbimin e hemodinamikës "		
Urdhër Prokurimi Nr.11, Dt 24.08.2021	Specifikimet teknike U. Nr. 9, prot., datë 04.08.2021	Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.11, prot.619/1, datë 24.08.2021
Lloji i Procedurës së Prokurimit "Procedure e Hapur" Mallra	M. Q N.M. R. K Njësia Prokurimit U. Nr.11, Dt 24.08.2021 P. D N. K A. A J. D N.M.	A. R. R. M M. C M. Q R. K
Fondi Limit 18,683,250 lekë pa tvsh	Oferta fituese 18,672,100 lekë pa tvsh	Diferenca me fondin limit 11,150 lekë pa tvsh
Data e hapjes së tenderit 17.09.2021	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike B Albania Boe "O D" R. S
Ankimime Pranë AK Nuk ka	Përgjigje Ankesës nga AK	Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		
Lidhja e kontratës Nr. 619/7 Prot datë 20.10.2021 Nr. 301 Prot datë 21.02.2022	Vlera e kontratës 8,591,750 lekë Tvsh 10,079,500 leke pa Tvsh Likujduar 18,671,250 lekë pa tvsh	Likujduar 18,671,250 lekë pa tvsh Afati i kontratës Nga nënshkrimi me afat 12 muaj.

Burimi: Të dhënat SRMF dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

-Urdhër prokurimi, Nr.619 prot., date 24.08.2021 i titullarit të AK për prokurimin e procedurës "Blerje materiale mjekimi për shërbimin e hemodinamikës për nevojat e SRMF" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj.

-Urdhër Nr.18/1, prot.1012/1, date 19.10.2021 i titullarit të AK "Për emërimin e Komisionin e Vlerësimit të Ofertave", për procedurën "Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore", i përbërë nga: znj. J. D. Kryetare, z. E. P Anëtar, Mjek, znj. M.Ç Anëtare, znj. B. H. Anëtare, Mjeke, znj. A. R. Anëtare.

-Argumentimi dhe Hartimi i Fondit Limit

-Me urdhërin nr.9, prot.553, datë 04.08.2021 është ngritur grupi i punës për përcaktimin e fondit limit i përbërë nga: z. M.Q Kryetar, znj. N.M. Anëtare, znj. R. K Anëtare.

Me procesverbalin Nr. 553/1 prot., datë 23.08.2021 është llogaritur vlera e kontratës në shumën 18,683,250 lekë pa TVSH. *Grupi i punës nuk ka argumentuar llogaritjen e fondit limit, veprime në kundërshtim me nenin 34, "Për llogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit", të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i punës i përbërë nga: z. M. Q, znj. R.K, znj. N.M..*

-Mbi kriteret e hartuara

Procedura është anularuar sepse APP i ka rekomanduar AK të saktësojë/riformulojë kriteret e tenderit me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen në plotësimin e kriterit nga OE ofertues. Rekomandimet e APP i referohen kryesisht, përcaktimit të "xhiros mesatare vjetore" ku të merret në konsideratë se, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK, referuar nenit 43, pika 3, të VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për prokurimin publik". Një tjetër rekomandim i APP ka të bëjë

me, shmangien e përcaktimit “të lotit apo shumës së loteve për të cilat oferton”, pasi procedura nuk është e ndarë në lote. Gjithashtu në lidhje me Certifikata ISO për “Sistemin e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore” që AK ka kërkuar nga OE nga ana e APP rekomandohet që të kërkohej certifikatë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *Kjo problematikë ka sjellë vonesë në shpalljen e OE fitues dhe lidhjen e kontratës me 2 muaj duke krijuar pasoja në furnizimin e SRMF me barna. Veprime në kundërshtim me Nenin 36 “Specifikimet teknike”, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi grupi i punës përbërë nga: z. M. Q., znj. N.M., znj. R. K.*

Mbi vlerësimin e ofertave

Me datë 01.10.2021 është mbajtur procesverbali Nr.619/8 prot., “Mbi hapjen, zhvillimin dhe vlerësimin e procedurave të tenderit me mjete elektronike”, me objekt “Blerje materiale mjekimi për shërbimin e hemodinamikës, për nevojat e Spitalit Rajonal Memorial Fier”. Nga sa më sipër rezultoi se, në procedurë kanë marrë pjesë 3(tre) OE konkretisht “B Albania shpk” me ofertë 17,740,000 lekë pa tvsh dhe BOE “D” dhe “M” me ofertë 18,672,100 lekë pa tvsh dhe “R S S.R.L” nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. Përpara se të kalohej në shqyrtimin e ofertave KVO ka tërhequr nga sekretaria e SRMF mostrat e paraqitura nga OE sipas kriterit të vendosur në DST Shtojca nr.7 e “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, pika 2 kriteret e veçanta të kualifikimit nën titullin 2.3 Kapaciteti teknik pika 11 ku përcaktohet se: kërkohej mostra vetëm për artikujt e përcaktuar nga grupi i punës. Nga shqyrtimi i mostrave të depozituara rezultoi si vijon: BOE “D” dhe “M” administruar me nr.619/6 prot., datë 17.09.2021 ora 10.00. OE “B Albania” administruar me nr.619/7 prot., datë 17.09.2021 ora 10.00.

-OE R.S S.R.L, nuk ka paraqitur asnjë ofertë ekonomike në sistemin elektronik si edhe nuk është paraqitur ditën e hapjes së ofertave për të sjellë mostrat pranë Autoritetit Kontraktor. Pas shqyrtimit të ofertave KVO ka shpallur fitues BOE: “O shpk” me NIPT K.....N dhe “M shpk” me vlerë oferte 18,672,100 lekë pa TVSH.

-Mbi Zbatimin e Kontratës,

- “Kontratë Furnizimi Nr.1”, prot.619/17, datë 20.10.2021, me vlerë 8,591,750 lekë pa tvsh, të nënshkruar ndërmjet SRMF dhe BOE “M” dhe “O” shpk rezultoi se, janë mbajtur procesverbalet e hyrjes dhe fletëhyrjet e materialeve mjekësore sipas listës bashkangjitur kontratës furnizimit të mara në dorëzim nga komisioni i pranimit SRMF. Materialet mjekësore janë dorëzuar nga BOE në ambientet e spitalit sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Datat e skadencës të medikamenteve janë sipas specifikimeve teknike.

- “Kontratë Furnizimi Nr.2” prot.301, datë 21.02.2022, 10,079,500 lekë pa tvsh, të nënshkruar ndërmjet SRMF dhe BOE “M” dhe “O” shpk rezultoi se, janë mbajtur procesverbalet e hyrjes së materialeve mjekësore dhe fletëhyrjet sipas listës së kontratës furnizimit. Materialet mjekësore janë dorëzuar nga BOE në ambientet e spitalit sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Datat e skadencës të medikamenteve janë sipas specifikimeve të DST.

4. “Blerje materiale mjekimi për nevojat e Spitalit Rajonal Memorial Fier”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore”		
Urdhër Prokurimi Nr.02 Dt 22.06.2021	Njësia Prokurimit Nr.02 Dt 22.06.2021	Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur” Mallra	P.D E.L. I. P. A. S N. A Specifikimet teknike Urdhër Nr. 14, datë 11.05.2021	A. R E.H. E. N. K. D. H. T.

	Procesverbal nr.23/6 Prot date 20.05.2021	
Fondi Limit (pa tvsh) 14,429,489 lekë pa Tvsh	Oferta fituese 14,379,483lekë pa Tvsh	Diferenca me fondin limit 50,005 Lekë
	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike BOE “O dhe E”
Ankimime Pranë AK Ankesë nga T -Nr.758/13 prot., datë 08.10.2021	Përgjigje Ankesës nga AK Nr.758/15 datë 12.10.2021	Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik Nr 1904/5 datë 22.10.2021
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		
Lidhja e kontratës Nr. 318/16 Prot, Datë 14.09.2021 Nr. 302 Prot, Datë 21.02.2022	Vlera e kontratës 13,509,430.92 lekë pa Tvsh 10,898,921.20 lekë pa Tvsh	Likujduar 14,408,352 lekë pa tvsh Afati i kontratës Nga nënshkrimi me afat 12 muaj.

Burimi: Të dhënat SRMF dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Argumentimi dhe Hartimi i Fondit Limit,

-Me urdhërin nr.14 prot. 34/4, datë 11.05.2021 është ngritur grupi i punës për përcaktimin e fondit limit i përbërë nga: z. R. Ç., znj. I. Ç., z. M. S., z. N. K, znj. V. D. Grupi i punës ka marë si referencë konsumin mesatar mujor faktik, raportuar nga 4 spitalet rajonal të jugut dhe çmimi për njësi është marë nga procedurat e zhvilluara nga MSHMS si organ qendror blerës. Vlera e kontratës është llogaritur në shumën 35,899,829leke, per 3 lote:

Loti 1- Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore me fond limit/vlera e pritshme e Kontratave 10,689,340 lekë pa Tvsh.

Loti 2- Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 14,429,489 lekë pa Tvsh.

Loti 3- Materiale mjekimi për shërbimin e hemodinamikës me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 10,781,000 lekë pa Tvsh.

-Formulari i njoftimit të anulimit, Nr.318/3 prot., date 05.07.2021lëshuar nga titullari i AK për anulimin e lotit 3, - Materiale mjekimi për shërbimin e hemodinamikës me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 10,781,000 lekë pa Tvsh, bazuar në Nenin 98, pika 1, c, “Konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme”, të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

-Mbi vlerësimin e ofertave,

Procesverbal Nr.318/7 prot., datë 29.07.2021 mbajtur nga KVO vendosi të shpallë fitues për tenderin me objekt: Loti 2- “Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevojat spitalore”, procedure e hapur, BOE “O” shpk dhe “E” shpk me vlerë të përgjithshme prej 14,379,483.66 lekë pa tvsh.

-Procesverbal Nr.318/4 prot., datë 18.08.2021 i mbajtur nga Njësia e Prokurimit mbi verifikimin e dokumenteve të BOE fitues O. shpk dhe E. shpk, për tenderin me procedurë të hapur, me objekt: “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore”. Nga auditimi rezulton se dokumentet e paraqitura nga BOE janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST.

-Formulari i njoftimit të anulimit, Nr.318/10 prot., date 18.08.2021 lëshuar nga titullari i AK për anulimin e lotit 1, - Loti 1- Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore me fond

limit/vlera e pritshme e kontratave 10,689,340 lekë pa Tvsh, bazuar në Nenin 98, pika 1, b, “Në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme”, të ligjit Nr.162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

-Mbi Zbatimin e Kontratës,

- “Kontratë Furnizimi Nr.1”, nr.318/16 prot., datë 14.09.2021, me vlerë 3,509,430.92 lekë pa tvsh, të nënshkruar ndërmjet SRMF dhe BOE “O” shpk dhe “E” shpk. Nga kontrolli rezultoi se, janë mbajtur procesverbalet e hyrjes së materialeve mjekimit dhe fletëhyrjet, sipas listës bashkangjitur kontratës furnizimit. Materialet mjekimit janë marë në dorëzim nga komisioni i pranimit SRMF, dorëzimi është bërë nga BOE në ambjentet e SRMF.

- “Kontratë Furnizimi Nr.2”, nr.302 prot., datë 21.02.2022 me vlerë 10,898,921.2 lekë pa tvsh, të nënshkruar ndërmjet SRMF dhe BOE “O” shpk dhe “E” shpk. Nga kontrolli rezultoi se, janë mbajtur procesverbalet e hyrjes së materialeve mjekimit dhe fletëhyrjet, sipas listës bashkangjitur kontratës së furnizimit. Materialet e mjekimit janë marë në dorëzim nga komisioni i pranimit SRMF, dorëzimi është bërë nga BOE në ambjentet e SRMF.

Për Vitin 2022, referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve të SRMF dhe analizës së riskut janë përzgjedhur për tu audituar dosjet e pasqyruara në tabelën më poshtë:

Nr.	Objekti prokurimit	Procedura	Fondi limit pa tvsh
1	Blerje kite dhe reagentë për nevoja spitalore	E hapur	29,866,347
2	Blerje materiale mjekimi hemodinamika	E hapur	10,093,850
3	Shpenzim për Qiramarrje Mjetesh Transporti	E hapur e Thjeshtuar	5,416,666
	Shuma		45,376,863

1. “Blerje materiale mjekimi hemodinamika”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Blerje materiale mjekimi hemodinamika		
Urdhër Prokurimi Nr.26 Prot, Dt 13.09.2022	Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Njësia Prokurimit Urdhër Nr. 26, datë 13.09.2022 E.G M.Q. K.K.	Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.26/1 Prot.1334/1, datë 105.09.2022 D. K N. K M. M
“Procedurë e Hapur” Mallra	Specifikimet teknike Urdhër Nr. 90, prot.,1284 datë 02.09.2022 N. K M. Q E. K M. K I. K Procesverbal nr. 1284/1 datë 07.09.2022	
Fondi Limit (pa tvsh) 10,093,850 lekë	Oferta fituese 10,072,400 lekë	Diferenca me fondin limit 21,450 lekë
Data e hapjes së tenderit 07.10.2022	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike BOE “O &M” shpk
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		
Lidhja e kontratës Nr.1334/16, Datë 26.10.2022	Vlera e kontratës 10,072,400 lekë pa Tvsh	Afati i Kontratës 31.12.2022

Burimi: Të dhënat SRMF dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

-Urdhër prokurimi, Nr.26, prot.317, datë 13.09.2022 i titullarit të AK për prokurimin e procedurës “Blerje materiale mjekimi hemodinamika” me fond limit 10,093,850 lekë pa tvsh.

-Llogaritja e fondit limit, Grupi i punës i përbërë nga z. N. K, z. M. Q, z. E. K, znj. M. K, znj. I. K. Në përlllogaritjen e fondit limit grupi i punës është bazuar në çmimet e unifikuara nga “Ministria e Shëndetësisë” të dërguara me email në adresën e SRMF. Bazuar në këto çmime është përlllogaritur fondi limit në vlerën totale prej 10,093,850 lekë pa tvsh.

-Urdhër, Nr.26/1, prot.1334/1, datë 15.09.2022 i titullarit të AK “Për emërimin e Komisionin e Vlerësimit të Ofertave”, për procedurën “Blerje materiale mjekimi hemodinamika”, i përbërë nga: znj. D.K Kryetar, z. N. K Anëtar, znj. M.M Anëtare.

-Procesverbal, Nr.1334/8 prot., datë 10.10.2022 i mbajtur nga KVO në lidhje me procedurën “Blerje materiale mjekimi për shërbimin e ortopedisë për nevojat e Spitalit Rajonal Memorial Fier”, procedurë e hapur, me fondin limit 10,093,850 lekë pa TVSH. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë BOE “O” shpk dhe “M” shpk me ofertë 10,072,400 lekë pa tvsh dhe OE “B Albania” shpk, i cili nuk ka paraqitur asnjë ofertë për këtë procedurë. Përpara se të kalohej në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik, KVO ka verifikuar mostrat e paraqitura nga OE sipas kriterit të vendosur në DST. Rezulton se mostrat kanë qenë të plota dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

-Njoftim i fituesit Nr.1334/11 prot., datë 11.10.2022 drejtuar BOE “O” shpk dhe “M” shpk, oferta e paraqitur me një vlerë 10,072,400 lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Mbi Zbatimin e Kontratës,

“Kontrata e furnizimit” Nr.1334/16 prot., datë 26.10.2022, e lidhur ndërmjet SRMF dhe BOE O.E.S D” shpk dhe “M” shpk me vlerë 10,072,400 lekë pa tvsh dhe afati i lëvrimit është deri më 31.12.2022. Nga auditimi fletëhyrjeve dhe procesverbaleve të marrjes në dorëzim, konstatohet se afati për zbatimin e kontratës është respektuar. Gjithashtu datat e skadencës së materialeve të mjekimit janë sipas specifikimeve të përcaktuara në kontratën e furnizimit. Likujdimi është bërë sipas afateve të vendosura në kontratë, në vlerën 10,072,400 lekë pa tvsh.

2. “Shpenzim për Qiramarrje Mjete Transporti”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Shpenzim për Qiramarrje Mjete Transporti		
Urdhër Prokurimi Nr.18 Dt 17.05.2022	Hartuesit e Dokumenteve Tenderit E.G N.M. K.K.	Komisioni i Vlerësimit Ofertave R. M D.K M. M
Lloji i Procedurës së okurimit “Procedurë e Hapur” Mallra	Specifikimet teknike Urdhër Nr. 22, datë 08.02.2022 Procesverbal nr.223/1, date 15.02.2022 Njësia Prokurimit Nr.18 Dt 17.05.2022	
Fondi Limit 4,049,669 lekë pa tvsh	Oferta fituese 3,799,000 lekë pa tvsh	Diferenca me fondin limit 250,669 lekë pa tvsh
	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike “C” Shpk
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		
Lidhja e kontratës 1.Nr. 792/7 Prot, Datë 18.07.2022	Vlera e kontratës 3,799,000 lekë pa Tvsh	Likujduar 3,799,000 lekë pa tvsh Afati i Kontratës 12 muaj

Burimi: Të dhënat SRMF dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

-Kërkesë për qiramarrje automjete për transportin e personelit turk, nr.485/2 prot., datë 01.04.2022 drejtuar titullares SRMF nga Nëndrejtori i Përgjithshëm Mjekësor z. A. C. dhe

Nëndrejtori i Përgjithshëm Ekonomik z. K. K. Kërkesa konsiston në marrjen me qira të 2 (dy) automjete me nr. vendesh 4+1 dhe 1 (një) *automjet me nr. vendesh 17+1*.

Argumentimi dhe hartimi i fondit limit

-Me procesverbalin Nr. 663/1 prot., datë 22.04.2022 është bërë studimi i tregut dhe janë marë ofertat nga 3 subjekte ekonomike me qëllim përlllogaritjen e fondit limit për këtë procedurë. Të tre këto subjekte kanë përcjellë ofertat pranë SRMF, përkatësisht “C shpk”, “TA”, “H A Albania”. Si rrjedhojë, për përlllogaritjen e fondit limit ka shërbyer mesatarja e të tre ofertave të mara, e cila është llogaritur në vlerën totale prej 4,049,669 lekë pa tvsh. *Nga grupi i punës nuk janë argumentuar specifikimet teknike, më konkretisht nuk është argumentuar specifikimi i automjetit me nr. vendesh 4+1 me tërheqje 4x4, veprime në kundërshtim me nenin 2 “Qëllimi”, nenin 34 “Përlllogaritja e vlerës parashikuar të prokurimit”, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi grupi i punës që përbëhet nga: z. K. K, z. E. Sh, z. D. H, znj. I. K.*

Nga kryqëzimi të dhënave të auditimit referuar automjetit 4x4 kemi shpenzim të pajustificuar për një vit qiramarrje në vlerën 279,000 lekë pa tvsh dhe diferenca në konsum karburanti për 1 vit ndërmjet autoveturës dhe automjetit 4x4 sipas statistikave të mara nga drejtoria e financës: Automjeti 4x4 (3,219 litra në vit), autovetura (2,475 litra në vit), si rrjedhim kemi diferencën (3,219-2,475=744 litra x 190 lekë=117,800 lekë pa tvsh). Në total (279,000+117,800=396,800 lekë pa tvsh) përbën efekt financiar për buxhetin e Spitalit Rajonal Memorial Fier.

Mbi vlerësimin e ofertave

-Procesverbal nr.792/5 prot., datë 28.06.2022 mbajtur nga KVO mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave për tenderin me objekt: “Shpenzim për qiramarrje mjetesh transporti”, procedurë e hapur e thjeshtuar. KVO ka konstatuar që në procedurë është paraqitur vetëm një ofertues OE “C” shpk me vlerë të përgjithshme prej 3,799,000 lekë pa tvsh. Në përfundim të verifikimit dhe shqyrtimit të dokumenteve të ngarkuara elektronikisht në SPE nga OE “C” shpk rezultoi se, dokumentet janë origjinale dhe brenda afateve ligjore të vlefshmërisë. Në përfundim nga KVO është bërë kualifikimi i ofertës.

Formulari i njoftimit të fituesit nr.792/6 prot., datë 07.07.2022. Është hartuar raporti përmbledhës me datë 12.07.2022. Titullari i AK ka nxjerrë vendimin nr.1108/1prot., datë 12.07.2022, për miratimin e procedurës dhe shpalljes fitues të OE “C” shpk me objekt “Shpenzim për qiramarrje mjetesh transporti”.

Në vijim është lidhur kontrata e shërbimit “Shpenzim për qiramarrje mjetesh transporti” me nr.792/7 prot., datë 18.07.2022, ku kohëzgjatja e kësaj kontrate ka qenë 12 muaj. Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin me nr.792/8 prot., datë 19.07.2022, për ndjekjen e zbatimit të kontratës, ku komisioni ka qenë i përbërë nga znj. K.K., z. E. Sh.

Mbi Zbatimin e Kontratës

-Kontrata e shërbimit nr.792/7 prot., datë 18.07.2022, zbatimi do të fillojë menjëherë pas nënshkrimit. Vendi dorëzimit të mjeteve është kryer në ambjentet e SRMF, sipas përcaktimeve të bëra në DST.

- Procesverbal nr.792/9 prot., datë 02.09.2022 për marrjen në dorëzim të automjeteve. Grupi i punës në SRMF nga kontrolli fizik i mjeteve ka konstatuar se, ka pasur përputhshmëri mbi specifikimet teknike midis atyre të kontratës dhe gjendjes reale të automjeteve. Afati për zbatimin e kontratës është respektuar dhe likujdimet janë bërë sipas afatit. Gjatë zbatimit të kontratës nga grupi i punës, *nuk është administruar dokumentecioni i monitorimit dhe nuk është hartuar asnjë raport mbi monitorimin. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 124, pika 5 “Detyrimet e AK gjatë zbatimit të kontratës”, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Për sa mësipër mbajnë përgjegjësi personat e ngarkuar nga titullari i AK për zbatimin e kontratës znj. K.K., z. E.SH.*

Procedura prokurimi të zhvilluara nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara (ASHPP) për periudhën 01.04.2021-30.12.2023

Janë përzgjedhur për auditim zbatimi i kontratave të procedurave më poshtë, përcaktuar sipas analizës së riskut

Furnizim me lëndë djegëse GLN (Mishelë) ndarë në 2 lote	46,172,880	46,172,880	24.11.2021 12 muaj
Shuma	46,172,880	46,172,880	

1. “Furnizim me lëndë djegëse GLN (Mishelë) loti 2”

Mbi Zbatimin e Kontratës loti 2

- “Kontratë Furnizimi Nr.1” nr.239 prot., datë 11.02.2022, nënshkruar ndërmjet SRMF dhe OE “Kast & Gas” sh.a. vijim i marrëveshje kuadër nr.66/12 prot., datë 24/11/2021 me afat 12 muaj. Vlera e kontratës 19,680,960 lekë pa tvsh, çmimi i përlllogaritur 63.08 lekë/litri pa tvsh. Marzhi i fitimit në vlerë absolute ka qenë 8.7 lekë/litër pa tvsh dhe i pandryshuar deri në përfundim të kontratës sipas *Reuters* lëvruar sipas CIF-Shqipëri.

Afati i lëvrimin brenda 4 muajve nga nënshkrimi i kontratës ose deri në ezaurimin e plotë të sasisë totale 312,000 litër Gaz LPG/GNL për kaldajat e SRMF.

Dorëzimi do të bëhet në depozitat pranë SRMF, me autobotët e OE të cilët janë të kolauduar nga inspektoriat përkatës dhe të pajisur me sasimatës dhe elektropompë me pistoletë shkarkimi për distancë deri në 25 m sipas përcaktimeve të bëra në kontratën e furnizimit.

Referuar kontrollit të grafikut të lëvrimin rezulton se, deri më datë 30.04.2024 nga sasia 312,000 litra e kontratës është dorëzuar 177,660 litra ose 57% e sasisë totale gazit GLN pranë SRMF. Për vitin 2021 sipas procesverbalit të mbajtur datë 30.12.2021 nga z. K. N, z. A. A, z. Xh. L SRMF ka konsumuar 24,384 litra gaz GLN. Janë likujduar 9,081,573 lekë pa tvsh. Nga sa mësipër rezulton se, grupi i punës nuk ka bërë përlllogaritjen e saktë të nevojave vjetore për gaz GLN veprime në kundërshtim me nenin 2 “Qëllimi”, nenin 34 “Përlllogaritja e vlerës parashikuar të prokurimit”, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. M.Ç, z. D. N.

Procedura prokurimi të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS) për periudhën 01.04.2021-30.12.2023

Janë përzgjedhur për auditim zbatimi i kontratave të procedurave si më poshtë:

Nr.	Objekti prokurimit	Fondi limit pa tvsh	Vlera fituese pa tvsh	Marrëveshje kuadër
1	B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshme, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi Respirator, Gjaku dhe organet formuese të gjakut	204,537,320	Sipas kontratave të loteve të realizuara	26.07.2022 24 muaj
2	B2-Blerje barna Gjaku dhe organet formuese të gjakut, Lëndë kontrasti për CT, Lëndë kontrasti gastrointestinale, Lëndë kontrasti për MRI, Metabolizmi dhe trakti tretës, Organet e shqisave, Psikiatrik, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskulo-skeletik dhe Sistemi nervor	147,828,721	Sipas kontratave të loteve të realizuara	21.07.2022 24 muaj
	Shuma	352,366,041		

1. “B1-Blerje barna Anti-Infektive të përgjithshme, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, nervor, respirator dhe organet formuese të gjakut”

Mbi Zbatimin e Kontratave

-Marrëveshje kuadër nr.1532/128 prot., datë 26.07.2022, lidhur ndërmjet AK (MShMS) dhe 29 OE. Objekti i tenderit “B1-Blerje barna Anti-Infektive të përgjithshme, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, nervor, respirator

dhe organet formuese të gjakut ndarë në 113 lote-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik (Një OE të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 204,537,320 lekë pa tvsh, procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar – mallra – prokurim me mjete elektronike. Sipas procesverbaleve të marrjes në dorëzim dhe likujdimeve të kryera nga drejtoria e financës deri më datë 26.07.2024 janë likujduar 30,789,780 lekë, ose kontrata rezulton e realizuar në masën 15%, *veprime që tregojnë planifikim të kërkesave për prokurim përtej nevojave reale të SRMF, veprime në kundërshtim me nenin 21 “Autoriteti ose Enti Kontraktor”, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.*

2.“B2-Blerje barna gjaku dhe organet formuese të gjakut, lëndë kontrasti për CT, lëndë kontrasti gastrointestinale, për MRI, metabolizmi dhe trakti tretës, organet e shqisave, psikiatrik, sistemi kardiovaskular, sistemi muskulo-skeletik dhe nervor”

Mbi Zbatimin e Kontratave

-Marrëveshje kuadër nr.1532/152 prot., datë 19.07.2022, lidhur ndërmjet AK (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) dhe 30 OE. Objekti i tenderit “B2-Blerje barna Antineoplastike dhe imunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistematike, hormone seksuale, gjaku dhe organet formuese të gjakut, Lëndë kontrasti për CT, Lëndë kontrasti për MRI, Lëndë kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna Dermatologjike ndarë në 128 lote-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik (Një OE të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 4,987,413,987 lekë pa tvsh, procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar – mallra – prokurim me mjete elektronike. Sipas procesverbaleve të marrjes në dorëzim dhe likujdimeve të kryera nga drejtoria e financës deri më datë 26.07.2024 janë likujduar 72,343,330 lekë, ose kontrata rezulton e realizuar në masën 1.45%, *veprime që tregojnë planifikim të kërkesave për prokurim përtej nevojave reale të SRMF, veprime në kundërshtim me nenin 21 “Autoriteti ose Enti Kontraktor”, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.*

Procedura prokurimi të zhvilluara nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara (ASHPP) për periudhën 01.04.2021-30.12.2023

1. “Furnizim me lëndë djegëse GLN (Mishelë) loti 2”

Mbi Zbatimin e Kontratës loti 2

- “Kontratë Furnizimi Nr.1” nr.239 prot., datë 11.02.2022, nënshkruar ndërmjet SRMF dhe OE “K & G” sh.a. vijim i marrëveshje kuadër nr.66/12 prot., datë 24/11/2021 me afat 12 muaj. Vlera e kontratës 19,680,960 lekë pa tvsh, çmimi i përllogaritur 63.08 lekë/litri pa tvsh.

Marzhi i fitimit në vlerë absolute ka qenë 8.7 lekë/litër pa tvsh dhe i pandryshuar deri në përfundim të kontratës sipas *Reuters* lëvruar sipas CIF-Shqipëri.

Afati i lëvrimin brenda 4 muajve nga nënshkrimi i kontratës ose deri në ezaurimin e plotë të sasisë totale 312,000 litër Gaz LPG/GNL për kaldajat e SRMF.

Dorëzimi do të bëhet në depozitat pranë SRMF, me autobotët e OE të cilët janë të kolauduar nga inspektoriati përkatës dhe të pajisur me sasimatës dhe elektropompë me pistoletë shkarkimi për distancë deri në 25 m sipas përcaktimeve të bëra në kontratën e furnizimit.

Referuar kontrollit të grafikut të lëvrimin rezulton se, deri më datë 30.04.2024 nga sasia 312,000 litra e kontratës është dorëzuar 177,660 litra ose 57% e sasisë totale gazit GLN pranë SRMF.

Për vitin 2021 sipas procesverbalit të mbajtur datë 30.12.2021 nga z. K. N, z. A. A, z. Xh. L. SRMF ka konsumuar 24,384 litra gaz GLN. Janë likujduar 9,081,573 lekë pa tvsh.

Nga sa mësipër rezulton se, grupi i punës nuk ka bërë përllogaritjen e saktë të nevojave vjetore për gaz GLN veprime në kundërshtim me nenin 2 “Qëllimi”, nenin 34 “Përllogaritja e vlerës parashikuar të prokurimit”, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i

ndryshuar. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. M.Ç, z. D. N.

Procedura prokurimi të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) për periudhën 01.04.2021-30.12.2023

Janë përzgjedhur për auditim zbatimi i kontratave të procedurave më poshtë, përcaktuar sipas analizës së riskut

1. “B1-Blerje barna Anti-Infektive të përgjithshme, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skelektik, nervor, respirator dhe organet formuese të gjakut”

Mbi Zbatimin e Kontratave

-Marrëveshje kuadër nr.1532/128 prot., datë 26.07.2022, lidhur ndërmjet AK (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) dhe 29 OE. Objekti i tenderit “B1-Blerje barna Anti-Infektive të përgjithshme, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skelektik, nervor, respirator dhe organet formuese të gjakut ndarë në 113 lote-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik (Një OE të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 204,537,320 lekë pa tvsh, procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar – mallra – prokurim me mjete elektronike. Sipas procesverbaleve të marrjes në dorëzim dhe likujdimeve të kryera nga drejtoria e financës deri më datë 26.07.2024 janë likujduar 30,789,780 lekë, ose kontrata rezulton e realizuar në masën 15%, *veprime që tregojnë planifikim të kërkesave për prokurim përtej nevojave reale të SRMF, veprime në kundërshtim me nenin 21 “Autoriteti ose Enti Kontraktor”, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.*

2.“B2-Blerje barna gjaku dhe organet formuese të gjakut, lëndë kontrasti për CT, lëndë kontrasti gastrointestinale, për MRI, metabolizmi dhe trakti tretës, organet e shqisave, psikiatrik, sistemi kardiovaskular, sistemi muskulo-skeletik dhe nervor”.

Mbi Zbatimin e Kontratave

-Marrëveshje kuadër nr.1532/152 prot., datë 19.07.2022, lidhur ndërmjet AK (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) dhe 30 OE. Objekti i tenderit “B2-Blerje barna Antineoplastike dhe imunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistematike, hormone seksuale, gjaku dhe organet formuese të gjakut, Lëndë kontrasti për CT, Lëndë kontrasti për MRI, Lëndë kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna Dermatologjike ndarë në 128 lote-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik (Një OE të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 4,987,413,987 lekë pa tvsh, procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar – mallra – prokurim me mjete elektronike. Sipas procesverbaleve të marrjes në dorëzim dhe likujdimeve të kryera nga drejtoria e financës deri më datë 26.07.2024 janë likujduar 72,343,330 lekë, ose kontrata rezulton e realizuar në masën 1.45%, *veprime që tregojnë planifikim të kërkesave për prokurim përtej nevojave reale të SRMF, veprime në kundërshtim me nenin 21 “Autoriteti ose Enti Kontraktor”, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.*

-Për vitin 2023, SRMF referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej 27 procedura prokurimi të mëdha me vlerë të fondit limit 433,452,190 lekë, pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 332,645,257 lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 100,806,933 lekë pa TVSH.

Për vitin 2023 është zhvilluar një procedurë nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, dhe është nënshkruar 1 kontratë me vlerë 2,671,180 lekë pa TVSH, procedura e prokurimit është “Marrëveshje Kuadër” me fond limit 5,700,717 lekë pa TVSH .

Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut

Referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve të SRMF dhe analizës së riskut janë përzgjedhur për tu audituar dosjet e pasqyruara më poshtë:

1. Procedura e prokurimit me objekt Loti 1 “Blerje Kite Reagent për Laboratorin Klinik-Biokimik” në Spitalin Rajonal Memorial Fier.

-Element i regjistrit të parashikimeve për vitin 2023, lloji i procedurës së prokurimit është procedurë “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Kite Reagente per Laboratorin Biokimik		
Urdhër Prokurimi Nr.49, Dt 22.09.2023	Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Njësia Prokurimit Urdhër Nr.49, Dt 22.09.2023 P. D- Përgjegjëse në Sektorin e Prokurimeve I.D.- Kryeinfermier i Përgjithshëm M. M- Specilaiste ne Sektorin e Financës M. J- Laborant R.F- Farmaciste Specifikimet teknike Urdhër Nr. 147, datë 11.09.2023 M. L- Mjeke Laborante I.D.- Kryeinfermier i Përgjithshëm F. Y- Kryeinfermiere Përgjithshme	Komisioni i Vlerësimit Ofertave M. B.- Specialiste në Sektorin Juridik G.K- Specialiste në Sektorin e Financës E. A-Laborant I. K- Specialiste në Sektorin e Planifikimit K.K.- Përgjegjëse në Sektorin e Financës
Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur		
Fondi Limit 39,209,955 Lekë (pa tvsh)	Oferta fituese 32,001,700 Lekë	Diferenca me fondin limit 7,208,255 Lekë
Data e hapjes së tenderit 26.12.2023	Burimi Financimit Buxheti Shtetit	Operatorët Ekonomike P shpk M shpk
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		
Lidhja e kontratës Nr. 1493/20, Datë 05.02.2024	Vlera e kontratës 47,042,844 lekë	Likuiduar 43,745,680 Lekë me tvsh

Nga dokumentecioni i vënë në dispozicion, u konstatua se:

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Për procedurën e prokurimit “Blerje kite dhe reagent” konstatohet se në regjistrin e realizimit të vitit 2023 është parashikuar si marrëveshje kuadër me afat 24 mujor. Kjo procedurë është anuluar disa herë dhe pas vendimit të KPP nr. 862/2023 datë 04.09.2023 është vendosur rihartimi i specifikimeve dhe fondit limit. Titullarja e AK-së me urdhër nr.1155/1 prot., datë 11.09.2023 ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, i përbërë nga M.L., I.D. dhe F.Y. (pjesë e stafit turk/ kryerinferimere e përgjithshme). Grupi i punës në procesverbalin me nr.1158/2 prot., datë 14.09.2023 ka përcaktuar specifikimet teknike.

Zhvillimi i procedurës

Për këtë procedurë prokurimi me nr REF-81612-09-28-2023 me datë zhvillimi 19.10.2023, janë paraqitur dy OE “M” shpk me ofertën ekonomike në vlerën e 33,833,000 lekë pa tvsh dhe “P” shpk me ofertën ekonomike në vlerën e 32,001,700 lekë pa tvsh.

Në procesverbalin me nr.1493/10 prot., datë 29.12.2023 të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit i ngritur me urdhër nr.1200/1 prot., datë 22.09.2023 i përbërë nga M. B, G. K, E. A, I. K dhe K.K. është vlerësuar se në përfundim të verifikimit dhe shqyrtimit të dokumenteve të ngarkuara elektronikisht, se të dy OE pjesëmarrës përmbushin të gjitha kriteret e përcaktuara në DST. Pas verifikimit të dokumentacionit fizik nga AK dhe në përfundim të afateve të ankimit është konfirmuar fitues “Pegasus”.

Zbatimi i Kontratës

Marrëveshja Kuadër me objekt “Blerje Kite Reagent për Laboratorin Klinik-Biokimik” me nr.1493/16 prot., datë 17.01.2024 e lidhur mes Spitalit Rajonale Memorial Fier dhe OE “P”, me kohëzgjatje 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës. Në vazhdim është lidhur kontrata e

furnizimit me nr.1493/20 prot., datë 05.02.2024 me një afat 12 mujor, me vlerë kontrate 47,042,844 lekë.

Titullarja e AK-së me urdhër nr.18 prot., datë 05.02.2024 ka caktuar si person përgjegjës për zbatimin e kontratës M. J, D. C dhe A.K.

Në shtojcën 5, të formularit të specifikimeve teknike të DST, një prej kushteve kualifikuese ka qenë ofrimi në përdorim i aparateve për realizimin e analizave imunologjike dhe dy aparateve biokimike. Sipas DST: *Për Paisjet që vë në përdorim pranë SRMF:*

a. *Autodeklarate ku saktësohet nr. dhe tipi i analizatoreve perfshire aksesoret e tij te cilet OE do t'i instalojë duke bashkëlidhur materialin përshkrues:*

b. *lloji i paisjes, modeli, viti i prodhimit, kompania prodhuese, vendi i prodhimit, gamen e plote te analizave te cilat propozon dhe eshte ne gjendje te beje sistemi.*

-Konstatohet se nuk ka gjurmë dokumentecioni për marrjen në dorëzim të pajisjeve në përdorim, nga personat përgjegjës për zbatimin e kontratës, duke vepruar në kundërshtim me specifikimeve teknike të vendosura në DST dhe me pikën 7 neni 107 e VKM nr.285 datë 19.05.2021, i ndryshuar.

-Për pajisjet në përdorim për realizimin e analizave biokimike dhe Imunologjike janë mbajtur 2 procesverbale nga farmacistja e spialit A.V dhe nga laborantia R. S, duke vepruar në kundërshtim me urdhrin nr.13/2 prot., datë 02.05.2024, duke qenë se grupi i marrjes në dorëzim nuk ka qenë i njëjti. Procesverbalet i përkasin datës 01.07.2024 dhe 27.06.2024. OE "P" i ka dorëzuar se bashku me raportin e servisit të aparaturës. Konstatohet se për një pjesë të kiteve për analizave biokimike dhe imunologjike përkatësisht të testeve 3-8, 12, 14-28, 33, 37-41, 43-54, 56-65 (Sipas të dhënave të DST) është KUSHT prania e aparaturave për funksionimin e tyre. Për këtë kontratë deri më 24.07.2024 është likujduar 43,745,681 lekë.

-Gjatë auditimit konstatohet se në disa prej fletëhyrjes së kiteve dhe reagentëve të prokuruar nuk është e përcaktuar data e e prodhimit të tyre, konkretisht:

- Fletëhyrje nr.50 datë 06.02.2024 ku për 50 artikuj me vlerë 5,397,804 lekë nuk kanë të përcaktuar datën e prodhimit të mallit.
- Fletëhyrje nr.70 datë 19.02.2024 ku për 26 artikuj me vlerë 1,320,864 lekë nuk kanë të përcaktuar datën e prodhimit të mallit.
- Fletëhyrje nr.85 datë 29.02.2024 ku për 7 artikuj me vlerë 627,828 lekë nuk kanë të përcaktuar datën e prodhimit të mallit.
- Fletëhyrje nr.53 datë 07.02.2024 ku për 10 artikuj me vlerë 363,936 lekë nuk kanë të përcaktuar datën e prodhimit të mallit.
- Fletëhyrje nr.57 datë 12.02.2024 ku për 18 artikuj me vlerë 2,910,684 lekë nuk kanë të përcaktuar datën e prodhimit të mallit.
- Fletëhyrje nr.123 datë 19.03.2024 ku për 7 artikuj me vlerë 1,712,880 lekë nuk kanë të përcaktuar datën e prodhimit të mallit.
- Fletëhyrje nr.113 datë 18.03.2024 ku për 33 artikuj me vlerë 2,713,200 lekë nuk kanë të përcaktuar datën e prodhimit të mallit.
- Fletëhyrje nr.107 datë 11.03.2024 ku për 8 artikuj me vlerë 178,380 lekë nuk kanë të përcaktuar datën e prodhimit të mallit.
- Fletëhyrje nr.155 datë 08.04.2024 ku për 29 artikuj me vlerë 971,730 lekë nuk kanë të përcaktuar datën e prodhimit të mallit.
- Fletëhyrje nr.160 datë 11.04.2024 ku për 17 artikuj me vlerë 4,636,032 lekë nuk kanë të përcaktuar datën e prodhimit të mallit.
- Fletëhyrje nr.170 datë 17.04.2024 ku për 5 artikuj me vlerë 1,436,760 lekë nuk kanë të përcaktuar datën e prodhimit të mallit.
- Fletëhyrje nr.171 datë 17.04.2024 ku për 1 artikull me vlerë 37,200 lekë nuk ka të përcaktuar datën e prodhimit të mallit.
- Fletëhyrje nr.188 datë 09.04.2024 ku për 4 artikuj me vlerë 282,960 lekë nuk kanë të përcaktuar datën e prodhimit të mallit.

- Fletëhyrje nr.190 datë 30.04.2024 ku për 16 artikuj me vlerë 1,039,480 lekë nuk kanë të përcaktuar datën e prodhimit të mallit.

-Konstatohet se për kontratën e furnizimit nr.1493/20 prot., datë 05.02.2024 deri më tani është ezuaruar vlera prej 23,630,284 lekë nga vlera e kontratës për të cilat nuk ka një gjurmë dokumentecioni mbi datën e prodhimit të kiteve dhe ragentëve, duke mos ofruar siguri nëse mallrat e prokuruar janë në përputhje me kriteret e vendosura.

-Mosevidentimi i saktë i datës është në kundërshtim Në shtojcën 5 të “Specifikimeve Teknike” të DST është përcaktuar që për të gjithë artikujt kërkuar : “Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe datës së skadencës”.

2. Procedura e prokurimit me objekt “Qiramarrje Automjetesh” në Spitalin Rajonal Memorial Fier.

-Element i regjistrimit të parashikimeve për vitin 2023, lloji i procedurës së prokurimit është procedurë “E Hapur e Thjeshtuar”.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Qiramamarrje automjetësh”.		
Urdhër Prokurimi Nr.39 Dt 05.06.2023	Hartuesit e Dokumenteve Tenderit R. M. E.SH G.K	Komisioni i Vlerësimit Ofertave M. I.D. G.K
Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur” Shërbime	Specifikimet teknike Urdhër Nr. 76 datë 22.05.2023 Procesverbal nr.710/5 Prot. Datë 01.06.2023 Njësia Prokurimit Nr.39 Dt: 05.06.2023	
Fondi Limit (pa tvsh) 3, 799, 000	Oferta fituese 3, 780, 000 Lekë	Diferenca me fondin limit 19, 000 Lekë
	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike 1. “T.A” sh.p.k
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		
Lidhja e kontratës 1.Nr. 710/14 Prot, Datë 18.07.2023	Vlera e kontratës 3, 780, 000 lekë pa Tvsh	Likuiduar 4,328,710 Lekë me tvsh

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se:

Hartimi i dokumenteve të tenderit

-Në hartimin e nevojave të Autoritetit Kontraktor në këtë rast Spitali Rajonal “Memorial” Fier, bazuar në fushën e veprimtarisë së tij dhe këkesës me nr.1780 prot., datë 30.12.2022 për “Qiramarrje automjetesh” të nëndrejtorit të përgjithshëm ka lindur nevoja për kryerjen e procedurës së prokurimit. Në kërkesën për zhvillimin e procedurës së prokurimit, automjetet e kërkuara kanë qenë një autoveturë 4+1vende, një autoveturë foristradë dhe një autobuz/furgon 17+1 vende për transportin e stafit turk, bazuar në vendimin nr.58 datë 26.01.2022 “Për miratimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkës të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, gjatë fazës kalimtare”, pika B : “Të drejtat dhe detyrimet e palës shqiptare janë: Të mbulojë shpenzimet e brendshme të pagave, akomodimit dhe transportit të personelit që do të emërohen në këtë projekt nga pala turke”.

-Nevoja për autoveturën foristradë është e paargumentuar. Duke pasur në vëmendje itinerarin e stafit turk nga aeroporti drejt spitalit dhe nga hoteli përsëri drejt spitalit, konstatohet se nuk ka asnjë argumentim ligjor dhe teknik për nevojën e një foristrade, kjo në kundërshtim me pika a) neni 2 i VKM nr.285 datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Mbi llogaritjen e fondit limit.

Në procesverbalin nr.710/5 prot., datë 01.06.2023 i mbajtur nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr.76 datë 22.05.2023, bazuar në mesataren e çmimeve të marra, fondi limit ka qenë 3,799,000 lekë pa tvsh.

Nga procesverbali i llogaritjes së fondit limit konstatohet se çmimi i autoveturës është 58,361 lekë/muaj ndërsa për foristradën është 83,666 lekë/muaj.

Nevoja e paargumentuar si edhe kryerja e njejtë e shërbimit nga të 2 mjetet, sjell rritjen e fondit limit prej **272,004 lekë**, (për 12 muaj (83,666-58,361= 22,667 x 12= 272,004)

Nga dokumentecioni i vënë në dispozicion, shpenzimet për karburant për autoveturën 4 +1 janë në sasinë 2,650 litra dhe në vlerën **483,825 lekë**.

Për foristradën janë konsumuar 4,431 litra në vlerën e **808,999 lekë**. Konstatohet se marrja me qira e foristradës ka sjellë si rezultat edhe një harxhim më të lartë të karburantit, në vlerën **325,174** pa tvsh.

Marrja e foristradës me qira krahasuar me autoveturën ka sjellë vlerën **597,178 lekë** më shumë e cila përbën efekt ekonomik negativ për SRMF.

Përgatitja e specifikimeve teknike.

Gjatë shqyrtimit të dokumentecionit konstatohet se njësia e prokurimit i ngritur me udhër nr.76 datë 22.05.2023 e përbërë nga E.G, I.K dhe E.SH.

Konstatohet se asnjë prej kriterëve të veçanta nuk janë argumentuar ligjërisht dhe teknikisht, kjo në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021, ndryshuar neni 2 “Dokumentimi i Procesit” *Konkretisht: Për cdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën: c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit...*, dhe neni 78 pika 2 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 e ndryshuar. Në cdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet ligjërisht dhe teknikisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat përgjegjës. Procesverbal i cili është mbajtur nga njësia përgjegjëse për këtë procedurë prokurimi, por nuk ka argumentuar asnjë kriter. Konstatohet se nevoja për foristradën nuk është e argumentuar si në kërkesën për fillimin e procedurës po ashtu edhe nga grupi i punës për specifikimet teknike.

Zhvillimi i procedurës

Konstatohet se në këtë procedurë prokurimi me nr REF-71845-06-07-2023 me datë zhvillimi 20.06.2023 është paraqitur vetëm një OE “T.A” shpk me oferten ekonomike në vlerën e 3,780,000 lekë pa tvsh.

Zbatimi i Kontratës

Kontrata e Shërbimit me objekt “Qiramarrje automjetesh” me nr.710/14 prot., datë 18.07.2023 e lidhur mes Spitalit Rajonale Memorial Fier dhe OE “T.A”, me kohëzgjatje 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Titullarja e AK-së me urdhër nr.710/15 prot., datë 18.07.2023 ka caktuar si person përgjegjës për zbatimin e kontratës K.K. dhe E.SH. Personat përgjegjës në procesverbalin me nr.931/1 prot., datë 18.07.2023 në zbatim të kontratës së shërbimit nr.710/14 prot., datë 18.07.2023 kanë marrë në dorëzim automjetet si më poshtë:

Nr.	Targa	Modeli	Ngjyra
1	AB867IV	Ssangyong korando	Gri
2	AA686VE	Hyundai	Blu
3	AA839TS	Fiat	Portokalli

Për këtë kontratë shërbimi likujdimi i saj është bërë cdo muaj, ku përcaktohet se pagesa për shërbimet e kryera do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e dorëzimi të procesverbaleve.

Konstatohet personat përgjegjës për zbatimin e kontratës nuk kanë mbajtur procesverbalet mbi shërbimin e kryer, veprim ky në kundërshtim me nenin 6 të kontratës së shërbimit nr.710/14 prot., datë 18.07.2023 është përcaktuar se : “*Autoriteti Kontraktor është i detyruar të likujdojë*

pagesën, për shërbimin e kryer në fakt, mbi bazën e dorëzimit të procesverbaleve dhe raportimeve mbi shërbimin e kryer”.

-Konstatohet se nga SMRF gjatë zbatimit të kontratës nuk ka gjurmë dokumentecioni mbi kryerjen e shërbimit kjo në kundërshtim me pikën 1 të nenit 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” të VKM nr.285 datë 19.05.2021 e ndryshuar. Deri më tani është likuiduar 4,328,710 lekë nga vlera totale e procedurës së prokurimit që prej muajit korrik 2023 e deri në qershor të vitit 2024.

- **Nga auditimi i Marrëveshjeve Kuadër për periudhën 2022-2024**

3. Procedura e prokurimit me objekt: “Ofrimi i Shërbimit të Lavanderisë për Spitalin Rajonal Memorial Fier”. (Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara)

-Element i regjistrit të parashikimeve për vitin 2022, lloji i procedurës së prokurimit është procedurë “E Hapur”, marrëveshje kuadër me afat 24 muaj.

Shërbim i Lavanderisë për pacientët e hospitalizuar -24 muaj.		
Urdhër Prokurimi	Specifikimet teknike Urdhër Nr. 133 datë 28.07.2023 I.D.- Kryeinfermier i Përgjithshëm F. Y-Kryeinfermiere e Përgjithshëm R.M-Specialiste ne Sektorin Juridik I.K-Specialiste në Sektorin e Planifikimit E.G-Specialiste në Sektorin e Financës Procesverbal nr.983/1 date 08.09.2023	Komisioni i Vlerësimit Ofertave Për Prokurim te Organi Blerjeve të Përqëndruara
Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedure e Hapur mbi kufirin e lartë monetar , Sherbime		
Fondi Limit (pa tvsh) 84,109,000 Leke	Oferta fituese (pa tvsh) 73,343,343 Lekë	Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 10,765,657 Lekë
Data e hapjes së tenderit 02.08.2024	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		
Lidhja e kontratës MK nr.88/10 prot., datë 31.03.2023	Vlera e kontratës 88,012,012 Lekë	Likuiduar 79,221,371 Lekë me tvsh

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se:

Hartimi i dokumenteve të tenderit

-Në hartimin e nevojave të Autoritetit Kontraktor në këtë rast Spitali Rajonal “Memorial” Fier, bazuar në fushën e veprimtarisë si dhe kërkesës nr.650/1 prot., datë 26.08.2021 drejtuar Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara ku të cilës i është dërguar kërkesa për procedurën me objekt “Ofrimi i Shërbimit të Lavanderisë për Spitalin Rajonal Memorial Fier”.

Mbi llogaritjen e fondit limit.

Grupi punës ka vijuar me studimin e tregut, i cili është bazur në kontratat e ngjashme të realizuara nga Autoritete Kontraktore të tjera. Konkretisht AK i është referuar kontratës së shërbimit nr.3983/3 prot., datë 19.08.2015 e QSU “Nënë Tereza” Tiranë, ku cmimi për njësi i referuar ka qenë 358.50 lekë për kg. Gjatë auditim konstatohet se në QSUNT gjatë kohës që është bërë studim tregut për vendosjen e fondit limit kontrata e shërbimit të lavanderisë në fuqi ka qenë me nr.543/5 prot., datë 27.01.2020 e lidhur me QSUNT dhe OE. Çmimi për njësi në atë periudhë ka qenë 357 lekë për kg, me një diferencë prej 1,5 lekë me i lartë ku është referuar SRMF për llogaritjen e fondit limit. Nëse AK do ti referohej vlerës reale të periudhës së cilës është bërë studimi i tregut, fondit limit do të ishte 210,153 kg x 357 lekë = 75,024,621 lekë pa tvsh. Diferenca me vlerën e përlllogaritur është 315,299 lekë mbi fondin limit.

Shërbimi i Lavanderisë për Spitalin Rajonal Memorial Fier është marrëveshje kuadër, ku fondi limit është bazuar në kontratat e mëparshme, kjo e sipërcituar në paragrafin më lart. Llogaritja e fondit limit bazuar në kontratën e vitit 2015 është në kundërshtim me nenin 34, pika 8 e LPP nr.162 datë 23.12.2020 i ndryshuar, si dhe nenin 12, pika 9 e VKM nr.285 datë 19.05.2021, e ndryshuar. Autoriteti kontraktor, në këtë rast SRMF mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

-Konstatohet se AK nuk ka argumentuar shifrën e frekuencës ditore të larjes së materialit të butë, po ashtu edhe vlerat e nxjerra për larjen e materialit të stafit mjekësor dhe bllokut operator, duke sjell si pasojë një sasi të paargumentuar, kjo në kundërshtim me nenin 2 pika c e VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Në vijim të procedurës, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara nxjerrë urdhrin e prokurimit me nr.88 prot., datë 23.11.2021 dhe numri i referencës së procedurës së prokurimit REF-12-21-2021. OE fitues i procedurës ka qenë "U.S" me ofertën ekonomikë 73,343,397 lekë pa tvsh.

Marrëveshja Kuadër e lidhur midis Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara në emër dhe përlllogari të Spitalit Memorial Rajonal Fier me OE "U.S" shpk me nr.88/10 prot., datë 31.03.2022 me një kohëzgjatje 24 (njëzetë e katër) muaj.

Ftesa për Ofertë drejtuar OE me nr.554/2 prot., datë 08.04.2022 për ofrimin e shërbimit të lavanderisë, ku më pas kontrata e parë e furnizimit e lidhur mes SMRF dhe "U.S" shpk me nr.554/4 prot., datë 11.04.2022 me kohëzgjatje 3 muaj.

Për monitorimin, ndjekjen dhe zbatimin e procesit të lavanderisë, titullari i AK nxjerr urdhër nr.49/1 datë 20.04.2022 i përbërë nga z.I.D., znj A. A. dhe zn. I.K. Grupi i punës ka ndryshuar përsëri me urdhër të titullares së AK-së me nr.49/2 datë 01.06.2022 i përbërë nga z.I.D., z.E. K, znj. I.K.

Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar me nr.554/6 prot., datë 14.04.2022 është dërguar pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara me nr.554/7 prot., datë 14.04.2022. Në përfundim të kontratës së furnizimit të parë, grupi i punës ka dërguar relacionin drejtuar Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve mbi realizimin e kontratës. Kontrata e furnizimit nr.2 e lidhur me nr.554/13 prot., datë 08.07.2022 me afat 9 muaj. Kontrata e furnizimit nr.3 e fundit e lidhur mes OE dhe "Spitalit Rajonal Memorial Fier" me afat 12 muaj me nr.501/3 prot., datë 11.04.2023. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet në relacionin me nr.398 prot., datë 01.03.2024 është kërkuar të mundësohet shërbimi i lavanderisë me 7854 kg të paezauruara nga dy kontratat e para.

4. Procedura e prokurimit me objekt "Shërbimi i Akomodimit" në Spitalin Rajonal Memorial Fier.

-Element i regjistrimit të parashikimeve për vitin 2022, lloji i procedurës së prokurimit është procedurë "E Hapur", marrëveshje kuadër me afat 24 muaj.

"Shërbim i Akomodimit për personelin turk"		
Urdhër Prokurimi Nr.12, Dt 15.04.2022	Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Njësia Prokurimit Urdher Nr.11, Dt 24.08.2021	Komisioni i Vlerësimit Ofertave P.D-Përgjegjëse në Sektorin e Prokurimeve
Lloji i Procedurës së Prokurimit "Procedure e Hapur" Shërbime	E.G- Drejtoresh Juridike dhe Prokurimeve K.K.-Përgjegjëse në Sektorin e Financës I.D.- Kryeinfermier i Përgjithshëm Specifikimet teknike Urdhër Nr. 41, datë 08.04.2022 A. A- Drejtoresh Planifikimit dhe Koordinimit K. K - Nëndretor i Përgjithshëm N. C -Kryeinfermiere e Përgjithshme K.K.-Përgjegjëse në Sektorin e Financës R.M - Drejtoresh Burimeve Njerëzore	J. D- Përgjegjëse në Sektorin e Burimeve Njerëzore I. K - Specialiste në Sektorin e Financës

Fondi Limit (pa tvsh) 32, 247, 180 Lekë	Oferta fituese 32, 239, 200 Lekë pa TVSH	Diferenca me fondin limit 7, 980 Lekë
Data e hapjes së tenderit 19.05.2022	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike E SHPK H SH
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		
Lidhja e kontratës Nr. 858/15 Prot Datë 01.07.2022 Nr. 858/22 Prot Datë 29.27.2022	Vlera e kontratës 4, 508, 640 lekë pa Tvsh 28 ,247, 680 leke pa Tvsh	Likuiduar 39,307,584 Lekë me tvsh

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se:

Hartimi i dokumenteve të tenderit

-Në hartimin e nevojave të Autoritetit Kontraktor në këtë rast Spitali Rajonal “Memorial” Fier, për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e spitalit si projekt pilot, lind nevoja e akomodimit të personelit turk. Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 41 datë 08.04.2022 , është ngritur komisioni për argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe nevojave.

Mbi llogaritjen e fondit limit.

Grupi i punës është bazuar në studimin e tregut për llogaritjen e fondit limit. Gjatë studimit të tregut ka dërguar ftesën për ofertë në 3 OE ku dhe ka marrë ofertat. Vlera e ofertuar nga OE “J” shpk ka qenë 4550 lekë pa tvsh për person në ditë. Vlera e dytë e ofertuar nga OE “A.M” shpk ka qenë 4500 lekë pa tvsh për person në ditë. Oferta e tretë nga OE “H.Sh” ka qenë 5500 lekë me tvsh (5170 lekë pa tvsh).

Në procesverbalin nr.587/4 prot., datë 12.04.2022 i mbajtur nga grupi i punës, studimi i tregut bazuar në mesataren e cmimeve të marra, konstatohen cmimet, 5500 lekë me tvsh, 4550 lekë me tvsh dhe 4500 lekë me tvsh. Konstatohet se grupi i punës dy prej ofertave të marra gjatë studimit të tregut, në përlllogaritjen e mesatares janë llogaritur me tvsh, kjo në kundërshtim me nenin 76, pika 1 c e VKM nr.285 datë 19.05.2021. Nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se gjatë llogaritjes së fondit limit nga grupi i punës është aplikuar tvsh 20%, kjo në kundërshtim me nenin 49, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, pika 3.

Përgatitja e specifikimeve teknike.

Grupi i punës i ngritur me nr.41 datë 08.04.2022 ka hartuar specifikimet teknike. Gjatë auditimit konstatohet se, për këtë procedurë është kërkuar se OE fitues i cili do të kryejë shërbimin e akomodimit të personelit turk, duhet të mbulojë fjetjen në dhoma standarte teke ose dyshe, akomodimi në hotel do të jetë maksimumi për 38 (tridhjetë e tetë) persona në natë. Koha e qëndrimit do të jetë 12 muaj si dhe OE fitues duhet të ketë të përfshirë mëngjesin.

Në Dokumentet standarde të tenderit janë përcaktuar kriteret e vecanta nga njësia e prokurimit ku është kërkuar që OE fitues të ketë të punësuar 5 të punësuar nga të cilët pastrues, kuzhinier, mirëmbajtjes ose ekuivalent. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që OE të ketë punësuar një punonjës “përkthyes” të gjuhës turke, për të cilin të paraqitet kontratë punë dhe OE fitues të marrë përsipër që në raste emergjence shëndetësore të ekipit turk të vëjë në dispozicion një automjet 4+1 për transportin e personelit mjekësor nga hoteli drejt spitalit.

Konstatohet se për asnjë prej kriterëve të vecanta nuk janë argumentuar ligjërisht dhe teknikisht, kjo në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021, ndryshuar neni 2 “Dokumentimi i Procesit” Konkretisht: *Për cdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën: c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit...*, dhe neni 78 pika 2 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 e ndryshuar. Në cdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet ligjërisht dhe teknikisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat përgjegjës, procesverbal i cili nuk është mbajtur nga njësia përgjegjëse për këtë procedurë prokurimi.

Zhvillimi i procedurës

Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave me nr.649//1 prot., të datës 19.05.2022, si dhe sistemit elektronik të APP, konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 (dy) operator ekonomik “E” sh.p.k., me ofertë në vlerë 17,483,800 lekë pa TVSH dhe “H.Sh” me ofertën në vlerë 32,239,200 lekë pa tvsh.

Zbatimi i Kontratës

Marrëveshja kuadër me objekt “Shërbimi i Akomodimit të personelit turk” me nr.88/33 prot., datë 29.06.2022 e lidhur mes Spitalit Rajonale Memorial Fier dhe OE “H Sh”, me kohëzgjatje 7 muaj nga nënshkrimi i kontratës. Kontrata e shërbimit nr.858/15 prot., datë 01.07.2022 ka qenë me afat 1 muaj (31 ditë) dhe për akomodimin e 36 personave në natë. Me urdhër nr.02, datë 04.07.2022 janë caktuar personat përgjegjës për zbatimin e kontratës, K.K. dhe J. D. Kontrata e shërbimit nr.858/22 prot., datë 29.07.2022 ka qenë me afat 6 muaj (184 ditë) për akomodimin e 38 personave. Me urdhër nr.88, datë 04.07.2022 janë caktuar personar përgjegjës për zbatimin e kontratës K.K. dhe J. D.

Në lidhje me zbatimin e kontratave, janë përzgjedhur 2 muaj të marrëveshjes kuadër. Muaji nëntor 2022 (01.11.2022-30.11.2022), nevoja për të akomoduar ka qenë për 32 persona të personelit turk, ku për cdo natë numri i personelit turk nuk ka qenë i njëjtë. Në procesverbalin e mbajtur nga grupi i zbatimit të kontratës, i cili konstaton pas verifikimit se ekipi turk është akomoduar pranë M B H dhe këtë periudhë janë përmbushur të gjitha detyrimet kontraktuale. Lista e akomodimit për muajin nëntor 2022 e nënshkruar kjo nga nëndrejtori i përgjithshëm (ekonomik) z. I. A dhe nëndrejtori i përgjithshëm (mjekësor) Kursat Dal, rezulton se vetëm 10 prej personelit turk janë akomoduar pranë MH, ndërkohë 22 veta të tjerë të personelit turk janë akomoduar ne P H, kjo në kundërshtim me kriterin e vendosur në DST ku vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë hotel “M”, po ashtu në kundërshtim të plotë planin e zbatimit të kontratës nr.858/18 prot., datë 04.07.2022.

Struktura përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës ka vepruar në kundërshtim me nenin 20 të kontratës së shërbimit nr.858/15 prot., datë 01.07.2022.

Për muajin tetor 2022 (01.10.2022-31.10.2022), nevoja për të akomoduar ka qenë 34 persona të personelit turk. Lista e akomodimit për muajin nëntor 2022 e nënshkruar kjo nga nëndrejtori i përgjithshëm (ekonomik) z. I.A dhe nëndrejtori i përgjithshëm (mjekësor) K. D, rezulton se vetëm 14 prej personelit turk janë akomoduar pranë M.H, ndërkohë 20 veta të tjerë të personelit turk janë akomoduar ne P.H, kjo në kundërshtim me kriterin e vendosur në DST ku vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë hotel “M”, po ashtu në kundërshtim të plotë planin e zbatimit të kontratës nr.858/18 prot., datë 04.07.2022.

Struktura përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës ka vepruar në kundërshtim me nenin 20 të kontratës së shërbimit nr.858/15 prot., datë 01.07.2022.

Shërbimi i akomodimit, ushqimit për personelin Turk për vitin 2021

Spitali Rajonal “Memorial” Fier është një institucion i cili ka filluar akitvitetin spitalor në maj të vitit 2021. Personeli turk në kuadër të marrjes së masave për ushtrimin e veprimtarisë funksionale të ofrimit të shërbimit spitalor, ka kërkuar të plotësohen kushtet për akomodimin, ushqimin dhe pastrimin, larjen, hekurosjen për personelin turk. Pas kërkesës drejtuar titullares së SRMF, me urdhër nr.10/2 prot., datë 20.05.2021 është ngritur grupi i punës për marrjen e ofertave për akomodimin e stafit Turk. Pas administrimit të ofertave të marra nga komisioni, është miratuar oferta më e ulët. Oferta fituese ka qenë e OE “M B H” me 6,100 lekë për akomodim në natë, shërbimi i ushqimit për 3 vakte ka qenë 2,500 lekë dita dhe 650 lekë dita për shërbimin e pastrimit, larjes dhe hekurosjes. Kontrata e shërbimit mes Spitalit Rajonal Memorial Fier dhe “MB H” Fier me nr.10/14 është lidhur me datë 24.05.2021 e vlefshme deri më datë 31.12.2021. Kjo kontratë shërbimi është shtyrë me aneks kontrate nr.10/18 prot., datë 05.01.2022 pas afatit të përfundimit deri në datën e nënshkrimit të kontratës së re për këtë shërbim.

VKM nr.58, datë 26.01.2022 “Për miratimin, në parim, të protokollit, ndërmjet Këshilli të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për

funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, gjatë fazës kalimtare”, në nenin 4, pika b) Të drejtat dhe Detyrimet e Palës Shqiptare janë: “...Të mbulojë shpenzimet e brendshme të pagave, akomodimit dhe transportit të personelit që do të emërohen në këtë projekt nga Pala Turke....”

Stafi i SRMF me një memo drejtuar titullares së institucionit shprehet se kanë detyrimin të mbulojnë shpenzimet financiare për akomodim (banim të përkohshëm dhe vaktet e ushqimit) për personelin turk. Në VKM 58/2022 nuk përcaktohen rregulla për mënyrën e mbulimit të këtyre shpenzimeve të ushqimit, por vetëm të akomodimit dhe transportit. Në memon nr.726 prot., datë 29.04.2022 grupi i përbërë nga K. K. (nëndrejtor ekonomik), A. C. (nënrejtori i përgjithshëm), N.M. (drejtore e Financës), E.G (drejtore juridike), I.D. (kryeinfermier), N.C (kryeinferimere e përgjithshme), I. G (përgj. e sektorit të kordinimit me pacientët), R. M (përgj. e sektorit të burimeve njerëzore), J. D (përgj. e sektorit të performancës), kanë gjykuar që për mbulimin e shërbimit të ushqimit për personelin turk, të zbatohet për **analogji** VKM nr.870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. Dieta Ditore është caktuar në vlerën e 1,000 lekë dhe më një total prej 9,310,000 lekë për periudhën 01.05.2022-31.12.2022. Këto veprime në kundërshtim me VKM.870/2011, pasi objekt i saj janë vetëm punonjësit e qeverisjes së përgjithshme, punonjësit e institucioneve të pavarura, për njësitë e qeverisjes vendore, për punonjësit e gjykatës si dhe njësitë vartëse dhe punonjësve të përfaqësive tona jashtë vendit. Ky trajtim financiar nuk u përket kategorisë së punonjësve të shtetasve të huaj të punësuar në institucione shqiptare. Në vijim personeli turk në një kërkesë drejtuar titullares së SRMF, pas dokordësimit unanimisht që vlera prej 1,000 lekë/dita të ndalet nga shërbimet e tyre dhe të kalojë në llogarinë e OE “H Sh”. Drejtoresha e Përgjithshme me shkresën nr.1046/1 prot., datë 01.07.2022 i kalon për dëgjim dhe njohje ndaljen e vlerës përkatëse, Drejtorisë së Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme. Ky trajtim financiar për shërbimin e ushqimit vazhdon të funksionojë po njësoj edhe sot në kundërshtim me VKM nr.58, datë 26.01.2022, neni 4 pika 3, ku është detyrim i SRMF të mbulojë vetëm shpenzimet e brendshme të pagave, akomodimit dhe transportit të personelit turk.

5. Procedura e prokurimit “Shërbim gatimi dhe Shpërndarje Ushqimi për Spitalin Rajonal Memorial Fier”, viti 2022 (Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara)

<i>Sherbim gatimi dhe shperndarje ushqimi per Spitalin Rajonal Memorial Fier</i>		
Urdhër Prokurimi Nr. 356 date 06.09.2022 Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedure e Hapur, Shërbime	Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Prokuruar nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara. Specifikimet teknike Urdhër Nr. 29 datë 29.09.2021 A. A - Drejtore Koordinimit dhe Planifikimit. I. G -Përgjegjëse në Sektorin të Kujdesit ndaj Pacientit. I.D.-Kryeinfermier i Përgjithshëm M. Ç-Përgjegjëse në Sektorin e Planifikimit J. D- Përgjegjëse në Sektorin e Burimeve Njerëzore	Komisioni i Vlerësimit Ofertave Prokuruar nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.
Fondi Limit (pa tvsh) 15,154,300 Leke	Oferta fituese 15,106,657 Lekë	Diferenca me fondin limit 47,643 Lekë
Data e hapjes së tenderit 27.09.2022	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike “L C”shpk
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		

Lidhja e kontratës Nr. 1464/4 Prot. date 25.10.2022 Nr 1174/3 Prot., date 15.09.2023	Vlera e kontratës 7,553,800 lekë pa Tvsh 7,517,812 leke pa Tvsh	Likuiduar 18,085,935 Lekë me tvsh
---	--	-----------------------------------

Grupi i punës i ngritur me urdhër nr.28 datë 29.09.2021 në procesverbalin nr.946/1 prot., datë 14.06.2022 për llogaritjen e fondit limit është bazuar në marrëveshjen kuadër të procedurës së “Shërbim gatimi dhe shpëndraje ushqimi” për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Spitali Memorial i Fierit, ka marrë për referencë cmimet e përdorura të marrëveshjes kuadër nr.54/12 prot., datë 26.03.2019. Për këtë procedurë prokurimi fondi limit ka qenë 15,154,300 lekë pa tvsh.

-Konstatohet se grupi i punës nuk ka argumentuar ligjërisht dhe teknikisht asnjë prej specifikimeve teknike dhe termave të referencës, por janë një kopje e kontratës të cilës SRMF i është referuar për cmimin e racionit/person. Konstatohet se të gjitha kriteret e vendosura janë një kopje e marrëveshjes kuadër të lidhur mes QSUNT dhe OE. Grupi i punës ka vepruar në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021, e ndryshuar “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 2 “Dokumentimi i Procesit”.

-Konstatohet se SMRF për ofrimin e shërbimit të gatimit, shpërndarjes dhe servirjes së ushqimit për pacientët e hospitalizuar, për të gjitha llojeve të dietave nuk është argumentuar asnjë prej sasive të kërkuara. Për 16 lloje dietash adulte, asnjë prej tyre nuk ka një historik pacientësh, për të cilën janë prokuruar sasi të për vitin 2023.

-Konstatohet se në grupin e punës nuk ka patur specialistë të fushës edhe pse kemi të bëjmë me shërbim gatimi për pacientë të hospitalizuar, kjo në kundërshtim pika 2 neni 78, VKM nr.285 datë 19.05.2021 e ndryshuar.

Kjo procedurë prokurimi është zhvilluar në SPE nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Me shkresën n.1464 prot., datë datë 07.10.2022 SRMF i është dërguar njoftimi për lidhje kontrate me OE fitues “L C” shpk me vlerën prej 15,106,675 lekë pa tvsh.

Marrëveshja Kuadër mes OE dhe Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara nr.166/5 prot., është lidhur më datë 07.10.2022 me një afat 12 mujor.

Me shkresën nr.1646/1 prot., datë 12.10.2022 Drejtoria e Kujdesit për Pacientin i është drejtuar Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve për sasinë e dietave ushqimore për një periudhë 6 mujore. Me urdhër nr.108, datë 25.10.2022 të titullares së AK-së janë caktuar personat përgjegjës për zbatimin e kontratës së furnizimit nr 1, nr.1464/4 prot., datë 25.10.2022, e përbërë nga I. K, R.M dhe K.K.

6. Procedura e prokurimit me objekt “Evadimi i mbetjeve spitalore” në Spitalin Rajonal Memorial Fier.

-Element i regjistrimit të parashikimeve për vitin 2022, lloji i procedurës së prokurimit është procedurë “E Hapur e Thjeshtuar”, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj.

“Evadimi i mbetjeve spitalore”		
Urdhër Prokurimi Nr. 27 date 14.09.2022	Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Sherbime	Urdhër Nr.27, Dt 14.09.2022 E.G K.K. I.D. Specifikimet teknike Urdhër Nr. 97 datë 13.09.2022	D.K R. M M. M
Fondi Limit (pa tvsh) Lekë 8 862 945 Leke	Oferta fituese 7, 088, 550 Lekë	Diferenca me fondin limit 1,774, 395 Lekë
Data e hapjes së tenderit 31.10.2022	Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	Operatorët Ekonomike E. R shpk

		M- T shpk V.A.L.E
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		
Lidhja e kontratës Nr. 1742/1 Prot. date 28.12.2022 Nr 327/3 Prot., date 01.03.2022 Nr 1456/3 Prot., date 24.11.2023	Vlera e kontratës 2, 359, 710 lekë pa Tvsh 728, 840 leke pa Tvsh 1, 758, 400 leke pa Tvsh	Likuiduar 5,816,340 Lekë me tvsh

Nga dokumentecioni i vënë në dispozicion, u konstatua se:

Hartimi i dokumenteve të tenderit

-Në hartimin e nevojave të Autoritetit Kontraktor në këtë rast Spitali Rajonal “Memorial” Fier, bazuar në fushën e veprimtarisë së tij dhe këkesës me nr.64/13 prot., datë 07.04.2022 për “Trajtimin e Mbetjeve Spitalore”, ka lindur nevoja për kryerjen e procedurës së prokurimit. Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr.13 datë 08.04.2022 , është ngritur komisioni për llogaritjen dhe argumentimin e fondit limit.

Mbi llogaritjen e fondit limit.

Grupi i punës është bazur në cmimet e kontratave të ngjashme të lidhura nga Autoritete Kontraktore të tjera për llogaritjen e fondit limit. Në procesverbalin nr.587/4 prot., datë 12.04.2022 i mbajtur nga grupi i punës, studimi i tregut bazuar në mesataren e cmimeve të marra, konstatohen cmimet, 460 lekë/kg pa tvsh, 410 lekë/kg pa tvsh, 380 lekë/kg pa tvsh, 378 lekë/kg pa tvsh, 335 lekë/kg pa tvsh, ku cmimi mesatar i llogaritur është 392.6 lekë/kg pa tvsh.

-Konstatohet se sasia e përcaktuar për procedurën e trajtimit të mbetjeve spitalore për një periudhë 12 muajore ka qenë 22,577 kg në total. Për referencë është marrë muaji dhjetor si muaji me ngarkesën më të madhe me një total mujor prej 1186 kg ku për 12 muaj vlera e llogaritur do të ishte 14,232 kg (1186x12). Sasi për të cilën është prokuruar kjo procedurë prokurimi e trajtimit të mbetjeve është e paargumentuar si nga grupi i cili ka bërë kërkesën dhe nga grupi i punës për llogaritjen e fondit limit kjo në kundërshtim me neni 2 “Dokumentimi i Procesit” dhe pika 4 b) e nenit 62 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Fondi limit për “Për trajtimin e mbetjeve spitalore për Spitalin Rajonal Memorial Fier” është 8,862,945 lekë pa tvsh.

Përgatitja e specifikimeve teknike.

Konstatohet se asnjë prej kriterëve të vecanta nuk janë argumentuar ligjërisht dhe teknikisht, kjo në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021, ndryshuar neni 2 “Dokumentimi i Procesit” *Konkretisht: Për cdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën: c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit..*, dhe neni 78 pika 2 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 e ndryshuar. Në cdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet ligjërisht dhe teknikisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat përgjegjës. Procesverbal i cili është mbajtur nga njësia përgjegjëse për këtë procedurë prokurimi, por nuk ka argumentuar asnjë kriter.

Zhvillimi i procedurës

Formulari i njoftimit të fituesit me nr.1717/2 prot., datë 20.12.2022 pas përfundimit të afateve të ankimimit është shpallur fitues OE “E.R” me vlerë 7,088,550 lekë, pa tvsh.

Zbatimi i Kontratës

Marrëveshja kuadër me objekt “Evadimin e mbetjeve spitalore” me nr.1717/3 prot., datë 22.12.2022 e lidhur mes Spitalit Rajonale Memorial Fier dhe OE “E.R”, me kohëzgjatje 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Për këtë marrëveshje kuadër janë lidhur 2 kontrata shërbimi: Kontrata e shërbimit nr.1742/1 prot., datë 28.12.2022 ka qenë me afat 3 mujor me vlerë kontratë 2,359,710 lekë pa tvsh dhe Kontrata e shërbimit nr. 327/3 prot., datë 01.03.2023 me afat 9 mujor me vlerë kontrate 4,728,840 lekë pa tvsh. Në përfundim të afatit të marrëveshjes kuadër është lidhur kontrata e shërbimit nr.3 me nr.1456/3 prot., datë 24.11.2023 me një afat 6 mujor me një sasi prej 5600 kg sasi mbetjesh. Konstatohet se kjo kontratë shërbimi është zhvilluar në përfundim të afatit

12 mujor të marrëveshjes kuadër duke mos njoftuar për modifikim kontrate, kjo në kundërshtim me nenin 23 të VKM nr.285 datë 19.05.2021.

Personat përgjegjës për zbatimin e kontratës së mbetjeve spitalore kanë mbajtur procesverbalet duke rakorduar sasinë e mbetjeve të nxjerra nga cdo pavion spitalore me sasinë e marrë nga OE fitues. Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar, dokumentecioni që shërben për shlyerjen e faturës dhe që i bashkëlidhet urdhër shpenzimeve përkatëse janë situacioni, grafiku mujor i evadimit, informacion mbi realizimin e trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve konform kushteve të kontratës dhe deklaratë magazinimi. OE, në zbatim të pikës 3.3.5, të termave të referencës DST, sipas së cilës ”O.E duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të lincensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive dhe ë vlefshme në momentin e hapjes së ofertave” .

OE ka paraqitur pranë AK kontratën nr.287 prot., datë 02.09.2022 për depozitim mbetjesh pranë impjantit të përpunimit të mbetjeve urbane të lidhur ndërmjet “E.R”shpk dhe “E.-E” , është parashikuar detyrimi i OE që të përcjellë cdo 3 muaj analizat e hireve nga djegia e mbetjeve spitalore kjo sipas Rregullores nr.6 datë 30.11.2007 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.

-Si rezultat është e paqartë ecuria e procesit të hirit të krijuar, nëse ai dorëzohet pranë një subjekti të licencuar për ta trajtuar apo jo. Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në fund të çdo muaji OE nuk ka përcjellë konfirmimin e asgjësimit të cilin e shoqëron me shiritat e incineratorit për të vërtetuar realizimin e kontratës, kjo në kundërshtim me pikën 3.3.5 të specifikimeve teknike.

- **Procedura prokurimi të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) për periudhën 01.04.2021-30.12.2023**

Është përzgjedhur për auditim zbatimi i kontratës të procedurës më poshtë, përcaktuar sipas analizës së riskut

Nr.	Objekti prokurimit	M Vlera fituese pa tvsh (për SMRF)	Realizimi i Kontratave të Furnizimit
1	Hemodinamika – LOTI 1	6,556,500	6,555,500
2	Hemodinamika – LOTI 2	16,549,750	16,539,750
3	Hemodinamika – LOTI 3	22,030,400	21,914,000
4	Hemodinamika – LOTI 5	4,872,200	2,841,720
5	Hemodinamika – LOTI 6	67,471,885	5,962,300
6	Hemodinamika – LOTI 7	16,546,750	8,872,900
	Totali i Loteve për shërbimin e “Hemodinamikës”	134,027,485	62,686,170

Informacion i marrë nga SRMF

Mbi Zbatimin e Kontratave

1. Blerje materiale mjekimi për shërbimin e Hemodinamikës

-Marrëveshje kuadër nr.3578/16 prot., datë 26.07.2022, lidhur ndërmjet AK (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) dhe “M” shpk, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 6,556,500 lekë pa tvsh.

Për Lotin 1 “Kartatere koronare diagnostike” janë lidhur 3 kontrata furnizimi:

-Nr.149/14 prot., datë 16.02.2023 me vlerë kontrate 1,627,400 lekë pa tvsh.

-Nr.149/56 datë 10.08.2023 me vlerë kontrate 1,627,400 lekë pa tvsh.

-Nr.190/28 prot., datë 30.11,2023 me vlerë kontrate 3,300,700 lekë pa tvsh.

-Marrëveshje kuadër nr.3578/18 prot., datë 12.12.2022, lidhur ndërmjet AK (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) dhe “O” shpk, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara -

me afat 24 muaj” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 16,546,750 lekë pa tvsh.

Për Lotin 2 “Set për përgatitjen për koronografi angioplastike” janë lidhur 3 kontrata furnizimi:

-Nr.149/11 prot. datë 16.02.2023 me vlerë kontrate 4,114,300 lekë pa tvsh.

-Nr.149/41 prot., datë 03.07.2023 me vlerë kontrate 5,799,800 lekë pa tvsh.

-Nr.190/15 prot., datë 05.10.2023 me vlerë kontrate 6,625,650 lekë pa tvsh.

-Marrëveshje kuadër nr.3578/18 prot., datë 12.12.2022, lidhur ndërmjet AK (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) dhe “O” shpk, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 22,030,400 lekë pa tvsh.

Për Lotin 3 “Ballona dhe kateter guide dhe gida angioplastike” janë lidhur 4 kontrata furnizimi:

-Nr.149/19 prot., datë 10.03.2023 me vlerë kontrate 5,284,900 lekë pa tvsh.

-Nr.149/57 prot., datë 10.08.2023 me vlerë kontrate 5,284,900 lekë pa tvsh.

-Nr.149/65 prot., datë 13.09.2023 me vlerë kontrate 3,050,000 lekë pa tvsh.

-Nr.190/24 prot., datë 13.09.2023 me vlerë kontrate 8,294,200 lekë pa tvsh

-Marrëveshje kuadër nr.3578/17 prot., datë 12.12.2022, lidhur ndërmjet AK (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) dhe “O” shpk, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 4,872,200 lekë pa tvsh.

Për Lotin 5 “Stenda të medikuara” janë lidhur 2 kontrata furnizimi:

-Nr.190/1 prot., datë 02.02.2023 me vlerë kontrate 2,435,760 lekë pa tvsh.

-Nr.190/4 prot., datë 05.10.2023 me vlerë kontrate 405,960 lekë pa tvsh.

-Marrëveshje kuadër nr.3578/26 prot., datë 23.01.2023, lidhur ndërmjet AK (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) dhe BOE: “O” & “M” shpk, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 67,471,885 lekë pa tvsh.

Për Lotin 6 “Stenta të medikuara për resetonzë” janë lidhur 3 kontrata furnizimi:

-Nr.149/7 prot., datë 13.02.2023 me vlerë kontrate 1,104,940 lekë pa tvsh.

-Nr.149/29 prot., datë 24.05.2023 me vlerë kontrate 1,104,940 lekë pa tvsh.

-Nr.149/47 prot., datë 12.07.2023 me vlerë kontrate 3,752,420 lekë pa tvsh.

-Marrëveshje kuadër nr.3578/18 prot., datë 12.12.2023, lidhur ndërmjet AK (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) dhe BOE: “O” shpk & “M” shpk ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 16,546,750 lekë pa tvsh.

Për Lotin 7 “Stenda të medikuara” janë lidhur 3 kontrata furnizimi:

-Nr.149/20 prot., datë 10.03.2023 me vlerë kontrate 2,632,120 lekë pa tvsh.

-Nr.149/35 prot., datë 05.06.2023 me vlerë kontrate 2,632,120 lekë pa tvsh.

-Nr.190/13 datë prot., 13.07.2023 me vlerë kontrate 3,609,660 lekë pa tvsh.

Mbi zbatimin e kontratave të shërbimit spitalor

Për kryerjen e shërbimeve nga SRM Fier janë nënshkruar kontratat me operatorët ekonomik sipas procedurave të prokurimi, si:

- “Shërbimi i lavanderisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Memorial Fier - 12 muaj”.

- “Shërbim dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Rajonal Memorial Fier -12 muaj”.

- “Shërbim i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore” - 12 muaj”.

Nga verifikimi rezultoi se:

Kontratat e shërbimeve kanë përfunduar më 30.03.2024 dhe këto shërbime të domosdoshme për pacientët mungojnë në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier, pra për këto shërbime nuk janë kryer shtesa kontrate me operatorin ekonomik fitues i tenderit të vitit 2023 si edhe deri në datën 02.08.2024, nuk janë nënshkruar kontrata për kryerjen e shërbimeve, si më poshtë:

1. “Shërbimi i lavanderisë për pacientet e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Memorial Fier - 24 muaj” 2022-2024

- Marrëveshja Kuadër me afat 24 muaj është nënshkruar më datë 31.03.2022.
- Kontratat (4 kontrata) në bazë të Marrëveshjes Kuadër të datës 31.03.2022 kanë përfunduar më datë 25.03.2024, **pra, spitali është pa shërbimin e lavanderisë.**

Nga verifikimi në vend në ambientin e shërbimit të lavanderisë, u konstatua se:

-Shërbimi kryhej nga dy punonjëse të spitalit në ambientin dhënë me qira, ku më parë përdorej nga OE “U” shpk.

-Pajisjet për larjen e materialeve spitalore janë lavatrice dhe tharse me kapacitet rreth 6 kg, për të cilat nga dokumentecioni i magazinës, rezulton se 4 copë lavatrice me vlerë 30,000 mijë lekë/copë janë bërë hyrje me fletë-hyrje me datë 24.04.2024 nga subjekti person fizik “E. J”, por fletë dalja është nënshkruar vetëm nga magazinierja dhe jo nga personi që e ka marrë në dorëzim në kundërshtim me Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pika 38,39 dhe 40, po kështu nga pamja vizuale lavatriçet janë të konsumuara/përdorura.

Nisur nga ky fakt kërkua dokumentecionin e procedurës së prokurimit, e cila rezulton të jetë kryer “blerje emergjente” me OE “E.J”, i cili në fushën e veprimtarisë së tij ka “elektroshtëpiake të përdorura”, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, referuar edhe testimin të tregut janë në shitje lavatriçe të reja me vlerë 30.000 lekë, të cilat mund të ishin prokuruar nga komisioni i blerjeve të vogla, me qëllim plotësimin e nevojave emergjente, zbatimin e legjislacionit dhe shmangien e infeksioneve të ndryshme nga përdorimi i një malli të përdorur për larjen e materialeve spitalore.

2. “Shërbim dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Rajonal Memorial Fier - 12 muaj” 2022-2024

- Marrëveshja Kuadër me afat 12 muaj është nënshkruar më datë 22.10.2022.
- Kontratat (2 kontrata) në bazë të Marrëveshjes Kuadër të datës 22.10.2022 kanë përfunduar më datë 12.04.2024 **pra, spitali është pa shërbimin e furnizimit me ushqim për të sëmurët.**

3. “Shërbim i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore” - 12 muaj” 2022-2024

- Procedurë e hapur e thjeshtuar - Marrëveshje kuadër me afat 12 muaj është nënshkruar më datë 22.12.2022.
- Kontratat (3 kontrata) në bazë të Marrëveshjes Kuadër të datës 22.12.2022 kanë përfunduar më datë 30.04.2024 **pra, spitali është pa shërbimin e asgjësimit të mbetjeve.**

Nga verifikimi në vend në ambientin e asgjësimit të mbetjeve spitalore, u konstatua se:

Dhoma e dedikuar për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve që prej datës 30.04.2024 ishte e tejmbushur, sa nuk të linte mundësinë për të hapur derën, si me poshtë:



Përgjegjësia për administrimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore.

-Nga regjistri i mbetjeve spitalore sasia e administruar që prej përfundimit të marrëveshjes kuadër të 2023 është 6594 kg për periudhën 01.04.2024-15.07.2024, nga verifikimi në terren i grumbullimit dhe administrimit të tyre, konstatojmë se nuk është kryer ndarja sipas llojit dhe kategorisë përkatëse, veprim në kundërshtim me shtojcën 1 të VKM nr.798/2010.

-Spitali Rajonal Memorial Fier në cilësinë e prodhuesit të mbetjeve spitalore, ka grumbulluar dhe ka magazinuar në ambientet e spitalit nga 01.04.2024 deri më 15.07.2024 duke tejkaluar afatin ligjor prej 45 ditë, në kundërshtim me pikën 8.9 të VKM nr. 798/2010 “Magazinimi i mbetjeve spitalore”, ku përcaktohet se **“mbetjet infektive nuk duhet të magazinohen për më shumë se 45 ditë para trajtimit”**.

Spitali Rajonal Memorial Fier është përgjegjës për mbetjet spitalore, kjo referuar shkronjës e), pika 5, kreu II, VKM 798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, sipas së cilit “Prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe në shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre”.

Pra, ky spital në cilësinë e prodhuesit të mbetjeve të rrezikshme nuk ka marrë asnjë masë për evadimin e mbetjeve si edhe nuk ka hartuar një program për uljen e vëllimit, të sasisë dhe toksicitetit të mbetjeve të rrezikshme, në kundërshtim me shkronjën a), pika 3, neni 7, ligji Nr. 9537, 18.05.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”, i cili parashikon se “Çdo prodhues brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e planit kombëtar për administrimin e mbetjeve të rrezikshme dhe në përputhje me të, harton dhe zbaton një program të shkruar për uljen e vëllimit, të sasisë dhe toksicitetit të mbetjeve të rrezikshme”. Referuar sasisë së grumbulluar të mbetjeve prej 6594 kg x314 lekë/kg (çmimi/njësi i kontratës 2023) është në vlerën **2,070,516** lekë, vlerë e cila duhet të reflektohet e llogaritet për këtë sasi referuar çmimit të OE fitues, veprim cili është në kushtet e një kontrate me efekt prapaveprues.

6. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave

Për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore, u shqyrtua dokumentecioni si më poshtë:

- Rregullorja e brendshme e shoqërisë
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e SRM, Fier.
- Statuti i Spitalit

- Dokumentecioni mbi pasqyrimin dhe evidentimin e të ardhurave.
- Dokumentecioni i mbajtur për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave.
- Kontratat e qirasë të nënshkruara me subjektet qiramarrës, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentecionit të sipërcituar konstatohet se:

Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier (SRMF), janë klasifikuar nga Ministria e Shëndetësisë si të ardhura me të drejtë përdorimi 100% nga spitali. Mënyra e përdorimit të këtyre të ardhurave është e përcaktuar në VKM nr.687, datë 26.10.2022 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të spitalit rajonal “Memorial”, Fier si aplikues i autonomisë spitalore menaxheriale” neni 17, ku përcaktohet se: “Të ardhurat dytësore, të realizuara nga spitali “Memorial” Fier, përdoren nga vetë spitali sipas kritereve që përcaktohen në statut dhe miratohen nga Bordi Drejtues i spitalit”.

Burimi i të ardhurave në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier, janë:

- Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve që u kryhen pacientëve, të cilët nuk kanë rekomandimin e mjekut të përgjithshëm dhe të familjes, si tarifa për vizita, analiza dhe ekzaminime të ndryshme.
- Të ardhurat nga veprimtaria ekonomike, si qiratë, parkimi i automjeteve në territorin e spitalit, etj.
- Të ardhurat e krijuara nga dhurimet në vlerë materiale e monetare.

SRMF, realizon të ardhura nga veprimtaria e tij kryesore. Burimi i të ardhurave për periudhën objekt auditimi, në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier, janë të ardhurat e krijuara nga shërbimi ndaj pacientëve, parkimi dhe qiratë e krijuara nga dhënia e disa ambienteve me qira, si klub, vendosja e 4 distributorëve automatik dhe 2 ambiente për kryerjen e shërbimit të lavanderisë dhe ushqimit.

Për periudhën objekt auditimi nga SRMF, janë realizuar të ardhura nga qiratë, parkimi si dhe kryerja e ekzaminimeve të ndryshme, të cilat për 3 vitet paraqiten si më poshtë:

Viti	2021		2022		2023	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Burimi i të Ardhurave						
Shërbimi i Pacientëve	-	12,276,700	24,170,000	24,438,900	24,000,000	20,828,100
Parkimi	-	-	-	-	2,400,000	2,256,310
Qira	-	271,500	830,046	863,065	900,000	639,764
Total	-	12,548,200	25,000,064	24,301,965	27,300,000	23,724,174

Burimi: Drejtorja e Financës

Referuar të dhënave të tabelës konstatohet se për vitin 2021 nga drejtorja e financës dhe shërbimeve nuk është planifikuar niveli i të ardhurave si edhe burimet e krijimit të tyre.

Për vitet 2021, 2022 deri në muajin gusht të vitit 2023, nuk janë miratuar tarifa dhe nuk janë arkëtuar të ardhura nga shfrytëzimi i teritorrit të spitalit me objekt “Parkimi”, duke ndikuar negativisht në nivelin total të të ardhurave, pasi miratimi i tarifave për shfrytëzimin e teritorrit të spitalit është bërë me vendimin nr.2, datë 21.07.2023 “Për miratimin e tarifës së Shërbimeve të parkimit të automjeteve në Spitalit Rajonal “Memorial” Fier”.

Realizimi i të ardhurave paraqitet më i lartë në vitin 2022, ndërsa në vitin 2023 niveli i të ardhurave rezulton me ulje, ndikim ka dhënë ulja e të ardhurave të zërit “shërbim ndaj pacientëve” dhe ulja e të ardhurave nga “dhënia e ambienteve me qira”.

Të ardhurat e gjeneruara nga shërbimet përdoren nga spitali në masën 100%, për vitin 2021 është përdorur nga të ardhurat dytësore shuma 2,259,190 lekë për “shpenzime operative” (602) dhe mbetur shuma 10,289,010 lekë. Për vitin 2022 është përdorur nga të ardhurat dytësore shuma 12,838,133 lekë për “Paga” (600), shuma 8,348,445 lekë dhe shuma 3,030,000 lekë për “Investime” (231) dhe mbetur shuma 10,724,174 lekë. Për vitin 2023 është përdorur nga të ardhurat dytësore shuma 11,314,465 lekë për “shpenzime operative” (602), shuma 14,953,200 lekë për “Investime” (231) dhe mbetur shuma 7,830,906 lekë. Përdorimi i të ardhurave dytësore kryesisht për paga dhe investime është miratuar me vendimet përkatëse të bordit drejtues.

Nga SRMF për periudhën objekt auditimi, janë nënshkruar kontratat e qirasë si më poshtë:

1-Kontrata nr. 276, prot, datë 11.06.2021 nënshkruar me shoqërinë “A&A” me objekt “Dhënia me qira e ambientit të spitalit me sipërfaqe të brendshme 35 m dhe sip të jashtme 30 m” me afat 1 vit përfaqësuar nga z. A. K dhe zj. R.D.

Në nenin 3.1 të kontratës “Qiraja dhe mënyrat e pagesës” përcaktohet se palët bien dakord për çmimin 68,000 lekë/muaj.

Referuar nenit 3.2 pagesa për fillimin e kontratës do të jetë data 01.09.2021, në nenin 3.3 përcaktohet se pagesa do të kryhet brenda datës 5 të muajit, në numër llogarie të spitalit memorial, Fier në Tirana bank dhe në nenin 3.4. përcaktohet se nëse qiramarrësi nuk kryen ndonjë pagesë në afat, Qiradhënësi e njofton me shkrim, duke i lejuar një afat prej 14 ditë për shlyerjen e saj. Pas 4 njoftimesh të bëra me shkrim, Qiradhënësi gëzon të drejtën e përfitimit të kamatëvonesave në vlerën 5000lekë/muaj deri në pagimin e plotë të shumës.

Amendim kontrate 276/2, datë 12.06.2022 me objekt “Zgjatje afati kontrate” deri në 31.03.2023

Nga auditimi konstatohet se kontrata ka përfunduar në datën 31.03.2023.

Pagesat e kryera nga qiramarrësi për periudhën shtator 2021-Mars 2023, paraqiten si më poshtë:

Viti	Muaji	Fatura	Data	Vlera	Paguar	Data
2021	Shtator-Nëntor	1	09.12.2021	204,000	203,750	14.12.2021
	Dhjetor	3	22.12.2021	68,000	67,750	30.12.2021
2022	Janar	3	11.01.2022	68,000	68,000	21.01.2022
	Shkurt	5	04.02.2022	68,000	68,000	08.02.2022
	Mars	7	07.03.2022	68,000	68,000	30.03.2022
	Prill	10	24.05.2022	68,000	68,000	04.06.2022
	Maj	11	24.05.2022	68,000	136,000	25.08.2022
	Qershor-Korrik	12	27.07.2022	136,000	68,000	23.09.2022
	Gusht-Tetor	16	24.10.2022	204,000	204,000	27.10.2022
	Nëntor	18	05.12.2022	68,000	-	-
	Dhjetor	19	07.12.2022	68,000	136,000	28.12.2022
	2023	Janar	1	24.01.2023	68,000	-
Shkurt		9	17.02.2023	68,000	68,000	03.02.2023
Mars		10	03.03.2023	68,000	136,000	10.03.2023
Shuma				1,292,000	1,291,500	

Sipas tabelës konstatohet se pagesat janë kryer në kundërshtim me nenin 3.2 dhe 3.3 të kontratës dhe nuk janë llogaritur kamatëvonesat **në shumën 80,000 lekë.**

2- Kontrata nr. 627, prot, datë 14.04.2022 nënshkruar me shoqërinë “U.S” me objekt “Dhënia me qira e ambientit të spitalit me sipërfaqe 49.38m për ta përdorur për shërbimin e lavanderisë” me afat deri në përfundimin e marrëveshjes kuadër me çmim 9,340 lekë/muaj, përfaqësuar nga z. P. Gj dhe zj. R.D.

Viti	Muaji	Fatura	Data	Vlera	Paguar	Data
2022	14 Prill-dhjetor	4	27.01.2023	80,013	80,013	31.01.2023
2023	Janar	5	27.01.2023	9,340	9,340	31.01.2023
	Shkurt	6	17.02.2023	9,340	9,340	22.02.2023
	Mars	13	03.03.2023	9,340	9,340	24.03.2023
	Prill	15	03.04.2023	9,340	9,340	28.04.2023
	Maj	18	04.05.2023	9,340	9,340	23.05.2023
	Qershor	20	13.06.2023	9,340	9,340	18.07.2023
	Korrik	22	04.07.2023	9,340	9,340	18.07.2023
	Gusht	25	02.08.2023	9,340	9,340	29.08.2023
	Shtator	29	04.09.2023	9,340	9,340	22.09.2023
	Tetor	31	10.10.2023	9,340	9,340	27.10.2023
	Nëntor	34	07.11.2023	9,340	9,340	21.11.2023
	Dhjetor	40	07.12.2023	9,340	9,340	19.12.2023

	Shuma		192,093	192,093	
--	--------------	--	----------------	----------------	--

Referuar nenit 8 të kontratës “Modalitetet e pagesës”, përcaktohet se pagesa do të kryhet brenda datës 5 të muajit pasardhës. Megjithëse pagesat janë kryer jashtë afatit të përcaktuar në kontratë nuk janë llogaritur penalitete pasi në kontratën e nënshkruar nga palët nuk janë përcaktuar penalitete.

3-Kontrata nr.495, datë 27.07.2021, me objekt “Dhënia me qira e disa ambienteve të spitalit me sipërfaqe 1-7.5m për distributor automatik” me afat 1 vit me çmim 3,768 lekë/muaj, përfaqësuar nga T. M dhe zj. R.D.

Viti	Muaji	Fatura	Data	Vlera	Paguar	Data
2021	Korrik-dhjetor	2	09.12.2021	22,608	22,608	24.01.2022
2022	Janar	1	11.01.2022	3,768	3,768	24.01.2022
	Shuma			26,378	26,378	

Në nenin 7.1. “Modalitetet e pagesës” përcaktohet se pagesa do të kryhet brenda datës 5 të çdo muaji dhe 7.2. për çdo ditë vonesë do të paguhet 0.04% e vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë.

4- Kontrata nr. 1464/1, prot, datë 31.10.2022 nënshkruar me shoqërinë “L Kompani” me objekt “Dhënia me qira e ambientit të spitalit me sipërfaqe 18.45 m për mbajtjen e enëve për shpërndarjen e ushqimit” me afat 1 vit me çmim 19,596 lekë/muaj, përfaqësuar nga z. E.K dhe zj. R.D.

Viti	Muaji	Fatura	Data	Vlera	Paguar	Data
2022	Tetor 2022-2023	30	10.10.2023	235,152	235,152	23.11.2023
2023	Nëntor	35	07.11.2023	19,596	-	-
	Dhjetor	39		19,596	-	-
	Shuma			274,344		

Në nenin 8 të kontratës “Modalitetet e pagesës” përcaktohet se pagesa do të kryhet brenda datës 5 të muajit pasardhës. Nuk janë caktuar penalitete si edhe nuk janë respektuar kushtet e pagesës sipas nenit 8 të kontratës.

5- Kontrata nr. 134, prot, datë 27.01.2022 me objekt “Dhënia me qira e ambientit të spitalit me sipërfaqe 18.45 m për mbajtjen e enëve për shpërndarjen e ushqimit” me afat 2 vjet me çmim 3,651 lekë/muaj, përfaqësuar nga z. L. K dhe zj. R.D.

Viti	Muaji	Fatura	Data	Vlera	Paguar	Data	
2022	Janar-Mars	9	15.04.2022	3,651			
	Prill-Qershor	14	27.07.2022	3,651	7,302	23.08.2022	
	Korrik-Nëntor	15	05.08.2022	6,085	13,387	23.09.2022	
	Dhjetor	21	07.12.2022	1,217			
2023	Janar	2	24.01.2023	1,217			
	Shkurt	7	17.02.2023	1,217			
	Mars	12	03.03.2023	1,217			
	Prill	14	03.04.2023	1,217			
	Maj	19	04.05.2023	1,217	1,217	23.05.2023	
	Qershor	21	13.06.2023	1,217	1,217	04.07.2023	
	Korrik	23	04.07.2023	1,217			
	Gusht	24	02.08.2023	1,217	1,217	03.08.2023	
	Shtator	27	04.09.2023	1,217	1,217	07.09.2023	
	Tetor	32	10.10.2023	1,217	1,217	13.10.2023	
	Nëntor	33	07.11.2023	1,217	1,217	13.11.2023	
	Dhjetor	41	11.12.2023	1,217	1,217	13.12.2023	
		Shuma			29,208	29,208	

Sipas nenit 4 “Çmimi i kontratës” pagesa e qirasë do të bëhet çdo 3 muaj brenda datës 30 të muajit janar, mars, qershor dhe shtator. Konstatohet se nuk janë respektuar afatet e pagesave sipas përcaktimeve në kontratë.

Referuar dokumentacionit konstatohet se për nënshkrimin dhe monitorimin e kontratave të qirasë mungojnë kërkesat e përcaktuara në VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”,

Kreu II “Procedurat e dhënies me qira ose enfitozoë të pasurisë shtetërore” pika 1, germa a, b, ç, dh si edhe pika 7 germa a, c, ç, d, dh; ku kërkohet:

1. Institucioni shtetëror që ka në administrim objektin përgatit dokumentacionin si vijon:

a) *propozimin për dhënien me qiratë objektit, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që do të ushtrohet në këtë pasuri dhe afatin e dhënies me qira.*

b) *vendimin e organit drejtues të institucionit shtetëror (Bordi drejtues)*

ç) *Genplanin e objektit në 6 kopje origjinale, të hartuar nga eksperti topograf i licencuar dhe konfirmuar nga drejtuesi i institucionit*

dh) *konfirmimin nga ZRPP për pronësinë shtet të objektit dhe nga AKKP për vendimet që mund të jenë dhënë për njohje /kompesim prone.*

7. Dokumentecioni për marrje me qira:

a) *kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore*

c) *ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë*

ç) *certifikatën e regjistrimit në QKR*

d) *vërtetimin nga tatimet për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve*

dh) *vërtetim që nuk ka procese gjyqësore dhe nuk është në ndjekje penale në lidhje me aktivitetin.*

-Kreu VI “Monitorimi i kontratave” pika 2, germa a, b dhe c.

2. Njësia monitoruese e kontratave të qirasë kryen këto detyra:

a) *Pas lidhjes së kontratës së qirasë bën dorëzimin të qiramarrësi me procesverbal të objektit të përshkruar në kontratë. Në procesverbal përshkruhet qartë gjendja fizike e pronës, vlera kontabël shoqëruar me pamje fotografike të momentit.*

b) *Kur mbaron afati merr në dorëzim me procesverbal objektin që ka në administrim*

c) *ndjek në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratave të qirasë çdo 6 muaj dhe harton akte rakordimi me subjektin qiramarrës.*

Procesverbali për marrjen/dorëzimin e ambientit mbajtur nga Drejtoresha Përgjithshme dhe jo nga komisioni i monitorimit të kontratave, nuk përshkruhet gjendja fizike, etj, veprime në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05.02.2014, i ndryshuar.

II. Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve që u kryhen pacientëve, të cilët nuk kanë rekomandimin e mjekut të përgjithshëm dhe të familjes, si tarifa për vizita, analiza dhe ekzaminime të ndryshme.

Tarifat për shërbimin ndaj pacientëve janë miratuar me vendimin e Bordit Drejtues Nr.5, dt.15.11.2023 “Mbi miratimin e tarifave të ekzaminimeve ambulatorore dhe kostove të shërbimeve” ku janë përcaktuar kostot e shërbimeve dhe kategorizimi i pacientëve me sistem referimi, të siguruar dhe të pa siguruar.

Kryerja e pagesave kryhej nëpërmjet arkës bazuar në sistemin e referimit shoqëruar me rekomandimin e mjekut mandat arkëtimi në 3 kopje të nënshkruar nga personat përgjegjës dhe në vitin 2022 e në vazhdim, edhe nëpërmjet faturës elektronike gjeneruar nga platforma e fiskalizimit.

7. Mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, funksionimi i strukturës së Auditit të Brendshëm.

Për funksionimin e sistemit të MFK, u shqyrtua dokumentecioni si më poshtë:

-Rregullorja e Brendshme,

-Gjurma e auditit,

-Menaxhimi strategjik,

-Rregulloret e ndryshme etj.

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- *pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;*
- *informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;*
- *mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.*

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga strukturat e Spitalit Rajonal Memorial, Fier si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si edhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”

- Spitali Rajonal Memorial, Fier ka hartuar Udhëzimin nr. 1, datë 28.09.2021 për “Disiplinën dhe Etikën e punonjësve në Spitalin Rajonal Memorial Fier” të mirëfilltë, të trupëzuar në një dokument të veçantë. Neni 25, pika 1 e këtij udhëzimi përcakton se “Punonjësi i institucionit duhet të marrë masa konkrete, në përputhje me Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike’”, si dhe disa raste të konfliktit të interesit për zbatim nga Drejtori i Përgjithshëm.

Me Urdhrin nr.9, datë 21.01.2022 për “Ngritjen e Bordit të Etikës” është ngritur bordi i përbërë nga:

1. Znj. R.D., Drejtore e Përgjithshme (kryetare),
2. Z. K. K, Nëndrejtor i Përgjithshëm (anëtar),
3. Z. A. C, Nëndrejtor i Përgjithshëm Mjekësor (anëtar),
4. Znj, E.G, Drejtore Juridike dhe e Prokurimeve (anëtar),
5. Znj. R. G, Përgjegjëse e Sektorit të të Rekrutimit (anëtar),

Në kreun 8, neni 37, pika 3 “Bordi i Etikës” parashikohet “Bordi i Etikës miraton vendimin përfundimtar për dhënien e masës disiplinore bazuar në raportet të komisioneve të disiplinës, rast pas rasti”. Grupi i auditimit konstaton se në asnjë rast nuk është zbatuar kjo pikë.

Grupi i auditimit konstaton se nuk është përcaktuar detyrimi për njohjen dhe zbatimin e VKM nr. 874, datë 29.09.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”. Neni 34 “Dhuratat, shpërblimet për punonjësit” parashikon kufizimet dhe rastet në të cilat lejohet marrja e dhuratave nga punonjësit e SRMF. Konkretisht në pikën 2 përcaktohet se “Gjatë marrëdhënieve të punësimit në SRMF, punonjësi mund të pranojë artikuj ushqimorë në vlerë të vogël në raste jo të shpeshta”, si dhe në pikën 4 përcaktohet se “Lejohet që punonjësi të marrë dhurata spontane të dhëna me dëshirë për rastet e veçanta si martesë, ditëlindje, dalje në pension, përfundim mandati ose raste ngushëllimi për vdekje apo për sëmundje. Këto lloj dhuratash si rregull kufizohen vetëm në rrethin e ngushtë të bashkëpunëtorëve”

Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, por nuk ka trajnime për këto raste.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, me ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, nenet 8, pika 8/a, 12, pika 3, 16, 21.

- Për procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, për periudhën objekt auditimi nuk është ngritur Njësia Përgjegjëse për Sinjalizimet, nuk janë hartuar rregullore.

Në Rregulloren e Brendshme në Kreun 3 “Etika”, nenit 20-36 janë përcaktuar veprimet që parandalohen, detyrimet dhe normat e sjelljes, ndërsa për ndëshkimin e rasteve në nenin 148 “Sanksione” përcaktohet se mos respektimi i rregullores përbën shkak për procedim disiplinor sipas Kodit të Punës dhe akteve të tjera ligjore në fuqi. Mos njohja e rregullores, nuk e justifikon punonjësën nga përgjegjësia dhe sanksionet në rast të shkeljeve të mundshme. Grupi i auditimit konstaton se për periudhën objekt auditimi nuk është hartuar raporti i Njesisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, dhe për pasojë nuk është dërguar pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të interesave (ILDKPKI). Nga testimi rezultoi se nuk ka patur raste të raportuara të shkeljeve të kodit etik. Nuk ka programe të trajnimit nga ana e Spitali Rajonal Memorial, Fier për integritetin dhe sjelljen.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit në Drejtorinë për Kujdesin ndaj Pacientit dhe në faqen zyrtare të spitalit duke iu adresuar SRMF dhe përgjigjja kthehet nga zyrat përkatëse. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 120 “Detyrat dhe përgjegjësitë në Sektorin e Koordinimit me Pacientin” të Rregullores së Brendshme.

-Ka proces vlerësimi 1-vjetor për punonjës të që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të Kodit të Punës dhe sipas Rregullores nr. 543/1 prot, datë 01.04.2022 për “Vlerësimin e personelit në Spitalin Rajonal Memorial Fier”.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”

- Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse, që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar në rregulloren e brendshme.

- Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë nuk hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Bordit Drejtues lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme, në detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha niveleve janë përcaktuar mënyra e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët, Përgjegjësit e Sektorëve sipas fushave që ato mbulojnë.

-Ka raporte monitorimi periodik për procedura të ndryshme të cilat i adresohen Drejtoreshës të Përgjithshme.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE.

-Bordi Drejtues me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Spitalit.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”

- Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Spitali Rajonal Memorial, Fier me Vendimin e Titullarit nr. 1360 prot, datë 31.12.2021.

- Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimet e menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e PBA-së, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat janë mbajtur procesverbale të takimeve të tyre, apo procesverbale të takimeve me grupet e interesit, Në Spital kjo është bërë vetëm për vitin 2023.

- Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike, por nuk ka urdhër të veçantë të Drejtorit Përgjithshëm.

- Nuk është hartuar plan i veprimit për menaxhimin financiar për periudhën e auditimit 2021-2023 për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilin përfshihen, aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

- Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Spitalit. Organigrama e Spitali Rajonal Memorial, Fier është e ndërtuar në mënyrë të tillë që, 3 nën/Drejtorët, Kryeinfermieri, Sektori e Auditit të Brendshëm varen direkt nga Drejtori i Përgjithshëm, ku dhe llogaridhënia është direkt tek Drejtori i Përgjithshëm i Spitalit në linjë horizontale, ndërsa shërbimet dhe drejtoritë kanë varësi nga nën/Drejtorët përkatës, nga niveli më i ulët specialist, përgjegjës sektori e specialistët llogaridhënia është në linjë vertikale. Strukturat organike sipas viteve janë:

Për vitin 2021 me urdhrin e Ministrit nr.181/1, datë 25.03.2021 “Për miratimin strukturës dhe organikës së Spitalit Rajonal Memorial Fier” me 398 punonjës të miratuar dhe strukturë: 17 Shërbime, 1 Farmaci, 6 Drejtori, 3 Kabinete dhe 11 Sektorë.

- Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë saj. Për çdo Drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilin drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion, por nuk janë të shoqëruara dhe me objektivat për secilin punonjës, dhe janë të pasqyruara në vlerësimet e punës.

- Spitali Rajonal Memorial, Fier ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet por në të nuk janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për këtë spital.

- Vlerësimin e punës së strukturës organike, spitali nuk e ka kryer, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Me urdhrin e Ministrit nr.181/1, datë 25.03.2021 është krijuar struktura e Spitalit Rajonal Memorial Fier (SRMF), e cila ka në përbërjen e saj 398 punonjës, staf administrativ, mjekësor dhe mbështetës.

Me vendimin e Bordit Drejtues nr. 6, datë 21.09.2021, me urdhrin e Ministrit nr. 503, datë 22.11.2021 dhe urdhrin e brendshëm nr.503/1, datë 24.11.2023 “Për një ndryshim në strukturën organizative të spitalit Memorial Fier”, janë bërë ndryshime ku Kabineti i Hemodinamikës me 4 punonjës është kthyer në Shërbim Hemodinamike me 1 Shef Shërbimi, 1 mjek, 1 kryeinfermier dhe 7 infermierë.

Numri i teknikëve të Shërbimit të Anestezi–Reaminacionit ka shkuar nga 5 teknikë në 3. Numri i infermierëve në shërbimin e Transfuzioligjisë ka shkuar nga 2 në 1, në shërbimin e Pneumonisë nga 7 në 6 dhe në shërbimin e Kardiologjisë nga 8 në 6.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.

Në rastet e testuara afërsisht 30% të rekrutimit rezultoi se ishin kryer procedurat në përputhje me Kodin e Punës. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale, e cila përmban të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat

disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: certifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

-Mungon një program strategjik i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë spitali nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Spitali Rajonal Memorial, Fier nuk ka paraqitur pranë ASPA kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve me nr. 371 prot., datë 23.01.2023, e cila i dërgohet Shkollës Shqiptare të Administratës Publike për trajnimin e stafit me qëllim ngritjen profesionale sipas nevojave duke përcaktuar qartë tematikat e trajnimeve që kërkohen të kryhen. Ekzistojnë të dhënat për trajnime e punonjësve jashtë institucionit.

-Për Spitalin Rajonal Memorial Fier nëpunësi autorizues është Drejtori i Përgjithshëm, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Për sa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimi.

- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika 8/a, Kreu III, neni 20; Mjedisi *i kontrollit pika 1,2/a, d dhe* - “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.1, Kapitulli IV “Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit”, Kapitulli V, Anekset.

Në lidhje me parimin 5 “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”

Në Rregulloren e Brendshme është parashikuar “funksionet/detyrat që delegohen” në zbatim të ligjit 44/2015 “kodi i Procedurave Administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollin i institucionit rezulton se për periudhën objekt auditimi ka patur Urdhëresa për delegime detyrash.

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Drejtoresha e Përgjithshme e Spitalit ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Me shkresën nr. 449/1 prot., datë 19.07.2021” Relacioni” formulari nr. 1 “Të ardhurat dhe shpenzimet” në DRF Fier, referuar shkresës nr.621 prot., datë 14.07.2021” Për hartimin e treguesve të programit buxhetor 2022-2024” të DRF Fier, pa miratim të Bordit Drejtues.

Me shkresën nr. 38 prot, datë 12.05.2021 “Detajimi i buxhetit për Spitalin Rajonal Memorial Fier” është detajuar buxheti detajuar buxheti për periudhën maj-dhjetor 2021.

Me shkresën nr. 539 prot, datë 31.03.2022 “Detajimi i buxhetit dhe plani i arkës për vitin 2022” është detajuar buxheti detajuar buxheti për vitin 2022.

Me shkresën nr. 320 prot, datë 27.02.2023 “Detajimi i buxhetit për Spitalin Rajonal Memorial Fier” është detajuar buxheti detajuar buxheti për vitin 2023.

Për vitin 2022 me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 179 prot, datë 02.02.2022 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me 11 anëtarë dhe është ngarkuar me zhvillimin e takimeve periodike për diskutimin e çështjeve kryesore dhe mangësive të cilat lidhen me ofrimin dhe garantimin e shërbimit mjekësor si dhe çështje të tjera që lindin dhe janë objekt

diskutimi. Përgjegjësi i Sektorit të Auditit të Brendshëm ngarkohet të marrë pjesë në këto mbledhje në cilësinë e vëzhguesit, pa të drejtë vendimmarrje.

Me shkresën nr.1122 prot., datë 14.07.2022 “Relacion” dhe pasqyrat e PBA 2023-2025 janë dërguar në Drejtorisë Rajonale të FSDKSH Fier (DRF Fier) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Hartimi është bërë referuar shkresës nr.2589 prot., datë 05.07.2023 “Procedurat e hartimit të Projektbuxhetit për vitin 2024-2026” të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pa miratim te Bordit Drejtues.

Për vitin 2023 me Urdhrin e Brendshëm nr. 298 prot, datë 21.02.2023 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me 11 anëtarë dhe është ngarkuar me zhvillimin e takimeve periodike për diskutimin e çështjeve kryesore dhe mangësive të cilat lidhen me ofrimin dhe garantimin e shërbimit mjekësor si dhe çështje të tjera që lindin dhe janë objekt diskutimi. Përgjegjësi i Sektorit të Auditit të Brendshëm ngarkohet të marrë pjesë në këto mbledhje në cilësinë e vëzhguesit, pa të drejtë vendimmarrje.

Referuar shkresës nr 2589 prot., datë 05.07.2023 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale është dërguar relacioni dhe pasqyrat PBA 2024-2026 me shkresën nr.979/4 prot., datë 28.07.2022 “Shkresë përcjellëse” DRF Fier dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale me miratim nga GSM por jo te Bordit Drejtues.

Në Kreun V të Rregullores së Brendshme janë të përcaktuara komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Spitalit me detyrat përkatëse, por nuk është përfshirë Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), për të cilin nuk përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tij:

Nga verifikimi rezulton se GSM nuk ka kryer detyrat si:

- Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar
- Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së spitalit, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GSM për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

Në Udhëzimin e MF nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike’, lidhur me rolin e GSM në sistemin e MFK, përcaktohet se ‘GMS duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike’. Për sa më sipër, për periudhën 2021-2023 rezulton se janë kryer vetëm 3 mbledhje të kryera nga GSM, për të cilat janë mbajtur procesverbale të protokolluar me nr. 298/1 prot, datë 21.02.2023, nr. 320/2 prot, datë 27.02.2023 dhe nr. 1168 prot, datë 13.09.2023.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.

Spitali Rajonal Memorial, Fier në hartimin e PBA-ve ka nuk vendosur objektiva ashtu dhe në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë të përcaktuara në Planin e përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit të Spitali Rajonal Memorial, Fier. Këto objektiva nuk bëhen të njohura, si në stafin e spitalit nëpërmjet shkresave drejtuara Drejtorive dhe duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE.

Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.

- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, SRMF nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.

Në nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘*Për t’i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.*

-Me Urdhrin nr. 873 prot, datë 03.07.2023 për “Hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në Spitalin Rajonal Memorial Fier”, është ngritur grupi prej 15 anëtarësh për hartimin e kësaj strategjie dhe përcaktimin e objektivave të këtij grupi.

-Me Vendimin nr. 873/2 prot, datë 18.08.2023 për “Miratim i Regjistrit të Riskut të Spitalit Rajonal Memorial Fier” është hartuar dhe miratuar regjistri i riskut i SRMF.

- Me shkresën nr. 873/3 prot, datë 15.08.2023 është hartuar “Strategjia e Menaxhimit të Riskut dhe Plani Afatgjatë i veprimit”.

Për sa më sipër, rezulton se Spitali Rajonal Memorial, Fier nuk ka hartuar një strategji plotë risku, duke e unifikuar atë me regjistrin e riskut, pasi mungojnë objektivat dhe planet e veprimit janë të mangëta, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296.

Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘*Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësive të tij, nëpunësi autorizues mund t’i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës.*’ Nuk ka Urdhër të Titullarit për përcaktimin e koordinatorit të riskut, si dhe mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut.

Është hartuar regjistri i riskut, ku është bërë identifikimi dhe vlerësimi i risqeve për Drejtoritë përkatëse. Duke mos u përcaktuar koordinatori i riskut dhe grupi i menaxhimit të riskut si pasojë dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut.

Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të spitalit ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e spitalit, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”

Spitali Rajonal Memorial, Fier në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj nuk ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara, por personat zëvendësues përgjegjës janë përcaktuar rast pas rasti. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 21, pika 2; me Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe

kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3 “Përgjegjësitë dhe detyrat e KR”, pika 3.2.1 “Titullari i njësisë publike” pika 4 “Hapat për ngritjen e sistemit të MR” dhe - “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.2, Kapitulli V, Aneksët.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë krahas përcaktimit të detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, të prokurimit të fondeve publike, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj).

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Statistikës. Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Statistikës dhe ndiqet nga Njësia Zbatues/Autorizimi i pagesës nga Drejtori i Përgjithshëm (NA). Struktura e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme përbëhet nga 17 punonjës, 2 përgjegjës Sektori dhe 1 drejtor.

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit. Detyrat dhe përgjegjësitë e NjHDT dhe KVO janë parashikuar edhe kapitullin V të Rregullores së Brendshme.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh dhe objekte prokurimesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurma e auditimit e vërtetohet ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga dega e Thesarit, e cila konfirmohet me regjistrimin në SIFQ dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.

- Në Rregulloren e Brendshme, neni 88 “Detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësit të arkivës” përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar dhe Vendimit të titullarit të Spitalit “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve të Spitali Rajonal Memorial, Fier”, në bazë të të cilave është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili nuk përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”

- Spitali Rajonal Memorial, Fier nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë shkresore dhe elektronike. Faqja Zyrtare e Spitali Rajonal Memorial, Fier në internet ka një sistem back-up. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të

dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, ku përgjegjësitë janë të identifikuara në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të tij, nuk ka plan-veprime të ndryshme operative për menaxhimin e riskut, pavarësisht se është bërë SRMF, identifikimi dhe vlerësimi i riskut sipas aktiviteteve.

-Në nenet 68-79 të rregullores së brendshme janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme për të gjitha nivelet në të gjitha aktivitetet e përfshira, duke eliminuar riskun që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar si hartim, miratim, zbatim, monitorim.

-Për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi merret Sektori i Administrimit dhe Planifikimit Spitalor, Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, dhe Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve. Këto funksione janë përfshirë në detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre drejtorive referuar rregullores së Brendshme.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregulime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listë pagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. Pasqyrat Financiare konfirmohen nga NA dhe NZ.

Nga AB nuk është ushtruar auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare kryhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”).

Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar përcaktohet se ‘*Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi*’. Për sa më sipër, rezulton se Titullari i Spitali Rajonal Memorial, Fier për vitin 2021 dhe 2022 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

Me vendimin e GMS nr. 873/3 prot, datë 18.08.2023 është miratuar “Gjurma e Auditit në Spitalin Rajonal Memorial Fier”

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi”, me “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”. Drejtuesit në Spitali Rajonal Memorial, Fier kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacionale, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

-Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.

-Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

-Institucioni operon me program të vetin të kontabilitetit, pa e dubluar programin SIFQ. Në bazë të këtij programi kontabilitetit me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i të ardhurave dhe shpenzimeve sipas programeve dhe projekteve.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm. Ka faqen e saj zyrtare. Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në Kreun II “Rregulla të përgjithshme”, neni 6 “Parime të përgjithshme dhe funksionet e administratës”, Kreu III “Etika”, neni 26 “Komunikimi”, neni 27 “Komunikimi i brendshëm me rrjet elektronik”, neni 35 “Marrëdhëniet me median, deklaratimet publike dhe publikimet”.

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit herë pas here, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar.

Komunikimi zyrtar mes punonjësve të spitalit realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale. Për mbledhjet e ndryshme të stafit drejtues dhe të menaxherëve me Bordin Drejtues janë mbajtur procesverbale. Në faqen e Spitali Rajonal Memorial Fier nuk janë të publikuar dokumentet kryesore, broshura, planet strategjike, raportet periodike, struktura organike, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e spitalit. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet, që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

-Nuk ka raporte periodike dhe publikime vjetore për performancën e spitalit në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

-Nga Spitali Rajonal Memorial, Fier kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të evidentuara në dokumentin e konsultimit publik.

-Korrespondenca zyrtare me institucionet dhe subjekteve juridik dhe individë bëhet nëpërmjet zyrës së protokoll-arkivës. Ndërsa ankesat dhe përgjigjet e individëve/publikut realizohet nëpërmjet Drejtorisë të Kujdesit me Pacientin, e cila i evidenton në një regjistër tjetër protokollit. Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Spitali Rajonal Memorial, Fier nuk siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit.

V. Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”

- Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e spitalit, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efijencës e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Spitali monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili nuk është plotësuar dhe nuk është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave,

- Në Spitali Rajonal Memorial, Fier mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe nuk është hartuar plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Në Spitali Rajonal Memorial, Fier aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

- Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm, ku për vitin 2023 janë audituar nga Auditi i Brendshëm 3 subjekte.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo të në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Drejtorin e Përgjithshëm të Spitalit, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 24, “Monitorimi” pika 1, me “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.5, Kapitulli V, Anekset.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: R.D., Drejtor i Përgjithshëm të SRMF, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, znj. N.M., Drejtor i Drejtorisë të Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme në SRMF, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

-Për funksionimin e strukturës së Auditit të Brendshëm, u shqyrtua dokumentecioni si më poshtë:

-Karta e Auditimit të Njesisë AB të Spitalit “Memorial” Fier (SRMF);

-Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;

-Programimi i auditimeve të brendshme për vitet 2021-2023;

-Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;

-Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;

-Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

-Ligji Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar;

-Ligji Nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”;

-VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”;

-Manuali i “Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016;

-Urdhëri nr.4, datë 10.01.2020 i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”;

-VKM nr.160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike” i ndryshuar;

-Udhëzimi Nr.42, datë 27.10.2020 “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;

-Normat Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Auditimi u fokusua kryesisht në këto çështje:

▣ organizimi dhe funksionimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm/Komitetit të Auditimit, niveli profesional i audituesve, çertifikimi i tyre dhe trajnimet e detyrueshme,

☒ bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, niveli i raportimit në këtë drejtori,

☒ realizimi i treguesve të planifikuar nga NJAB,

☒ sigurimi i brendshëm i cilësisë së auditimit, etj,

me qëllim vlerësimin nëse veprimtaria e auditit të brendshëm është në përputhje me kriteret ligjore dhe standardet e auditimit, konkretisht Ligjin Nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm

Në zbatim të Ligjit Nr.114/2015, datë 20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 10, pika 1, ku përcaktohet se:

“Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në gerrat a-c të kësaj pike”

është ngritur dhe funksionon Sektori Auditit të Brendshëm në varësi funksionale nga Drejtori përgjithshëm.

Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e NJAB në sektorin publik” Spitali Rajonal “Memorial” Fier, në strukturën e miratuar ka ngritur Sektorin e auditit.

Për vitin 2021, nuk është ngritur NJAB dhe nuk ka funksionuar me 3(tre) auditues, sipas strukturës organizative të miratuar nga Bordi Drejtues me vendimin nr. 1, datë 25.03.2021 “Miratimi i strukturës dhe organikës së Spitalit Rajonal “Memorial” Fier”, në kundërshtim me VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 3 e cila përcakton se: *“Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3(tre) punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë. Në strukturën e Njesisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.”*

Për vitin 2022, NJAB nuk ka funksionuar deri në datën 01.09.2022 me emërimin e zj. M.Ç dhe zj. D.I (02.11.2022- 03.04.2023), kjo njësi nuk është plotësuar me 3(tre) auditues, sipas strukturës organizative të miratuar nga Bordi Drejtues me vendimin nr. 1, datë 25.03.2021 “Miratimi i strukturës dhe organikës së Spitalit Rajonal “Memorial” Fier”, në kundërshtim me VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 3.

Për vitin 2023, Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 2(dy) auditues zj. V.D.(punonjëse me kontratë 23.01.2023-24.10.2023) dhe zj.M.Ç. Pra, për periudhën objekt auditimi njësia e Auditit nuk është plotësuar sipas strukturës së miratuar, ligjit nr.114/2015 neni 10/c dhe VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 6/b.

Detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit në sektorin e auditit janë të përcaktuara në nenin 130 të rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier”.

Struktura e NJAB, niveli i arsimit, çertifikimi, përvoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten sipas tabelës se mëposhtme:

Nr	Emër mbiemër	Funksioni	Arsimimi	Vite/pune	Vite/auditim	Certifikimi	Trajnime
1	D. I	Auditues	Marketing	10	-	-	-
2	V. D	Auditues	Ek/Agrare	30	-	Nr.1778/2013	-
3	M.Ç	Auditues	Marketing	4	-	Nr.2117/2023	-

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjeve të punonjësve të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se 2 punonjës janë çertifikuar, 1 prej tyre ka qenë kontraktuar dhe është larguar në 24.10.2023.

Konstatim: Për periudhën 2021-2023, nuk është ngritur NJAB dhe nuk ka funksionuar me 3(tre) auditues, sipas strukturës organizative të miratuar nga Bordi Drejtues me vendimin nr. 1, datë 25.03.2021 “Miratimi i strukturës dhe organikës së Spitalit Rajonal “Memorial” Fier”, në kundërshtim me VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 3.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjeve të punonjësve të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se 2 punonjës janë çertifikuar, 1 prej tyre ka qenë kontraktuar për një periudhë 9-mujore, në kundërshtim me ligjin nr.114/2015 neni 10/c dhe VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 6/b.

Detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit në sektorin e auditit janë të përcaktuara në nenin 130 të rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier”. Struktura rezulton e pa plotësuar pasi vetëm 12 muaj është e plotësuar me 2 (dy) punonjës, nga të cilët 1 me kontratë.

Trajnimet e NJAB dhe certifikimet

Referuar, Ligjit Nr.114/2015 “Mbi Auditimin e Brendshëm” dhe “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, rëndësi i është kushtuar trajnimeve të audituesve të NJAB sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

Audituesit e brendshëm duhet të zgjerojnë njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Përgjegjësia për trajnimin nuk është vetëm e Drejtuesit të auditimit të brendshëm ose struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit, por çdo auditues duhet të përditësojë individualisht njohuritë dhe aftësitë e veta mbi zhvillimet e fundit, përmirësimet, standardet e auditimit dhe këshillat praktike mbi teknikat dhe praktikat e reja të auditimit.

Punonjësit e kësaj njësie nuk kanë ndjekur trajnime për kualifikimin profesional, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, “Punësimi i Auditit të Brendshëm”, neni 19 “Certifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20 “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm”.

Konstatim: Punonjësit e kësaj njësie nuk kanë ndjekur trajnime për kualifikimin profesional, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, “Punësimi i Auditit të Brendshëm” neni 19 “Certifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20 “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm”.

Komiteti i Auditit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësive të saj, nuk është krijuar nga Spitali “Memorial” Fier.

Referuar ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 12, pika b, përcakton se Titullari i Njësisë Publike është përgjegjës për vendimmarrjen e krijimit të Komitetit të Auditimit.

Nga auditimi rezulton se nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se: “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

a) duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;

- b) duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;
- c) duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
- ç) duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;
- d) duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna;
- dh) duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.

2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.

3. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

Konstatim: Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 të ligjit 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

Karta e Auditimit është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, e cila përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

NJAB në mbështetje të Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” nuk ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” në Spitalin “Memorial” Fier.

Konstatim: Karta e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, nuk është hartuar në kundërshtim me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve.

Në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3, kapitulli, III miratuar me Urdhërin e Ministrit të MFE Nr.100, datë 25.10.2016.

Plani strategjik është një dokument që përgatitet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publike edhe përfaqëson veprimtarinë audituese për një periudhë 3 vjeçare. Plani vjetor i auditimit hartohet vetëm pasi të jetë përfunduar plani strategjik i Auditimit të Brendshëm.

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar plani strategjik për vitet 2023-2025. Plani strategjik për vitet 2023-2025 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2023 janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr.16986/9, datë 07.10.2022.

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar plani strategjik për vitet 2024-2026. Plani strategjik për vitet 2024-2026 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2024 janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr.1307, datë 18.10.2023.

Për vitet 2021-2022, nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk janë hartuar e miratuar plane strategjik dhe as plane vjetore auditimi, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

Konstatim: Për vitet 2021-2022, nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk janë hartuar e miratuar plane strategjik dhe as plane vjetore auditimi, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2023

Për vitin 2023, bazuar në planin strategjik dhe vjetor 2023-2025, me nr.1450, datë 06.10.2022, janë planifikuar për t'u kryer 4 auditime dhe janë realizuar 3 prej tyre, pasqyruar si më poshtë:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				Tjera
				Përputh	Financë	Kombinuar	Performancë	
	Viti 2023	4	3	1	1			1

Burimi: NJAB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nr	Planifikuar	Nr	Audituar
1	Auditim i burimeve financiare	1	Auditim i burimeve financiare
2	Auditim i sekt. të burimeve njerëzore	2	Auditim i sekt. të burimeve njerëz
3	Auditim i sektorit farmaci	3	Auditimi sektorëve mbështetës
4	Auditimi sektorëve mbështetës		-
		3	

-Për vitin 2023, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete të cilat vlerësohen me risk të lartë, si Drejtoria juridike dhe prokurimeve, Shërbimi i Farmacisë, etj.

Konstatim: konstatohet se për vitin 2023 nuk është realizuar plani i auditimeve pasi nga 4 auditime janë kryer 3 auditime si edhe nuk janë mbuluar me auditim aktivitete të cilat vlerësohen me risk të lartë, si Drejtoria Juridike dhe prokurimeve, Shërbimi i Farmacisë, etj.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2023, rezulton se janë dhënë 7 rekomandime gjithsej, të cilat janë pranuar nga subjektet objekt auditimi. Nga rekomandimet e pranuar janë zbatuar 7, në mënyrë të përmblëdhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				Sipas Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime (shpërbllim dëmi)			
		Gjithsej	Pranuar	Zbatuar	Në proces	Gjithsej	Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar
1	2023	7	7	7					
TOTAL		7	7	7					

Burimi: NJAB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar shkresës dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr.176/1 prot., datë 14.02.2024, “Mbi veprimtarinë e Auditimit të brendshëm” konstatohet se formulari nr.5, plotësuar mbi zbatimin e rekomandimeve ku për rekomandimet e propozuara dhe zbatimin e tyre konfirmohet se janë me status “të zbatuara”, pasi nga njësia e auditit të brendshëm nuk janë kryer auditime për zbatimin e rekomandimeve si edhe nga auditimi i KLSH konstatohet se ato nuk rezultojnë të zbatuara, po kështu ankesi 3 “pyetësori i vetëvlerësimit për njësitë e Auditit të brendshëm” është plotësuar formalisht pasi ka devijime nga kërkesat e legjislacionit dhe manuali i auditit të brendshëm.

Konstatim: Për aktivitetin e vitit 2023, është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr.176/1 prot., datë 14.02.2024, formulari nr.5, plotësuar mbi zbatimin e rekomandimeve ku për rekomandimet e propozuara dhe zbatimin e tyre konfirmohet se janë me status “të zbatuara”, pasi nga njësia e auditit të brendshëm nuk janë kryer auditime për zbatimin e rekomandimeve si edhe nga auditimi i KLSH konstatohet se ato nuk rezultojnë të zbatuara, po kështu ankesi 3 “pyetësori i vetëvlerësimit për njësitë e Auditit të brendshëm” është plotësuar formalisht, pasi ka devijime nga kërkesat e legjislacionit dhe manuali i auditit të brendshëm.

Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB

Njësia e Auditit të Brendshëm (NJAB) për periudhën 2021-2023 ka kryer 3 auditime si më poshtë:

- Auditimi sektorëve mbështetës, referuar programit të angazhimit nr.295/1, datë 20.02.2023

Objekti i auditimit është Verifikimi dhe vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në sektorin e shërbimeve. **Periudha e auditimit** 01.01.2022-31.01.2022, **Auditues (M.Ç dhe V. D)** në fakt është audituar periudha 01.09.2022-31.01.2023.

Nga auditimi i kryer janë lënë 5 rekomandime (*masa organizative*), si më poshtë:

1. *Sektori i financës të regjistrojë në llogaritë e duhura veprimet e magazinës.*

2. *Fletëudhëtimet të firmosen nga personi përgjegjës.*

3. *Sektori i Financës/Sektori Teknik të kontrollojë normativën e harxhimit të karburantit. Sektori Teknik të marrë masa për plotësimin me të dhëna të sakta të librave të shfrytëzimit të automjeteve dhe pajisjeve që konsumojnë lëndë djegëse.*

4. *Fletëudhëtimet të firmosen nga personi përgjegjës. Sektori Teknik në bashkëpunim me shoferët të bëjnë plotësimin e dokumentacionit përkatës justifikues të lëvizjes së autoambulancave apo automjeteve në përputhje me rregulloren teknike dhe bazën ligjore në fuqi.*

5. *Drejtoria e finances të hapë kartela personale për dhënien e aktiveve në përdorim punonjësve sipas përcaktimeve në udhëzimin nr.30, date 27.12.2011 “për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, i ndryshuar.*

- Auditim i burimeve financiare, referuar programit të angazhimit nr.749, datë 01.06.2023.

Objekti i auditimit është Verifikimi dhe vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në sektorin e financës (veprimet nëpërmjet arkës dhe të ardhurat dytësore). **Periudha e auditimit** 01.09.2022-31.12. 2022 **Auditues (V.D dhe M.Ç)**

Nga auditimi i kryer janë lënë 1 rekomandim (*masa organizative*), si më poshtë:

1. *Blerjet të bëhen në bazë të kërkesës të paraqitur nga përgjegjësi i sektorit përkatës, pagesat të kenë bashkëlidhur dokumentet justifikues. Pagesat për të tretët të bëhen nëpërmjet bankës.*

- Auditim i sektorit të burimeve njerëzore, referuar programit të angazhimit nr.1020, datë 01.08.2023.

Nga auditimi i kryer është lënë 1 rekomandim (*masa organizative*), si më poshtë:

1. *Të plotësohen të gjitha rubrikat e regjistrit themeltar të punonjësve, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.*

Objekti i auditimit është Verifikimi dhe vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, **Periudha e auditimit** 01.09.2022-31.07.2023, **Auditues (V. D dhe M.Ç)**

Dokumentacioni i mbajtur nga audituesit në lidhje me gjendjen e depozitave të naftës dhe gazit ka mangësi të theksuara pasi nuk jepet sasia faktike, etj element të nevojshëm për kryerjen e auditimit dhe verifikimin e sasive në vend.

Në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit për:

a- Letrat e punës së auditimit në fazën përgatitore të programit ;

b- Letrat e punës në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit, hartimit të Projekt Raportit Përfundimtar dhe Raportit Përfundimtar Final nga audituesit ;

c- Bazueshmërinë ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standartet e auditimit, rezultoi se nuk janë respektuar me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, neni 12, shkronja “d”, neni 19 dhe neni 20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i dryshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në MAB miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”, Kapitulli II 2.4.1 “Auditimi i përputhshmërisë” dhe 2.4.2 “Auditimi financiar”; Kapitulli III, pika 3.5; Kapitulli IV pika 4.1.1 “planifikimi i një angazhimi auditimi”, pikës 4.1.11 dhe 4.1.12; kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” pika 6.1 “Niveli i dokumentimit”;

- Në të gjitha dosjet e auditimit mungon “*Memo e planifikimit*”, pra projektdrafti i programit të auditimit në fazën përgatitore të hartimit të programit të angazhimit, në të cilën duhet të përfshihet:

- Madhësia dhe kompleksiteti i njësisë, pra të kuptuarit dhe përshkrimi i mjedisit të auditimit, duke plotësuar edhe;

- Kompleksitetin dhe riskun e sistemit/fushës që auditohet, duke plotësuar edhe Formatin e përgjithshëm të riskut;

- Plotësimi i Formatit të vlerësimit të riskut për sistemin/fushën që auditohet, përlllogaritja e koeficientit të riskut për sistemin që auditohet. Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit, duke plotësuar edhe Formatet 4 e 5.

- Përcaktimi i objektivave në bazë të rezultateve të vlerësimit të riskut.

- Eksperiencia dhe numri i audituesve;

- Përgjegjësitë individuale të çdo audituesi;

- Kohëzgjatja (ose afatet kohore);

- Buxheti dhe afati kohor për angazhimin e auditimit;

- Masat për sigurimin e cilësisë;

- Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim “vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm”, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Për pasojë nuk është bërë trajtimi si çështje më vehte vlerësimi dhe analizimi e komponentëve të kontrollit të brendshëm për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të qenë më të qarta rekomandimet për të ardhmen dhe të përfshihej opinionin i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm (referuar dosjeve të shqyrtuara). Opinioni i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të jetë prezent si në përmbledhësen ekzekutive edhe në memorandumun e çdo raporti angazhimi.

- Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirëpërcktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra “në zbatim të akteve ligjore”, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem.

- Mungon dhënia e opinionit mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit dhe cilat sisteme janë vlerësuar me risk.

Konkluzion: Në të gjitha dosjet e auditimit mungojnë: projektdrafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit me të gjitha elementët e tij; Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim “vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim indentifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të dhënë një opinion për funksionimin e kontrolleve në çdo sistem e për të qenë më të qarta rekomandimet; Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirëpërcktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra “në zbatim të akteve ligjore”, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve, të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem.

- Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;

- Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12 e audituara;

- Dosjet e auditimit nuk përmbajnë “Dokumentet e mbledhura përpara fillimit të angazhimit të auditimit” sipas kërkesave të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të MF “Për

miratimin e Manualit të AB në sektorin publik” i ndryshuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” pika 2.

Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm

Për të analizuar mjedisin e kontrollit, në manual jepet formati standard 1 “Pyetësor vlerësimi për mjedisin e kontrollit të brendshëm” në fund të kapitullit III i cili duhet të plotësohet një herë në vit dhe të bëhet si pjesë e procesit të planifikimit fillestar. Pyetësori i vlerësimit të Mjedisit të Kontrollit ka për qëllim të ndihmojë njësinë e auditimit të brendshëm të kuptojë se sa mirë menaxhohet njësia dhe se cilat janë fushat/sistemet më me risk.

Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk është bërë vlerësimi i kontrollit të brendshëm si një nga detyrat themelore të auditimit të brendshëm.

Konstatim: NJAB në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier nuk ka kryer trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në Ligjin “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm, si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Programi i sigurimit të cilësisë, vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka miratuar Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe nuk kryen vlerësimet e brendshme të cilësisë. Pra, rezulton se nuk janë përcaktuar indikatorët e performacës, dhe evidentohet se monitorimi i veprimtarisë së njësive, nuk është hartuar në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Konstatim: Për vitin 2023, nuk është hartuar Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë të njësive së auditimit të brendshëm”, nuk janë përcaktuar mjetet që do të përdoren për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, të cilat duhet të mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim analizimin e nivelit të zbatimit të indikatorëve të performancës, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm Kapitulli VII.

Dosja e përhershme

Audituesit e Brendshëm duhet të njohin mirë njësinë publike, veprimtaritë operationale dhe sistemin financiar me qëllim që të sigurojnë se puna e tyre do të jetë e përshtatshme për organizatën vlerësimin e sistemeve, proceseve të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përditshme të njësive që auditohet. Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.

Grupi auditimit kërkoj të auditojë 2 dosje të përhershme por NJAB nuk ka dosje të përhershme.

Konstatim: NJAB nuk ka përditësuar dosjet e përhershme pas plotësimit të çdo angazhim auditimi me qëllim që të sigurohen ndryshimet e ndodhura në përmbajtjen e tyre. Informacioni që ruhet në dosjen e përhershme të auditimit duhet të jetë sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika 6.3 “Dosja e Përhershme”, Formatin Standard nr. 2 “Indeksi i Dosjes së Përhershme”.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion u konstatua se:

-Për periudhën 2021-2023, nuk është ngritur NJAB dhe nuk ka funksionuar me 3(tre) auditues, sipas strukturës organizative të miratuar nga Bordi Drejtues me vendimin nr. 1, datë 25.03.2021 “Miratimi i strukturës dhe organikës së Spitalit Rajonal “Memorial” Fier”, në kundërshtim me

VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisve të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 3.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjeve të punonjësve të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se 2 punonjës janë çertifikuar, 1 prej tyre ka qenë kontraktuar për një periudhë 9-mujore në kundërshtim me ligjin nr.114/2015 neni 10/c dhe VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisve të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 6/b.

Struktura rezulton e pa plotësuar pasi vetëm 12 muaj është e plotësuar me 2 (dy) punonjës, nga të cilët 1 me kontratë.

- Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 të ligjit 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.
- Karta e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, nuk është hartuar, në kundërshtim me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.
- Punonjësit e kësaj njësie nuk kanë ndjekur trajnime për kualifikimin profesional, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, “Punësimi i Auditit të Brendshëm” neni 19 “Certifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20 “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm”.
- Për vitin 2023, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete të cilat vlerësohen me risk të lartë, si Drejtoria juridike dhe prokurimeve, Drejtoria Financës dhe Shërbimeve të përgjithshme, Shërbimi i Farmacisë, etj.
- Në Planin Strategjik, planifikimi i subjekteve të cilat janë parashikuar të auditohen nuk është në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm i cili përcakton se: *Plani strategjik i veprimtarisë së NJAB bazohet në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve. Në vitin e parë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuara me risk më të lartë, në vitin e dytë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuara me risk më të ulët se në vitin e parë dhe në vitin e tretë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuara me risk më të ulët se në vitin e dytë por duhet respektuar frekuenca jo më shumë se 5 vjet.*
- Për vitet 2021-2023, nga Njësia e Auditit të Brendshëm nuk janë hartuar e miratuar plane strategjik dhe as plane vjetore auditimi, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.
- NJAB në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier nuk ka kryer trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një insitucioni bazuar në Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.
- Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar:
- NJAB në periudhën objekt auditimi nuk ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.
- Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirëpërçktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra “në zbatim të akteve ligjore”, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem.
- Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshtkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12;
- Dosjet e auditimit nuk përmbajnë “Dokumentet e mbledhura përpara fillimit të angazhimit të auditimit” sipas kërkesave të MAB të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të MF “Për

miratimin e Manualit të AB në sektorin publik” i ndryshuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” pika 2;

- Për vitin 2023, nuk është hartuar Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë të njësisë së auditimit të brendshëm”, nuk janë përcaktuar mjetet që do të përdoren për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, të cilat duhet të mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim analizimin e nivelit të zbatimit të indikatorëve të performancës, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm Kapitulli VII.

- NJAB nuk ka përditësuar dosjet e përhershme pas plotësimit të çdo angazhim auditimi me qëllim që të sigurohen ndryshimet e ndodhura në përmbajtjen e tyre. Informacioni që ruhet në dosjen e përhershme të auditimit duhet të jetë sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika 6.3 “*Dosja e Përhershme*”, Formatin Standard nr. 2 “*Indeksi i Dosjes së Përhershme*”.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për funksionimin dhe ligjshmërinë e vendimeve të marra nga Bordi Drejtues i SRMF, referuar relacioneve dhe numrit të tematikave për marrjen e vendimeve konstatohet se nuk është respektuar koha e nevojshme për njohjen nga anëtarët e Bordit me temat që do të trajtohen në mbledhje, si edhe vonesa kohore në marrjen e disa vendimeve nga Bordi drejtues, pasi periudha nga krijimi i spitalit deri në marrjen e disa vendimeve është rreth 2 vjet, si:

-Miratimin e tarifës së Shërbimeve të parkimit të automjeteve në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier me vendimin nr.2, datë 21.07.2023.

-Miratimin e tarifave të ekzaminimeve ambulatore dhe kostove të shërbimeve me vendimin nr.5, datë 15.11.2023

-Miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Spitalit me vendimin nr.7, datë 11.10.2022.

-Bordi drejtues nuk ka respektuar nenin 12/b/e dhe d, të Statutit, ku përcaktohen detyrat e Bordit, nga ku konstatohet se nuk ka gjurmë të mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së spitalit, nuk ka vendime për miratimin e bilanceve vjetore si edhe miratim të planit të trajnimeve dhe programit të ekselencës.

-Referuar vendimmarrjeve të Bordit Drejtues konstatohen ndryshime të vazhdueshme të Statutit të SRMF sa i takon përcaktimit të masës së shpërblimit për anëtarët e bordit Drejtues, e cila në vitin 2021 barazohet me pagën e drejtorit të përgjithshëm. Veprime në kundërshtim me VKM nr.656, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave bordeve, komisioneve të përhershme të njësisë të qeverisjes qendrore”, i ndryshuar. Me urdhrin nr.453, datë 25.10.2021, të ministrit të shëndetësisë “Për disa ndryshime në urdhrin nr.182/3, datë 07.05.2021 “Për miratimin e statutit të spitalit “Memorial”, Fier”, është ndryshuar masa e pagesës për anëtarët e bordit, megjithëse Ministri nxjerr urdhra dhe udhëzime, në këtë rast urdhri bie në kundërshtim me VKM nr.656, datë 31.10.2018, i ndryshuar, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave bordeve, komisioneve të përhershme të njësisë të qeverisjes qendrore” dhe VKM nr.687, datë 26.10.2022 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të spitalit rajonal “Memorial”, Fier si aplikues i autonomisë spitalore menaxheriale” neni 13 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 1.1. Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Juridike e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, të marrin masa për hartimin e një statuti të ri me qëllim eliminimin e ndryshimeve, si edhe të analizojnë dhe propozojnë pranë Ministrisë së Shëndetësisë përcaktimin e masës për shpërblimin e anëtarëve të Bordit Drejtues, me qëllim pasqyrimin, koherencën dhe përshtatjen me organizimin dhe funksionimin e aktivitetit të spitalit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se referuar buxhetit të miratuar në SMRF për vitet 2021, 2022 dhe 2023 numri i parashikuar i punonjësve ka qenë 398 punonjës. Sipas statistikave të punës, numri mesatar i punonjësve dhe fondi i pagave i planifikuar nuk janë realizuar. Shërbimet të cilat nuk janë funksionale në këtë spital janë shërbimi i kirurgjisë kardio-vaskulare dhe shërbimi i kirurgjisë torakale. Shërbimi infektiv për vitin 2021, ka funksionuar 179 ditë dhe 53 ditë për vitin 2022. Nga strukturat drejtuese të SRMF nuk është analizuar nevoja për numër punonjësish, ecuria e punësimeve, si dhe shkaqet të cilat kanë sjellë mosrealizim të numrit të planifikuar të punonjësve (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 41-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 2.1. Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i SRMF të analizojnë strukturën, numrin dhe ecurinë e punësimeve, si edhe ti propozojë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ndryshime të cilat do të sillnin për pasojë plotësimin në burime njerëzore dhe funksionimin e shërbimeve të munguara në spital.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit konstatoi se në muajin gusht të vitit 2021 janë rekrutuar 20 sanitare për të cilat janë lidhur kontrata individuale pune me afat të caktuar 3-mujor, dhe me përfundimin e këtij afati është vazhduar me anekse kontratash me shtyrje afati 6-mujor.

Detyra dhe puna e sanitareve është një detyrë e nevojshme e lidhur me funksionimin e spitalit, me higjienën spitalore, pra kjo kategori rezulton se duhet të ishte përfshirë dhe miratuar në strukturë si punonjës të përhershëm. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimin e nenit 140, pika 2 të Ligjit nr. 136, datë 05.12.2015 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 41-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 3.1. Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i SRMF ti drejtohen Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me propozimin e përcaktimit të pozicioneve të punës të sanitareve si pjesë e përhershme të stafit, si edhe të marrin masa lidhur me ndryshimin e kontratave individuale nga të përkohshme në “me afat të pacaktuar”.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit konstaton se për periudhën maj-shtator 2021, rezulton se midis SRMF dhe stafit turk nuk janë lidhur kontrata punësimi. Kontratat me stafin turk janë lidhur në tetor të vitit 2021. Nga grupi i auditimit konstatohet se kontratat e lidhura midis SRMF dhe stafit turk kanë pasur ndryshime në krahasim me kontratat e lidhura midis SRMF dhe stafit shqiptar, pavarësisht se në vendimin e Bordit nr. 5, datë 21.09.2021 është vendosur se kontrata Tip për të dy stafet do të ishte e njëjtë. Me vendimin e Bordit Drejtues nr. 4, datë 15.03.2022 “Miratimi i kontratës Tip për personelin turk”, kontrata Tip e personelit turk ndryshon nga kontrata Tip e personelit shqiptar, duke miratuar kontratën faktike e cila është përdorur për stafin turk nga krijimi i SRMF deri në mars 2022.

Referuar pikës 2 të vendimit të Bordit “Kontrata Individuale e Punës, kontratë tip për personelin shqiptar dhe turk e miratuar me vendimin e Bordit Drejtues nr. 5, datë 21.09.2021 të zbatohet vetën për personelin shqiptar” rezulton se ndryshimet konsistojnë në 6 nene të cilat nuk janë pjesë e kontratave individuale të personelit turk, konkretisht: Neni 4 “Koha e punës”, Neni 5 “Detyrimet e punëmarrësit”, Neni 6 “Detyrimet e përgjithshme të punëdhënësit”, Neni 10 “Mungesa për shkak të sëmundjes”, Neni 11 “Dëmet”, dhe Neni 12 “Masat disiplinore”. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 58, datë 17.03.2021 “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Spitalit Rajonal Memorial në Fier si projekt pilot”, neni 20, Kodin e Punës (*ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015*), neni 3/1, pika 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 41-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 4.1. Bordi Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtorja e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të SRMF të analizojnë ndryshimet e paargumentuara midis kontratave të

palës turke dhe asaj shqiptare, dhe të marrin masa lidhur me azhurnimin e kontratave individuale me palën turke.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Gjatë periudhës maj 2021-dhjetor 2023, SRMF ka punësuar në total 83 mjek turq. Nga grupi i auditimit konstatohet se janë licencuar vetëm 8 mjekë turq (afërsisht 10%) me “Urdhrin e mjekut” duke derdhur detyrimin financiar, prej 300,800 lekë.

Për periudhën Maj 2021-Dhjetor 2023, janë punësuar 250 punonjës turq në profesionin “Infermierë”, të cilët nuk janë licencuar nga urdhri i Infermierit në RSH.

-Bazuar në legjislacionin shqiptar çdo shtetas i huaj i cili ushtron profesionin e mjekut dhe infermierit në Republikën e Shqipërisë duhet të licencohet nga Urdhri i Mjekëve dhe Urdhri i Infermierëve. Mjekët dhe infermierët turq nuk janë të licencuar në shtetin e tyre, pasi në shtetin turk nuk njihet procedura e licencimit të stafit mjekësor. Pjesë e Protokollit të hartuar mes palës shqiptare dhe asaj turke është detyrimi i palës shqiptare të bashkëpunojë me urdhrat përkatës për lëshimin e lejeve të ushtrimit të profesionit për të gjithë profesionistët mjekësor turq.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 58, datë 26.01.2022 “Për miratimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë të Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, gjatë fazës kalimtare”, neni 4. B, pika 5, Ligjin nr. 123/2014 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 5, pika 3 dhe me Ligjin nr. 9718, datë 19.04.2007 “Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë”, neni 5, pika 4 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 41-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 5.1. Drejtori i Përgjithshëm i SRMF, Drejtorja e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe pala turke të marrin masa për të bashkëpunuar me Urdhrin e Mjekut dhe të Infermierit për licencimin e profesionistëve mjekësor turq të punësuar në SRMF.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Spitali Rajonal Memorial Fier i dërgon e publikon njoftimet e vendeve të lira të punës për mjekë dhe infermierë në Drejtorinë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (DQOSHKSH) Vlorë në portalet përkatës “Mjek për Shqipërinë” e “Infermier për Shqipërinë”. Nga auditimi i marrëdhënieve të punës evidentohet se shpallja e vendeve të punës për administratën e spitalit bëhet në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë të Prokurimit Publik dhe në asnjë rast Zyrën e Punësimit Fier. Po ashtu konstatohet mungesë e kriterëve të nevojshme për rekrutimin në pozicionet e lira.

-Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se në përgjithësi nuk ka procedura transparente, dhe nuk ka komision apelimi për të ankimuar vendimin përfundimtar. Këto veprime bien në kundërshtim me pikën 3, kreu 6, të Udhëzimit të Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 481, datë 27.06.2019 “Për procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në Institucionet Shëndetësore Publike në Republikën e Shqipërisë”

-Janë kryer ndalesat për tatimin e të ardhurave personale nga punësimi sipas përcaktimeve në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe janë paguar brenda datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa, me përjashtim të muajit maj 2021 dhe në muajin shkurt 2023, vonesa për të cilat janë gjobitur nga Drejtorja e Tatimeve në vlerën 30,000 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 41-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 6.1. Drejtorja e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në SRMF të vijojë bashkëpunimin me Drejtorinë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (DQOSHKSH) Vlorë për punësimin e mjekëve dhe infermierëve, si dhe me Zyrën e Punësimit Fier, me qëllim punësimin e specialistëve të administratës për rritjen e cilësisë së shërbimit.

Rekomandim 6.2. Drejtorja e Spitalit Rajonal Memorial Fier të marrë masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies së masave disiplinore, si edhe ngritjen e komisionit të apelimit lidhur me dhënien e tyre.

Rekomandim 6.3. Drejtoria e Financës dhe e Shërbimeve të Përgjithshme në SRMF të marrë masa lidhur me deklaratimet përkatëse në sistemin tatimor, në mënyrë që në ardhmen të shmangen gjobat dhe penaltetet e mundshme për shkak të këtyre vonesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Kite Reagentë për Laboratorin Biokimik” për vitin 2023, struktura përgjegjëse për marrjen në dorëzim dhe zbatimin e kontratës nuk ka marrë në dorëzim materialet mjekësore sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST.

Një prej kriterëve kualifikuese është ofrimi në përdorim i aparateve për realizimin e analizave imunologjike dhe dy aparateve biokimike, ku për një pjesë të kiteve të analizave biokimike dhe imunologjike është *kusht* prania e aparaturave për funksionimin e tyre. Nuk ka gjurmë dokumentacioni për marrjen në dorëzim të pajisjeve në përdorim, nga personat përgjegjës për zbatimin e kontratës, duke vepruar në kundërshtim me specifikimeve teknike të DST dhe me pikën 7 neni 107 e VKM nr.285 datë 19.05.2021, i ndryshuar.

-Në procedurën e prokurimit *Marrëveshja kuadër me objekt “Shërbimi i Akomodimit të personelit turk” për vitin 2022*, struktura përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës nuk ka raportuar saktë për mos përmbushjen e të gjitha detyrimeve kontraktuale nga OE fitues.

-Në lidhje me zbatimin e kontratës së shërbimit nr.858/22 prot., datë 01.07.2022 me afat 6 muaj, janë përzgjedhur 2 muaj. Në muajin nëntor 2022 (01.11.2022-30.11.2022), nevoja për të akomoduar ka qenë për 32 persona të personelit turk, ku për çdo natë numri i personelit turk nuk ka qenë i njëjtë. Në procesverbalin e mbajtur nga grupi i zbatimit të kontratës, konfirmohet se pas verifikimit ekipi turk është akomoduar pranë “M.B.H.” dhe për këtë periudhë janë përmbushur të gjitha detyrimet kontraktuale. Raportimi i grupit të zbatimit të kontratës është në mospërputhje me listën e akomodimit për muajin nëntor 2022, e nënshkruar kjo nga nëndrejtori i përgjithshëm (ekonomik) z. I. A. dhe nëndrejtori i përgjithshëm (mjekësor) K.D, ku rezulton se vetëm 10 prej personelit turk janë akomoduar pranë “M.B. H.” ndërkohë 22 persona të tjerë të personelit turk janë akomoduar në “P. H.”, veprim në kundërshtim me kriterin e vendosur në DST ku vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë hotel “M”, pikën 7, neni 100, i VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar dhe nenin 20 të kontratës së shërbimit nr.858/15 prot., datë 01.07.2022 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 61-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve të marrë masa që strukturat përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, të marrin në dorëzim mallrat dhe shërbimet nga Operatorët ekonomikë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe planin e zbatimit të kontratës, me qëllim realizimin e kontratës me cilësi dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve kontraktuale.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Kite Reagente për Laboratorin Biokimik” për vitin 2023, Shërbimi i Farmacisë dhe personat përgjegjës të marrjes në dorëzim nuk kanë përcaktuar datën e prodhimit dhe skadencës së kiteve dhe reagentëve të prokuruar, në kundërshtim me shtojcën 5 të “Specifikimeve Teknike” të DST (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 61-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1 Rekomandimi: Shërbimi i Farmacisë dhe personat përgjegjës të marrjes në dorëzim të “kiteve dhe reagentëve” të marrin masa që mallrat e prokuruar të jenë në përputhje me kriteret e përcaktuara në lidhje me datën e prodhimit dhe të skadencës, duke ofruar siguri në përdorimin për pacientët si edhe nëse materialet mjekësore të prokuruar janë në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit për vitin 2022 “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore”, Loti 5- “Blerje Gazra mjekësor (Oksigjen)”, “Blerje materiale mjekimi për shërbimin e hemodinamikës”, “Shpenzim për Qiramarrje Mjete Transporti” si edhe për vitin 2023 “Qiramarrje automjetesh”, “Shërbimi i akomodimit të personelit turk” dhe “Evadimi i mbetjeve spitalore” nuk janë argumentuar ligjërisht dhe

teknikisht kriteret e veçanta për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021, ndryshuar neni 2 dhe neni 78 pika 2 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 61-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Prokurimeve të marrë masa për argumentimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, duke analizuar arsyet e kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe të dokumentojë procesin e hartimit të kriterëve ekonomikë dhe teknik me procesverbal nga personat përgjegjës.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit, marrëveshje kuadër “Shërbimi i Lavanderisë”, “Evadimi i Mbetjeve Spitalore” dhe “Shërbimi i gatimit, shpërndarjes dhe servirjes së ushqimit për pacientët e hospitalizuar”, grupet e punës nuk kanë argumentuar sasinë e shërbimit të prokuruar, në kundërshtim me nenin 2 pika c e VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

-Për procedurën e “Shërbimit të lavanderisë”, AK nuk ka argumentuar shifrën e frekuencës ditore të larjes së materialit të butë, po ashtu edhe vlerat e nxjerra për larjen e materialit të stafit mjekësor dhe bllokut operator, duke sjell si pasojë një sasi të pargumentuar.

-SMRF për ofrimin e shërbimit të gatimit, shpërndarjes dhe servirjes së ushqimit për pacientët e hospitalizuar, për të gjitha llojet e dietave ushqimore nuk është argumentuar asnjë prej sasive të kërkuara. Për 16 lloje dieta adulte, asnjë prej tyre nuk ka një historik pacientësh, për të cilën janë prokuruar sasi të vitin 2023.

-Sasi për të cilën është prokuruar procedura e trajtimit të mbetjeve është e paargumentuar si nga grupi i cili ka bërë kërkesën edhe nga grupi i punës për llogaritjen e fondit limit. Sasia e prokuruar për procedurën e trajtimit të mbetjeve spitalore për një periudhë 12 muajore ka qenë 22,577 kg në total, për referencë nga grupi i punës është marrë muaji dhjetor si muaji me ngarkesën më të madhe me një total mujor prej 1186 kg, ku për 12 muaj vlera e llogaritur do të ishte 14,232 kg (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 61-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse, të marrin masa për planifikimin dhe argumentimin e saktë të nevojave dhe sasive për prokurimin e “shërbimit të lavanderisë”, “shërbimit të gatimit, shpërndarjes dhe servirjes së ushqimit për pacientët e hospitalizuar” dhe “evadimit të mbetjeve spitalore”, me qëllim plotësimin e nevojave të shërbimeve mjekësore përkatëse dhe arritjen e një prokurimi me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Shërbimi i akomodimit të personelit turk” për vitin 2022, grupi i punës për llogaritjen e fondit limit, gjatë studimit të tregut është bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga operatorët ekonomik në kushte jo të barabarta, konkretisht ofertat e marra janë 5500 lekë me tvsh/person në ditë, 4550 lekë pa tvsh/person në ditë dhe 4500 lekë me tvsh/person në ditë. Struktura përgjegjëse për përllogaritjen e fondit limit ka vepruar në kundërshtim me nenin 76, pika 1/c e VKM nr.285 datë 19.05.2021 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 61-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse për llogaritjen e fondit limit të marrin masa në fazën e studimit të tregut për llogaritjen e fondit limit të sigurojnë oferta ekonomike nga ofertuesit në kushte të barabarta pa përfshirë vlerën e TVSH.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Komisioni i vlerësimit të ofertave në procedurën e prokurimit “Shërbimi i akomodimit të personelit turk” për vitin 2022 ka kualifikuar OE fitues i cili nuk ka përmbushur detyrimin për kriterin teknik profesional të personelit të hotelit dhe kapacitetin mbajtës akomodues sipas numrit të personelit turk, në kundërshtim me kriterin 3.3.2 të DST dhe pika 2 neni 82 VKM nr.285 datë 19.05.2021 i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 61-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandimi: Komisionet e vlerësimit të ofertave të marrin masa të verifikojnë dhe vlerësojnë ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar ofertat të cilat përmbushin të gjitha kërkesat për kualifikim.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Evadimi i mbetjeve spitalore, grupi i punës për zbatimin e kontratës nuk ka informacion mbi realizimin e trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve konform kushteve të kontratës dhe deklaratë magazinimi të OE, në kundërshtim me Rregulloren nr.6 datë 30.11.2007 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”. OE nuk ka përcjellë pranë AK-së konfirmimin e asgjësimit të cilin e shoqëron me shiritat e incineratorit për të vërtetuar realizimin e kontratës, kjo në kundërshtim me pikën 3.3.5 të specifikimeve teknike. Si rezultat është e paqartë ecuria e procesit të hirit të krijuar, nëse ai dorëzohet pranë një subjekti të licencuar për ta trajtuar apo jo (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 61-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandimi: Shërbimet spitalore mjekësore që ndjekin mbetjet të marrin masa që në çdo rast që kryhet dorëzimi i mbetjeve të rrezikshme të plotësojë regjistrat me të gjithë elementët e tyre: origjina e mbetjeve, lloji i materialit, sasia në kg, data e dorëzimit dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm që lidhet me ecurinë e procesit të hirit të krijuar pranë subjekteve të licensuar për trajtimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.Gjetje nga auditimi: Kontrata për Shërbimin e mbetjeve spitalore ka përfunduar në datën 30.04.2024 dhe deri në datën 15.07.2024 nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara nuk janë zhvilluar në kohë procedurat e prokurimit. Në ambientin e asgjësimit të mbetjeve spitalore, u konstatua se dhoma e dedikuar për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve ishte e tej mbushur, sa nuk të linte mundësinë për të hapur derën. Referuar regjistrin të mbetjeve spitalore sasia e administruar që prej përfundimit të marrëveshjes kuadër të vitit 2023 është 6594 kg, nga verifikimi në terren i grumbullimit dhe administrimit të tyre, nuk është kryer ndarja sipas llojit dhe kategorisë përkatëse, veprim në kundërshtim me shtojcën 1 të VKM nr.798/2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”.

-Spitali Rajonal “Memorial” Fier në cilësinë e prodhuesit të mbetjeve spitalore, ka grumbulluar dhe ka magazinuar mbetjet infektive spitalore duke tejkaluar afatin ligjor prej 45 ditë, në kundërshtim me pikën 8.9 Kreu II të VKM nr.798/2010 dhe shkronjës e), pika 5, kreu II, VKM 798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”. Referuar sasisë së grumbulluar të mbetjeve prej 6594 kg është në vlerën **2,070,516** lekë, vlerë e cila duhet të reflektohet e llogaritet për këtë sasi referuar çmimit të OE fitues, veprim i cili është në kushtet e një kontrate me efekt prapaveprues (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 61-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1. Rekomandimi: SMRF të marrë masa për ngritjen e grupit të administrimit të mbetjeve spitalore (GAMS) brenda afateve, me qëllim zbatimin me eficiencë dhe efektivitet të Planit të Administrimit të Mbetjeve, si edhe hartimin dhe zbatimin e një programi për uljen e vëllimit, të sasisë dhe toksicitetit të mbetjeve të rrezikshme, me qëllim uljen e ndikimit në mjedis dhe shëndetin publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Spitali Rajonal “Memorial” Fier për 3 shërbimet kryesore të mbarëvajtjes spitalore dhe në funksion të pacientëve të hospitalizuar për një periudhë 4 muaj, nuk ka ofruar *Shërbimin e lavanderisë, Shërbimin e trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore dhe Shërbimin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit*, për të cilat nuk janë realizuar procedurat e prokurimit.

-*Kontrata për Shërbimin e lavanderisë* ka përfunduar në datën 25.03.2024, ky shërbim nga verifikimi në vend kryhej nga punonjëset e spitalit dhe pajisjet për larjen e materialeve spitalore janë lavatriçe dhe tharëse me kapacitet rreth 6 kg, për të cilat nga dokumentacioni i magazinës, rezulton se 4 copë lavatriçe me vlerë 30,000 mijë lekë/copë janë bërë hyrje me fletë-hyrjen e datës 24.04.2024 nga subjekti person fizik “E. J”, por fletë dalja është nënshkruar vetëm nga

magazinerja dhe jo nga personi që i ka marrë në dorëzim, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pika 38,39 dhe 40. Po kështu nga pamja vizuale lavatriçet janë të konsumuara/përdorura dhe referuar dokumentacionit të procedurës së prokurimit “blerje emergjente” me OE “E. J”, konstatohet se në fushën e veprimtarisë së tij ka “elektroshtëpiake të përdorura”, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, referuar edhe testimin të tregut janë në shitje lavatriçe të reja me vlerë 30.000 lekë, të cilat mund të ishin prokuruar nga komisioni i blerjeve të vogla, me qëllim plotësimin e nevojave emergjente, zbatimin e legjislacionit dhe shmangien e infeksioneve të ndryshme nga përdorimi i një malli të përdorur për larjen e materialeve spitalore.

-Kontrata për Shërbim dhe shpërndarje ushqimi Marrëveshja Kuadër me afat 12 muaj është nënshkruar më datë 22.10.2022 dhe ka përfunduar në datën 12.04.2024 me kapacitet 150 pacientë, deri në datën 02.08.2024, nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara nuk janë zhvilluar në kohë procedurat e prokurimit për këtë shërbim duke lënë pacientët e hospitalizuar pa shërbimin e furnizimit me ushqim (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 61-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 15.1. Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve në bashkëpunim me Operatorin e Blerjeve të Përqendruara të marrë masa për kryerjen brenda afateve kohore të procedurave të prokurimit me qëllim ofrimin pa ndërprerje të shërbimeve kryesore ndaj pacientëve.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: SRMF në vitin 2021, ka përfutuar donacione nga individë dhe subjekte artikuj të ndryshëm, si: mjete kancelarie, medikamente, materiale pastrimi, laptop, pajisje kompjuterike, etj. Këto artikuj nuk janë inventarizuar (magazinuara), kontabilizuar dhe nuk janë pasqyruar në ditarët e magazinës sipas llogarive: llog. 63 “Ndryshimi i gjendjes”, llog. 74 “Të ardhura në natyrë”, llog. 312 “Materiale” llog.327 “Materiale”si dhe llogaritë e klasës 2 (213,214,218). Nga SRMF nuk është ngritur komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit për të përcaktuar çmimet/artikull dhe vlerat, në kundërshtim me pikën 57, 58, 59, 60 të udhëzimit 30, datë 21.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Në llog. 45 “Marrëdhënie midis institucioneve apo njërive ekonomike” nuk pasqyrohet asnjë e dhënë kontabël përsa i takon huamarrjeve nga spitalet e tjera për artikujt (lëndë djegëse LPG/, diesel), medikamente, çadër promovimi, artikuj pastrimi, artikuj kancelarie).

-Konstatohet se nuk janë debituar/kredituar vlerat në llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjeve”, në llogarinë 74 “Të ardhura në natyrë” për vlerën 4,280,381 lekë, për oksigjenin e lëngshëm nga Spitali Rajonal Fier në vlerën 3,489,079 lekë, për ushqimin katering nga Spitali Rajonal Vlorë në shumën 3,048,426 lekë,mbetje spitalore nga Spitali Rajonal Fier në shumën 2,194,320 lekë, kite dhe reagent për analiza laboratorike nga Spitali Rajonal Fier në shumën totale 24,540,950 lekë, Shërbim Lavanderienga Spitali Rajonal Fier në shumën 2,492,220 leke, sete kirurgjikale nga Spitali Rajonal Fierme shumën totale 9,592,002 lekë, ndërsa donacionet në total janë në shumën 49,637,378 lekë. Në asnjë rast nuk është ngritur komisioni i vlerësimit për pajisjet kompjuterike të dhuruara në shkelje të pikës 57 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Regjistrime jo korrekte në ditarin e magazinës duke pasqyruar gjendjen jo reale të inventarëve dhe dhënien jo korrekte të evidencave, regjistrave kontabël.

Në Pasqyrat Financiare të vitit 2021 llogaria 218 “Inventar ekonomik” me vlerën 55,377,721 lekë nuk paraqitet me shumën reale. Nga dokumentacioni vërtetues konstatohet se nuk janë regjistruar në regjistrin e aktiveve disa aktive (pajisje kompjuterike, pajisjeve mjekësore, tavolina për zyrën e angioskanerit, kasaforta për arkën etj) për këto pajisje nuk është ngritur asnjë komision i cilit të bëjë rivlerësimin të aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale për këtë vit buxhetor në kundërshtim me pikën 57, 58, 59, 60 të udhëzimit 30, datë 21.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 51-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 16.1. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme të ngrejë grupin për inventarizimin dhe për vlerësimin e pajisjeve të cilat nuk kanë çmime, të analizojë efektin negativ, të sistemojë kontabilizojë vlerat përkatëse dhe ti pasqyrojë këto ndryshime në regjistrin e aktiveve në ditarët e magazinës, në kartelat e punonjësve për aktivet që janë në përdorim si dhe në Pasqyrat Financiare.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se nuk është bërë mjaftueshëm në lidhje me:

“*Mjedisin e kontrollit*” Nuk është hartuar plan i veprimit për menaxhimin financiar për vitin 2021-2023, për monitorimin dhe arritjen e objektivave.

-Nuk është ngritur Njësia Përgjegjëse për Sinjalizimet, nuk janë hartuar rregullore.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm e për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Për periudhën 2021-2023 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, i cili nuk ka kryer detyrat për vendosjen e rregullave të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.

“*Menaxhimin e Riskut*” Spitali Rajonal Memorial, Fier nuk ka hartuar një strategji të plotë risku, duke e unifikuar atë me regjistrin e riskut, pasi objektivat dhe planet e veprimit nuk janë të plota. Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe nuk është ngritur grupi i punës së riskut. Mungojnë planet e veprimit për menaxhimin e riskut dhe nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtimin.

“*Aktivitetet e Kontrollit*” Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT në sektorë të ndryshëm dhe hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) për ruajtjen e tij në raste të jashtëzakonshme.

“*Informimin dhe komunikimin*” Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8/a, neni 10,16, Kreu III, neni 20,21/2,24/1, me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 95-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 17.1. Strukturat drejtuese të Spitali Rajonal Memorial Fier, të marrin masa për hartimin e një plan veprimi për menaxhimin financiar, hartimin e një strategjie të plotë të riskut dhe të përcaktojë koordinatorin e grupin riskut, si dhe hartimin e një programi strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Të sigurojë raporte periodike mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm shoqëruar me një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit për çdo proces pune, të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e GMS dhe EMP, si edhe të dokumentohet puna e tyre. Të përcaktohen rregulla të monitorimit dhe plan veprimit për ecurinë e sistemit të MFK dhe në bazë të saj të sigurohet informim dhe raportim i menaxherëve për përmbushjen e objektivave.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2021-2023, nuk është ngritur NJAB dhe nuk ka funksionuar me 3(tre) auditues, sipas strukturës organizative. Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjeve të punonjësve të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se 2 punonjës janë certifikuar, 1 prej tyre ka qenë kontraktuar për një periudhë 9-mujore. Punonjësit e kësaj njësie nuk kanë ndjekur trajnime për kualifikimin profesional. Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të. Nga auditimi i 3 dosjeve të auditimit nga NJAB, e SRMF rezultoi se:

- Në Planin Strategjik, planifikimi i subjekteve të cilat janë parashikuar të auditohen nuk është në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm.

-Për vitet 2021-2023, nga Njësia e Auditit të Brendshëm nuk janë hartuar e miratuar plane strategjik dhe as plane vjetore auditimi, pra për këtë periudhë nuk janë kryer auditime.

-Për vitin 2023, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete të cilat vlerësohen me risk të lartë, si Drejtoria juridike dhe prokurimeve, Drejtoria Financës dhe Shërbimeve të përgjithshme, Shërbimi i Farmacisë, etj.

-Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirë përcaktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra “në zbatim të akteve ligjore”, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem.

-Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

-Dosjet e auditimit nuk përmbajnë “Dokumentet e mbledhura përpara fillimit të angazhimit të auditimit”.

- Në raportimin e progresit të rekomandimeve të adresuara në auditimet e kryera, NJAB nëpërmjet raporteve vjetore të dërguara zyrtarisht në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm është dhënë statusi i rekomandimeve, pasi në dosjet e shqyrtuara dhe raportet e auditimeve nuk janë kryer auditime të zbatimit të rekomandimeve.

- Për vitin 2023, nuk është hartuar Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë të njësisë së auditimit të brendshëm.

- NJAB nuk ka përditësuar dosjet e përhershme pas plotësimit të çdo angazhim auditimi me qëllim që të sigurohen ndryshimet e ndodhura në përmbajtjen e tyre.

-Në të gjitha dosjet e auditimit mungon projektdrafti i programit të auditimit në fazën përgatitore të hartimit të programit të angazhimit me Formatet e miratuara dhe testet përkatëse; Programet e angazhimit në të gjitha rubrikat nuk janë hartuar sipas Formatit 8 të miratuar; Raportet për vitin 2023 nuk janë në përputhje me formatin e raportimit; nuk dokumentohet procesi i ndarjes së detyrave, sipas drejtimeve të auditimit për secilin anëtar të grupit të punës. Në angazhimet e shërbimit të kryera për vitin 2023 nuk janë realizuar auditimet në sistemin e prokurimeve, në sistemin administrimin dhe menaxhimin e aseteve, në sistemin e pagesave, transaksioneve financiare dhe raportimit të pasqyrave financiare etj; Mungon Programi për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të NJAB i miratuar nga titullari dhe procedura e vlerësimit të brendshëm të cilësisë për çdo program angazhimi nuk kryhej.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 3, 5, 6/b, ku citohet se “Në Njësitë publike, të cilat kanë varësi nga 2 ose më shumë institucione dhe nuk kanë krijuar NJAB, shërbimi i auditit të brendshëm të kryhet nga institucioni në fushën e përgjegjësisë shtetërore të të cilit bën pjesë njësi publike”, Ligjin nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” nenet 11,13,19,20, Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, Kapitulli VII, VI, pika 6.3 “Dosja e Përhershme”, Formatin Standard nr. 2 “Indeksi i Dosjes së Përhershme” Manualin e Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12; Urdhërin nr. 4, datë 10.01.2020 kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” pika 2 (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 95-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, të marrin masa për plotësimin e strukturës së Sektorit të auditimit me rekrutime cilësore dhe të kujdesen për certifikimin dhe trajnimin e tyre, ose të vlerësojnë ndryshim në strukturë për suprimim të NJAB, referuar legjislacionit në fuqi pasi Spitali Rajonal “Memorial” Fier, ka varësi dyfishe nga FDSKSH dhe Ministria e Shëndetësisë.

18.2. Rekomandimi: Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB dhe të ngrihet Komiteti i Auditimit. Të hartohen saktë dhe në mënyrë të plotë planet strategjike, raportimet e veprimtarisë, programet e angazhimeve, raportet e auditimit në të gjitha rubrikat e tyre, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dhënien e opinionit për to, si edhe formulimin e saktë, të adresuar e të plotë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Në fund të auditimit të hartohen memot informuese për titullarin me konkluzionet dhe sistemet e vlerësuara me risk.

18.3.Rekomandimi: Të programohet dhe të realizohet auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e KLSH dhe NJAB, si edhe të kryhen angazhime auditimi në fushat të vlerësuara me risk. NJAB të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të monitorimit dhe të vetëvlerësimit periodik.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Në hartimin e Pasqyrave të PBA (2024-2026) dhe relacionin sqarues për planifikimin e shpenzimeve dhe të ardhurave, nuk janë paraqitur kërkesat reale buxhetore sipas Drejtorive/departamenteve/pavioneve. Në evidencën e shpenzimeve dhe të ardhurave plan buxheti nuk është detajuar në nivel 7 shifror.

Në zbatimin e buxhetit janë konstatuar tejkalime shpenzimesh në kundërshtim me nenin 2, 49, 52, 54 të Ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të kontratës me FSDKSH, neni 10 “Financimi”.

-Janë kryer shpenzime për investime me fonde buxhetore dhe nga të ardhurat e krijuara pa miratim nga Bordi Drejtues. Grupi i auditimit konstatoi se me financimin e FSDKSH janë blerë pajisje kompjuterike dhe mjekësore, në kundërshtim me nenin 10 dhe 2 të kontratës vjetore me FSDKSH.

-Evidencat e shpenzimeve dhe të ardhurave nuk rakordojnë me shpenzimet e konstatuara në ditarin e bankës dhe arkës.

-Janë lidhur kontrata pa pasur fonde në dispozicion, në kundërshtim me nenin 10 dhe 12 të kontratës vjetore me FSDKSH (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 95-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1. Rekomandimi: Grupi i Menaxhimit Strategjik i SRMF të marrë masa që strukturat që do të merren me programimin e Planifikimit buxhetor afatmesëm, të kryejnë analiza të hollësishme të treguesve të buxhetit, me qëllim eliminimin e ndryshimeve të konsiderueshme të buxhetit gjatë vitit ushtrimor.

19.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Shërbimeve të Përgjithshme të marrë në konsideratë kërkesat reale buxhetore sipas Drejtorive/departamentet/pavijoneve për hartimin e treguesve buxhetor afatmesëm PBA. Për të gjitha ndryshimet e konstatuara të njoftohet Bordi Drejtues dhe të merret miratimi i tij. Të bëhet kontabilizimi i transaksioneve të kryera me bankë.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.Gjetje nga auditimi: Në Pasqyrat Financiare janë konstatuar mangësi në regjistrimin e të dhënave kontabile për llogaritë e të ardhurave, të shpenzimeve për paga dhe shpërblime, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, në kontabilitet nuk përputhen me të dhënat sipas dokumenteve vërtetues, ku të ardhurat e krijuara nuk janë regjistruar mbi bazën e metodës së detyrimeve dhe të drejtave të konstatuara.

-Në llogarinë 7111 “Të ardhura sekondare pagesa shërbimesh” diferenca në shumën 2,710,510 lekë. Dhe në kundërparti në llog. 468 “Llogari të arkëtueshme” në vlerën 2,710,510 lekë

Në llogarinë 600 “Paga dhe shpërblime” për vitin 2023 janë konstatuar diferenca në shumën 2,625,875lekë. Diferencat janë konstatuar edhe në vitet 2021 dhe 2022.

-Në llogarinë 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore” (punëdhënës) për vitin 2023 janë konstatuar diferenca në shumën 1,984,184 lekë. Diferencat janë konstatuar edhe në vitet 2021 dhe vitin 2022.

-Në pasqyrën e Pozicionit Financiar (*Pasivi*) viti 2021, 2022, 2023 u konstatuan diferenca në Llog. 421“Detyrime ndaj personelit” konstatohet diferenca për vitin 2023 për vlerën (-280,141) lekë. Diferencat janë konstatuar edhe në vitet 2021 dhe 2022.

-Në llogarinë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” konstatohet për vitin 2023 diferenca 77,493 lekë. Diferencat janë konstatuar edhe në vitet 2021 dhe vitin 2022.

-Në llogarinë 435 “Sigurimet shoqërore” për vitin 2023 nuk konstatohet diferenca por janë konstatuar për vitet 2021 dhe 2022

-Në llogarinë 436 “Sigurimet shëndetësore” për vitin 2023 nuk konstatohet diferenca por janë konstatuar për vitet 2021 dhe vitin 2022

-Në llog.214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" kontabilizuar si AAGJIT me vlerën 117,846 lekë për blerje "Program alpha" dhe e pasqyruar edhe në regjistrin e aktiveve konstatohet se shpenzimi i kryer nuk është investim por është shërbim nga të tretët.

Miratimi i Pasqyrave financiare në asnjë rast nuk i është paraqitur për miratim Bordit Drejtues para dërgimit zyrtarisht në FSDKSH (DRF Fier) dhe në Ministrinë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 12 të Statutit të Bordit, me nenin 8, pika b) të Ligjit Nr.10296, datë 8.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar të pikës 2 dhe pikës 5 f) të UMF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", në kundërshtim me pikën 26, 35, 60 dhe 93 të udhëzimit 30, datë 21.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 51-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 20.1. Drejtoria e Financës dhe e Shërbimeve të Përgjithshme të analizojë vlerat me diferencë, të kryej sistemimet në llogaritë kontabile, të nxjerrë përgjegjësitë lidhur me pasaktësitë e krijuara dhe të pasqyrohen ndryshimet në Pasqyrat Financiare të vitit 2024.

Deri në 28.02.2025

21. Gjetje nga auditimi: Në ditarin e magazinës u konstatuan mungesa në regjistrimet kontabile për grandet, të ardhurat nga donatorë të ndryshëm dhe regjistrime jo korrekte duke pasqyruar gjendjen jo reale të inventarëve. Për hyrjet në magazinës (pa pagesë) në asnjë rast, nuk janë dërguar akt konfirmimet për marrjen e mallrave/shërbimeve/punëve. Për donacionet që janë pa çmime nuk janë ngritur komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit për përcaktimin e çmimit/njësi të aktiveve dhe materialeve të dhuruara pa dokumentacion vërtetues, në kundërshtim me pikën 57, 58, 59, 60 të udhëzimit 30, datë 21.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Po kështu për donacionet nga individë dhe subjekte, nuk janë inventarizuar, magazinuar, kontabilizuar veprimet ekonomike në ditarët e magazinës sipas llogarive respektive llog. 45 "Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike", në llog. 63 "Ndryshimi i gjendjes", llog. 74 "Të ardhura në natyrë", llog. 312 "Materiale" llog.327 "Materiale" dhe për llogaritë e aktiveve afatgjata të ndara sipas klasës (213,214,218), në kundërshtim me pikën 26, 60 dhe 93 të udhëzimit nr.30, datë 21.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", UMF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 51-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 21.1. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme të ngriejë grupin për inventarizimin dhe vlerësimin e pajisjeve të cilat nuk kanë çmime, të analizojë diferencat, të sistemojë dhe kontabilizojë vlerat përkatëse dhe ti pasqyrojë këto ndryshime në regjistrin e aktiveve në ditarët e magazinës, në kartelat e punonjësve për aktivet që janë në përdorim si edhe në Pasqyrat Financiare.

Deri në 28.02.2025

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për "Blerjet me vlera të vogla" u konstatuan shmangie nga procedurat e prokurimit duke bërë copëzim të fondeve publike, si për "shpenzimet e pastrimit gjeneral të SRMF" me vlerë 1,198,758 lekë, për "shërbimin e dezinfektimit, dezisektimit dhe deratizimit të ambienteve të brendshme të SRMF" me vlerë 1,188,000 lekë, për "blerjet me emergjencë për medikamente" u konstatuan 31 raste të blerjeve me emergjencë likuiduar në vlerën 2,999,520 lekë dhe për vitin 2023 u konstatuan 17 raste të blerjes së medikamenteve me procedurë emergjence në vlerën 1,398,451 lekë, të cilat nuk janë pasqyruar në regjistrin e parashikimit dhe realizimit, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 11 "Kufijtë monetar" me nenin 56 "Procedura e prokurimit me vlerë të vogël", VKM 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik", nenin 1, 11 dhe 56 të VKM 285, datë

19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. Përgjegjësia është e nëpunësit zbatues dhe e komisionit të blerjeve me vlerë të vogël (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 18-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 22.1. Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës të marrë masa për parashikimin të gjitha nevojave vjetore sipas shërbimeve spitalore dhe grupimin e tyre sipas natyrës duke përcaktuar llojin e procedurës me qëllim realizimin e procedurave të prokurimeve me ekonomicitet, efektivitet dhe efijence.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë" nenet 98-102, nga Titullari i Njësisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në shumën **3,338,561 lekë**, sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të trajtuara.

1. Gjetje nga auditimi: SRMF i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) lidhur me procedurën e rekrutimit të Përgjegjës të Auditit të Brendshëm, nisur nga fakti që kjo procedurë është mbyllur pa aplikante, me shkresën nr. 1639 prot, datë 01.12.2022 “Kërkesë për asistencë juridike”. Paqartësia lidhet me mundësinë e këtyre 2 specialisteve për të hartuar Kartën e Brendshme të Auditit, Kodin e Etikës të Auditit, Rregulloren e Brendshme për funksionimin e Auditit të Brendshëm, planin vjetor e strategjik, angazhimin në auditim, etj, deri sa të plotësohet pozicioni i Përgjegjës të Auditit të Brendshëm.

Në vijim pas sqarimeve me MFE, Drejtori i Përgjithshëm i SRMF me shkresën nr. 130 prot, datë 20.01.2023 “Caktimin e ekspertit të jashtëm të përkohshëm për Sektorin e Auditit” ka emëruar znj. Valentina Doko (eksperte e jashtme) në pozicionin Përgjegjëse e Sektorit të Auditit të Brendshëm pranë SRMF.

Mes palëve është lidhur kontrata e shërbimit e përkohshme nr. 130/1 prot, datë 23.01.2023 me datë fillimi 23.01.2023 dhe datë përfundimi 23.04.2023, afati i së cilës është shtyrë deri në datën 24.10.2023 me aneksin e kësaj kontrate nr. 130/2 prot, datë 24.04.2023. Me shkresën nr. 130/3 prot, datë 11.10.2023 është caktuar përfundimi i punësimit të ekspertit të jashtëm në këtë pozicion data 24.10.2023, sipas përcaktimeve në aneksin e kontratës.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM Nr.353, datë 11.05.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, pika 5 dhe pika 6.b.

Nga grupi i auditimit konstatohet se nuk janë përmbushur kërkesat e sipër përmendura për të cilat ekspertja është punësuar dhe rezulton angazhimi në vetëm tre auditime. Po ashtu konstatohet se Përgjegjësja e Auditit të Brendshëm, në periudhën në të cilën është kontraktuar në këtë detyrë ka qenë njëkohësisht e punësuar me kohë të plotë në Degën e Thesarit Fier, fakt të cilin nuk e ka deklaruar në lidhjen e marrëdhënies së punësimit.

Veprime këto në kundërshtim me Kontratën e Shërbimit nr. 130/1 prot, datë 23.01.2023, neni 4, pika 1, pika 2 “, dhe Rregullores të Brendshme, Kreu 3, neni 28, pika 1.

Lidhja e kontratës të shërbimit mes palëve bie në kundërshtim me Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015, i ndryshuar “Për auditin e brendshëm në Sektorin Publik”, kreu IV, neni 10, pika 2/1. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk justifikojnë në asnjë rast pagesën e Përgjegjës së Auditit të Brendshëm, e për pasojë vlera e pagesës **557,003 lekë** konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e SMRF (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 41-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 1.1. Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i SRMF të marrin masa për analizën e dëmit ekonomik **në vlerën 557,003 lekë**, ndjekjen e hapave për nxjerrjen e përgjegjësive dhe ndjekjen e rrugëve ligjore lidhur me dëmshpërblimin e kësaj vlere.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës nr. 276, prot, datë 11.06.2021, nënshkruar nga SRMF me shoqërinë “A&Airport” me objekt “Dhënia me qira e ambientit të spitalit” konstatohet se pagesat janë kryer me vonesë dhe nuk janë llogaritur kamatëvonesat në shumën 80,000 lekë, në kundërshtim me nenin 3.2 dhe 3.3 të kontratës (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 91-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 2.1. Drejtori përgjithshëm, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të marrë masa dhe ndjekjen në rrugë ligjore për arkëtimin nga shoqëria “A&Airport” të kamatëvonesave në vlerën **80,000 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për shpenzimet e karburantit për vitet 2021-2023, u konstatuan mangësi në evidentimin e lëvizjeve të tyre, si në dokumentet autorizues edhe në dokumentet justifikues, nuk janë nënshkruar nga personat përgjegjës dhe drejtuesit e mjeteve fletë udhëtimet, urdhrat e punës, etj. Evidentohen sipas normativave të konsumit dhe distancave/km të përshkruar tejkalime të pa justifikuara në sasinë e karburantit për 10 599 litra si edhe 1700 litra diferencë e konsumit të karburantit për makinat e marra me qira të cilat janë deklaruar si të reja por në fakt janë të përdorura dhe normativa faktike është më e lartë, si rrjedhojë është shkaktuar dëm ekonomik për SRMF në shumën **2,123,085 lekë**, në kundërshtim me nenin 2, 20, të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për kontrollin dhe menaxhimin financiar”, pikat 35, 36, 42, 43, 45, 46 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 18-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 3.1. Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës të analizojë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për dëmin ekonomik të shkaktuar në shumën **2,123,085 lekë**, dhe të ndjekë rrugët ligjore për arkëtimin e kësaj shume nga personat përgjegjës.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për zbatimin e kontratës nr. 13/11 prot., datë 04.05.2021 me objekt “Qiramarrje automjetesh për vitin 2021”, nënshkruar me subjektin “CI” SHPK, konstatohet se automjetet janë marrë në dorëzim më datën 18.06.2021, pagesa është llogaritur nga data e nënshkrimit të saj, ose 47 ditë më parë si pagesë për likuidimin pjesor të kontratës, para marrjes në dorëzim të automjeteve duke shkaktuar një dëm ekonomik në shumën **578,473 lekë**, në kundërshtim me nenin 7 të kontratës, nenin 52, 54 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 18-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 4.1. Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës të analizojë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për dëmin ekonomik të shkaktuar në shumën **578,473 lekë**, dhe të ndjekë rrugët ligjore për arkëtimin e kësaj shume nga personat përgjegjës.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të procedurës prokurimit me objekt: “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore”, rezultoi se, vlera e fondit limit nga 10,689,340 lekë pa TVSH e llogaritur në procedurën e anuluar është prokuruar pas një periudhë rreth 3 muaj në vlerën 13,705,188 lekë pa TVSH, e cila nuk është argumentuar nga grupi i punës për llogaritjen e vlerës së kontratës. Pra vlera **3,015,848 lekë pa**

TVSH ka sjellë efekt financiar negativ për buxhetin e SRMF, veprime në kundërshtim me nenin 34, “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 61-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Titullari i SRMF të caktojë në grupet e punës persona me kualifikimin e duhur sipas llojit të objektit të prokurimit. Vlerat e prokurimit duhet të llogariten sipas nevojave reale që ka SRMF.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Për procedurën e prokurimit “Qiramarrje automjetesh” per vitet 2022-2023, konstatohet se në kërkesën për zhvillimin e procedurës së prokurimit, automjetet e kërkuara kanë qenë një autoveturë 4+1 vende, një autoveturë foristradë (4x4) dhe një autobuz/furgon 17+1 vende për transportin e stafit turk, bazur në vendimin nr.58 datë 26.01.2022 “Për miratimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, gjatë fazës kalimtare”, pika B: “Të drejtat dhe detyrimet e palës shqiptare janë: Të mbulojë shpenzimet e brendshme të pagave, akomodimit dhe transportit të personelit që do të emërohen në këtë projekt nga pala turke”. Nevoja për auto veturën foristradë është e paargumentuar. Duke pasur në vëmendje itinerarin e stafit turk nga aeroporti drejt spitalit dhe nga hoteli drejt spitalit, konstatohet se nuk ka asnjë argumentim ligjor dhe teknik për nevojën e prokurimit të një foristrade. Nevoja e paargumentuar si edhe kryerja e njëjtë e shërbimit nga 2 mjete të ndryshme ka sjellë rritjen e fondit limit si edhe rritjen e shpenzimeve për karburant. Shërbimi i kryer nga foristrada për të 2 vitet krahasuar me auto veturën ka sjellë rritje të shpenzimeve në vlerën **993,978 lekë**, më shumë e cila përbën efekt ekonomik negativ për SRMF (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 61-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Autoriteti kontraktor, të marrë masa për argumentimin e nevojës për auto veturën foristradë për efektin ekonomik të shkaktuar në vlerën **993,978 lekë** si dhe me qëllim eliminimin e shpenzimeve pa efektivitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Shërbimi i Lavanderisë”, grupi punës për llogaritjen e fondit limit është bazuar në kontratat e ngjashme të realizuara nga Autoritete Kontraktore të tjera. Konkretisht AK i është referuar kontratës së shërbimit nr.3983/3 prot., datë 19.08.2015 e QSUT “Nënë Tereza” Tiranë dhe jo kontratës aktuale të shërbimit duke sjellë rritje të fondit limit me një diferencë me vlerën e përlllogaritur prej **315,299 lekë** mbi fondin limit, në kundërshtim me nenin 34, pika 8 e LPP nr.162 datë 23.12.2020 i ndryshuar, si dhe nenin 12, pika 9 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 61-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Autoriteti kontraktor, në këtë rast SRMF në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës duhet ti referohet një ose me shumë alternativave, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut, të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes të sa më shumë operatorëve ekonomikë dhe të sigurojë realizimin e prokurimit me efektivitet, economicitet dhe efijçencë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Me vendimin e Bordit Drejtues nr. 9, datë 29.12.2022 “Për miratimin e mënyrës të përdorimit të të ardhurave dytësore të Spitalit Rajonal ‘Memorial’ Fier” është miratuar shpërblymi i punonjësve shqiptarë të këtij spitali në vlerën 13,306,000 lekë dhe është dërguar për miratim në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Nga grupi i auditimit konstatohet se vendimi i Bordit Drejtues nuk është miratuar nga MSHMS dhe punonjësit e SRMF janë shpërblyer në vlerën **12,838,133 lekë**, vlerë kjo e cila konsiderohet si shpenzim pa economicitet në buxhetin e SRMF, në kundërshtim me pikën 1 të VKM nr. 809, datë 12.12.2022 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 61-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 4.1. Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i SRMF të marrin masa për analizën e shpenzimit pa ekonomikitet të vlerës prej **12,838,133 lekë**, shkaqet të cilat kanë sjellë këtë situatë, organizimin e trajnimeve të punonjësve lidhur me përdorimin e fondit të veçantë, si dhe ndjekjen e hapave për nxjerrjen e përgjegjësive lidhur me këtë shpenzim.

Menjëherë

5.Gjetje nga auditimi: Spitali Rajonal “Memorial” Fier ka kryer pagesë për personelin turk në vlerën 1,000 lekë/dita për shërbim ushqimi, në kundërshtim me pika 3, neni 4, i VKM nr.58, datë 26.01.2022 “Për miratimin, në parim, të protokollit, ndërmjet Këshilli të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, gjatë fazës kalimtare”. Ky trajtim financiar nuk i përket kategorisë së punonjësve të shtetasve të huaj të punësuar në institucione shqiptare në kundërshtim me VKM nr.870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit. Me një total prej **9,310,000 lekë** për periudhën 01.05.2022-31.12.2022 e cila përbën efekt negativ për SRMF (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 61-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 5.1. Bordi Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm të marrë në analizë efektin negativ të shkaktuar në vlerën **9,310,000 lekë**, përfituar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi si dhe të marrë masa për ndërprerjen e këtij shpenzimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për zbatimin e kontratës me objekt “shërbimi i ruajtjes e sigurisë fizike të ambienteve të Spitalit Rajonal Memorial Fier” nënshkruar me “I.G SHA”, konstatohet se pagesa për shërbimin është kryer 21 ditë më parë nga nënshkrimi i kontratës dhe e pashoqëruar me dokumentet vërtetues për kryerjen e shërbimit, duke shkaktuar efekt financiar në vlerën **2,384,190 lekë** me TVSH, në kundërshtim me nenin 52, 54 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 2 i Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 18-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 6.1. Drejtorja Juridike dhe Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve të Përgjithshme, të marrë masa për nënshkrimin e kontratave brenda afateve të përfundimit të kontratave të mëparshme si edhe kryerjen e likuidimeve shoqëruar me dokumentacionin vërtetues dhe justifikues për kryerjen e shërbimeve nga operatorët ekonomik, me qëllim shmangien e pagesave me efekt prapaveprues.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç; ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 37 “Masa disiplinore” dhe Kontratën Kolektive të Punës, neni 19 “Zgjidhja e kontratës së punës” pika 2 “Masat disiplinore” i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “*Vërejtje me paralajmërim*” deri në “*Zbritje në detyrë në një cikël më të ulët për një periudhë deri në një vit*”.

Referuar shkeljeve të konstatuara:

1. Zj. N.M., me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Financës, për arsye se:
-nuk ka hartuar planin për monitorimin dhe arritjen e objektivave për vitet 2021-2023.

-nuk ka hartuar raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm e për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të personelit, nuk ka hartuar një strategji të plotë risku, duke e unifikuar atë me regjistrin e riskut, pasi objektivat dhe planet e veprimit nuk janë të plota. Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT në sektorë të ndryshëm dhe hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) për ruajtjen e tij në raste të jashtëzakonshme.

-për shkeljet e konstatuara në pasqyrim jo korrekt të evidencave, regjistrave kontabël, për gjendjen jo reale të inventarëve, në kundërshtim të nenit 8, të ligjit 10296 date 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, me pikën 57, 58, 59, 60 të udhëzimit 30, datë 21.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, në nenet 10 e 12, të kontratës vjetore me FSDKSH.

-për shkeljet e konstatuara për likuidimet e pagesave të realizuara pa procedurë prokurimi në kundërshtim me nenin 8, të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

2. Zj.K. K, me detyrë Përgjegjës Sektori Financës

-për shkeljet e konstatuara për likuidimet e pagesave të realizuara pa procedurë prokurimi në kundërshtim me nenin 8, të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

-Për shkeljet e konstatuara në copëzimin e fondit në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, për vitet 2021-2022, në kundërshtim me nenin 11, pika 3 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

3. Zj. E. G, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve, për arsye se:

Për efektin financiar negativ të shkaktuar në shumën 9,310,000 lekë, për trajtimin financiar për mbulimin e ushqimit të subjekteve pranë Spitalit Memorial Rajonal Fier, të cilët janë trajtuar sipas parashikimeve ligjore të VKM.870/2011, ku objekt i të cilës janë vetëm punonjësit e qeverisjes së përgjithshme, punonjësit e institucioneve të pavarura, për njësitë e qeverisjes vendore, për punonjësit e gjykatës si dhe njësitë vartëse dhe punonjësve të përfaqësive tona jashtë vendit dhe jo personeli turk.

Për shkeljet e konstatuara në copëzimin e fondit në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, për vitet 2021-2022, në kundërshtim me nenin 11, pika 3 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

4. Z.I. D, me detyrë Kryeinfermier i Përgjithshëm

5. Zj.R. M, me detyrë Specialiste në Sektorin Juridik

6. Zj.I. K, me detyrë Specialiste në Sektorin e Planifikimit

7. Zj.E. G, me detyrë Specialiste në Sektorin e Financës, në cilësinë e anëtarëve të grupit të punës në llogaritjen e fondit limit në procedurën e prokurimit “Shërbimi i lavanderisë për vitin 2022”

8. Z.M. J, me detyrë Laborant

9. Zj.D. Ç, me detyrë Farmaciste

10. Zj.A. K, me detyrë specialiste në Degën e Financës, në cilësinë e anëtarëve të grupit punës për marrjen në dorëzim dhe zbatimin e kontratës për prokurimin e “Kite dhe reagentë për laboratorin bio kimik për vitin 2023”.

11. Zj. M. Ç, me detyrë Përgjegjës i NJAB, në cilësinë e anëtarëve të grupit të punës në llogaritjen e fondit limit në procedurën e prokurimit “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore për vitin 2022” për llogaritjen e fondit duke shkaktuar efekt negativ në shumën 3,015,848 lekë.

-nuk ka kryer detyrën funksionale në NJAB për periudhën 2021-2022.

Për shkeljet e konstatuara në copëzimin e fondit në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, për vitet 2021-2022, në kundërshtim me nenin 11, pika 3 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

12. Z. E. Sh, me detyrë Koordinator i shërbimeve të brendshme

13. Z. D. H, me detyrë shofer, në cilësinë e anëtarëve të grupit të punës në llogaritjen e fondit limit në procedurën e prokurimit “Shpenzim për qiramarrje automjesh për vitin 2022” duke shkaktuar efekt negativ në shumën 396,800 lekë.

14. Zj. M. G, me detyrë Magaziniere

-nuk ka mbajtur dokumentacionin e magazinës për mallrat e prokuruar si lavatriçe, kompjutera, artikuj kancelarie, etj, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 21.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 37,38,39.

15. Z. D. N, me detyrë Specialist në Sektorin e Shërbimeve

-nuk kanë mbajtur dokumentacionin justifikues mbi shpërndarjen dhe harxhimin e karburantit për vitet 2021-2022, duke shkaktuar dëm ekonomik, në shumën **2,123,085 lekë**, si pasojë e mungesës së dokumentacionit autorizues dhe justifikues për lëvizjet e automjeteve, etj, në kundërshtim me nenin 2, nenin 4 (pikat 16,19,20), nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikën 26, 35, 60 dhe 93 të Udhëzimit nr. 30, datë 21.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

16. Zj. P. D, me detyrë specialiste në Sektorin e prokurimeve

Për shkeljet e konstatuara në copëzimin e fondit në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, për vitet 2021-2022, në kundërshtim me nenin 11, pika 3 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.